

# **MARRËDHËNIET E SHQIPËRISË ME JUGOSLLAVINË**

## **1945-1948**

Doktoranti:

**LEDION KRISAFI**

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakultetin e Shkencave Sociale me profil **MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE** për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof. Dr. KSENOFON KRISAFI**

Numri i fjalëve: 67 816

Tiranë, Gusht 2016



## Përmbajtja

<b>1. Hyrja dhe baza teorike</b> .....	7
1.1 Hyrja.....	7
1.2 Struktura e punimit.....	15
1.3 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat.....	17
1.4 Metodologjia.....	19
1.5 Teoria.....	22
1.5.1 Udhëheqja shqiptare dhe sistemi ndërkombëtar.....	24
1.5.2 Interesi kombëtar dhe marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.....	25
<b>2. Nën mbrojtjen e Jugosllavisë (1945-1946)</b> .....	26
2.1 Hapi i parë, shkurt 1945.....	26
2.2 Dyshimet e jugosllavëve ndaj udhëheqjes shqiptare.....	29
2.3 Politika e jashtme e Shqipërisë kalon nga Beogradi.....	39
2.4 Jugosllavia dhe organizimi i ushtrisë shqiptare (1946).....	48
<b>3. Afrimi dhe keqkuptimet e tij</b> .....	54
3.1 Vizita e Enver Hoxhës në Beograd.....	54
3.2 Marrëveshjet.....	56
3.3 Reagimi ndërkombëtar ndaj marrëveshjeve me Jugosllavinë.....	64
3.4 Qëndrimi i udhëheqjes shqiptare dhe roli i sovjetikëve në marrëveshjet me Jugosllavinë.....	67
3.5 Ideja e Federatës Ballkanike.....	73
<b>4. Zhvillim i vërtetë ekonomik apo shtojcë ekonomike e Jugosllavisë?</b> .....	80
4.1 Shkëmbimet e para tregtare dhe marrëveshjet ekonomike (1945-1947).....	80
4.2 Qëndrimi i udhëheqjes shqiptare mbi marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë.....	90
4.3 Pakënaqësitë e palës shqiptare për marrëdhëniet ekonomike.....	94
4.4 Funksionimi i shoqërive të përbashkëta shqiptaro-jugosllave.....	102
4.5 Problemet në marrëdhëniet ekonomike.....	105
4.6 Qëndrimi i jugosllavëve ndaj problemeve ekonomike mes dy vendeve.....	114
4.7 Arritjet e marrëveshjeve ekonomike.....	118
<b>5. Kosova, çështja që nuk ishte</b> .....	121
5.1 Propozimi i Titos për Kosovën (1944).....	121
5.2 Koncepti i jugosllavëve për çështjen e Kosovës.....	123

5.3 Qëndrimi i udhëheqjes shqiptare për çështjen e Kosovës.....	128
5.4 Pse Kosova nuk ishte një çështje në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave?...	130
<b>6. Fundi i vëllazërisë së panatyrshme shqiptaro-jugosllave.....</b>	<b>132</b>
6.1 Vizita e Enver Hoxhës në Moskë.....	132
6.2 Reagimi i jugosllavëve ndaj vizitës së Enver Hoxhës në Moskë.....	138
6.3 Kritikkat e jugosllavëve ndaj udhëheqjes shqiptare.....	142
6.4 Problemet sovjeto-jugosllave dhe ndikimi i tyre në Shqipëri.....	146
6.5 Shtimi i presionit jugosllav ndaj afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik .....	151
6.6 Lëvizja e fundit e Titos për të mbajtur Shqipërinë.....	161
6.7 Në kërkim të fajtorit brenda Partisë Komuniste Shqiptare.....	164
6.8 Përkeqësimi i marrëdhënieve sovjeto-jugosllave dhe Shqipëria.....	170
6.9 Prishja e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë.....	186
<b>7. Konkluzione.....</b>	<b>201</b>
<b>8. Bibliografia.....</b>	<b>207</b>

## **Deklarata e Autorësisë**

Ky është një punim original.

## Abstrakti

Qëllimi i këtij punimi është të japë një përmbledhje të marrëdhënieve diplomatike, ekonomike, kulturore, etj., midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948, por në të njëjtën kohë të rrëzojë disa “mythe” mbi këto marrëdhënie, të tilla si synimi i Enver Hoxhës dhe udhëheqjes shqiptare për ta bërë Shqipërinë pjesë të Jugosllavisë apo nëse ishte Enver Hoxha dhe udhëheqja shqiptare e pas Luftës së Dytë Botërore që i dha Kosovën Jugosllavisë. Në punim argumentohet se asnjë prej dy pohimeve të mësipërme nuk është i saktë dhe se thelbësore në këto marrëdhënie ishte ekonomia. Për këtë arsye në këtë punim i kushtohet shumë rëndësi marrëdhënieve ekonomike mes dy vendeve, pasi autori i punimit mendon se ishin të një rëndësie themelore edhe për të kuptuar ato probleme në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë që në pamje të parë mund të dukeshin sikur kishin të bënin me politikën apo çështje ideologjike. Në punim argumentohet se Jugosllavia nuk ishte zgjedhja e parë e udhëheqjes shqiptare, por ishte Bashkimi Sovjetik. Në këtë punim gjithashtu argumentohet se në një masë të madhe marrëveshjet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishin të ngjashme me ato që Jugosllavia nënshkroi edhe me vende të tjera të lindjes, veçanërisht me Bullgarinë. Në punim argumentohet se pavarësisht masave të parashikuara në marrëveshjet mes dy vendeve, në praktikë shumë pak u realizua. Gjithashtu për çdo marrëveshje të nënshkruar udhëheqja shqiptare ishte e këshilluar me sovjetikët, ashtu siç bënin dhe jugosllavët, që do të thotë se në një masë të madhe kjo marrëdhënie shqiptaro-jugosllave ishte ndërtuar nga sovjetikët. Për realizimin e këtij punimi, në një pjesë të madhe autori është bazuar mbi dokumente në shqip, serbokroatisht dhe rusisht, dokumente të botuara por edhe të nxjerra nga arkivat nga autori. Në një masë më të vogël është shfrytëzuar literatura e deritanishme mbi këtë çështje ose çështjet që prek ky punim.

**Fjalë kyçe:** Shqipëria, Jugosllavia, marrëdhënie, realizmi

## Abstract

The purpose of this work is to present the diplomatic, economical, cultural relations between Albania and Yugoslavia in the years 1945-1948, but at the same time to try to topple several “myths” about these relations, as is the intention of Enver Hoxha

and the Albanian leadership to make Albania part of Yugoslavia and if it was Enver Hoxha and the Albanian leadership after the Second World War that left Kosovo to Yugoslavia. The author argues that neither of these statements is true and that in these relations the economy was essential. For this reason, in this work, the economic relations have taken a great attention because the author thinks that they were essential for understanding those problems that at first sight had to do with politics or ideology. It is argued that Yugoslavia was not Albania's first choice, but it was the Soviet Union. In this work it is also argued that in a great part the treaties between Albania and Yugoslavia were similar to the treaties that Yugoslavia signed with other Eastern European countries, especially with Bulgaria. Also, despite the measures foreseen in the treaties, in practice little was implemented. For every treaty signed between the two countries, the Albanian leadership was consulted with the soviets, as were doing the Yugoslavs, which means that in a great part, these relations were constructed by the Soviet Union. For writing this work, the author has used mostly documents in Albanian, Serbo-Croatian or Russian, published or researched by the author.

**Key words:** Albania, Yugoslavia, relations, realism

## **Kreu I. Hyrja dhe Baza Teorike**

### **1.1 Hyrja**

Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948 janë të mbuluara me një tis mitesh që ka ngritur për to historiografia shqiptare postkomuniste dhe që ky punim do të përpiqet sadopak ta shpërndajë duke treguar një fytyrë tjetër të Enver Hoxhës dhe udhëheqjes shqiptare, njerëz shpeshherë naivë dhe injorantë në lojrat e politikës ndërkombëtare që Stalini nga Moska dhe Tito nga Beogradi luanin me fatin e popujve të Ballkanit dhe Enver Hoxha e udhëheqësit shqiptarë gjendeshin në mesin e dëshirave dhe synimeve për pushtet dhe ndikim mbi botën komuniste të dy udhëheqësve të ardhur nga periferitë e vendeve të tyre për të synuar të formësonin me vullnetin e tyre Evropën Lindore.

Për një kohë të gjatë në historiografinë shqiptare në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të viteve 1945-48 kanë zënë një vend të rëndësishëm dhe pothuajse eklipsues ndaj temave të tjera dy mitet për përfshirjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave dhe çështja e Kosovës, ashtu si dhe marrëdhëniet e ndërlikuara të Partisë Komuniste Shqiptare dhe Partisë Komuniste të Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore dhe ndikimit të kësaj të fundit ndaj të parës duke supozuar se e para ishte veçse një sajese jugosllave dhe që mbeti e nënshtruar ndaj fqinjit verior e perëndimor, marrëdhënie ndërpartish simotra, siç quhen në dokumentet e kohës, që sipas historiografisë shqiptare të pas rënies së komunizmit, u reflektua edhe në marrëdhëniet ndërshtetërore të udhëhequra nga këto dy parti në të dy krahët e kufirit.

Por, e mbuluar nga mitet e Shqipërisë si Republikë e Shtatë e Jugosllavisë dhe çështjessë Kosovës gjendet thelbi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave: ekonomia.

Ekonomia ishte arsyeja pse këto marrëdhënie u krijuan dhe ekonomia ishte arsyeja kryesore e problemeve dhe kritikave të vazhdueshme mes dy palëve që çuan dhe në prishjen e marrëdhënieve në vitin 1948. Ekonomia ishte gur i themelit të sigurimit të pavarësisë së Shqipërisë në këndvështrimin e udhëheqjes shqiptare ndërkohë që ekonomia gjithashtu ishte themeli i nënshtrimit të Shqipërisë në këndvështrimin e udhëheqjes jugosllave.

Pse ishte ekonomia kaq e rëndësishme në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë?

E para, sepse udhëheqësit shqiptarë vazhdimisht pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore i referoheshin gjendjes së vështirë ekonomike në vend dhe nevojës për ndihma nga jashtë. Pra, ekonomia ishte në rendin e ditës.

E dyta, në çështjet ekonomike u dalluan dy pikëpamje të ndryshme mes udhëheqësve shqiptarë dhe atyre jugosllavë, që është dhe thelbi i marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948. Për udhëheqjen shqiptare marrëdhëniet me Jugosllavinë duhet ta ndihmonin Shqipërinë të bëhej ekonomikisht e pavarur dhe vazhdimisht udhëheqësit shqiptarë vënë në dukje faktin që marrëveshjet me Jugosllavinë nuk janë si ato me Italinë në vitet 20-të dhe 30-të, të cilat e nënshtuan Shqipërinë ndaj Italisë. Shqipëria kërkonte nga Jugosllavia atë ndihmë që ta mundësonte Shqipërinë të vazhdonte më tutje e vetme rrugën e zhvillimit ekonomik, pa Jugosllavinë.

Nga ana tjetër, jugosllavët synon të kundërtën e asaj që kërkonte udhëheqja shqiptare. Jugosllavët vazhdimisht refuzuan të jepnin atë ndihmë ekonomike që do t'i mundësonte Shqipërisë të krijonte pavarësi ekonomike, por synonin të përfitonin nga burimet natyrore të Shqipërisë dhe ta nënshtonin ekonomikisht Shqipërinë. Gjatë punimit do të shohim se shumica e materialeve që Shqipëria eksportoi drejt Jugosllavisë ishin lëndë të para si minerale apo naftë.

E treta, ekonomia është shumë e rëndësishme në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë pasi pikërisht në çështjet ekonomike u krijuan problemet më të mëdha, që dhe çuan në fundin e këtyre marrëdhënieve kaq të ngushta. Vazhdimisht në takimet me sovjetikët Enver Hoxha e ka kritikuar Jugosllavinë për mënyrën se si synon t'i ndërtojë marrëdhëniet ekonomike me Shqipërinë dhe nga ana tjetër Bashkimi Sovjetik ishte i gatshëm të ofronte atë që nuk e jepte Jugosllavia: zhvillimin e pavarur ekonomik.

Në të njëjtën kohë, çështjet ekonomike kanë një rëndësi shumë të madhe, pasi ndihma dhe ndikimi ekonomik i Jugosllavisë në Shqipëri në vitet 1945-1948 ishte i



konsiderueshëm, por nga ana tjetër hedhin dritë mbi një aspekt më praktik, më afër nevojave të njerëzve dhe që tregon se marrëdhëniet me Jugosllavinë nuk kishin brenda vetëm politikën apo mosmarrëveshje ideologjike apo edhe çështjen e Kosovës, por mbi të gjitha kishin të bënin me çështje ekonomike shumë bazike.

Për Nako Spirun, marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë kishin të bënin vetëm me ekonominë dhe sipas tij Shqipëria kishte nevojë për ndihmën e Jugosllavisë sepse ishte një vend i vogël dhe i dobët në kufi me një vend të madh dhe të fuqishëm. Shqipëria, sipas tij, kishte nevojë për ndihmë që të zhvillonte industrinë dhe një pjesë të produkteve bazike që i nevojiteshin, t'i prodhonte vetë, domethënë të krijonte një pavarësi ekonomike dhe se këto marrëveshje nuk ishin aspak si ato me Italinë në vitet 20-të dhe 30-të në të cilat përfituan vetëm kompanitë italiane që erdhën në Shqipëri.

Por, marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë, pak u realizuan në praktikë dhe aq sa u realizuan, u bënë keq dhe nuk arritën asnjë prej qëllimeve dhe synimeve që kishin. Përgjegjësinë për këtë dështim secila palë ia hedh palës tjetër. Enver Hoxha ankohet se jugosllavët vetëm janë vonuar dhe kanë zvarritur çështjet që kishin të bënin me krijimin e planit, të buxhetit për vitin 1947, për unifikimin e çmimeve dhe krijimin e një tregu të përbashkët ashtu siç ankohet për një qëndrim përçmues dhe superioriteti nga jugosllavët kundrejt shqiptarëve ndërsa jugosllavët akuzojnë shqiptarët për vonesa dhe për mungesë dëshire për realizimin e marrëveshjeve, diçka që ata shkojnë më tej se një kritikë për ekonominë duke e shndërruar në një qëndrim anti-jugosllav brenda udhëheqjes shqiptare.

Megjithë fjalët e mëdha në marrëveshjet ekonomike dhe përshtypja që ato lanë në mediat dhe kancelaritë e Perëndimit, fakti është që shumë pak prej atyre çka ishin parashikuar në marrëveshje u zbatuan në praktikë dhe ato që u zbatuan, u zbatuan keq dhe detyrimisht ndikimi i tyre nuk ishte shumë i madh.

Megjithatë, ndihma ekonomike e Jugosllavisë siguroi disa materiale bazë ashtu siç hodhi themelet për një zhvillim të mëtejshëm duke realizuar disa vepra të rëndësishme infrastrukturore.

Pse pikërisht Jugosllavia? Pse Shqipëria krijoi marrëdhënie aq të ngushta pikërisht me Jugosllavinë? Marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë ishin marrëdhënie të imponuara dhe jo një zgjedhje e parë e udhëheqjes shqiptare. Ato ishin të imponuara prej qëndrimit që Bashkimi Sovjetik mbajti kundrejt Shqipërisë menjëherë pas fundit të Luftës së Dytë Botërore, në të cilat sovjetikët ofruan gjithë mbështetjen e tyre ndaj Shqipërisë, por ishte një mbështetje që erdhi nëpërmjet Jugosllavisë dhe jo drejtpërdrejt.

Enver Hoxha dëshironte të shkonte në Moskë për të takuar Stalinin menjëherë pas fundit të luftës, fakt ky që vërehet në bisedimet mes Titos dhe Stalinit në Moskë, ku ky i fundit i bën me dije Titos se Enver Hoxha ka shprehur disa herë dëshirën për të shkuar në Moskë, por kanë qenë vetë sovjetikët ata që e kanë ndaluar atë të shkojë. Kjo është bërë pasi për Stalinin, marrëdhëniet me Shqipërinë janë përgjegjësi e Jugosllavisë, prandaj Stalini nuk mund të priste Enver Hoxhën para se të takohej dhe të binte dakord me jugosllavët.

Vazhdimisht theksohet se udhëheqja shqiptare e shihte ndihmën jugosllave si ndihmë sovjetike përmes Jugosllavisë dhe Enver Hoxha vazhdimisht do të mbajë të hapur një kanal komunikimi me sovjetikët që e anashkalonte Jugosllavinë, një kanal komunikimi pikërisht për të kritikuar dhe denoncuar sjelljen e jugosllavëve.

Historiografia shqiptare pas rënies së komunizmit ka ngritur në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të viteve 1945-48 dy mite. Miti i parë është ai i synimit dhe dëshirës së Enver Hoxhës në veçanti dhe të udhëheqjes shqiptare në atë kohë në përgjithësi për ta shndërruar Shqipërinë në republikë të shtatë të Jugosllavisë, që në këtë punim argumentohet se nuk ishte e vërtetë.

Çështja e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë nuk ishte në axhendën e Enver Hoxhës, megjithëse në fund të vitit 1947 edhe Enver Hoxha foli, në terma konfuzë për bashkimin me Jugosllavinë, por kjo ishte më tepër prej presionit të madh jugosllav në atë kohë se sa prej një strategjie të caktuar, por kjo çështje ishte në axhendën e sovjetikëve, si pjesë e një plani për të krijuar një Federatë Ballkanike në të cilën do të bënte pjesë edhe Bullgaria, madje mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë u nënshkruan traktate në të cilat thuhej shprehimisht se Jugosllavia dhe Bullgaria do të krijonin një

shtet të përbashkët mes tyre, por një traktat i këtij lloji mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk u nënshkrua kurrë.

Kjo është një çështje për të cilën është folur shumë në historiografinë shqiptare. Por, marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe marrëveshjet që u nënshkruan duhen parë brenda një konteksti të caktuar të marrëdhënieve të vendeve komuniste pas Luftës së Dytë Botërore. Marrëveshjet që Shqipëria nënshkroi me Jugosllavinë në vitet 1945 dhe 1946 nuk ndryshonin shumë prej marrëveshjeve që Jugosllavia nënshkroi me vendet e tjera të Evropës Lindore: Poloninë, Çekoslllovakinë, Hungarinë etj. Megjithëse marrëveshjet që Shqipëria nënshkroi me Jugosllavinë në vitet 1945-1946, për sytë e mediave dhe diplomacisë Perëndimore ishin një hap i rëndësishëm drejt bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë, fakti është se përtej fjalëve të përgjithshme për një çështje të tillë, nuk kishte asgjë praktike, ashtu siç pati mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë.

Jugosllavia dhe Bullgaria duke filluar nga dhjetori i vitit 1944, nënshkruan disa marrëveshje që jo vetëm parashikonin të njëjtat veprime si ato me Shqipërinë: heqja e doganave, koordinimi i planeve ekonomike, bashkëpunimi i gjithanshëm etj., por shkruan e bardha mbi të zezë se Jugosllavia dhe Bullgaria kishin për qëllim të krijonin një shtet të përbashkët. Diçka e tillë, kaq e drejtpërdrejt dhe me një synim të qartë nuk u parashtrua kurrë në marrëdhëniet me Shqipërinë.

Projekti i një Federate Ballkanike, një ndër temat që do të preket dhe shtjellohet në këtë studim, ishte një projekt shumë më i madh se shndërrimi i Shqipërisë në republikë të shtatë të Jugosllavisë dhe ideja e kësaj Federate Ballkanike që nuk u realizua kurrë nuk lindi as në Shqipëri e as në Jugosllavi.

Siç vërehet prej procesverbaleve të takimeve mes Stalinit dhe Titos në vitet 1946 dhe 1947, ishte udhëheqësi sovjetik që këmbëngulte për krijimin e një Federate Ballkanike dhe jo udhëheqësi jugosllav. Madje, ishte pikërisht Tito ai që shpeshherë përsëriste se asgjë nuk kishte për të dalë prej këtij projekti.

Për arsyen e këmbënguljes së Stalinit për realizimin e këtij projekti mundemi vetëm të spekulojmë pasi askund nuk gjendet një dëshmi që të tregojë arsyen e dëshirës së

Stalinit për shndërrimin e shumicës së Gadishullit Ballkanik në një shtet federal të drejtuar prej komunistëve. Ndoshta kjo këmbëngulje e Stalinit ka të bëjë me kontrollimin më të mirë të Evropës Lindore prej Moskës. Sigurisht është më e thjeshtë të kontrollosh udhëheqësit dy apo tre shteteve se sa të shtatë a tetë të tillë që gjendeshin në Evropën Lindore në atë kohë.

Miti i dytë që historiografia shqiptare ka ngritur për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në këto vite është ai i dhënies apo lëshimit të Kosovës Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë prej Enver Hoxhës në veçanti dhe udhëheqjes shqiptare të asaj kohe në përgjithësi. Ky këndvështrim mitik ndaj marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave pas Luftës së Dytë Botërore ndoshta është ndikuar edhe nga një frymë anti-komunizmi në historiografinë shqiptare pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri.

Ndërsa qëndrimi i jugosllavëve ishte shumë më kompleks dhe i ndikuar edhe prej etnisë së udhëheqësit jugosllav. Për kroatët dhe sllovenët si Tito dhe Kardelji, ideja që Kosova mund të bashkohej me Shqipërinë pas luftës, nuk ishte diçka e pamundur. Vetë Tito në bisedimet me anglezët para fundit të luftës kishte mbajtur qëndrimin që Kosova do të bashkohej me Shqipërinë, një qëndrim që Enver Hoxha e përsërit pas luftës, megjithëse në krahasim me para luftës, është e vështirë për ta vërtetuar pas lufte. Një qëndrim të tillë pak a shumë kishte edhe Edvard Kardelji në bisedat me Stalinin.

Por, çështja e Kosovës dhe mundësia që ajo të bashkohej me Shqipërinë nuk u shtruan asnjëherë brenda Jugosllavisë pas luftës. Kosova në përfundim të luftës ishte pjesë e Republikës së Serbisë, kufinj të cilës ishin të njohur ndërkombëtarisht në momentin kur Serbia u bë pjesë e Jugosllavisë. Qëndrimi i pjesës serbe të Jugosllavisë ishte i qartë në atë se Kosova ishte një çështje që i përkiste Serbisë dhe me kushtetutën e vitit 1946, kjo çështje mori fund për aq kohë sa do të ekzistonte Jugosllavia. Kushtetuta e vitit 1946 përcaktoi kufijtë mes republikave dhe krahinave autonome brenda Jugosllavisë dhe pas Kushtetutës është e kotë të diskutohet më nëse Shqipëria mund ta kërkonte Kosovën apo se Jugosllavia mund t'ia jepte. Pas Kushtetutës së vitit 1946, çështja e Kosovës dhe e pjesëve të tjera të banuara me

shqiptarë në Jugosllavi, është një çështje e mbyllur në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.

A do të ishin prishur marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave pa ndërhyrjen e Stalinit? Me shumë mundësi po, por jo kaq shpejt dhe jo kaq tërësisht sa ç'ndodhi në verën e vitit 1948. Nënshkrimi i marrëveshjeve me Bullgarinë për të krijuar një shtet të përbashkët, marrëveshje që kishin jo plotësisht miratimin e Stalinit pasi vinin në një kohë që ai mendonte se ishte e papërshtatshme pasi kundërshtimi anglo-amerikan për çështje të tilla ishte ende i madh, ashtu siç ishte dhe ndikimi shumë i madh që Jugosllavia kishte krijuar në Shqipëri, shoqëruar me ndërhyrjen e herëpashershme jugosllave në Luftën Civile në Greqi, një ndërhyrje që sipas Stalinit duhej ndaluar, bënë që në sytë e Stalinit Tito të shfaqej si një person që dëshironte një ndikim shumë më të madh se ai që kishte brenda Jugosllavisë.

Por, nga ana tjetër, edhe jugosllavët, të cilët në momentet e para pas përfundimit të luftës, u shfaqën si nxënësit më të dalluar të Stalinit, me kalimin e kohës u përpoqën gjithmonë e më shumë të dilnin nga ndikimi i Stalinit dhe të krijonin një politikë të jashtme të tyre. Në një masë të madhe, kjo sjellje e jugosllavëve vinte prej faktit që ata, ashtu si edhe në Shqipëri, e kishin çliruar vetë vendin e tyre, pa ndërhyrjen e Ushtrisë së Kuqe dhe popullariteti i Titos në vend ishte shumë i madh, në krahasim me atë të udhëheqësve të tjerë komunistë të Evropës Lindore të cilët ishin vënë në krye të vendeve të tyre nga Bashkimi Sovjetik dhe nuk mund të dilnin përtej kornizave të politikës së jashtme sovjetike.

Por, nga ana tjetër edhe pa ndërhyrjen e Stalinit, në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë po krijoheshin dalëngadalë një hendek në këndvështrimin që kishin dy palët mbi zhvillimin e këtyre marrëdhënieve.

Megjithëse prishja e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave ishte e beftë, ajo nuk ishte e papritur, për shkak se problemet, sidomos në marrëdhëniet ekonomike, mes dy vendeve, kishin kohë që ishin shfaqur dhe duket se ishin përkeqësuar pas vizitës së Enver Hoxhës në Moskë dhe shtimit të ndikimit sovjetik në Shqipëri.

Së fundi, pavarësisht traktateve të rëndësishme të nënshkruara mes dy vendeve dhe fjalëve të mëdha për bashkëpunimin vëllazëror dhe zgjidhjen e problemeve në frymën e marksizëm-leninizmit, në praktikë mes dy vendeve u bë pak, ndoshta edhe për shkak të faktit që koha e marrëdhënieve të ngushta ishte e paktë, vetëm tre vjet, në krahasim me marrëdhëniet e mëvonshme me Bashkimin Sovjetik dhe Kinën, por edhe për faktin se zbatimi në praktikë i marrëveshjeve të nënshkruara mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ishte shumë problematik dhe asnjëherë nuk u bë sa duhet. Enver Hoxha kishte mbajtur vazhdimisht një qëndrim të lëkundur kundrejt jugosllavëve, fakt ky i vënë në dukje shpesh herë prej tyre.

Nuk është e vërtetë të thuhet se ishte lëvizja e Stalinit që shpëtoi Shqipërinë nga shndërrimi në pjesë të Jugosllavisë. Në këtë punim tregohet se megjithëse Shqipëria nënshkroi marrëveshje për heqjen e doganave dhe barazimin e monedhës me Jugosllavinë, masa që çonin pothuajse në një treg të përbashkët, në praktikë ato nuk u realizuan dhe nuk duket se kishte ndonjë zell për t'i zbatuar.

Marrëdhënia e ngushtë me Jugosllavinë i shërbeu kryesisht dy qëllimeve: e para, krijoi një farë mburoje dhe garancie për pavarësinë dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë, dhe e dyta, përmirësoi pak gjendjen ekonomike të Shqipërisë në momentet e para pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Përtej këtyre dy aspekteve, në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet 1945-1948, pati shumë fjalë, por shumë pak veprime konkrete.

## 1.2 Struktura e punimit

Në këtë punim kapitulli i parë është hyrja dhe një shtjellim i metodave të përdorura në studim, i teorisë së marrëdhënieve ndërkombëtare brenda së cilës janë vendosur marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit. Pesë kapituj e tjerë janë ata që i përgjigjen pyetjeve kërkimore dhe zhvillohen hipotezat e punimit. Autori ka vendosur që pesë kapitujt të mos i ndajë në nënkapituj për shkak se shkrimi është bërë i tillë që të ketë homogjenitet gjatë gjithë kapitullin dhe ngjarjet lidhen me njëra-tjetrën.

Kapitulli i dytë, që është i pari që zhvillon temën e punimit, merret kryesisht me fillimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, ndikimin e madh që kishin jugosllavët në politikë jashtme të Shqipërisë, dyshimet e jugosllavëve ndaj shqiptarëve dhe çështjen e kufirit greko-shqiptar në këndvështrimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.

Kapitulli i tretë ka të bëjë me zhvillimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, me nënshkrimin e marrëveshjeve mes dy vendeve, duke filluar nga viti 1945, por duke kulmuar me marrëveshjet e vitit 1946. Në kapitull shtjellohet me detaje përmbajtja e marrëveshjeve, diskutimet e palës shqiptare dhe asaj jugosllave për përmbajtjen e marrëveshjeve dhe pasojave të tyre. Gjithashtu shtjellohet çështja e krijimit të një Federate Ballkanike mes Jugosllavisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë, pikëpamjet e aktorëve kryesorë për këtë çështje dhe pse nuk u realizua.

Kapitulli i katërt merret me marrëdhëniet ekonomike, të cilave i është kushtuar një rëndësi e madhe në këtë punim. Në kapitull shtjellohen zbatimi i marrëveshjeve ekonomike, krijimi dhe funksionimi i kompanive të përbashkëta, projektet në infrastrukturë të realizuara, volumi i shkëmbimeve tregtare. Gjithashtu në këtë kapitull shtjellohen problemet që lindën nga çështjet ekonomike dhe përpjekjet për t'i zgjidhur këto probleme.

Kapitulli i pestë merret me çështjen e Kosovës duke argumentuar se Kosova nuk ishte një çështje në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Momenti kur ky argument u sanksionua ishte Kushtetuta e Federatës Jugosllave e vitit 1946, që e vendosi Kosovën

brenda kufinjve të Republikës së Serbisë dhe në këtë mënyrë çështja hipotetike e një bashkimi të mundshëm të Kosovës me Shqipërinë u mbyll. Një çështje e tillë, e bashkimit, nuk u shtrua asnjëherë zyrtarisht në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948.

Kapitulli i gjashtë ka të bëjë me prishjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, rrugën në të cilën u arrit deri tek prishja, arsyet e prishjes, roli i Bashkimit Sovjetik në këtë zhvillim, qëndrimi i Enver Hoxhës dhe veprimet e fundit në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.



### 1.3 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Ky punim ka disa pyetje kërkimore:

- A ishte Jugosllavia zgjedhja e parë e udhëheqjes shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore dhe cili ishte roli i Bashkimit Sovjetik në këtë afrim?
- Synonte Enver Hoxha dhe udhëheqja shqiptare ta shndërronte Shqipërinë në Republikë të shtatë të Jugosllavisë?
- Cilat ishin marrëveshjet e nënshkruara mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948?
- Cilat ishin marrëdhëniet ekonomike mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948?
- Cilat ishin arsytet e mosmarrëveshjeve të herëpashershme mes jugosllavëve dhe shqiptarëve?
- Cili ishte vendi i Kosovës në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave?
- Cila ishte arsyeja e prishjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë?

Bazuar në pyetjet e mësipërme kërkimore, ky punim ka disa hipoteza, të cilat autori do të përpiqet t'i vërtetojë nëpërmjet të dhënave dokumentare.

*Hipoteza e parë:* Jugosllavia nuk ishte zgjedhja e parë e udhëheqjes shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore për të krijuar marrëdhënie të ngushta politike dhe ekonomike, por zgjedhje e parë ishte Bashkimi Sovjetik aq sa dhe vetë jugosllavët nuk ishin të bindur për besnikërinë e plotë të udhëheqjes shqiptare.

*Hipoteza e dytë:* As Enver Hoxha dhe as Josip Broz Tito nuk kishin qëllim të krijonin një shtet të përbashkët shqiptaro-jugosllav dhe zyrtarisht nuk u bë asnjë hap në këtë drejtim, përkundër marrëveshjeve bullgaro-jugosllave për të krijuar një shtet të përbashkët të të gjithë sllavëve të jugut.

*Hipoteza e tretë:* Çështja më e rëndësishme e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave ishte ekonomia, pasi udhëheqësit shqiptarë kërkonin të krijonin pavarësi ekonomike të

Shqipërisë, ndërkohë që jugosllavët synonin varësi ekonomike të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë dhe kjo ishte arsyeja kryesore e mosmarrëveshjeve të shpeshta mes shqiptarëve dhe jugosllavëve.

*Hipoteza e katërt:* Kosova nuk ishte asnjëherë zyrtarisht një çështje në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe Kushtetuta e Federatës Jugosllave e vitit 1946 sanksionoi kufinj të brendshëm të Jugosllavisë duke e lënë Kosovën brenda Republikës së Serbisë.

*Hipoteza e pestë:* Prishja e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave ishte rezultat i një kombinimi të problemeve sovjeto-jugosllave dhe mosmarrëveshjeve me sfond çështjet ekonomike mes shqiptarëve dhe jugosllavëve.

## 1.4 Metodologjia

Metodologjia e përdorur në këtë studim është e karakterit cilësor duke u bazuar tek rasti studimor duke u fokusuar tek konteksti i marrëdhënieve ndërkombëtare në një periudhë të caktuar, që në këtë rast janë marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948.

Strategjia e hulumtimit është e kombinuar ndërmjet hulumtimit vlerësues dhe hulumtimit krahasues. I pari përqëndrohet në vlerësimin e periudhës që është marrë në studim, përkatësisht periudha mes viteve 1945-1948 dhe kjo bëhet nëpërmjet identifikimit të treguesve kryesorë, vlerave të tyre dhe ndikimit në analizën e rastit studimor. Gjithashtu vlerëson implikimin e marrëdhënieve në kontekstin e brendshëm dhe ndërkombëtar nëpërmjet analizimit të sjelljes së aktorëve, diskursit të tyre dhe vendimeve. Hulumtimi krahasues ka të bëjë me konstatimin e ngjashmërie dhe ndryshimeve mes dukurive të ndryshme, në rastin konkret për të kuptuar dhe interpretuar sjelljet e dy shteteve, Shqipërisë dhe Jugosllavisë, dhe politikat e tyre në lidhje me marrëdhëniet mes të dy vendeve.

Pjesa më e madhe e studimit është realizuar duke u bazuar tek dokumentet arkivore, të botuara ose jo. Ato të botuarat janë në gjuhët shqipe, serbishte dhe rusishte, ndërsa ato të pabotuarat dhe të kërkuara në arkivat shqiptarë nga autori i punimit janë më së shumti në gjuhën shqipe.

Ato dokumente të pabotuara që janë përdorur i përkasin më së shumti marrëdhënieve ekonomike mes dy vendeve. Ato janë në formën e raporteve financiare të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë ose të drejtorive të ndryshme të kësaj ministrie dhe ministrive të tjera që merreshin me çështje ekonomike. Gjithashtu ka raporte nga drejtori të rretheve për veprimtari të ndryshme ekonomike që kishin lidhje me Jugosllavinë.

Përveç dokumenteve arkivore në lidhje me çështjet ekonomike, autori i punimit ka përdorur dhe dokumenteve të mbledhjeve të Kuvendit Popullor në lidhje me çështje që i përkasin marrëdhënieve me Jugosllavinë, telegrame të Legatës Shqiptare në

Beograd dhe telegrame ndërguar Legatës Shqiptare në Beograd nga Tirana në lidhje me çështje të marrëdhënieve mes dy shteteve.

Dokumente të tjera të kërkuara nga autori në arkivat shqiptare kanë lidhje me marrëveshjet e nënshkruara mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948, marrëveshje që kishin të bënin me çështje të ndryshme bashkëpunimi.

Dokumentet e botuara, veçanërisht ato në gjuhët serbe dhe ruse, na lejojnë të hedhim një vështrim se si i shihnin jugosllavët këto marrëdhënie. Ato kanë të bëjnë me marrëveshjet e nënshkruara mes dy vendeve, raporte të ministrive të financave dhe ekonomisë së Republikës Federale të Jugosllavisë, telegrame të të dërguarit jugosllav në Shqipëri si dhe përmbledhje të bisedave mes ambasadorit sovjetik në Beograd dhe udhëheqjes jugosllave në lidhje me marrëdhëniet me Shqipërinë.

Literatura kritike e përdorur është më e paktë, por po aq e rëndësishme sa dhe dokumentet. Për shembull, pjesë të caktuara të këtij punimi nuk do të kishte qenë e mundur të shkruheshin pa u konsultuar dhe cituar disa prej punimeve të viteve të fundit të botuara në revistat shkencore të Serbisë.

Në fillim kam shqyrtuar librat dhe shkrime akademike për çështjen e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948 për të parë literaturën e deritanishme mbi këtë çështje, ashtu siç kam konsultuar edhe vepra që nuk lidhen drejtpërdrejt me këtë çështje, por që ndihmojnë për ta kuptuar atë. Pastaj kam shqyrtuar dokumentet e botuara në lidhje të drejtpërdrejtë ose jo me këtë çështje dhe pastaj kam filluar kërkimet në arkivat shqiptare për dokumenta të tjera, veçanërisht ato që kanë lidhje me çështjet ekonomike janë plotësisht të nxjerra prej autorit.

Përsa i përket shkrimeve në revista akademike, më së shumti kam shfrytëzuar ato të botuara në Serbi në vitet e fundit për arsye se shfrytëzojnë dokumente të arkivave të ish-Jugosllavisë që më përpara nuk njiheshin dhe që lejojnë të krijohet një ide më e plotë për këtë çështje pasi ato dokumente tregojnë anën jugosllave të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.

Gjithashtu është shfrytëzuar dhe Arkiva e Jugosllavisë në Beograd. Në të janë konsultuar dokumente të arkivit të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Jugosllave, të Presidencës Jugosllave, të Kuvendit Popullor.

Si çdo punim tjetër i këtij lloji, edhe ky punim ka kufizim të caktuara, që vijnë më së shumti prej dokumenteve në dispozicion.

Kufizimi më i madh ka të bëjë me pamundësinë për të patur gjithë dokumentet e nevojshme në dispozicion. Dokumentet në arkivat e ish-Jugosllavisë dhe ish-Bashkimit Sovjetik janë të paarrtshme, kështu që më është dashur të përdor ato dokumente që autorë të këtyre vendeve kanë përdorur në shkrimet e tyre në revista akademike, ose dokumente që janë botuar.

Problemi i dytë ka të bëjë me vetë dokumentet dhe literaturën në dispozicion në dispozicion. Kam përdorur pak libra kujtimesh të protagonistëve, atëherë kur ato kanë qenë të mundura, pasi në raste të tilla, ndodh që shkruarit e kujtimeve të zmadhojnë rolin e tyre në ngjarje. Edhe në ato raste kur janë përdorur kujtimet e ndonjë protagonistit, është treguar kujdes për t'i përdorur sa më pak dhe jo në ato raste që mund të ndikonin në këndvështrimin e përgjithshëm të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.

## 1.5 Teoria

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të viteve 1945-1948 paraqesin disa kontradikta përsa i përket teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo ndodh për shkak se në njërin krah janë dy Parti Komuniste shumë të afërta me njëra tjetrën që drejtojnë dy shtetet respektive dhe në krahun tjetër janë dy shtete që në marrëdhëniet mes tyre në vitet 1945-1948 udhëhiqen më së shumti prej interesave të tyre kombëtare, ndërkohë që ideologjia Marksiste-Leniniste në marrëdhëniet e tyre shërben më tepër si fasadë. Pra, është mendimi Marksist-Leninist në themel të Partive Komuniste respektive përballë një sjelljeje shtetërore që mund të klasifikohet brenda teorisë realiste të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Por, as Karl Marksi dhe as Fridrih Engelsi nuk parashtruan ndonjë teori të qartë dhe të mirëpërcaktuar të marrëdhënieve ndërkombëtare, megjithëse shkruan shumë për marrëdhëniet mes shteteve. Në themel të teorive të Karl Marksit ishte lufta e klasave, jo konflikti mes shteteve. Sipas Marksit, 'ndarja horizontale e botës në shtete është projektim në sipërfaqe e konfliktit themelor mes klasave dhe shërben vetëm për të fshehur konfliktin e vërtetë nën të' (Lynch, A. 1989: 13).

Nga kjo mund të arrihet në përfundimin, që në këndvështrimin e Marksit, mes shteteve kapitaliste nuk ka konflikte që lindin prej interesave të tyre të kundërta, por janë konflikte që linin prej problemeve të brendshme, që janë të natyrës klasore. Në këtë mënyrë, Marksi duket se hedh poshtë teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare që përpiqen t'i shpjegojnë konfliktet mes shteteve jo si rezultat i problemeve të tyre të brendshme, por si projektim i interesave të tyre të jashtme. Ky është një qëndrim reduksionist i Marksit në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare (Lynch, A. 1989: 13).

Udhëheqësi i parë sovjetik, Vladimir Iliç Lenin ecën në gjurmët e Marksit dhe Engelsit kur thotë se lufta dhe konflikti mes shteteve është rezultat i paevitueshëm i luftës së klasave. Në këtë mënyrë, 'konfliktet ndërshtetërore paraqiten si rezultat i projeksioneve të kontradiktave të brendshme të sistemit kapitalist' (Lynch, A. 1989: 14).

Triumfi i revolucionit dhe zëvendësimi i sistemit kapitalist nga ai socialist supozon që dhe konfliktet mes shteteve do të zhduken pasi ato janë reflektim i luftës së klasave brenda shteteve dhe nëse lufta e klasave me sistemin e ri do të zhduket edhe konflikti ndërshtetëror do të zhduket.

Në këtë drejtim shohim të ecin në dukjen e jashtme marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Terminologjia e përdorur nga udhëheqësit e të dy shteteve në ndërtimin e marrëdhënieve në vitet 1945-48 bazohet plotësisht tek ajo marksiste-leniniste. Ajo që kishte ndodhur në të kaluar midis popujve jugosllavë dhe shqiptarëve nuk do të përsëritej më, pikërisht sepse tashmë në pushtet ishin Parti Komuniste. Ajo që kishte ndodhur në të shkuarën shpjegohet nga udhëheqësit shqiptarë dhe jugosllavë si pasojë e politikave imperialiste që Jugosllavia kishte ndërmarrë ndaj një shteti të vogël si Shqipëria. Por, në praktikë marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave nuk mund të shpjegohen nëpërmjet Marksizëm-Leninizmit, sepse siç do të tregohet në këtë punim, në themel të tyre ishte interesi kombëtar dhe këtu nevojitet teoria realiste e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Teoria realiste si e propozuar në librin e Hans Morgentaut *Politika ndërmjet Kombeve* parashtron që ‘shtetarët mendojnë dhe veprojnë në lidhje me interesat e pushtetit’ (Morgenthau, H. 2008: 5).

Morgentau e përcaktoi më tej interesin kombëtar duke e identifikuar me mbijetesën e një njësie politike në identitetin e saj, duke përfshirë integritetin territorial të një shteti, institucionet e saj politike dhe kulturën e saj. (Olson W.C, 1991:37). Në këtë punim do të shohim se qëllimi kryesor i udhëheqjes shqiptare në marrëdhëniet me Jugosllavinë ishte ruajtja e sovranitetit kombëtar dhe zhvillimi ekonomik që do të sillte një lloj pavarësie ekonomike që do të ishte garant i sovranitetit.

Keneth Waltz thotë se çdo shtet duhet të jetë i gatshëm të kundërshtojë forcën me forcë, ose të paguajë koston e dobësisë së vet (Waltz, K. 2001: 160), dhe udhëheqja shqiptare e pas Luftës së Dytë Botërore kërkon me çdo kusht t’i shpëtojë dobësisë që e çoi Shqipërinë e Mbretit Zog tek pushtimi nga Italia.

### **1.5.1 Udhëheqja shqiptare dhe sistemi ndërkombëtar**

Këndvështrimi i sistemit ndërkombëtar të Enver Hoxhës, Nako Spirut dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948 ishte një sintezë e mendimit Marksist-Leninist dhe e përvojës së Shqipërisë në vitet 20-të dhe 30-të në marrëdhëniet me Italinë.

Në këtë studim vazhdimisht do të shihet se udhëheqësit shqiptarë i referohen marrëveshjeve të nënshkruara me Italinë në dy dekadat para Luftës së Dytë Botërore si shembull i asaj që nuk duhet të ndodhë më në marrëdhëniet me një shtet tjetër. Shqipëria në fillim u nënshtrua ekonomisht dhe pastaj dhe politikisht duke përfunduar me një pushtim nga Italia. Fakti që marrëdhëniet me Italinë në ato vite përsëriten vazhdimisht nga Enver Hoxha, Nako Spiru dhe të tjerët, tregon se ato kishin lënë gjurmë në këndvështrimin e tyre për politikën e jashtme.

Ajo përvojë e hidhur e Shqipërisë, në gjuhën e udhëheqësve shqiptarë paraqitet duke shfrytëzuar terminologjinë e mendimit Marksist-Leninist me ‘imperializmin’ dhe ‘shfrytëzimin’ e Italisë kundrejt Shqipërisë. Edhe marrëdhëniet e dikurshme me Jugosllavinë paraqiten në prizmin e imperializmit dhe shfrytëzimit të shteteve fqinje. Marrëdhënia e re me Jugosllavinë paraqitet në termat e Marksizëm-Leninizmit se vendosja e sistemeve socialiste në të dy vendet do të ndryshojë radikalisht marrëdhëniet mes tyre.

Qenia e Partive Komuniste në pushtet në Shqipëri dhe Jugosllavi dhe zhdukja e ekonomisë kapitaliste dhe në këtë mënyrë zhdukja e klasave brenda shteteve respektive, supozohet të krijojë një marrëdhënie krejtësisht ndryshe mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Terminologjia që udhëheqësit e dy vendeve përdorin për të justifikuar dhe shpjeguar ndërtimin e një bashkëpunimi të ngushtë mes tyre është në linjën e Marksizëm-Leninizmit.



### **1.5.2 Interesi kombëtar dhe marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave**

Në këtë punim do të tregohetse pavarësisht Partive Komuniste në qeverisjen e dy shteteve respektive, marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë udhëhiqen nga interesat kombëtare respektive. Për udhëheqjen shqiptare me rëndësi themelore ishte ruajtja e sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Shqipërisë dhe hapi i parë i realizimit të këtij qëllimi ishte krijimi i një ekonomie deri diku të vetëmjaftueshme. Shqiptarët kërkonin nga jugosllavët atë ndihmë që më vonë do e lejonte Shqipërinë të zhvillohej ekonomikisht që të mos kishte më nevojën e ndihmës së jashtme për të mbijetuar. Udhëheqja shqiptare i frikësohej Jugosllavisë pavarësisht se në dy vendet respektive në pushtet ishin Parti Komuniste. Kjo frikë e udhëheqjes shqiptare vinte prej ndikimit që Jugosllavia kishte në Shqipëri. Udhëheqja shqiptare tek marrëdhënia me Jugosllavinë shihte ndikimin e interesave kombëtare të Jugosllavisë në Shqipëri

Nga ana tjetër, për jugosllavët gjithashtu Shqipëria shërbente për interesat e tyre kombëtare. Ata e shihnin marrëdhënien me Shqipërinë si një mundësi për të përfituar lehtësisht burimet minerale shqiptare por edhe për të projektuar një pushtet më të madh në Ballkan.

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave por edhe ato që vetë Bashkimi Sovjetik ndërtoi pas Luftës së Dytë Botërore me vendet komuniste të Evropës Lindore mbulonin me terminologji marksiste-leniniste një sjellje krejtësisht të përqëndruar tek interesi kombëtar. Nje sjellje e tillë ishte krejtësisht e mundshme. Henry Kissinger e cilëson Stalinin si realistin suprem në politikën e jashtme (Kissinger, 1994: 333).

## **Kreu II. Nën mbrojtjen e Jugosllavisë (1945-1946)**

### **2.1 Hapi i parë, shkurt 1945**

Hapi i parë drejt marrëdhënieve ndërshtetërore mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë është hedhur në 20 shkurt të vitit 1945 në Beograd, ku është nënshkruar traktati mbi aleancën dhe ndihmën e ndërsjellë midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Traktati, i nënshkruar nga Josip Broz Tito nga ana e Komitetit Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë dhe Myslim Pezës në emër të qeverisë shqiptare, kishte për qëllim zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve të mira të fqinjësisë dhe miqësisë midis popujve aleatë të Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Në traktat vihen në dukje fakti që këto marrëdhënie u krijuan me një ‘‘përzemërsi të veçantë’’ gjatë luftës kundër pushtuesve nazi-fashistë (AMPJ, Dosja numër 50, Drejtorja IV, Jugosllavia).

Në traktat vihet në dukje e kaluara e përgjashkme e dy popujve, shqiptarëve dhe jugosllavëve, por ‘‘kjo armiqësi mbaroi dhe vëndin e saj e zuri një miqësi e patrone ditur, në një moment kur popujt e jugosllavisë dhe populli i shqipërisë muarrë në duart e veta fatin e tyre dhe të bashkuar filluan luftën për asgjësimin e invadoreve fashistë dhe të bashkëpunëtorëve të tyre tradhëtorë vëndës’’ (AMPJ, Dosja numër 50, Drejtorja IV, Jugosllavia).

Qëllimi i këtij traktati është që Shqipëria të dërgojë në Jugosllavi dy divizione të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, për operacione të përbashkëta me Ushtrinë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë në luftë kundër Gjermanisë. (AMPJ, Dosja numër 50, Drejtorja IV, Jugosllavia).

Artikujt e tretë dhe të katërt të traktatit e fusin Shqipërinë në një aleancë të ngushtë me Jugosllavinë. Në to thuhet se ky traktat i detyron të dyja palët ‘‘të mos hyjnë në aleanca ose blloqe me shtete të tjerë, që janë drejtuar kundra interesave të njëjës nga palët kontraktgjëse’’, si dhe gjithashtu ‘‘të dy palët kontraktgjëse marrin përsipër t’i japin njëra tjetrës çdo ndihmë për ruajtje dhe mbrojtje të independencës, të sovranitetit e të kufive të shtetit kundra një cënimi ose sulmi nga ana e shteteve të tretë’’ (AMPJ, Dosja numër 50, Drejtorja IV, Jugosllavia).

Sigurisht, artikulli katër i shkon përshtat Jugosllavisë, pasi ushtria shqiptare e sapo riorganizuar pas përfundimit të luftës ishte në vështirësi të mëdha, kështu që artikulli katër i lë dorë të lirë Jugosllavisë të ndërhyjë ushtarakisht në Shqipëri nëse Shqipëria sulmohet nga një shtet tjetër.

Ky traktat është nënshkruar disa muaj para se Jugosllavia të njihje zyrtarisht qeverinë e re shqiptare. Kohë më vonë, një prej përfaqësuesve shqiptarë në nënshkrimin e traktatit si dhe në delegacionin shqiptar që vizitoi Beogradin në qershor të vitit 1946, Bedri Spahiu, e përcaktoi kështu qëndrimin e Shqipërisë ndaj Jugosllavisë:

“Populli jonë nuk do ta harrojë kurrë ndihmën që na u dha në gjatë luftës nacionalçlirimtare, nga Marshalli Tito, lideri i madh, dhe ushtria e tij heroike duke sulmuar divizionet armike që kishin ardhur mbi kokat e njerëzve tanë, nuk do ta harrojmë kurrë ndihmën materiale që na u dha pa asnjë kusht në periudhën e parë të çlirimit të vendit tonë, nuk do ta harrojmë kurrë ndihmën politike që na u dha në lidhje me problemet tona ndërkombëtare ashtu si dhe njohjen e shpejtë të qeverisë sonë.

Populli jonë shikon në rolin paqedashës të Jugosllavisë një garant të vendosur të pavarësisë së tij. Për të gjitha këto arsye, emri i Titos jehon nëpër të gjithë Shqipërinë bashkë me emrin e Enverit tonë. Për këtë arsye, populli jonë e mban fotografinë e Titos në krah me fotografinë e birit tonë të madh Enverit” (O’Donnel, J.S 1999: 18).

Në fjalët e Bedri Spahiut theksohet e njëjta gjë që më vonë vë në dukje Nako Spiru e Enver Hoxha: roli i Jugosllavisë si garant dhe mbrojtës i pavarësisë së Shqipërisë.

Pjesa më e madhe e traktatit të janarit të vitit 1945 ka të bëjë me përfundimin e luftës ndaj Gjermanisë, ashtu siç do të jetë edhe në traktatin që Jugosllavia do të nënshkruajë me Bashkimin Sovjetik në mars të vitit 1945, kur artikulli i parë i traktatit flet pikërisht për fundin e luftës në Evropë (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 810).

Megjithatë, po të shohim traktatin e miqësisë dhe bashkëpunimit që Jugosllavia nënshkroi me Poloninë një vit më vonë, në mars të vitit 1946, artikulli katër në

traktatin me Shqipërinë, shfaqet edhe në traktatin me Poloninë, por më i përcaktuar në objektivin e tij.

Artikulli i tretë i traktatit polako-jugosllav thotë se nëse njëra prej palëve nënshkruese për shkak të një sulmi, do të jetë e detyruar të futet në veprime ushtarake kundër Gjermanisë, ose kundër një shteti që ka qenë në luftën e fundit aleat i Gjermanisë, ose me një shtet të tretë që hapur ose në një mënyrë tjetër është përkrahur nga Gjermania ose nga një prej aleatëve të Gjermanisë në këtë sulm, atëherë pala tjetër nënshkruese do të vëjë në dispozicion ushtrinë e saj dhe çdo ndihmë tjetër (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 810).

Traktati polako-jugosllav është më i përcaktuar në drejtimin e rrezikut për paqen dhe drejtimin në të cilin do të shkojë ndihma ushtarake mes dy vendeve, ndoshta për shkak edhe të pozitës gjeografike të Polonisë në kufi me Gjermaninë, por ndoshta edhe për shkak të ndikimit të Bashkimit Sovjetik për të rrethuar Gjermaninë e pas luftës me aleanca ushtarake të vendeve kufitare me të.

Ajo që ka rëndësi të nxjerrim në pah prej traktatit polako-jugosllav është se traktati me Shqipërinë nuk ishte aspak një veçanësi dhe se me shumë mundësi idetë për nënshkrimin e këtyre traktateve nuk vinin nga Beogradi por nga Moska, ashtu siç nga Moska do të vijë edhe ideja e Federatës Ballkanike.

## **2.2 Dyshimet e jugosllavëve ndaj udhëheqjes shqiptare**

Por, megjithëse Jugosllavia kishte filluar rolin e mentores në politikën e jashtme të Shqipërisë qysh prej fundit të Luftës së Dytë Botërore, rol ky i lënë asaj prej Bashkimit Sovjetik, brenda udhëheqjes shqiptare, gjërat nuk duket se ishin kaq të thjeshta dhe diçka e tillë i shqetësonte jugosllavët të cilat nga njëra anë realizon politikën e jashtme të Shqipërisë dhe nga ana tjetër nuk ishin plotësisht të bindur për besnikërinë e plotë të udhëheqjes shqiptare ndaj tyre.

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, udhëheqja e re shqiptare ishte e ndarë në dy kampe për sa i përket rrugës që duhet të ndiqte Shqipëria në marrëdhëniet e saj të jashtme pas luftës. Njëri kamp përfaqësohej prej Enver Hoxhës dhe Koçi Xoxës të cilët preferonin një marrëdhënie sa më të ngushtë me Bashkimin Sovjetik dhe Jugosllavinë, ndërsa kampi tjetër përfaqësohej prej Sejfulla Malëshovës i cili ishte për një politikë të jashtme të lëkundur mes Lindjes dhe Perëndimit (Zivotić, A. 2010: 84).

Kjo shihet dhe në konkluzionet e Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Shqipërisë në 11 dhjetor 1945. Sejfulla Malëshova akuzohet se i ka dhënë Byrosë Politike një tendencë oportuniste për sa i përket marrëdhënieve të jashtme që Shqipëria duhet të ndjekë (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 23-24). Byroja Politike është ndikuar prej Sejfulla Malëshovës ‘tue e konsiderue më të pjekur dhe më të përgatitur’ (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 23-24).

Megjithatë, nga konkluzionet e kësaj mbledhjeje të dhjetorit 1945 shihet se kundërshtime për vijën politike që duhet të ndjekë Shqipëria në politikën e jashtme ka pasur. Konkluzionet e Byrosë thonë se ka qenë pikërisht kjo tendencë oportuniste, e frymëzuar siç u tha më lart prej Sejfulla Malëshovës, që ka bërë që Shqipëria të mos jetë orientuar sa duhet drejt ‘një vëllazërimi të shëndoshë me Jugosllavinë’ e cila sipas Byrosë ‘është një konditë e domosdoshme për ekzistencën e një Shqipërie demokratike popullore’ (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 23-24).

Fundi i konkluzioneve të mbledhjes së Byrosë Politike tregon dhe drejtimin e ardhshëm të politikës së jashtme të Shqipërisë, ashtu siç tregon dhe fatin politik e më vonë fizik të Sejfulla Malëshovës. Shqipëria, me firmat e Enver Hoxhës, Nako Spirut,

Koçi Xoxes, Bedri Spahiut, Tuk Jakovës dhe Pandi Kristos ka vendosur të ndjekë rrugën e afrimit me Jugosllavinë dhe jo oportunizmin e Sejfulla Malëshovës.

I vetmi që kundërshtoi dhe nuk ra dakord me konkluzionet e mbledhjes ishte pikërisht Sejfulla Malëshova.

Tendenca ‘‘oportuniste’’ e Sejfulla Malëshovës bëri që në ditët dhe javët e para pas çlirimit, Shqipëria të shikonte me sy të mirë marrëdhëniet me Italinë (Zivotić, A. 2010: 84). Këtë konfirmojnë dhe konkluzionet e mbledhjes së Byrosë Politike të 11 dhjetorit 1945(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 24). ‘‘Qëndrimi ynë karshi Italisë nuk ka qenë si duhet të ish karshi një okupatori që ka detyrime të mëdha karshi nesh’’ thuhet në konkluzionet e Byrosë(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 24).

Kjo tendencë drejt Italisë krijoi reagim dhe kritika nga diplomacia jugosllave, e cila mendonte se Shqipëria nuk duhet të futet në politika spekuluese me vende perëndimore, por të orientohet vendosmërisht drejt Lindjes, Jugosllavisë, Ballkanit dhe Bashkimit Sovjetik(Zivotić, A. 2010: 85). Jugosllavia kishte investuar politikisht brenda Shqipërisë duke ndihmuar në krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, kështu që një afrim i Shqipërisë me Perëndimin nuk ishte aspak i mirëpritur.

Por, duket se kjo tendencë lëvizjeje mes Lindjes dhe Perëndimit nuk ekzistonte vetëm tek Sejfulla Malëshova dhe ata të cilët ishin ndikuar prej tij. Vetë në konkluzionet e mbledhjes së Byrosë Politike të 11 dhjetorit 1945 thuhet se ‘‘qëndrimi ynë karshi anglo-amerikanëve ka qenë oportunist. Ne ushqyem në vendin tonë opinionin se çështja e njohjes së qeverisë nga ana e anglo-amerikanëve ishte një konditë *sine qua non* për regjimin popullor në Shqipëri’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 23). Pra, për qeverinë e re shqiptare çështja e njohjes prej fuqive perëndimore ishte paraqitur si diçka e domosdoshme, pa të cilën qeveria e re dhe pushteti i saj nuk mund të ekzistonin.

Lëkundja në politikën e jashtme, në sytë e jugosllavëve, kishte filluar qysh në Kongresin e Beratit, në fund të vitit 1944. Koçi Xoxe kishte kritikuar Enver Hoxhën, Ymer Dishnicën dhe Sejfulla Malëshovën si shumë intelektualë dhe kundër klasës proletare dhe se Enver Hoxha, sipas tij, kishte një qëndrim pajtues ndaj Ballit

Kombëtar. Në majin e vitit 1944, me këmbënguljen e Dushan Mugoshës, Ymer Dishnica u përjashtua nga Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste të Shqipërisë, por më vonë Enver Hoxha e bëri atë Ministër të Shëndetësisë(Griffith, W. E, 1963: 18) megjithëse ai ishte i padëshiruar nga jugosllavët.

Menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, sipas jugosllavëve dhe Koçi Xoxes, Enver Hoxha vazhdoi me mëkatet e tij. Supozohet se nën ndikimin e Malëshovës, Enver Hoxha lavdëroi De Golin dhe Francën, rifilloi marrëdhëniet diplomatike me Italinë, duke lejuar disa shqiptarë të studionin aty dhe italianët në Shqipëri të riatdhesheshin dhe në përgjithësi morri një qëndrim pro-italian(Griffith, W. E, 1963: 18). Kjo është diçka e mundshme dhe në linjë me traditën historike shqiptare që Hoxha po përpiqej të zvogëlonte varësinë prej Beogradit.

Çështjes së Sejfulla Malëshovës dhe ndikimit të tij në Partinë Komuniste Shqiptare, në vitin 1947 i kushton rëndësi edhe një njoftim i Sektorit të Politikës së Jashtme të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Sovjetike (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 38). Aty thuhet se ‘‘në përbërje të Byrosë Politike të Komitetit Qëndror, ka depërtuar një trockist i betuar dhe ideolog i restaurimit të kapitalizmit në Shqipëri, profesor Sejfulla Malëshova’’ (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 38).

Më tej thuhet se ‘‘duke shfrytëzuar mungesën e parimeve, nivelin e pamjaftueshëm ideologjik të drejtuesve të Komitetit Qëndror dhe mungesën e tyre për një politikë të fortë në çështjet e ndërtimit të pushtetit të ri popullor, Malëshova u bë udhëheqës faktit i Komitetit Qëndror. Ai u përpoq me të gjitha mënyrat, që ta drejtonte politikën e partisë në rrugën e restaurimit të kapitalizmit në Shqipëri. Gjatë dy viteve të pasluftës udhëheqja e PKSH-së ndiqte verbërisht ‘‘këshillat’’ e Malëshovës dhe nuk bënte luftë me kapitalin privat.

Nën maskën e nxitjes së iniciativës private (gjë për të cilën Malëshova insistonte shumë) sektori privato-bujqësor u forcua dhe zuri një pozitë sunduese. Krahas kësaj, Malëshova frymëzonte reaksionin shqiptar për veprime të hapura kundër qeverisë së Enver Hoxhës dhe regjimit popullor në vend’’ (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 38).Kjo fjali e fundit, për ndihmën ndaj reaksionit, duket pak e dyshimtë, gjë që të bën të

dyshosh edhe për ca më lart kur në raport thuhet se Sejfulla Malëshova u bë udhëheqës faktik i Byrosë Politike.

Më tej në njoftim thuhet se “gabim serioz ka bërë Komiteti Qëndror i PKSH nën ndikimin e Malëshovës, në përcaktimin e politikës së jashtme të qeverisë shqiptare. Komiteti Qëndror nuk përpunoi një vijë të shëndoshë për orientimin e politikës së jashtme të Shqipërisë drejt Bashkimit Sovjetik. BRSS konsiderohej vetëm si aleat krahas Anglisë dhe SHBA” (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 38).

I dërguari jugosllav në Shqipëri i shkruan Beogradit se nën preteksin e njohjes së pavarësisë dhe integritetit territorial të Shqipërisë prej anglo-amerikanëve, roli dhe ndikimi i Jugosllavisë në Shqipëri dhe në Ballkan po minimizohet (Zivotiç, A. 2010: 86). Në të njëjtën linjë me të dërguarin jugosllav në Tiranë është edhe mbledhja e sipërpërmendur e Byrosë Politike e 11 dhjetorit 1945 në konkluzionet e së cilës thuhet se “u përpoqëm që t’u linim të kuptonin anglo-amerikanëve se në vëndin tonë ka një demokraci të gjerë liberale dhe kështu, për të shpjetuar njohjen e qeverisë, u theksua tendenca oportuniste në vijën politike tonën karshi anglo-amerikanëve” (Plasari, N. & Malltezi, L. 1996: 23).

Kjo sjellje e qeverisë shqiptare pas luftës ishte në sytë e jugosllavëve një keqkuptim i madh, e cila në të njëjtën kohë dhe vuri në dukje një dobësi ideologjiko-politike të udhëheqjes shqiptare dhe se në Jugosllavi mendohej se udhëheqja politike shqiptare e vlerëson gabim fuqinë e forcave të rrethuara rreth Bashkimit Sovjetik (Zivotiç, A. 2010: 86).

Nga shënimet e mbledhjes së 4 dhjetorit të 1945 e Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë shihet qartë shqetësimi i udhëheqjes së Jugosllavisë mbi orientimin e politikës së jashtme të Shqipërisë (Petranoviç, B. 1995: 106). Udhëheqja jugosllave shihte me shqetësim veçanërisht rolin ende të rëndësishëm në shoqërinë shqiptare të një klase të vogël të mirëarsimuar e cila ishte thellësisht antikomuniste, e cila e injoronte realitetin e Ballkanit dhe orientohej drejt Perëndimit (Zivotiç, A. 2010: 86).



Në telegramet e fundit të vitit 1945 dhe gjer mesit të vitit 1946 të të dërguarit jugosllav në Tiranë shprehet tensioni që ekziston tek udhëheqësit shqiptarë se ajo garanci që ata kërkojnë për pavarësinë dhe sigurimin e tërësisë territoriale të Shqipërisë gjendet pikërisht në Perëndim dhe këtë tension nuk mund ta shuajnë deklaratat për vëllazërinë dhe bashkëpunimin me popujt e Jugosllavisë(Zivotić, A. 2010: 88).

Shikojmë që mbledhja e Byrosë së Partisë Komuniste të Shqipërisë ka ndodhur pak ditë pasi në mbledhjen e Politbyrosë së Partisë Komuniste të Jugosllavisë janë shprehur shqetësimet për politikën e jashtme të Shqipërisë dhe menjëherë duket se udhëheqja shqiptare ka reflektuar dhe ndryshuar udhë, aq sa edhe fjalët në konkluzionet e kësaj mbledhje ku me kritikë përshkruhen gabimet e deriatëhershme të udhëheqjes shqiptare në politikën e jashtme tingëllojnë të ngjashme me shqetësimet e jugosllavëve.

Megjithatë, fakti që në maj të vitit 1946, i dërguari jugosllav në Tiranë, Josip Xherxha (Josip Đerđa) vazhdonte t'i shprehte dyshimet e tij Beogradit, tregon se ende udhëheqja shqiptare nuk kishte bërë një zgjedhje përfundimtare. Megjithatë, që pas njohjes ndërkombëtare në fund të vitit 1945 dhe gjatë vitit 1946, udhëheqja shqiptare ndalon të ashtuquajturat lëkundje mes Lindjes dhe Perëndimit dhe përfundimisht pozicionohet në një marrëdhënie shumë të ngushtë me Jugosllavinë e më pas me Bashkimin Sovjetik(Zivotić, A. 2010: 88).

Kësaj paqartësie të politikës së jashtme Enver Hoxha i rikthehet pas mbledhjes së Byrosë në 11 dhjetor 1945, edhe në Pleniumin e 5-të të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, mbajtur më 21 shkurt 1946.

Aty Enver Hoxha i rikthehet oportunitizimit të Sejfulla Malëshovës(AQSH, Fondi 14\AP, dosja 1, viti 1946). Në raportin politik që Enver Hoxha paraqiti në Pleniumit ai thotë se “të influencuar nga kjo tendencë oportuniste, nuk e kemi orientuar popullin tonë sa duhet drejt vëllazërimit të shëndoshë me Jugosllavinë, që është një konditë e domosdoshme për ekzistencën e vendit tonë”(AQSH, Fondi 14\AP, dosja 1, viti 1946).

Edhe tek fjalët e Enver Hoxhës dallohet shqetësimi për pavarësinë dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë, të njëjtin shqetësim që sipas të dërguarit jugosllav në Tiranë, kishte shkaktuar tek udhëheqja shqiptare mospozicionimin e saj përfundimtar në politikën e jashtme, dhe siç është parë më sipër e do të shihet në vazhdim, shqetësim kryesor i udhëheqësve shqiptarë në këtë kohë ishte kufiri greko-shqiptar.

Duket se Enver Hoxha kërkonte garanci qoftë në Perëndim, qoftë në Lindje për pavarësinë dhe paprekshmërinë territoriale të Shqipërisë. Garancia nga Perëndimi vinte me një sërë kushtesh që në rradhë të parë kishin të bënin me demokracinë, zgjedhjet e lira dhe liritë dhe të drejtat e njeriut, kushte këto që binin ndesh me synimin kryesor të Enver Hoxhës dhe Partisë Komuniste të Shqipërisë: ruajtja e pushtetit.

Fakti që këtij çorientimi në dukje në politikën e jashtme, iu dha fund me ndërtimin e marrëdhënieve shumë të ngushta me Jugosllavinë dhe më vonë me Bashkimin Sovjetik kishte të bënte jo vetëm me përkimin ideologjik dhe të ashtuquajturin patronazh të Partisë Komuniste të Jugosllavisë nën të cilin gjendej Partia Komuniste Shqiptare dhe udhëheqja e saj, por edhe me faktin që garancitë nga Jugosllavia për paprekshmërinë e tërësisë territoriale të Shqipërisë nuk shoqëroheshin me kushte për demokracinë dhe zgjedhjet e lira.

Siç do ta shohim edhe më në vazhdim, përmendja e ‘‘ekzistencës së vendit tonë’’ nga Enver Hoxha në Pleniumin e 5-të nuk është as hera e parë dhe as e fundit që kjo përmendet nga ai vetë apo pjesëtarë të tjerë të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Më tej Enver Hoxha në raportin politik të Pleniumit të 5-të citohet të ketë thënë se ‘‘edhe shumë lëshime të tjera i kanë dhënë shpresa dhe kanë inkurajuar borgjezinë reaksionare të përpiqet të orientojë marrëdhëniet tona ekonomike drejt Perëndimit, në rradhë të parë drejt Italisë’’(AQSH, Fondi 14\AP, dosja 1, viti 1946).

Për rëndësinë e fjalës së Enver Hoxhës në Plenium më poshtë po e citojmë shumicën e saj: ‘‘Për Jugosllavinë duhet të ngjallim në popull dashurinë dhe vëllazërimin që u lind në këtë luftë. Jugosllavia ka qenë përkrahësja më e madhe dhe direkte në Luftën

Nacionalçlirimtare, ajo do të vazhdojë të jetë një nga ndihmëset më të mëdha të popullit tonë dhe të pushtetit. Duhet të luftojmë me mish e me shpirt tendencat shoviniste të atyre shqiptarëve që kërkojnë të ngjallin mërinë e vjetër kundër popujve të Jugosllavisë.

Me Jugosllavinë dhe Bullgarinë ne duhet të kemi një vijë, si brenda, ashtu dhe jashtë dhe marrëdhëniet ekonomike të një vendi të mos komprometojnë vendin tjetër. Ne duhet gjithashtu që çështjet e mbrojtjes nga armiqtë e jashtëm si edhe ata të brendshëm të arrimë të kemi një pikëpamje të përbashkët, pse armiqtë i kemi të përbashkët dhe të njëjtë.

Qeveria jugosllave jo vetëm që ka treguar një interesim të veçantë për ne për të na mbrojtur jashtë, por ka qenë kurdoherë e gatshme të na ndihmojë dhe në sektorët e brendshëm, si ata të ekonomisë, arsimit etj''(AQSH, Fondi 14\AP, dosja 1, viti 1946).

Edhe një herë në fjalën e tij, Enver Hoxha thekson mbrojtjen e jashtme që Jugosllavia i siguron Shqipërisë, duke kuptuar se kjo është gjëja më e rëndësishme në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe pastaj vjen ndihma ekonomike.

Më tej, Hoxha thekson pakënaqësinë prej marrëdhënieve ekonomike të deriatëhershme me Jugosllavinë. "Por këto marrëdhënie ekonomike, si pas mendimit tonë, nuk janë konkretizuar si duhet, përkundrazi ato janë të shthurura. Ne nuk u kemi vënë kujdesin e duhur. Me Jugosllavinë ne duhet të kemi marrëdhënie ekonomike më të vendosura, më konkrete dhe më të ngushta dhe, pa i konkretizuar këto marrëdhënie do të jetë gabim dhe marrëzi të kërkojmë tregje jashtë, si në Itali, Çekosllovakia e gjetkë.

Me Jugosllavinë kemi pasur një marrëveshje të vogël dhe provizore për shkëmbime mallrash, por kjo nuk është e mjaftueshme. Nga anarkia që ka ekzistuar në tregun tonë, shumë gjëra kanë mbetur pa u plotësuar në lidhje me jugosllavët dhe ne nuk kemi qenë aq korrektë sikundër kanë qenë ata''(AQSH, Fondi 14\AP, dosja 1, viti 1946).

Në fund Enver Hoxha i rikthehet dhe një herë çështjes të theksuar prej autorit të këtij studimi si arsyeja thelbësore që përcaktoi marrëdhëniet e ngushta me Jugosllavinë në vitet 1945 dhe 1946. Hoxha thotë se “forcimi i marrëdhënieve ekonomike e kulture me Jugosllavinë janë aq të rëndësishme sa edhe koordinimi i politikës së jashtme dhe i mbrojtjes nga armiqtë e përbashkët”(AQSH, Fondi 14\AP, dosja 1, viti 1946).

Për të kuptuar paqartësinë dhe vështirësinë e politikës së jashtme të qeverisë shqiptare në këtë kohë, ndihmon dhe kërkesa e të dërguarit francez në Tiranë, për të sqaruar rolin e Jugosllavisë në politikën e jashtme të Shqipërisë si dhe shpjegimin për marrëveshjet që Shqipëria ka nënshkruar me Jugosllavinë(Zivotić, A. 2010: 94).

Në këtë kohë ndikimi i Bashkimit Sovjetik në Shqipëri ishte i paktë, në kuptimin e një ndikimi të drejtpërdrejtë, pasi nga ana tjetër Bashkimi Sovjetik ishte “fanari” i botës komuniste, por lidhja dhe komunikimi mes shqiptarëve dhe sovjetikëve bëhej më së shumti nëpërmjet Jugosllavisë. Por, udhëheqja shqiptare nuk është se e pranonte symbyllur këtë fakt. Shqiptarët përpqeshin të lidheshin direkt me Moskën, pse jo dhe ta vizitonin vetë atë, pa ndërlihdjen e jugosllavëve, por kjo përpjekje hidhej poshtë prej Stalinit, i cili duket se ia kishte lënë Shqipërinë në dorë Jugosllavisë.

Në takimin e majit të vitit 1946, në Moskë, mes Titos, Stalinit dhe delegacioneve përkatëse, jugosllavët i bëjnë me dije Stalinit dëshirën e udhëheqësve shqiptarë, Enver Hoxhës dhe Koçi Xoxes për të ardhur në Moskë, por për Stalinit vizita e Hoxhës dhe Xoxes në Moskë duhet të shihet pas vizitës së tyre në Beograd(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 24). Përsëri Stalini vendosi Beogradin si ndërlihdje mes Tiranës dhe Moskës. Këtë e thekson dhe Molotovi kur thotë se ata (domethënë sovjetikët) e kanë frenuar “synimin e shqiptarëve për të ardhur në Moskë, por shqiptarët ngulin këmbë për këtë”(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 24).

Në takimin e majit të vitit 1946 shikohet edhe paqartësia e jugosllavëve për politikën në Shqipëri(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 24). Por, jugosllavët shpresonin se të gjitha paqartësitë e tyre ndaj Shqipërisë dhe politikës së saj do të sheshoheshin me vizitën e Enver Hoxhës në Beograd, dhe ashtu ndodhi vërtet, që pas vizitës së delegacionit shqiptar në Beograd, Shqipëria u pozicionua përfundimisht në krah të Jugosllavisë në

politikën e saj të jashtme dhe filluan nënshkrimet e marrëveshjeve të rëndësishme, sidomos ato ekonomike, për të cilat do të flitet në kapitujt e mëvonshëm.

Paqartësia e jugosllavëve kishte të bënte me ndikimin e Sejfulla Malëshovës në Byronë Politike, që siç u prek dhe më sipër, kishte shkaktuar një lëkundje të udhëheqjs shqiptare për drejtimin e politikës së saj të jashtme. Për këtë problem, në takimin e majit 1946, jugosllavët i thanë Stalinit se ‘në Plenumin e Prillit ata diskutuan problemin e vijës, veçanërisht ndaj Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik dhe konstatuan gabime të njohura, dhe si mbartës të këtyre gabimeve, përjashtuan nga Byroja Politike Sejfulla Malëshovën. Qysh atëherë udhëheqja është më kompakte’ (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 24).

Por duket se dyshimet në udhëheqjen shqiptare nuk kishin lidhje vetëm me Sejfulla Malëshovën. Savo Zllatiç, në shkurt të vitit 1947, në një raport për Komitetin Qëndror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë thotë se në rradhët e udhëheqjes shqiptare, duke përfshirë dhe vetë Enver Hoxhën, ekziston frikë prej Jugosllavisë. Në shumë qarqe përmenden, sipas tij, edhe marrëveshjet me Italinë në vitet 20-të dhe 30-të dhe ekziston frika se përfundimi i atyre marrëveshjeve do të jetë edhe me Jugosllavinë. Sipas Zllatiçit, vetëm duke ndihmuar ekonomikisht rimëkëmbjen e Shqipërisë, do të arrihet të eliminohen ato pakënaqësira që ekzistojnë kundrejt Jugosllavisë, edhe tek personat më të gatshëm për të bashkëpunuar me Jugosllavinë. Ai thotë se natyra e marrëdhënieve me Jugosllavinë nuk i është e qartë as udhëheqësve shqiptarë, dhe kjo thënie është e shkurtit të vitit 1947, kur supozohet që marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të jenë thelluar.

Të njëjtat fjalë me Savo Zllatiçin përdor dhe Josip Xherxha. Në 7 shkurt 1946, Josip Xherxha i shkruante Titos nga Tirana se tek udhëheqja shqiptare, duke përfshirë dhe Enver Hoxhën ka një përpjekje sipas tij të pasuksesshme për të fshehur frikën (strah është fjala në serbokroatisht që përdor Xherxha dhe Zllatiç pas tij) prej Jugosllavisë dhe qëllimeve që jugosllavët kanë kundrejt Shqipërisë. Sipas tij kjo duket edhe në faktin që popullarizimi i udhëheqësve dhe arritjeve të Jugosllavisë mes popullit shqiptar kryhet pa ndonjë dëshirë të madhe. Arrdhja e ambasadorit sovjetik në Tiranë, Çuvahinit, sipas Xherxhës, shtoi prezencën e Bashkimit Sovjetik në shtypin shqiptar. I dërguari jugosllav thotë se me këtë sjellje mund të arrihet në përfundimin se

Bashkimi Sovjetik shërben si mjet për t'i shpëtuar rrezikut nga Jugosllavia. (ACKSKJ, IX, 1-I – 42, fq. 15).

Në korrik të vitit 1947, Savo Zllatiç ndërsa i shkruan Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, përsërit frikën prej Jugosllavisë që ekziston tek udhëheqja shqiptare, duke përfshirë dhe Enver Hoxhën. Sipas tij, në mentalitetin e udhëheqjes shqiptare është e vështirë të hiqen konceptet e së kaluarës në lidhje me Jugosllavinë, është e vështirë të besohet në qëllimet e mira të jugosllavëve. Sipas tij, në themel të problemeve me Jugosllavinë qëndron dëshira për t'u lidhur direkt me Bashkimin Sovjetik, dëshira për të qenë sa më të pavarur, për të mos zvogëluar sovranitetin shtetëror (ACKSJK, IX, 1-I – 122).

Nga raportimet drejt Beogradit të të dërguarit jugosllav në Tiranë, Josip Xherxha, u pa më sipër që jugosllavët në momente të caktuara nuk ishin dhe aq të sigurtë për besnikërinë apo dëshirën e Enver Hoxhës dhe udhëheqjes shqiptare të kohës për t'u kthyer plotësisht drejt Jugosllavisë. Jugosllavët dëshironin ta kishin ata vetë kontrollin mbi Shqipërinë, ashtu siç kishin rënë dakord edhe me Stalinin, i cili dëshironte t'i mbante shqiptarët sa më larg tij dhe t'i kalonte ata nën patronazhin e jugosllavëve. Në mbledhje Stalini i tha Titos se 'ne vazhdimisht e shtyjmë ardhjen e tyre...Më mirë ne i ndihmojmë ata nëpërmjet jush'', ndërsa Tito iu përgjigj se 'ne mund të realizojmë gjithçka me ata''(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 24).

Vetë jugosllavët, në raportet që dërgonin nga Tirana dukeshin të çuditur se pse shqiptarët nuk e pranonin ndihmën e Jugosllavisë me më shumë dëshirë, pse nuk e pranojnë më shumë përvojën më të madhe të jugosllavëve, sidomos në ekonomi (Zivotic, 2011: 130).

### **2.3 Politika e jashtme e Shqipërisë kalon nga Beogradi**

Qeveria federale e Jugosllavisë njohu qeverinë e re shqiptare, të dalë prej Luftës Nacionalçlirimtare në 28 prill 1945(Petranović, B, 1977: 189). Qeverisë shqiptare njohja iu bë e ditur prej Velimir Stojaniçit, të dërguarit të Partisë Komuniste Jugosllave pranë Partisë Komuniste të Shqipërisë, i cili më vonë do të emërohet ministër fuqiplotë i Jugosllavisë në Shqipëri. Gazeta "Bashkimi" në Tiranë e njoftoi njohjen e qeverisë shqiptare më 1 maj, shoqëruar në po të njëjtin numër me një kryeartikull në të cilin shkruhej për "sakrificat mbinjerëzore" në luftë "për të shpëtuar atdheun...nga thonjtë e monstrës fashiste e të këlyshëve të saj" dhe se populli shqiptar kishte të drejtë që qeveria e tij e re të njihej prej vendeve të Bllokut(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 20).

Më tej kryeartikulli i gazetës "Bashkimi" vazhdon duke thënë se populli shqiptar "e njeh dhe çmon sot, më shumë se kurrë, përkrahjen e madhe që po gjen në qeverinë e Mareshalit Tito, njeh dhe çmon me mirënjohje të thellë gjestin e madh të Qeverisë Demokratike të Jugosllavisë" dhe se kjo njohje ka ardhur si rezultat i vëllazërimit të krijuar mes dy popujve gjatë luftës kundër armikut të përbashkët, fashizmit(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 20-21).

Njohja e qeverisë shqiptare dhe e luftës së popullit shqiptar prej Jugosllavisë ishte shtruar për diskutim qysh në muajt e fundit të vitit 1944, kur lufta në Shqipëri sapo kishte përfunduar. Gazeta "Borba" e 31 dhjetorit të vitit 1944 raporton fjalimin e Milovan Xhilasit, mbajtur një ditë më parë në Universitetin e Kolarçevit në të cilën ndër të tjera Xhilas foli dhe për njohjen e qeverisë popullore shqiptare si dhe të përkrahjes dhe ndihmës që formacione ushtarake shqiptare japin për çlirimin e Jugosllavisë(Zbornik dokumenata, 1969: 464). Me rastin e përmendjes së ndihmës së shqiptare, Xhilas foli dhe për vëllazërimin e popujve ballkanikë.

Qeveria e Federatës Jugosllave jo vetëm e njohu qeverinë e re shqiptare, por në të njëjtën kohë mori përsipër që në të gjitha konferencat ndërkombëtare të ndërhyjë në favor të njohjes së Shqipërisë si aleat dhe që Shqipërisë t'i jepen reparacione për dëmet e luftës(Petranović, B, 1977: 189).

Kur në fund të vitit 1946, në Konferencën e Parisit për reparacionet e luftës Shqipërisë iu akordua një kuotë minimale, delegacioni jugosllav në konferencë njoftoi se Jugosllavia është e gatshme ta ndajë me Shqipërinë një pjesë të kuotës së reparacioneve që asaj i akordoi konferenca (Petranović, B, 1977: 189). Kjo sjellje e delegatëve jugosllavë dhe e vetë Federatës Jugosllave ndaj Shqipërisë kishte të bënte me faktin që jugosllavët nuk e shihnin Partinë Komuniste të Shqipërisë si një parti tjetër, por si një degë të Partisë Komuniste Jugosllave e cila kishte ndihmuar në themelimin e Partisë Komuniste Shqiptare (Petranović, B, 1977: 184).

Duket se edhe prej Bashkimit Sovjetik, Shqipëria ishte lënë nën kujdesin e Jugosllavisë dhe komunikimi mes udhëheqjes shqiptare dhe asaj sovjetike, të paktën në vitet 1945 dhe 1946, realizohej nëpërmjet jugosllavëve. Qysh në maj të vitit 1945, sovjetikët kishin kërkuar prej jugosllavëve informacione për politikën e brendshme të Shqipërisë dhe udhëheqësve të saj (Petranović, B, 1977: 195).

Kjo sjellje shikohet edhe pas vitit 1946. Një shembull i tillë është dhe rasti i krijimit të Informbyrosë, një pasuese e Kominternit të para Luftës së Dytë Botërore por me dallimin që Informbyroja ishte vetëm për Europën. Themelimi i saj ndodh në shtator të vitit 1947 prej përfaqësuesve të Partive Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Jugosllavisë, Hungarisë, Rumanisë, Çekoslovakisë, Polonisë, Bullgarisë, Francës dhe Italisë. Mungon Partia Komuniste e Shqipërisë.

Stalini, në takimin me Titon në maj të vitit 1946 kërkon informacion për gjendjen në Shqipëri (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 24). Jugosllavët i thonë Stalinit se një delegacion shqiptar dëshiron të vijë në Moskë, por Stalini nuk e sheh këtë vizitë me sy të mirë duke u justifikuar se ‘‘ardhja e shqiptarëve në Moskë, mund të shkaktojë reagim të pakëndshëm nga ana e anglezëve dhe amerikanëve, dhe kjo do të ndërlikonte më shumë gjendjen e politikës së jashtme të Shqipërisë’’ (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 24).

Çështja e pakënaqësisë së anglezëve dhe amerikanëve duket më shumë një fasadë ndaj mosdëshirës së Stalinit për të pritur delegacionin shqiptar në Moskë. Duke parë dhe veprimet e mëparshme, ashtu si dhe themelimin e Informbyrosë një vit më vonë,



për Stalinin Shqipëria duket se ishte një çështje e Jugosllavisë dhe Bashkimi Sovjetik nuk kishte pse të përzihet në një çështje të tillë.

Shumë herë në tre vitet në vazhdim, Stalini do të ngrejë çështjen e pakënaqësisë së anglo-amerikanëve në marrëdhëniet e Jugosllavisë apo Bashkimit Sovjetik me Shqipërinë, duke thirrur shpeshherë për një politikë më të matur.

Jugosllavia, qysh në fund të Luftës së Dytë Botërore kishte marrë përsipër rolin e mbrojtjes së Shqipërisë para çdo Konferencë ndërkombëtare apo vendi tjetër ku diskutohej për çështje në të cilat prekej edhe Shqipëria. Enver Hoxha më vonë do të shkruante se jugosllavët me këtë sjellje “nuk mbronin Shqipërinë si shtet të lirë e sovran, por mbronin ato troje, që në planet e tyre të fshehta, përbënin gubernën jugore të “shtetit të madh” shumëkombësh e shumëpopujsh jugosllav të ëndërruar prej kohësh”(Hoxha, E. 1983: 214).

Edvard Kardelji, kreu i përfaqësisë jugosllave në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, përpara kësaj organizate, në janar të vitit 1945, mbi kërkesën e Shqipërisë për t’u bërë pjesë e OKB-së, tha se “delegacioni i Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë dëshiron t’i japë kërkesës së Republikës Popullore të Shqipërisë mbështetjen më të përzemërt. Duke iu drejtuar përmes jush Këshillit të Sigurisë, ne kërkojmë që Këshilli i Sigurimit t’i rekomandojë Asamblesë së Përgjithsme që Republika Popullore e Shqipërisë të pranohet në Kombet e Bashkuara.

Gjithashtu dëshiroj t’i tërheq vëmendjen Këshillit të Sigurimit mbi faktin që Shqipëria ishte një ndër viktimat e para të agresionit fashist në Evropë, që populli shqiptar, nëpërmjet Ushtrisë së tij Nacionalçlirimtare, luftoi me vetmohim në luftë në krah të Kombeve të Bashkuara dhe proporcionalisht forcave të tij, kontribuoi në fitoren mbi agresorët si një aleat i besueshëm i vendeve demokratike” (O’Donnel, J.S, 1999: 17).

Të njëjtin mendim paraqiti edhe Moshe Pijade, një ndër përfaqësuesit jugosllavë në Konferencën e Paqes në Paris, në vitin 1946, kur tha se “delegacioni jugosllav e konsideron të pajustificueshëm mosthirrjen e Shqipërisë në Konferencë, si një shtet anëtar dhe me të drejta të plota si të gjithë ne. Është Shqipëria një vend armik që të thirret në Konferencë vetëm për t’u dëgjuar, si në rastin e vendeve që më parë ishin

armike, apo është një vend aleat që meriton admirimin dhe mirënjohjen e të gjitha vendeve demokratike?”(O’Donnel, J.S, 1999: 18).

Jugosllavia luajti një rol të rëndësishëm që Shqipëria të thirrej në Konferencën e Paqes në Paris. Përfaqësuesit jugosllavë në Konferencë vazhdimisht vunë në dukje faktin që Shqipëria ishte vendi i parë në Europë që u pushtua nga Italia fashiste dhe ishte një ndër vendet ku rezistenca e armatosur kundër fashizmit u shfaq sëpari. (Dokumenti o Spoljnoj Politici SFRJ, 1985: 265).

Mbështetja jugosllave ndaj Shqipërisë në këtë Konferencë por edhe në raste të tjera duket e sinqertë. Është një mbështetje që i shkon për shtat teorisë Marksiste-Leniniste në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe natyrës së re të marrëdhënieve mes tyre që Jugosllavia dhe Shqipëria po përpiqeshin të ndërtonin. Ishin lënë pas ndasitë nacionaliste. ‘Bratsvo i jedinstvo’ i Titos duket se shkonte përtej kufijve të Jugosllavisë, në ndihmë të shteteve që kishin afri ideologjike me Jugosllavinë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës refuzuan hyrjen e Shqipërisë në OKB nëse kjo e fundit nuk respektonte marrëveshjet e mëparshme mes dy vendeve(Zivotić, A. 2010: 94). I dërguari sovjetik, Çuvahini, e këshilloi qeverinë shqiptare që për shkak të refuzimit të SHBA-ve për të lejuar hyrjen e Shqipërisë në OKB, qeveria shqiptare nga ana e saj të rishikonte qëndrimin e misionit amerikan në Shqipëri, por kjo këshillë e sovjetikëve u hodh poshtë prej të dërguarit jugosllav, Josip Xherxhës, i cili i tha qeverisë shqiptare që nëse në të ardhmen gjendet përsëri në një situatë të ngjashme, më parë duhet të marrë mendimin e qeverisë jugosllave për veprimet që duhet të kryejë (Zivotić, A. 2010: 94).

Në këtë periudhë, Shqipëria dëshironte të bëhej pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, por edhe kjo dëshirë e Shqipërisë u penguan nga Britania e Madhe dhe SHBA. Në maj të vitit 1945, përfaqësuesi i qeverisë amerikane në Tiranë i bën me dije qeverisë shqiptare se një shtet që dëshiron të bëhet pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara duhet të njohë dhe të respektojë marrëveshjet e nënshkruara mes shteteve.

Problemet më të mëdha kishin të bënin me koncensionet dhënë SHBA-ve, koncensione që qeveria e re shqiptare nuk kishin aspak në plan t'i respektonte. Kongresi i Përmetit i majit të vitit 1944 kishte vendosur të shfuqizonte dhe të mos njihnte marrëveshjet që kishte bërë Mbretëria e Shqipërisë me shtetet Perëndimore(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 33).

Me rëndësi të veçantë ishte dhe marrëveshja në të cilën Shqipëria njihet Shtetet e Bashkuara si shtetin më të favorizuar në marrëdhëniet me Shqipërinë(Zivotić, A. 2010: 91). Por, në këtë pikë shihet ndërhyrja e jugosllavëve të cilët këshilluan qeverinë shqiptare që kjo marrëveshje si dhe çdo kusht tjetër i qeverisë amerikane të hidhej poshtë nga qeveria shqiptare dhe ashtu u bë(Zivotić, A. 2010: 91). Edhe një vit më vonë, çështja e marrëdhënieve me SHBA-të vazhdonte të ishte problematike për Shqipërinë, por në të gjitha rastet duket se vendimin përfundimtar të politikës së jashtme që Shqipëria duhet të ndiqte e jepte Jugosllavia.

Në një radiogram të Hysni Kapos nga Beogradi më 21 prill 1946 drejtuar Koçi Xoxes shkruhet se në bisedimet që i pari ka kryer me Edvard Kardeljin, ky i fundit i kishte thënë se interesi i Shqipërisë është që të jenë të stabilizuara marrëdhëniet me anglo-amerikanët. Gjithashtu në radiogram thuhet se kërkesat e tyre duhen studiuar se ç'mund t'u jepet, por kjo duhet bërë në mënyrë të tillë që interesi i vendit, domethënë i Shqipërisë, të mos cënohet(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 31).

Një muaj më vonë, në maj të vitit 1946, në mbledhjen e Byrosë Politike, në diskutimet për telegramet që Nako Spiru ka dërguar nga Beogradi, Enver Hoxha thotë se për "traktatet me amerikanët jugosllavët thonë se ata vetë i kanë pranuar dhe se mund t'i pranojmë edhe ne këto traktate që kanë karakter ndërkombëtar. Ata kërkojnë vetëm që të lihet mënjane (marrëveshja) që Amerika të jetë një shtet i favorizuar"(AQSH. F.14\AP, dosja 7, 1946).

Në takimin e Londrës, në shkurt të vitit 1946, në të cilën Jugosllavia mori pjesë, u vu në dukje që mundësitë e Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ishin minimale(Zivotić, A. 2010: 94). Ky qëndrim u pa edhe në një mbledhje të shkurtit të vitit 1946 të Byrosë Politike të Partisë Komuniste të Jugosllavisë(Petranović, B. 1995: 132).

Duket se mbështetja kryesore e Shqipërisë për të hyrë në OKB ishte Jugosllavia. Në një mbledhje të Këshillit të Sigurimit, Jugosllavia shtroi kërkesën për anëtarësimin e Shqipërisë, por kjo kërkesë u kundërshtua fuqishëm nga vendet Perëndimore, veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Zivotić, A. 2010: 94). Jo vetëm delegacioni jugosllav po mbështeste fuqishëm hyrjen e Shqipërisë në OKB por edhe mediat jugosllave shkruanin vazhdimisht për kërkesën e Shqipërisë dhe mbështetjen që Jugosllavia jepte ndaj Shqipërisë.

Gazeta kryesore e Beogradit "Borba" dhe Agjencia e Lajmeve "TANJUG", raportuan vazhdimisht nga Janari deri në Dhjetor të vitit 1946, për kërkesën e Shqipërisë dhe mbështetjen Jugosllave (Zivotić, A. 2010: 94).

Por, Jugosllavia nuk merrte përsipër thjesht të bënte avokatin e Shqipërisë në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare, apo në Konferencën e Paqes në Paris, por shkonte një hap më tej duke u bërë përfaqësuese e politikës së jashtme të Shqipërisë, siç u pa më lart ku në fjalën e tij në Plenumin e Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, Enver Hoxha tha se e kishin pranuar kërkesën e jugosllavëve për të patur një përfaqësues shqiptar në të gjitha përfaqësitë diplomatike të Jugosllavisë.

Vijën e përfaqësuesve jugosllavë në Konferencën e Paqes për mbrojtjen e Shqipërisë e ndiqte edhe shtypi beogradas. Gjatë gjithë Konferencës së Paqes shtypi në Beograd shkruante vazhdimisht për diskutimet që bëheshin në Paris dhe çështja e kufirit grek ishte një çështje kryesore, por në të gjithë artikujt shtypi jugosllav mbështeste Shqipërinë ndaj kërcënimit grek (Zivotić, A. 2010: 109).

Kjo vërtetohet edhe në reportet e Legatës Shqiptare në Beograd e cila i shkruan Ministrisë së Punëve të Jashtme se shtypi jugosllav, nëpërmjet gazetave "Borba", "Glas" e të tjera ka shkruar shpesh në mbështetje të marrjes pjesë të Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris. "Të gjitha diskutimet që janë zhvilluar në Paris e që kanë qenë në favorin tonë janë vënë integralisht. Ndërsa fjalimet e delegacioneve të tjera që kanë qenë kundërshtues, janë vënë shkurtimisht sa për të vënë në dukje qëllimet e tyre të erta dhe vijën politike të tyre që është kundër popujve të vegjël dhe

demokracive të ra që janë vendosur në ato vende” (AMJ, dosja nr b\I-8, numri rendor 95, fq. 8).

Që politikën e jashtme të Shqipërisë e drejtonin jugosllavët, kjo vërehet dhe në propozimin e jugosllavëve që Shqipëria të mos kishte përfaqësi (ambasada) të vetat jashtë vendit por të përfaqësohej prej përfaqësive të Jugosllavisë. Në plenumin e Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, në prill të vitit 1946, për këtë çështje Enver Hoxha thotë se “jugosllavët na kanë propozuar që kudo ku ata kanë përfaqësi diplomatike të kemi edhe ne një përfaqësues tonin pranë atyre përfaqësuesve për t’i ndihmuar ato në kërkesat tona e për të bërë punën tonë. Ne e kemi pranuar këtë propozim të jugosllavëve”(AQSH. F.14\AP, dosja 2, 1946).

Ndoshta propozimi i jugosllavëve vinte edhe për shkak të vështirësive financiare që shteti shqiptar mund të haste në hapjen e përfaqësive jashtë vendit, por nga ana tjetër ky propozim është në vazhden e propozimit të parë që Shqipëria të përfaqësohet prej Jugosllavisë në çdo Konferencë Ndërkombëtare.

Një problem i madh dhe shqetësues për qeverinë shqiptare ishte dhe çështja e kufirit greko-shqiptar. Edhe në këtë çështje roli i Jugosllavisë, jo vetëm si mbështetëse por dhe si garant i pavarësisë dhe tërësisë teritoriale të Shqipërisë, ishte i madhe dhe ishte në vazhden e të drejtuarit të politikës së jashtme të Shqipërisë nga Beogradi.

Qeveria greke e pas Luftës së Dytë Botërore ringriti çështjen e Epirit të Veriut, aq sa kryeministri grek Caldaris dhe përfaqësuesit e shtetit grek në Konferencën e Paqes së vitit 1946 mbajtur në Paris, jo zyrtarisht i parashtruan Jugosllavisë nëpërmjet një letre ndarjen e Shqipërisë mes Greqisë dhe Jugosllavisë(Petranović, B, 1977: 178).

Në datën 3 gusht të vitit 1946, Edvard Kardelji i shkruan Titos nga Parisi, ku po mbahej Konferenca e Paqes, se kryeministri grek Caldaris i kishte ofruar përsëri Jugosllavisë ndarjen e Shqipërisë mes Greqisë dhe Jugosllavisë, dhe sipas Kardeljit, Caldaris e kërkonte këtë për arsye të natyrës realpolitike(Zivotić, A. 2010: 109).

Duket se qeverinë greke dhe kryeministrin e saj, nuk e ka dekurajuar shumë refuzimi i Kardeljit, pasi të njëjtën ofertë e bën edhe pak ditë më vonë, në 11 gusht, siç shihet edhe nga telegrami i Kardeljit dërguar Titos(Zivotić, A. 2010: 109).

Përgjigjja e Kardeljit ishte përsëri e njëjtë, si në çdo rast tjetër të ofertës greke, që Jugosllavia do e mbrojë Shqipërinë si veten e saj(Zivotić, A. 2010: 112). Pak ditë më vonë, në 24 gusht, Enver Hoxha i shkruan Koçi Xoxes nga Parisi: “çekët, polonezët u treguan shumë miq me ne dhe në recepsion që dhanë na thirën, na prezantuan me shumë njerëz dhe të tërëve u flisnin me entuziazmë për fjalimin dhe për luftën t’onë. **Stop** sot isha për drekë te kardeli. Jugosllavët bëjnë ç’do gjë për të na ndihmuar. S’bëjnë ndryshim nga vetja e tyre. Për çdo gjë janë gati. **Stop** Enveri”(AMJ, dosja nr b\I-8, numri rendor 95, fq. 14).

Një ndër përfaqësuesit jugosllavë në Konferencë, Mosha Pijade, ja dërgoi letrën kreut të Konferencës. Si kundërbalancë të synimeve greke ndaj Shqipërisë së jugut, megjithëse përfaqësuesit jugosllavë nuk e ngritën në Konferencën e Paqes në Paris çështjen e Maqedonisë së Egjeut, rajon i gjendur në Greqinë verilindore, Tito deklaroi se kjo çështje mund të çohet për zgjidhje në Organizatën e Kombeve të Bashkuara(Petranović, B, 1977: 178).

Me shumë mundësi Kardelji do e ketë vënë në dijeni Enverin për ofertat e grekëve ndaj jugosllavëve. Fjalët e Enverit dërguar Koçi Xoxes vetëm pak ditë pas ofertave greke e tregojnë këtë. Por, oferta greke e 11 gushtit nuk ishte vetëm në fjalë, por kishte kaluar edhe në një propozim konkret. Greqia propozonte ta ndihmonte Jugosllavinë në çështje të tjera problematike për të, me kusht që Jugosllavia të mos i bënte më presion Shqipërisë në lidhje me marrëdhëniet e saj me Greqinë dhe ta lejonte Greqinë të bënte pjesë të sajën jugun e Shqipërisë(Zivotić, A. 2010: 109). Greqia i kërkonte Jugosllavisë t’i hapte rrugën drejt aneksimit të atij që qeveria greke e quante “Epiri i Veriut”.

Kërcënimi i marrjes së “Epirit të Veriut” me armë nga kryeministri Papandreu ishte drejtuar ndaj Shqipërisë, por duket se shqetësimi më i madh i Greqisë ishte Jugosllavia pasi nëse kërcënimi vihej në praktikë, me shumë mundësi forcat e

armatosura greke do të kishin përballë ushtrinë jugosllave në jug të Shqipërisë, dhe kjo ishte ajo që përpiquej të mënjanonte Greqia.

Përgjigja e Kardeljit i shqetësoi grekët, të cilën deklaruan se do të kërkonin ndihmën e fuqive të mëdha. Në raportin dërguar Titos në 11 gusht të vitit 1946, Kardelji i thotë se kryeministri grek i kishte thënë se Shqipëria nuk e meritonte të ishte shtet(Zivotić, A. 2010: 109).

Sipas tij, Greqia dhe Shqipëria, edhe për shkak të miqësisë së tyre, duhet ta trajtonin dhe zgjidhnin këtë çështje së bashku(Zivotić, A. 2010: 109). Në fund Kardelji i tha kryeministrit grek se bisedimet për këtë çështje nuk kishin asnjë kuptim(Zivotić, A. 2010: 109). Gjatë gjithë Konferencës së Paqes, përfaqësuesit jugosllavë u përpoqën që Shqipëria të njihej si fituese në Luftën e Dytë Botërore dhe të merrte pjesë në Konferencën e Paqes.

Çështja e kufirit greko-shqiptar dhe aspiratat greke për jugun e Shqipërisë, morrën fund në Konferencën e Paqes në fund të gushtit të vitit 1946. Përfaqësuesit jugosllavë, në bashkëpunim edhe me përfaqësues të tjerë të vendeve të Evropës Lindore, si për shembull çekoslovakët, ndikuan që kjo çështje të mbyllej. Vetëm një ditë pasi kishte informuar Titon për ofertën e fundit të Greqisë për ndarjen e Shqipërisë me Jugosllavinë, Kardelji e bëri të njohur këtë ofertë përpara gjithë pjesëmarrësve në Konferencë(Zivotić, A. 2010: 109), gjë që dëmtoi imazhin e Greqisë dhe diskreditoi kërkesat e saj.

## 2.4 Jugosllavia dhe organizimi i Ushtrisë shqiptare (1946)

Në fillimet e marrëdhënieve të ngushta mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, një rol të veçantë kishte dhe organizimi i ri i Ushtrisë Shqiptare, veçanërisht duke patur parasysh problemet me çështjen e kufirit greko-shqiptar. Edhe në këtë drejtim, kërkesat për mbështetje dhe këshillim u drejtuan kah Jugosllavisë.

Jo vetëm politika e jashtme, por edhe çështje të brendshme të rëndësishme, siç ishte organizimi i ushtrisë shqiptare apo shërbimi i fshehtë, nuk mund të realizoheshin pa këshillën dhe ndikimin e jugosllavëve. Në maj të vitit 1946, Koçi Xoxe i shkruan Aleksandar Rankoviçit, ministër i brendshëm i Jugosllavisë, për çështjen e shërbimit të fshehtë shqiptar. “Me organizimin e ri të drejtimit të Mbrojtjes së Popullit në Ministrinë e Brendshme” shkruan Koçi Xoxe, “ne kemi përpara dy mendime për sa i përket oficerëve të Shërbimit të fshehtë. 1) Të shkëputen oficerët e Shërbimit të fshehtë nga Komanda e Përgjithshme, sepse deri tani ata vareshin nga ajo, organizivisht dhe financiarisht. Duke i shkëputur, ata behen kuadro të Ministrisë së Brendshme; 2) Të lihen oficerët e Shërbimit të fshehtë, siç kanë qenë më parë, duke mbetur kuadro të Komandës së Përgjithshme, por të transferohen në Ministrinë e Brendshme vetëm për shërbimin.” Koçi Xoxe e mbyll telegramin e tij drejtuar Rankoviçit duke iu lutur që t’i përgjigjet sa më parë se si mendon ai (domethënë Rankoviçi) të zgjidhet kjo çështje “sepse ne kemi problemin e buxhetit të Ministrisë sonë” përfundon Koçi Xoxe(AQSH. F14\AP, dosja 5, viti 1946).

Përgjigja e Rankoviçit vonon vetëm tre ditë dhe ai merr si shembull për rregullimin e çështjes së shqiptarëve një projektligj jugosllav(AQSH. F14\AP, dosja 5, viti 1946). Një këshillim të ngjashëm me jugosllavët, por për çështjen e ushtrisë shqiptare, e kërkon dhe Enver Hoxha në fund të vitit 1946 në një letër dërguar Titos. “Me anën e kësaj letre dëshiroja të këshillohesha me ju për disa probleme që kanë lidhje veçanërisht me ushtrinë tonë dhe me veprimet që mendojmë të bëjmë gjatë vitit 1947”(AQSH. F14\AP, dosja 5, viti 1946) e fillon letrën Enver Hoxha.

Më tej vazhdon duke dhënë detaje për ushtrinë shqiptare. “Që të jetë e qartë ekspozija ime, dëshiroj t’ju vë në dijeni juve shkurtimisht mbi situatën e Ushtrisë sonë Kombëtare. Kjo ka një forcë komplekse prej 44.015 vetash, duke përjashtuar prej kësaj shume forcat e policisë”(AQSH. F14\AP, dosja 5, viti 1946). Më tej Enver



Hoxha numëron 2 mijë e 927 oficerë, 5 mijë e 321 nënoficerë, 34 mijë e 937 ushtarë dhe 800 nxënës ushtarakë. Më tej skicon dhe paraqitjen organike të numrave që sapo ka përmendur më lartë duke përcaktuar se sa prej tyre janë hedhur në ushtrinë vitet 1942-43-44, përkatësisht 8 mijë e 987 veta, sa prej tyre janë thirrur rezervistë në muajin gusht të vitit 1946 dhe sa në tetor të po të njëjtit vit(AQSH. F14\AP, dosja 5, viti 1946).

Më tej Enver Hoxha lajmëron Titon se çfarë do të bëjë ushtria shqiptare përgjatë vitit 1947. “Për të normalizuar gjendjen organike të ushtrisë dhe në lidhje me programin e stërvitjes që kemi gati për vitin 1947, ne mendojmë që gjatë muajit janar 1947 të bëjmë lirim të 18.550 ushtarëve (8.987 ushtarë të vjetër dhe 9.513 rezervistë të gushtit 1946). Njëkohësisht me lirim të këtyre ne mendojmë të bëjmë mobilizimin e rekrutëve të datëlindjeve 1920-27 që arrijnë në numrin 16.500”(AQSH. F14\AP, dosja 5, viti 1946).

Në këtë mënyrë, sipas Enver Hoxhës, pas riorganizimit të ushtrisë, në fund të janarit të vitit 1947, ushtria shqiptare, përveç Divizionit të Mbrotjes së Popullit, do të ketë gjithsej 25 mijë e 611 trupa, rreth 2 mijë më pak se viti 1946. “Në këtë mënyrë” shkruan Hoxha, “Ushtria jonë Kombëtare kompleksivisht, me gjithë Divizionin e Mbrotjes së Popullit, në shkurt 1947 ka për të pasur një forcë prej 42.000 vetash me gjithë oficerë dhe nënoficerë, duke përjashtuar forcat e Policisë”(AQSH. F14\AP, dosja 5, viti 1946).

Përsa i përket ushtrisë shqiptare dhe këshillave si dhe ndihmës materiale që ajo kërkonte prej Jugosllavisë, ja vlen të ndalemi edhe pak më tej, për të parë një relacion drejtuar Enver Hoxhës nga zëvendës drejtori politik i ushtrisë shqiptare. Autorët Malltezi dhe Plasari në botimin e tyre të disa dokumenteve mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet 1945-1948, një botim që është cituar dhe do të citohet në këtë punim për brendësinë e dokumenteve të botuara prej tyre, bëjnë një pohim të çuditshëm në faqen 90 të librit, ku thonë se “E. Hoxha...ka qenë plotësisht për bashkimin e Ushtrisë Shqiptare me Ushtrinë Jugosllave”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 90).

Ky pohim i tyre nuk është i vetmi në këtë libër dhe shërben për të përforcuar tezën e tyre se Enver Hoxha dhe udhëheqja shqiptare e kohës kishin për qëllim të bashkonin Shqipërinë me Jugosllavinë, domethënë ta bënin Shqipërinë republikë të shtatë të Jugosllavisë. Kjo tezë në këtë punim, hidhet poshtë, edhe për shkak të dokumenteve ish jugosllave që tregojnë se megjithëse kishte fjalë për këtë çështje, nuk kishte asnjë plan konkret dhe asnjë dëshirë as nga pala jugosllave, as nga vetë Josip Broz Tito, që kjo të ndodhte, madje marrëdhëniet e Jugosllavisë me Bullgarinë shkuan shumë më larg se ato me Shqipërinë në krijimin e një shteti të përbashkëto bullgaro-jugosllav, por për këtë do të flitet më vonë me detaje në këtë punim.

As në këtë relacion dërguar Enver Hoxhës, as në letrën që vetë Enver Hoxha i dërgoi Titos për problemet në ushtri dhe ndihma që ai priste nga Jugosllavia, as në telegramet e Koçi Xoxes dërguar Aleksandar Rankoviçit, nuk thuhet që Shqipëria synon ta bashkojë ushtrinë e saj me ushtrinë jugosllave. Nëse ky do të kishte qenë një qëndrim i Enver Hoxhës, vështirë që ai të mos e kishte përmendur në letrën dërguar Titos.

Ashtu si edhe në rastin e marrëdhënieve ekonomike që do i shohim më vonë, edhe në rastin e marrëdhënieve ushtarake, Enver Hoxha dhe udhëheqja shqiptare kërkoi prej jugosllavëve ndihmë për të ngritur në këmbë ushtrinë shqiptare apo ekonominë e Shqipërisë dhe jo të bashkonte ushtrinë shqiptare me atë jugosllave.

Zëvendesdrejtori politik i ushtrisë shqiptare, Pëllumb Dishnica, i shkruan Enver Hoxhës për takimin e tij me Shefin e Shtabit të Ushtrisë, Mehmet Shehun, dhe një ndër çështjet që ka diskutuar me të është ‘‘çështja për orientimin e zhvillimit të ushtrisë sonë dhe për karakterin e marrëdhënieve të ushtrisë sonë me Ushtrinë Jugosllave’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 93).

Më tej në relacion shkruhet se ‘‘në lidhje me ndërtimin e një doktrine lufte të ushtrisë sonë, kjo u prek në diskutimet. Mbi tezat shfaqta mendimin...se për ne nuk shtrohet çështja e një doktrine luftarake shqiptare, sepse ne jemi një vend i vogël, por për ne është puna të nxjerrim mësim nga Lufta jonë NÇ (nacionalçlirimtare *shën. i autorit*), si ato pozitive dhe negative dhe të bazohemi në doktrinën e Ushtrisë Sovjetike. Ushtria Jugosllave ndofta mund të mendojë për një doktrinë të saj.

Në lidhje me zhvillimin e armëve të ndryshme si xhenioja, ndërlihdhja, tanket, aviacioni, marina, që ngrihet në tezat e paraqitura, mua më duket se nuk mund të mendojmë pavarësisht nga Ushtria Jugosllave, ashtu si nuk mund të mendojmë për një plan veprimi në rast lufte, qoftë për mbrojtjen e bregdetit, qoftë për mbrojtjen e kufijve tanë të jugut, pavarësisht nga Ushtria Jugosllave''(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 93).

Çështja e kufijve të jugut të Shqipërisë del edhe në këtë rast, ashtu si përmendja e rastit të luftës nuk mund të jetë e rastësishme, edhe për shkak të situatës në Ballkan, por kjo nuk do të çonte në bashkim të ushtrisë shqiptare me ushtrinë jugosllave, por në bashkëpunim mes të dyjave, gjë që shihet edhe më tej në relacion:

''Duke marrë parasysh karakterin e marrëdhënieve tona me Jugosllavinë, të cilat do të vijjnë duke u bërë sa më të ngushta dhe duke nisur nga mendimi që përmenda më lart se në rast lufte ne nuk do të veprojmë në mënyrë independente, por me një plan të përbashkët, i cili më duket se është shumë i afërt se ndonjë plan që mund të bëhet midis dy vendeve çfarëdo, që kanë një aleancë të zakonshme ndihme reciproke, ngrita pyetjen në se ishte e drejtë që ta shtronim çështjen kështu:

Ne të mendojmë për zhvillimin e armëve të ndryshme si xhenio, ndërlihdhje, tanke, etj., ashtu si duhet t'i ketë një armatë e madhe që vepron në konditat e një terreni kryesisht malor (në qoftë se s'gabohem, me mobilizim total ne mund të kemi një armatë të madhe të përbërë prej rreth 8-9 divizionesh të plota), ndërsa për çështjen e zhvillimit të aviacionit e të marinës, më duket se duhet ta shikojmë të lidhur ngushtë me Ushtrinë Jugosllave''(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 94).

Pra, koncepti i tij për marrëdhëniet me ushtrinë jugosllave është ai i bashkëpunimit, veçanërisht në ato pika ku ushtria shqiptare ka dobësi, dhe se ushtria jugosllave ashtu si dhe ushtria shqiptare duhet të jetë modele për organizimin e ushtrisë shqiptare. ''...me një fjalë në dy vende miq e fqinj, që po shkojnë së bashku, po luftojnë së bashku për të ndërtuar socializmin, edhe ushtritë duhet të shkojnë sa më afër njëra-tjetrës, në zhvillimin e tyre, domethënë të përpiqemi që, sa të jetë e mundur, të krijojmë forma të njëjta si në armatim (të cilin e kemi të përbashkët, sepse furnizimin

e kemi që andej edhe në pikëpamje materiale), ashtu edhe në organizim, në stërvitje, përgjithësisht në të gjitha format e punës për përgatitjen e ushtrisë. Kjo do të thotë që në përpilimin e organikave të ushtrisë sonë duhet të marrim kryesisht për bazë organikat e ushtrisë jugosllave, ashtu si edhe në programet e stërvitjes duhet që të kemi gjithmonë parasysh programet e Ushtrisë Jugosllave dhe të përpiqemi që të adaptojmë programet tona sa më afër tyre të jetë e mundur”, shkruhet në relacion (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 94).

Tezën që ngrenë autorët Malltezi dhe Plasari për bashkimin e ushtrisë shqiptare me atë jugosllave e ngre si shqetësim edhe Mehmet Shehu, në atë kohë Shefi i Shtabit të Ushtrisë, i cili sipas zëvendës drejtorit politik të ushtrisë në relacionin dërguar Enver Hoxhës, thotë se Mehmet Shehu i kishte thënë se “kjo çështje ishte një çështje me shumë rëndësi, porse këtu paraqiteshin dy orientime: ose të veprohej kështu si ishte vepruar dhe ai ishte i atij mendimi ose të veprohej ashtu si mendoja unë, porse kjo desh të thoshte që të shndërroheshin menjëherë në një armatë të Ushtrisë Jugosllave, të merrnim e të kopjonim urdhrat që do të na dërgonte Koça Popoviçi, t’i vinim një kryq Komandantit të Përgjithshëm dhe t’i përzinin instruktorët sovjetikë” (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 94).

Megjithë shqetësimin e Mehmet Shehut, ushtria shqiptare nuk u bashkua me ushtrinë jugosllave, as në vitet 1946-47 kur marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishin në kulmin e afrimitetit të tyre, dhe nëse do të kishte qenë qëllim bashkimi i ushtrive ashtu si ç’mund të kishte qenë qëllim bashkimi i dy shteteve, kjo mund të ishte realizuar.

“Të shkosh drejt unifikimit në të gjitha format e organizimit politik e ushtarak të Ushtrisë sonë me Ushtrinë Jugosllave, të bazohesh kryesisht në organizimin, rregulloret, instruksionet, programet e Ushtrisë Jugosllave, nuk më duket se kjo do të thotë, ashtu si përfundon gjen. Mehmeti që të inkuadrohesh formalisht si një armatë në UJ, të shkëputësh menjëherë lidhjet me Komitetin Qëndror, t’i vësh kryq Komandantit të Përgjithshëm etj.” (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 96), shkruan Pëllumb Dishnica në relacionin dërguar Enver Hoxhës.

Qëndrimi i tij për këtë çështje është i pranueshëm, pasi flet për modelim të ushtrisë shqiptare në ushtrinë jugosllave, ashtu si në një masë të madhe ekonomia shqiptare u modelua sipas asaj jugosllave, dhe në vitin 1948, kur marrëdhëniet me Jugosllavinë u prishën dhe Shqipëria u afrua më shumë se më përpara me Bashkimin Sovjetik, edhe ekonomia shqiptare u modelua sipas asaj sovjetike.

### **Kreu III. Afrimi dhe keqkuptimet e tij**

#### **3.1 Vizita e Enver Hoxhës në Beograd**

Në 23 qershor të vitit 1946, në aeroportin e Zemunit, në periferi të Beogradit, për të pritur Enver Hoxhën dhe delegacionin shqiptar, ka dalë Mareshalli i Jugosllavisë, Josip Broz Tito si dhe anëtarë të tjerë të qeverisë jugosllave, sekretari i Presidiumit, kryetarët e këshillit qendror dhe këshillit të popullit, kryetarët e komiteteve, kryetari i Asamblesë Popullore të Serbisë, kryetari i qeverisë së Serbisë, shefi i Gjeneralshtabit të Armatës Jugosllave (AMPJ, drejtorja IV, Jugoslavia, dosja 94).

Në aerodrom nga krahu i djathtë vendoset muzika, batalioni i nderit, trupi diplomatik, përfaqësuesit e Asamblesë, përfaqësuesi i Presidiumit, anëtarët e qeverisë si dhe personalitetet të tjera. Mikrofonit është vendosur në krahun e majtë të kompanisë. Me rastin e ardhjes së aeroplanit Kryetari i qeverisë së Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë dhe njëkohësisht Mareshalli i Jugosllavisë, Josip Broz Tito zë vend përpara anëtarëve të qeverisë. Kompania muzikore luan hymnin shqiptar dhe atë jugosllav. Mbas përshëndetjes së qeverisë shqiptare, Mareshali i Jugosllavisë i prezanton kryetarit të qeverisë shqiptare, anëtarët e qeverisë së RPFJ dhe ministrin e punëve të jashtme si dhe trupin diplomatik(AMPJ, drejtorja IV, Jugoslavia, dosja 94).

Delegacioni shqiptar në vizitën në Jugosllavi kryesohet nga Enver Hoxha në cilësinë e kryetarit të qeverisë shqiptare, ministrit të mbrojtjes kombëtare dhe ministrit të punëve të jashtme. Më tej në delegacionin shqiptar është Gjeneral Major Myslim Peza, nënpresident i Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërisë, Gjeneral major Bedri Spahiu, Manol Konomi, ministër i drejtësisë, Nako Spiru, ministër i ekonomisë, Kolonel Nesti Nerenxhiu, zëvendës ministër i punëve të brendshme, Kolonel Manush Myftiu, drejtor i drejtorisë politike pranë Shtabit të Përgjithshëm dhe Nën kolonel Vasil Konomi, zëvendës ministër i punëve të jashtme(AMPJ, drejtorja IV, Jugoslavia, dosja 94).

Katër ditë më parë, në 19 qershor 1946, Koçi Xoxe, i dërgon telegram Hysni Kapos, ministrit shqiptar në Beograd, në të cilën i shkruan se ‘’ të djelën me datën 23 qershor vjen atje tarasi me shokët për punën që dinë të stop prandaj bëj përgatitjet stop njoftonani marrjen e radiogramit stop’’(AMPJ, drejtorja IV, Jugoslavia, dosja 94).

Shqiptarët dëshiron mbi të gjitha të shkonin në Moskë, te Stalini, për të diskutuar problemet dhe të ardhmen e tyre, por për të shkuar në Moskë, fillimisht duhej kaluar në paradhomën jugosllave, për të zgjidhur çdo problem dhe shqetësim që ata kishin, që më pas vizita në Moskë të ishte më shumë një vizitë kortezie se sa problemzgjdhëse.

Që Shqipëria pa dëshirë kishte mbetur në dorë të jugosllavëve e tregon dhe një raport nga Tirana për Beogradin i fundit të vitit 1945. Në të thuhet se ‘shqiptarët prisnin ndihmën sovjetike, e cila nuk erdhi, gjithë puna iu la në dorë jugosllavëve’ (ACKSKJ, IX, 1-I- 27).

Kjo ishte vizita e parë e Enver Hoxhës në Beograd, por jo e para e një delegacioni të qeverisë shqiptare të dalë nga lufta në Beograd. Një vit e gjysmë më parë, në dhjetor të vitit 1944, një delegacion shqiptar kishte vizituar Beogradin. Në të kohë delegacioni shqiptar kishte ardhur ilegalisht në Beograd(Đurić, L. 1989:260). a çështje të rëndësishme të cilat kishin të bëjnë me marrëdhëniet e jashtme të shtetit shqiptar në periudhën e luftës dhe të pasluftës. Myslîm Peza(Đurić, L. 1989:260). Funkzionari jugosllav që i shoqëroi dhe u përkujdes për vendosjen e tyre në hotelin “Union” shkruan se Omer Nishani ishte “burrë i vjetër, i qetë dhe i kulturuar, me një sjellje shumë fine ndaj të gjithëve, fliste frëngjisht...Koçi Xoxe dhe Nako Spiru dinin pak italisht dhe ndonjë fjalë nga tonat. Diçka prej gjuhës sonë e kishin mësuar nga Miladin Popoviçi dhe Dushan Mugosha. Myslim Peza njihte vetëm shqip dhe shumicën e kohës heshtte dhe ndonjë herë ngërdheshej”(Đurić, L. 1989:260).

Përshkrimi i pjesëmarrësve të delegacionit ilegal të dhjetorit 1944, na lejon të njohim sjelljen kundrejt jugosllavëve të një pjese të delegacionit të qershorit 1946 që ishte pjesë e delegacionit edhe një vit e gjysmë më parë.

Më tej, funksionari jugosllav vazhdon duke thënë se Nako Spiru ishte gjaknxehtë dhe shpeshherë i pakënaqur nga diçka (Đurić, L. 1989:260).

Por, Koçi Xoxe ishte njeriu që e qetësonte dhe që shfaqej si më racional dhe më i besueshmi në sytë e jugosllavëve. Këtë e konfirmon dhe Svetozar Vukmanoviç

Tempo, i cili gjatë një vizite në Shqipëri në fshatin Labinot, afër Elbasanit, në vitin 1943, në takim me Miladin Popoviçin dhe Dushan Mugoshën foli edhe për mbledhjen e parë që ishte zhvilluar në atë fshat e Konferencës së Partisë Komuniste, në të cilën ishte zgjedhur dhe Komiteti Qëndror. Ajo që i kishte bërë përshtypje Tempos pas takimit me drejtuesit e Partisë Komuniste Shqiptare, ishte se në udhëheqje ishin pothuajse të gjitha intelektualë dhe nuk kishte punëtorë (Tempo, S.V 1971: 357).

Miladini dhe Dushani më tej i kishin shpjeguar Tempos rastin e një punëtori, që sipas tyre ishte komunisti më i mirë në Partinë Komuniste Shqiptare, por që në atë kohë gjendej në burg, i akuzuar për vrasje. “Më vonë”, shkruan Tempo në librin e tij me kujtime, “mora vesh që bëhej fjalë për Koçi Xoxen” (Tempo, S.V 1971: 357).

Edhe disa vite pas prishjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në një takim me Hrushovin, Tempo do të përsëriste mendimin e tij pozitiv për Koçi Xoxen duke iu drejtuar Hrushovit me fjalët: “Komunistin më të mirë të Shqipërisë, Koçi Xoxen, ju e vratë... Ishte punëtor dhe revolucionar i madh” (Tempo, S.V 1971: 357).

Mendimin e mirë që jugosllavët kishin për Koçi Xoxen e paraqitën edhe në takimin me Stalinin, në maj të vitit 1946, ku sipas dokumentit jugosllav thuhet se “shokët e Byrosë Politike nuk e konsiderojnë Enver Hoxhën njeri me partishmëri fort të mjaftueshme dhe prandaj gjithnjë ngulin këmbë, që me të, të vijë Koçi Xoxe, si anëtar i vjetër i partisë në Byrosë Politike” (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 27).

Megjithëse vizita e Enver Hoxhës dhe delegacionit shqiptar në Beograd vinte në mesin e vitit 1946, marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë kishin filluar rrugën e afrimit mes tyre qysh në shkurt të vitit 1945.

Afrimi kishte filluar pikërisht në kohën kur Shqipëria dhe udhëheqja e saj shqetësoheshin për çështjen e kufirit greko-shqiptar dhe ndikimit që kjo çështje mund të kishte në marrëdhëniet me Britaninë e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat mbështesnin Greqinë.

Në të njëjtën kohë, vizita e delegacionit shqiptar në Beograd ishte vënie në praktikë e asaj që Tito kishte diskutuar me Stalinin, në Moskë, një muaj më parë. Siç e pamë dhe



në kapitullin e kaluar nga raportimet e të dërguarit jugosllav në Tiranë, për disa muaj, megjithëse afrimi në marrëdhënie kishte filluar qysh në fund të luftës, jugosllavët kishin qenë të paqartë me orientimin përfundimtar të Shqipërisë në politikën e jashtme, dhe ia kishin faturuar këtë ç'orientim pikërisht Sejfulla Malëshovës, por në të njëjtën kohë edhe një pjese të udhëheqjes shqiptare që kishte rënë brenda "kurtheve" të Sejfulla Malëshovës, por dhe dyshimeve të vetë Enver Hoxhës të bëra të njohura nga Josip Xherxha dhe Savo Zllatiç.

Fjalët e Stalinit gjatë takimit në Moskë me Titon për afrimin sa më të madh me Shqipërinë, duket se fshinë çdo rezervë që jugosllavët mund të kishin pasur në lidhje me afrimin me Shqipërinë. Vizita e Enver Hoxhës në Beograd ishte shtyrë me qëllim që jugosllavët të kuptonin qëndrimin e qartë të Stalinit për këtë çështje (Zivotic, 2011: 178).

Takimet e Titos me Stalinin në Moskë në fillim të vitit 1946 tregojnë një Stalin shumë më të prirur për një marrëdhënie të ngushtë të Jugosllavisë me Shqipërinë dhe Bullgarinë se sa tregohet vetë udhëheqësi jugosllav.

Vizita në Beograd do të shërbente për të fshirë çdo paqartësi tek jugosllavët, të cilët edhe në takimin e majit me Stalinin e kishin shprehur këtë paqartësi ku Titua i pyetur nga Stalini nëse dinte gjë për mosmarrëveshjet brenda Byrosë Politike të Partisë Komuniste Shqiptare, i tha që ishte i painformuar dhe se në kohën më të afërt parashikohej ardhja e Enver Hoxhës në Beograd (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 27).

Kjo thënie e Titos nuk ishte plotësisht e saktë, pasi jugosllavët ishin të informuar nga i dërguari i tyre në Tiranë për mbledhjen e Byrosë Politike në dhjetor të vitit 1945 dhe më pas në Pleniumin e shkurtit 1946 ishte diskutuar çështja e orientimit në politikën e jashtme dhe argumentet e Sejfulla Malëshovës.

Në të njëjtën kohë, vizita në Beograd do të shërbente edhe për të lidhur disa marrëveshje të rëndësishme mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë si dhe për të diskutuar ato marrëveshje që do të lidheshin në të ardhmen.

### 3.2 Marrëveshjet

Traktati i dytë i miqësisë dhe ndihmës së ndërsjelltë mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nënshkruhet në korriku të vitit 1946, pak ditë pas përfundimit të vizitës së Enver Hoxhës në Beograd. Ky traktat i dytë është përtëritje e traktatit të shkurtit të vitit 1945, por këtë herë bëhet ndërmjet dy shteteve dhe jo një shteti siç ishte Shqipëria në shkurt 1945 dhe një përfaqësie të Këshilit Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë.

Në artikullin e parë të kësaj marrëveshjeje të dytë thuhet se të dyja palët e ndërmarrin këtë marrëveshje në interes të të dyja shteteve me qëllim përmirësimin e marrëdhënieve që tashmë ekzistojnë mes dy vendeve dhe zgjerimin e tyre në të gjitha fushat (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 810).

Në artikullin e dytë të traktatit thuhet se të dy vendet do të bëjnë gjithçka me qëllim sigurimin e pavarësisë dhe integritetit të të dy vendeve, që të parandalohet një sulm i ngjashëm ndaj tyre siç ishte ai i Gjermanisë së Hitlerit apo Italisë së Musolinit, ndërkohë që në artikullin e tretë thuhet se nëse njëri prej dy shteteve nënshkruese të traktatit, do të sulmohet me qëllimin kërcënimin e sovranitetit apo marrjen e një pjese të territorit të saj, pala e dytë nënshkruese pa vonesë do të dërgojë ndihmë ushtarake dhe çdo lloj ndihme tjetër (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 811).

Artikulli i tretë i traktatit praktikisht vë në praktikë atë që gjer në atë moment Jugosllavia e kishte bërë në Konferenca Ndërkombëtare: mbrojtjen e Shqipërisë, tashmë edhe ushtarakisht.

Kjo i shkonte për shtat fjalëve të Titos, në maj të vitit 1945, i cili kishte thënë se Shqipëria nuk mund të qëndronte në këmbë pa ndihmën e Jugosllavisë dhe se është detyra e Jugosllavisë që ta ndihmojë (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 812).

Në korrik të vitit 1945, Tito tha se ishte krijuar një koalicion i pathyeshëm mes Jugosllavisë, Bashkimit Sovjetik, Polonisë, Çekosllovakisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 817).

Traktati i dytë me Shqipërinë në vitin 1946, pasohet në vitin 1947 me traktatet me Rumaninë, Hungarinë dhe Bullgarinë. Qëllimi i këtyre traktateve ishte krijimi i një sistemi sigurie në Evropën Lindore. Të gjitha këto traktate u nënshkruan duke pasur për bazë traktatin mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik në vitin 1945.

Është e rëndësishme që kjo gjë të vihet në dukje dhe traktatet dhe marrëveshjet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë të mos shihen të shkëputura nga konteksti i Evropës Lindore të pas Luftë së Dytë Botërore. Nëse do të shiheshin të shkëputura nga ky kontekst dhe të pakrahasuara me marrëveshjet që Jugosllavia nënshkroi me vendet e tjera të Evropës Lindore apo këto vende nënshkruan me njëra-tjetrën, do të dukej sikur nëpërmjet këtyre traktateve dhe marrëveshjeve Jugosllavia po përpiquej të nënshtrohte Shqipërinë.

Gazeta “Borba” e datës 11 korrik 1946 raporton fjalët e Enver Hoxhës pas nënshkrimit të traktatit, ku kishte thënë se “marrëveshja që kemi nënshkruar përfaqëson për popullin shqiptar garancinë e sigurimit dhe rigjenerimit të vendeve tona”. Më tej Enver Hoxha kishte thënë duke iu drejtuar Titos se “në popujt e Jugosllavisë dhe në personalitetin...e marshallit Josip Broz Tito, ne shohim miq të afërt dhe të sinqertë, i cili...ka ndihmuar popullin tonë për të arritur fitoren e sotme dhe i cili në masa edhe më të mëdha ofron ndihmë për mbrojtjen e lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit të vendit tonë, zhvillimin e Shqipërisë”(Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 817).

Në Shqipëri, gazeta “Bashkimi” raporton komunikatën e Agjencisë Telegrafike Shqiptare për nënshkrimin e traktatit dhe se “një pakt i tillë do të konfirmojë vëllazërimin e palëkundshëm të vaditur me gjak, të krijuar në Luftën e madhe Çlirimtare të përbashkët kundër të njëjtit armik, do të konfirmojë vullnetin e popujvet të të dy vendeve për të mbrojtur së bashku dhe në të ardhmen lirinë dhe independencën e tyre” (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 44)

Raportimin e 3 korrikut, gazeta “Bashkimi” e pason me një kryeartikull të 14 korrikut mbi traktatin e miqësisë mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Në kryeartikull thuhet se “traktati hap rrugën për prosperitetin e vendit tonë, për rindërtimin në të gjitha fushat. Vendi ynë ka nevojë për bashkëpunim me miq të sinqertë dhe besnikë si

Jugosllavia e Mareshalit Tito, ka nevojë për miq që nuk kanë qëllime grabitqare dhe shfrytëzimi. Traktati i miqësis dhe i Ndhmës reciproke patjetër do të sjellë një zhvillim më të madh të mundësive të vendit tonë për t'i përdorur fuqitë e tij për rindërtimin e vendit'' (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 44). Gjithashtu kryeartikulli i gazetës ''Bashkimi'' thekson faktin që marrëveshja me Jugosllavinë është një garanci e fortë për pavarësinë e Shqipërisë dhe faktor paqeje në Ballkan.

Traktati i Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë u miratua dhe u shndërrua në ligj në mbledhjen e Kuvendit Popullor të 6 gushtit 1946. Por, viti 1946, edhe para vizitës së Enver Hoxhës në Beograd, ishte dhe do të vazhdojë të jetë gjer në dhjetor, viti i marrëveshjeve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

Në 6 shtator të vitit 1946, Kuvendi Popullor miratoi marrëveshjen mbi aviacionin civil të nënshkruar në Tiranë më 11 korrik 1946 ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë (AQSH, fondi 489, v 1946, dosja 176, fq 1-5). Njëpërmjet kësaj marrëveshjeje të dyja vendet njohin sovranitetin e plotë dhe ekskluziv mbi hapësirën atmosferike mbi tokën e tyre. Gjithashtu pika gjatë e kësaj marrëveshjeje parashikon të drejtën e secilit shtet ''për arsye të domosdoshmërisë ushtarake apo në interes të sigurisë publike, t'u ndalojë mjeteve ajrore civile të Shtetit tjetër fluturimin përmbi disa zona të tokës së vet, në hapësirën civile ajrore të shtetit tjetër''(AQSH, fondi 489, v 1946, dosja 172, fq 1-33).

Gjithashtu në 10 shtator 1946 nënshkruhet dhe marrëveshja për shërbimin detar ''duke parë dëshirën e përbashkët për të vendosur një shërbim detar të rregullt ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë kanë rrënë në ujdë për të përfunduar këtë Marrëveshje dhe kanë emëruar për këtë qëllim përfaqësorët e tyre'': Spiro Koleka, ministër i punëve Botore të Shqipërisë dhe Josip Xherxha, ministër fuqiplotë dhe i dërguar i jashtëzakonshëm i Jugosllavisë në Tiranë (AQSH, fondi 489, v 1946, dosja 172, fq 1-33).

Njëpërmjet kësaj marrëveshjeje krijohet një itinerar Zadar-Shibenik-Split-Dubrovnik-Selenika—Shën Gjini-Durrës-Vlorë dhe duke përfunduar në Sarandë, për transportin e udhëtarëve dhe mallrave mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

Në marrëveshje parashikohet që do të jenë anijet jugosllave që do të bëjnë transportin e udhëtarëve dhe mallrave në portet e Shqipërisë, nëse anijet shqiptare nuk e sigurojnë dot këtë gjë (AQSH, fondi 489, v 1946, dosja 172, fq 1-33).

Më 21 shtator 1946 Presidiumi vendosi të ratifikojë marrëveshjen mbi vendosjen e shërbimit detar, lidhur e nënshkruar në Tiranë më 10 dhjetor 1946 ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë.

Para këtyre marrëveshjeve dhe para vizitës së Enver Hoxhës në Beograd, në 20 shkurt 1946, ora 11 e paradites, u nënshkrua në Beograd, nga ministri fuqiplotë Hysni Kapo dhe nënministri i punëve të jashtme të Jugosllavisë Vladimir Velebit, protokoll i trafikut kufizor midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë (AQSH, fondi 489, v 1946, dosja 172, fq 1-33).

Ky protokoll do të jetë i nevojshëm deri sa të mos jetë lidhur një akord tregtar i cili të disiplinojë në përgjithësi marrëdhëniet tregtare midis dy vendeve si dhe marrëdhëniet e banorëve të zonave kufitare. Nëpërmjet këtij protokoll banorët e zonave shqiptare të kufirit me Jugosllavinë lejohen të shkojnë deri në një thellësi prej 15 kilometrash në tregjet e zonës jugosllave për të shitur produktet e tyre (AQSH, fondi 489, v 1946, dosja 141, fq 1-33).

Çështja e trafikut kufizor dhe e kalimit të kufirit nga shtetasit shqiptar është shumë e rëndësishme për ekonominë e zonave kufitare me Jugosllavinë, sidomos ato në verilindje dhe veriperëndim. Për shumë fshatarë të Kukës, Tropojës apo rrethinave të Shkodrës, tregu më i afërt për shitjen e produkteve të tyre ishte në anën tjetër të kufirit shtetor mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në Kosovë për pjesën verilindore dhe në Ulqin në Mal të Zi për pjesën veriperëndimore.

Nga marrëveshjet e përmendura gjer tani nuk ka asgjë të jashtëzakonshme në marrëdhëniet mes dy vendeve fqinje, në të cilat partitë në pushtet janë ideologjikisht të afërta. Nuk ka asgjë në këto marrëveshje që të na çojë të mendojmë se Shqipëria

mund të bëhej pjesë e Federatës Jugosllave, ashtu siç shtypi i huaj, ai perëndimor, siç e pamë dhe më lart, kishte shkruar pas vizitës së Enver Hoxhës në Beograd.

Siç do e shohim edhe më vonë, Bullgaria shkoi shumë më larg se Shqipëria në hapat drejt krijimit të një Federate me Jugosllavinë, por qoftë në Bullgari, qoftë në Jugosllavi nuk kishte shumë interes për një çështje të tillë, një çështje për të cilën direktivat vinin nga Moska, jo nga Beogradi apo Sofia.

Para këtyre marrëveshjeve dhe para vizitës së Enver Hoxhës në Beograd, në 20 shkurt 1946, ora 11 e paradites, u nënshkrua në Beograd, nga ministri fuqiptotë Hysni Kapo dhe nënministri i punëve të jashtme të Jugosllavisë Vladimir Velebit, protokolli i trafikut kufizor midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë (AQSH, fondi 489, v 1946, dosja 172, fq 1-33).

Në nëntor të vitit 1946 mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nënshkruhet dhe traktati për koordinimin e planeve, për bashkimin doganor dhe barazimin e monedhave. Se çfarë përmban ekzaktësisht ky traktat dhe si u zbatua në praktikë do të flitet në një kapitull më vete ku do të trajtohen marrëdhëniet ekonomike, por këtu duhet paraqitur qëndrimi i qeverisë shqiptare, veçanërisht i Enver Hoxhës për këtë traktat, i cili do të jetë objekt diskutimi edhe në Plenumin e Jashtëzakonshëm të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare, mbajtur në dhjetor të vitit 1946.

Në një letër të 22 nëntorit 1946, drejtuar Nako Spirut, i gjendur në atë kohë në Beograd për nënshkrimin e marrëveshjes ekonomike, Enver Hoxha i shkruan se “përsa i përket akordit në princip për unifikimin e çmimeve, bashkimin doganor dhe bashkëpunimin në përpilimin e planeve, edhe atje s’kemi kundërshtim, vetëm shtojmë se për realizimin e këtij akordi duhet marrë parasysh çështja financiare me shumë rëndësi dhe që lyp studime të hollësishme” (AQSH, F.14\AP, dosja 12, viti 1946). Gjithashtu Enver Hoxha shprehet dakord edhe me krijimin e shoqërive të përbashkëta shqiptaro-jugosllave dhe përfundon duke thënë se “mendimi ynë është që t’i nënshkruash. Për realizimin mbasandaj duhet të studiohen mirë konkretisht, si nga ana jonë, ashtu edhe nga ana e tyre” (AQSH, F.14\AP, dosja 12, viti 1946).

Pak ditë më vonë, Enver Hoxha i dërgon përsëri letër Nako Spirut në Beograd ku i përsërit urdhrin për të nënshkruar marrëveshjet (AQSH, F.14\AP, dosja 12, viti 1946).“Për arsytet fundamentale ne jemi dakord” i shkruan Hoxha Spirut.

Ndihma jugosllave për Shqipërinë nuk vinte vetëm në marrëveshje ekonomike të një rëndësie të madhe shumëvjeçare apo në mbështetjen në Konferencën e Paqes në Paris, por edhe në çështje më të përditshme, siç ishin përmbytjet e mëdha në nëntor të vitit 1946, veçanërisht në rrethet e Beratit, Lushnjës, Rogozhinës dhe Elbasanit, “rajonë të shquara partizane”, thuhet në gazetën beogradase *Politika* e 6 nëntorit 1946 (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 822-823).

“Në këtë katastrofë”, shkruhet më tej, “një numër i konsiderueshëm njerëzish, grash e fëmijësh humbën jetën” (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 822-823).Gjithashtu pati një numër të madh banesash të dëmtuara. “Mijëra shqiptarë janë gjendur, sot, në prag të dimrit, pa çati mbi kokë, të cilat pak kohë më parë janë ngritur mbi shkatërrimet e luftës. Popullit shqiptar i duhet dhënë ndihmë”, vazhdon shkrimi, “nuk ka asnjë qytetar tonin, asnjë organizatë mase që nuk do t’i përgjigjej thirrjes së fqinjit të parë. Por kjo nuk duhet të jetë thjesht ndihmë e fqinjit për fqinjin” (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 822-823).

Më tej shkrimi i *Politikës* thotë se ndihma duhet të shkojë si një larje borxhi për shqiptarët që luftuan për çlirimin e Jugosllavisë në vitin 1944, por gjithashtu duhet të jetë edhe një njohje e përpjekjeve të shqiptarëve për ndërtimin e demokracisë së tyre dhe në të njëjtën kohë të mbrojtjes së pavarësisë së tyre dhe zhvillimit demokratik të gjithë popujve të ballkanit (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 822-823).

### 3.3 Reagimi ndërkombëtar ndaj marrëveshjeve me Jugosllavinë

Vizita e Enver Hoxhës dhe delegacionit shqiptar në Beograd si dhe marrëveshjet e nënshkruara mes dy vendeve ishin objekt komenti dhe analiza edhe prej shtypit perëndimor. Në rrethet diplomatike dhe mediatike perëndimore pas vizitës së Hoxhës në Beograd flitej edhe për një bashkim të mundshëm mes dy vendeve (Zivotić, A. 2010: 87).

Për median perëndimore ky afrim mes dy vendeve, shihej si një çmim që Shqipëria duhet të paguante për mbështetjen që Jugosllavia i kishte dhënë gjer atëherë, veçanërisht për mbrojtjen në Konferencën e Paqes në Paris. Për të dërguarin amerikan në Tiranë, i dyshimtë ishte roli i ekspertëve jugosllavë që ishin vendosur në Shqipëri. Gjithashtu, qeveria britanike, traktatin mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë për bashkimin e doganave, që do trajtohet në një kapitull tjetër në këtë punim më me detaje, e pa si një hap drejt krijimit të një Federate mes dy shteteve.(Zivotić, A. 2010: 87).

Për britanikët, Shqipëria kishte rëndësi gjeostrategjike dhe nëpërmjet kontrollit të saj prej Jugosllavisë i lejohej në mënyrë indirekte Bashkimit Sovjetik të kishte dalje në Mesdhe. Por, fakti është që mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk pati bisedime për krijimin e një Federate apo bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë as në Beograd në vitin 1946 me rastin e vizitës së Enver Hoxhës aty dhe as më vonë. Bisedime për krijimin e një Federate pati vetëm mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë, madje u nënshkruar dhe një marrëveshje e detajuar për këtë çështje, por që nuk u arrit të krijohet një Federatë mes tyre.

Edhë në shtypin italian, ndaj vizitës së Enver Hoxhës në Beograd dhe marrëveshjes për miqësinë dhe ndihmën reciproke mes dy vendeve, pati të njëjtin reagim si dhe në vendet e tjera perëndimore (Zivotić, A. 2010: 87).

Në këndvështrimin e ambasadorit amerikan në Itali, Shqipëria do të aneksohej nga Jugosllavia, apo Jugosllavia mbështeste pretendimet territoriale të Shqipërisë ndaj Greqisë apo se Shqipëria do të hynte në Federatën Jugosllave si republikë e shtatë, e cila do të kishte autonominë e saj dhe do të lejohej përdorimi i gjuhës së saj (Zivotić, A. 2010: 87).Të gjitha këto më lart janë vetëm supozime, pasi vizita e Enver Hoxhës



në Beograd sigurisht që e afroi shumë Shqipërinë me Jugosllavinë, ashtu siç më vonë marrëveshje ekonomike do e afrojnë edhe më shumë, por realizimi i një Federate mes të dy vendeve nuk duket se është shtruar për diskutim.

Kur shkruhet për marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948, është e nevojshme të bëhet një pyetje e rëndësishme: çfarë mundësish bashkëpunimi kishte Shqipëria, përveç Jugosllavisë? Nëse afrimi nuk do të kishte qenë me Jugosllavinë, me kë tjetër mund të ishte? Bashkimi Sovjetik do të fillojë të tregojë interes të veçantë për Shqipërinë vetëm pasi Shqipëria prishi marrëdhëniet me Jugosllavinë, ose të paktën kur prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë ishte afër, ndërkohë që siç u pa në kapitullin parardhës, afrimi me SHBA dhe Britaninë e Madhe nuk ishte i mundur. Të dy palët ideologjia, por mbi të gjitha i ndante mbështetja që SHBA dhe Britania e Madhe jepnin për Greqinë, e cila kërcënonte terrësinë territoriale të Shqipërisë.

Në një situatë të tillë, duket se mundësitë e bashkëpunimit ishin minimale. Gjendja ekonomike e Shqipërisë në fund të Luftës së Dytë Botërore, kërkonte pa dyshim një ndërhyrje të shpejtë, ndërhyrje që shteti shqiptar vetë nuk ishte në gjendje ta bënte, Bashkimi Sovjetik nuk kishte interes dhe e kishte deleguar këtë punë drejt Jugosllavisë, ndërsa SHBA dhe Britania e Madhe vinin kushte për bashkëpunim, kështu që hedhja drejt Jugosllavisë, ishte e detyruar.

Siç u pa nga biseda e Titos me Stalinin në Moskë në maj të vitit 1946, udhëheqja shqiptare dëshironte të shkonte në Moskë dhe jo në Beograd, por Moska nuk kishte interes për një vizitë të tillë. Për të shkuar në Moskë duhej në fillim të kaloje në Beograd dhe shqiptarët duket se nuk kishin zgjidhje tjetër.

E parë prej këndvështrimit britanik marrëveshjet e kësaj periudhe si dhe vizita e Enver Hoxhës në Beograd dhe marrëveshjet që e pasuan atë dhe që e afruan edhe më shumë ekonomikisht Shqipërinë me Jugosllavinë, dukeshin si hapa drejt krijimit të një Federate Ballkanike së bashku me Bullgarinë (Zivotić, A. 2010: 95). Por, ky këndvështrim britanik është anakronik me faktet që Shqipëria në këtë periudhë përpiqej të bëhej pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të merrte pjesë në Konferencën e Paqes në Paris si shtet i pavaruar, të njëjtën gjë si edhe Bullgaria,

kështu që këndvështrimi britanik apo perëndimor është larg fakteve sepse Shqipëria dhe Bullgaria nuk mund të kërkonin në të njëjtën kohë të bëheshin pjesë e OKB-së si shtete të pavarura dhe nga ana tjetër të përpiqeshin të krijonin një Federatë Ballkanike me Jugosllavinë.

### **3.4 Qëndrimi i udhëheqjes shqiptare dhe roli i sovjetikëve në marrëveshjet me Jugosllavinë**

I mbajtur në 18 deri në 20 dhjetor të vitit 1946, Plenumi i jashtëzakonshëm i Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Shqipërisë kishte së pari në rendin e ditës diskutimin për marrëveshjen ekonomike që ishte bërë mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe më ekzaktësisht rëndësinë politike të kësaj marrëveshje (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 68).

Në fjalën e tij Enver Hoxha filloi duke thënë se “nënshkrimi i këtij akordi tregoi se vendi ynë po hyn në një fazë të re historike” (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 68). Në fjalët e tij Enver Hoxha vë në dukje diçka që autori i këtij studimi e ka theksuar edhe më lart ashtu si edhe në kapitujt e mëparshëm, që afrimi i Shqipërisë me Jugosllavinë, ashtu si dhe afrimi i Jugosllavisë me Bullgarinë nuk ishin dëshira apo synime konkrete të shqiptarëve, jugosllavëve dhe bullgarëve, por ishte një skenar i krijuar dhe i dirigjuar nga Moska. “Këto që ishin direktivat e pavdekshme të Kominternit Partia jonë i bëri ato të sajat, ashtu si Partia Jugosllave”, thotë Enver Hoxha në Plenumin e jashtëzakonshëm.

“Si Jugosllavia, si ne kishim si dritë BS, d.m.th të dyja partitë e orientuan, dhe nuk gabuan, vijën e tyre drejt BS”, thotë Enver Hoxha, dhe duke qenë se qoftë për jugosllavët, qoftë për shqiptarët, burim frymëzimi ishte Bashkimi Sovjetik kjo bëri që “Partia shkoi në një binar me Partinë Jugosllave dhe populli shqiptar pa që në fillim te populli jugosllav atë popull që rroku armët dhe luftoi. Gjatë zhvillimit të marrëdhënieve në mes Partisë sonë dhe asaj jugosllave këto u bënë marrëdhënie midis partish motra” (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 69).

Problemin e varësisë së tepërt ekonomike nga Jugosllavia, vetë Nako Spiru duket se ishte i ndërgjegjshëm kur në Plenumin e dhjetorit thotë se “këtu mund të krijohen opinione se tani po na vjen buka nga Jugosllavia” (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 77). Në njëjtin shqetësim duket se kishin dhe pjesëmarrës të tjerë në Plenum, ku Peço Kagjini thotë se “akordi akoma nuk ka qenë i qartë para Partisë dhe në popull...Masat konsiderojnë se ndihmat që na jep ne Jugosllavia janë të mëdha. Për

masat vetë del problemi ekonomik si problem kryesor. Ka një preokupim serioz për këtë” (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 77).

Duket se udhëheqjen shqiptare e shqetëson fakti i justifikimit para popullit të marrëveshjeve me Jugosllavinë, e cila nuk ka pasur një reputacion të mirë tek populli shqiptar. Mënyra më e mirë për ta paraqitur Jugosllavinë në një dritë të re, në atë të shtetit ndihmues ndaj Shqipërisë, është duke i lidhur marrëveshjet ekonomike me faktin që ato në rradhë të parë do të sjellin bukë, e cila ishte shqetësimi kryesor ekonomik i popullit në këtë kohë.

Për këtë çështje, Reiz Malile, në Plenumin e dhjetorit 1946, thotë se “problemi i njohjes së Jugosllavisë Federative Popullore ka qenë një problem preokupant. Akordi ekonomik akoma nuk e ka bërë efektin...Ardhja e grurit në Durrës ka bërë një efekt të madh. Në Kuçovë nuk është ndier akoma akordi” (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 79).

Shqetësimi i Maliles në Plenum ishte edhe që shoqëritë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave, për të cilat do të flitet gjerësisht në kapitullin tjetër, krijimi i të cilave ishte pjesë e marrëveshjeve ekonomike, të mos interpretoheshin si shoqëritë aksionare italiane në vitet 30-të, të cilat ishin parë si spekuluese në popull (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 79).

Në rezolutën e Plenumit të Jashtëzakonshëm për marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë thuhet se janë “pasoja llogjike e Traktatit të Aleancës dhe Ndhmës Reciproke, është një hap i ri që forcon marrëdhëniet vëllazërore midis dy popujve”. Më pas përsëriten të njëjtat fjalë së populli shqiptar gjeti tek populli jugosllav mbështetje të madhe gjatë luftës, diçka që duket e çuditshme pasi asnjë partizan jugosllav nuk luftoi për çlirimin e Shqipërisë ndërkohë që partizanë shqiptarë luftuan për çlirimin e Jugosllavisë dhe se “luftonin të njëjtin armik dhe inpiroheshin nga të njëjtat parime” (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 82).

Një formulim i tillë, i pasjes së një armiku të përbashkët dhe i parimeve të njëjta, bëhet për të krijuar në popull një imazh tjetër të Jugosllavisë, në vend të imazhit jo popullor të para luftës.

Në këtë linjë vazhdon më tej rezoluta e Plenumit të dhjetorit 1946 duke thënë se “Konventa Ekonomike është konsekuente e vijës së Partisë sonë. Marrëdhëniet me popujt e Jugosllavisë kanë qenë të shëndosha gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, se rruga në të cilën ecnin këta ishte e njëjtë dhe në këtë rrugë inspiroheshin nga Bashkimi i madh Sovjetik” (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 83).

Në fund rezoluta mbyllet duke thënë se “Partia duhet të kuptojë rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me Jugosllavinë, rëndësinë e zbatimit të këtij akordi dhe të kuptojë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej tij, rolin e organizimit dhe të drejtimit, rolin e lidhjes me masat” (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 83).

Që marrëveshjet me Jugosllavinë kishin një rëndësi të madhe shihet edhe nga takimi i të dërguarit jugosllav në Tiranë, Josip Xherxha me të dërguarin e Bashkimit Sovjetik në Tiranë, Çuvahinin, në 5 korrik të vitit 1946, pas kthimit të të parit nga Beogradi me delegacionin shqiptar. Në takim Xherxha i “karakterizoi rezultatet e vajtjes së Enver Hoxhës në Beograd me rëndësi të madhe politike për të dy vendet. Ai mendon se si rezultat i takimit të Enver Hoxhës me Titon dhe bisedimeve kokë më kokë, u arrit një pikëpamje unike, për një sërë çështjesh tepër të rëndësishme” (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 31).

Duket se për jugosllavët marrëveshjet kishin më shumë rëndësi në pikëpamjen politike se sa atë ekonomike, ndërsa për shqiptarët çështjet ekonomike ishin të një rëndësie më të madhe. Gjendja e vështirë ekonomike në vend, e vënë në dukje edhe në Plenumin e dhjetorit, kushtëzonte që çështjet ekonomike të ishin shumë të rëndësishme.

Mund të thuhet se Bashkimi Sovjetik, Jugosllavia dhe Shqipëria kishin krijuar një ndikim zinxhir në mes tyre. Bashkimi Sovjetik ndikonte në Jugosllavi dhe Jugosllavia në Shqipëri. Siç u pa dhe në kapitullin e mëparshëm, udhëheqësit shqiptarë ende nuk mund të hynin plotësisht në Moskë, por edhe Moska nuk dëshironte të kishte të bënte drejtpërdrejt me Shqipërinë, kështu që të dyja palët ishin duhet të merreshin me Jugosllavinë. Më vonë, do shohim që kur marrëdhëniet mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik të fillojnë të ftohen për arsye të tyre dhe jo për shkak të

Shqipërisë, ndikimi i drejtpërdrejt i Bashkimit Sovjetik në Shqipëri do të rritet, deri sa të bëhet dominant pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë.

Vetë Partia Komuniste e Jugosllavisë shpresonte të merrte mbështetje të madhe nga Bashkimi Sovjetik, qoftë në politikën e jashtme, qoftë në zhvillimin ekonomik të vendit. Për këtë arsye, në 11 prill të vitit 1945, Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik nënshkruan një marrëveshje për miqësinë dhe ndihmën reciproke, një marrëveshje të ngjashme me atë që në fillim të vitit 1945 Jugosllavia kishte nënshkruar edhe me Shqipërinë.

Këto ishin marrëveshjet e para të këtij lloji që Jugosllavia nënshkroi pas përfundimit të luftës. Me Bullgarinë një marrëveshje e tillë u nënshkrua vetëm kur në krye të qeverisë së pasluftës erdhi Georgi Dimitrov, ish drejtuesi i Kominternit.

Që shumë prej zhvillimeve ekonomike dhe politike të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në vitet 1946 dhe 1947, vitet e afrimi të plotë mes dy vendeve, nuk ishin ndonjë shpikje e jugosllavëve, por një skenar i realizuar më parë edhe në marrëdhëniet mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik, shihet edhe nga fakti që qysh në vitin 1944, Edvard Kardelj kishte propozuar krijimin e shoqërive ekonomike të përbashkëta sovjeto-jugosllave, veçanërisht në shfrytëzimin e burimeve minerale të Jugosllavisë, i njëjti lloj shoqërih ekonomike të përbashkëta që do të krijonin më vonë Jugosllavia dhe Shqipëria (Gibianski, L. 1998: 112).

Kjo ofertë jugosllave ndaj Bashkimit Sovjetik u përsërit një vit më vonë nga Andrea Hebrang, ministër i industrisë, drejtues i Këshillit Ekonomik dhe Komisionit të Planifikimit të Jugosllavisë. Hebrang, përveç ofertës për krijimin e shoqërive të përbashkëve, i ofroi Bashkimit Sovjetik edhe të drejtën e konçensioneve. Sovjetikët pranuan ofertën e krijimit të shoqërive të përbashkëta, por jo konçensionet (Gibianski, L. 1998: 112).

Megjithatë, sovjetikët pranonin ndikimin e jugosllavëve në Shqipëri, por nuk dëshironin që ky ndikim të shkonte shumë larg. Ky është një qëndrim pak i çuditshëm, pasi ishte vetë Stalini që në takimin e majit të vitit 1946 me Titon në Moskë e këshilloi udhëheqësin jugosllav që të vazhdohej me planin e krijimit të një

Federate të përbashkët mes Jugosllavisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë. Në takimin e majit, Stalini e kishte pyetur Titon nëse Enver Hoxha ishte dakord që Shqipëria të përfshihej në Federatën Jugosllave (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 24). Pyetjes së Stalinit Tito i kishte dhënë një përgjigje pohuese.

Për sovjetikët, të shkoje shumë larg do të thoshte të ndryshojë kufijtë, aq më tepër t'i ndryshojë pa pëlqimin e tyre. Fakti që në raportin e Lavrishçevit përmendet qartësisht fakti që futja e Shqipërisë në Federatën Jugosllave duhej të shtyhej në kohë pasi nuk ishte ende koha e duhur, do të thotë se një plan i tillë ekzistonte vërtet.

Politika e Stalinit në Ballkan dhe gjithë Evropën Lindore në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore ishte që nga një anë të mos bëhej asnjë ndryshim kufijsh për të cilin të mos ishte rënë dakord më parë në Konferencën e Jaltës, në Krime me aleatët anglo-amerikanë, dhe nga ana tjetër politika e brendshme dhe e jashtme e shteteve të Evropës Lindore duhet të ishte plotësisht në kontrollin e sovjetikëve (Glenny, M. 2012: 534).

Është e pamendueshme që jugosllavët të bënin diçka në politikën e tyre të brendshme ose të jashtme, duke përfshirë edhe marrëdhëniet me Shqipërinë, pa këshillën dhe frymëzimin e sovjetikëve. Vështirë që Titos t'i shkonte ndërmend në një moment që të bashkonte në një shtet të vetëm treçerekun e Ballkanit dhe për këtë të mos kishte pëlqimin e Stalinit. Në takimet me Stalinin, Milovan Xhilasi vazhdimisht shprehu besnikërinë e jugosllavëve ndaj sovjetikëve (Gjilas, M. 2006: 46). Kaq larg shkonte besnikëria e jugosllavëve sa në Konferenca ndërkombëtare të Partive Komuniste, Stalini përdorte jugosllavët për të sulmuar dhe denigruar ata komunistë të vendeve të tjera që guxonin të devijonin sadopak nga urdhrat e tij (Glenny, M. 2012: 534).

Qëllimi i Stalinit në këtë kohë ishte që të mos krijohet asnjë konflikt me aleatët anglo-amerikanë. Urdhrat e tij ishin që pushteti i ri në gjithë Evropën Lindore të vendosej ngadalë dhe në fillim brenda tij të ishin sa më shumë forca të ndryshme nga komunistët (Applebaum, A. 2013: 95). Brenda kësaj logjike hynte edhe çështja e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.

Përpara takimit të majit dhe si përgatitje për këtë takim, shefi i sektorit të Ballkanit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Bashkimit Sovjetik, Lavrenti Lavrishçev, kishte përgatitur një raport ‘’Mbi çështjen e marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare’’, në të cilën mbron qëndrimin e sovjetikëve për një afrim mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, por ky afrim nuk duhet të shkonte shumë larg, ndoshta jo gjer në përfshirje të Shqipërisë në Federatën Jugosllave (Gibianski, L. 1998: 114).

Veçanërisht me rëndësi për sovjetikët ishte traktati i fshehtë ushtarak që pritej të nënshkruhej mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Për sovjetikët, ky traktat ndoshta nuk duhej të anullohej plotësisht, por të paktën të shtyhej në kohë nënshkrimi i tij, bashkë me të edhe mundësia e një përfshirje të Shqipërisë në Federatën Jugosllave. Një veprim i tillë, sipas sovjetikëve, do të përkeqësonte pozitën e Shqipërisë dhe Jugosllavisë në marrëdhëniet me vendet perëndimore.



### 3.5 Ideja e Federatës Ballkanike

Pohimi i Titos në takimin me Stalinin se Enver Hoxha ishte dakord me përfshirjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave, duket i dyshimtë, për faktin se Enver Hoxha që siç e pamë në kapitullin e mëparshëm ishte shumë i shqetësuar për çështjen e kufirit greko-shqiptar dhe pavarësinë e tërësinë territoriale të Shqipërisë, aq i shqetësuar që Shqipëria të njihej dhe të merrte pjesë si një shtet i pavarur dhe fitues në Luftën e Dytë Botërore në Konferencën e Paqes në Paris, të binte dakord nga ana tjetër që Shqipëria të bëhej pjesë e Federatës Jugosllave, ku nuk do të ishte gjë tjetër veçse një republikë ashtu si gjithë të tjerat.

Një veprim i tillë nuk do të ishte i arsyeshëm as për pushtetin e tij në vend. Nëse Shqipëria do të bëhej pjesë e Jugosllavisë, pushteti i Enver Hoxhës do të zvogëlohej jashtëzakonisht shumë. Ai nuk do të ishte më kryeministër i një vend sovran dhe udhëheqës i Partisë Komuniste të Shqipërisë, por do të ishte thjesht një drejtues i një republike të vogël brenda Federatës Jugosllave.

Në kohën që Shqipëria dhe Jugosllavia nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit dhe më vonë marrëveshjet në fushën e ekonomisë të cilat hoqën doganat e bashkuan monedhat mes dy vendeve, Bashkimi Sovjetik e njoftoi qeverinë shqiptare për miratimin prej sovjetikëve të këtyre marrëveshjeve (Gibianski, L. 1998: 114).

Qysh në vitin 1945, në ndihmat që Bashkimi Sovjetik kishte dërguar në Shqipëri, shqiptarëve iu ishte bërë e qartë që marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik do të zhvilloheshin nëpërmjet Jugosllavisë dhe jo drejtpërdrejt me Bashkimin Sovjetik. Kur në këtë kohë, një delegacion i qeverisë shqiptare kishte udhëtuar në Moskë, në diskutimet për ndihmën ushtarake dhe në armatime, sovjetikët kishin vendosur që të dërgonin në Shqipëri ndihma ushtarake nëpërmjet Jugosllavisë, brenda dërgesave ushtarake që do i bëheshin Jugosllavisë.

Pra, kishte qenë vetë Bashkimi Sovjetik, siç u pa dhe në kapitullin e mëparshëm që kishte bërë ç'mos që Shqipëria dhe Jugosllavia të afroheshin sa më shumë, por më sipër, në raportin e Lavrishçevit kërkohej që marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të mos shkonin shumë larg.

Nga njëra anë ishte vetë Stalini që edhe në takimin e majit me Titon e shtyn sa më shumë çështjen e Federatës Ballkanike dhe bashkimit të Jugosllavisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë, nga ana tjetër është po qeveria sovjetike që paralajmëron të mos shkohet larg me këtë çështje. Në takimin e majit të vitit 1946, Stalini i thotë Titos se për Jugosllavinë do të ishte diçka e vështirë që në të njëjtën kohë të zgjidhte çështjen e Triestes me Italinë dhe të përfshinte Shqipërinë brenda Federatës Jugosllave, një thënie kjo e pohuar prej Titos. Në këtë kontekst, këshilla e Stalinit ishte që në fillim me Shqipërinë të bëhej një marrëveshje bashkëpunimi dhe miqësie, me qëllim kryesor mbrojtjen e pavarësisë dhe tërësisë territoriale të Shqipërisë (Gibianski, L. 1998: 114).

Që idetë për marrëveshjet shqiptaro-jugosllave vinin nga Moska dhe jo nga Beogradi duket edhe nga fakti që vetë Tito i thotë Stalinit se e kanë shtyrë tre herë vizitën e Enver Hoxhës në Beograd, me qëllim që Tito dhe delegacioni jugosllav të shkojë më parë në Moskë dhe të këshillohet me Stalinit për marrëdhëniet me Shqipërinë dhe marrëveshjet që duhen nënshkruar (Gibianski, L. 1998: 122).

Por, ashtu siç Tito kërkonte këshillimin dhe miratimin e Stalinit për marrëveshjet me Shqipërinë, edhe Enver Hoxha kishte kërkuar dhe marrë prej sovjetikëve miratimin për vizitën e tij në Beograd dhe marrëveshjet që do të pasonin këtë vizitë rrjedhoja e të cilave do të ishte një afrim shumë i madh mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Enver Hoxha ishte këshilluar me ambasadorin sovjetik në Beograd, Anatoli Lavrentjev, para se të vizitonte vetë Beogradin (Gibianski, L. 1998: 122).

Pra, nga fjalët e Stalinit thënë Titos duket se marrëveshja e bashkëpunimit dhe miqësisë mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, nënshkruar pas vizitës së Enver Hoxhës në Beograd, duhet të ishte hapi i parë i përfshirjes së Shqipërisë në Federatën Jugosllave. A mendonin vërtet udhëheqësit shqiptarë të kohës së marrëveshja e bashkëpunimit dhe miqësisë dhe marrëveshjet e tjera ekonomike, ishin vërtet hapa drejt shndërrimit të Shqipërisë në republikë të shtatë të Jugosllavisë?

Më 9 shtator 1946, Koço Tashko i shkruan ministrisë jashtme shqiptare nga Moska për federatën ballkanike. Ai shkruan se “në qarket demokratike këtu besohet që pas triumfit të Republikës (Popullore) në Bullgari çështja e Federacionit fillestar

Ballkanik munt të shtrohet pa pritur vendimet definitive të Konferencës së Paqes në qoftë se këto vendime zgjaten përtej kufirit (që nuk duhet të jetë më tutje se fillimi i mbledhjes së Asamblesë së UNOS) Kapërximi i këtij kufiri do të thotë agravim të qëndrimit të Anglosaksonëve e pra përpara këtij agravimi s'ka veç se qëndrim të fortë, forcim të rradhëve tona'' (AMPJ, dosja nr 141, Probleme me Rëndësi, Jugosllavia, fq. 75).

Në Plenumin e dhjetorit të vitit 1946, Nako Spiru pyet se pse e bën gjithë këtë Jugosllavia për Shqipërinë dhe vetë përgjigjet se ''ajo ka interes që ne të forcohemi, që t'u bëjmë ballë investimeve. Këto nuk quhen si të huaja, sepse ne kemi një bashkim ekonomik'' (AMPJ, dosja nr 141, Probleme me Rëndësi, Jugosllavia, fq. 75).

Por, afrimi i Jugosllavisë me Shqipërinë është një ide e ardhur prej Moskës, pasi siç e pamë dhe më sipër udhëheqësi i Jugosllavisë, Josip Broz Tito, vendosi të shkojë në Moskë një herë për t'u këshilluar me Stalinin dhe pastaj të nënshkruajë marrëveshjet e parashikuara me Shqipërinë. Nëse këto marrëveshje do të kishin qenë një ide dhe projekt i Beogradit, atëherë nuk do të ishte nevoja për t'u këshilluar me Stalinin dhe ekspertët sovjetikë. Pra, marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në këtë kohë janë pjesë të një plani sovjetik për krijimin disa Federatave në Europën Lindore, ndoshta me qëllim kontrollimin më mirë prej Moskës të kësaj hapësire.

Sipas Moskës duhet të krijoheshin tre Federata: Polonia me Çekosllovakinë, Rumania me Hungarinë dhe Jugosllavia me Shqipërinë dhe Bullgarinë (Gibianski, L. 1998: 131). Një ide e tillë vazhdoi të diskutohej gjer në vitin 1948, të paktën në rastin e Jugosllavisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë.

Autori i këtij punimi nuk mund të thotë nëse Enver Hoxha dhe udhëheqja shqiptare ishte në dijeni apo ishte dakord me planet sovjetike, të cilat siç e pamë më sipër, u shtynë në kohë për të ardhmen, në lidhje me futjen e Shqipërisë brenda Federatës Jugosllave. Për këtë çështje, gazeta bullgare *Izgrev*, organ i Partisë Bashkimi Kombëtar i Bullgarisë, në 25 qershor 1946 shkruan se ''është shumë e mundshme që Shqipëria do të pranohet si një anëtare me të drejta të plota në Republikën Popullore Federale të Jugosllavisë së Titos'' (Pearson, O. 2007: 45).

Pak ditë më vonë, në korrik, gazeta italiane *Corriere della Sera* shkruante se aneksimi i Shqipërisë nga Jugosllavia ishte çështje ditësh, se Shqipëria do të bëhej një republikë autonome e Jugosllavisë dhe se Stalini personalisht kishte dërguar një telegram në të cilin miratonte diskutimet shqiptaro-jugosllave për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë (Pearson, O. 2007: 49).

Të dyja njoftimet në gazeta, qoftë atë bullgare, qoftë atë italiane duket se nuk ishin gjë tjetër veçse spekulime gazetareske. Për sovjetikët kjo ishte një çështje që tani nuk ishte koha për ta ngritur dhe në praktikë nuk po bëhej asnjë bisedim shqiptaro-jugosllav për këtë çështje. Fakti është se më shumë se sa Shqipëria, ishte Bullgaria ajo që dukej se kishte mundësi të madhe të krijonte një shtet të përbashkët me Jugosllavinë. Në fund të vitit 1944, Jugosllavia dhe një përfaqësi e qeverisë bullgare Frontit Kombëtar kishin nënshkruar një marrëveshje për krijimin e një shteti të përbashkët mes tyre, një marrëveshje që Shqipëria nuk e nënshkroi kurrë me Jugosllavinë.

Ashtu si dhe në rastet e marrëveshjeve me Shqipërinë, Poloninë, Çekoslovakinë apo Hungarinë, që Jugosllavia nënshkroi në vitet 1945, 1946 dhe 1947, edhe në marrëveshjen me bullgarët e dhjetorit 1944, gjuha është pak a shumë e njëjtë, gjë që na tregon se marrëveshjet me Shqipërinë nuk kishin asgjë më shumë se të tjerat, duke përjashtuar atë me Bullgarinë.

Në artikullin e parë të marrëveshjes së Jugosllavisë me Bullgarinë, flitet për bashkëpunimin sa më të ngushtë në politikën e tyre duke treguar njëra ndaj tjetrës ndihmën dhe mbështetjen më të madhe, gjithashtu do të zgjidhin në bashkëpunim me njëra-tjetrën çdo çështje që ka të bëjë me sigurinë e tyre (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 737). Në artikullin e tretë të marrëveshjes, dy palët bien dakord në një pikë që do të shfaqet edhe në marrëveshjet ekonomike me Shqipërinë: bashkimi doganor. Në të njëjtën kohë me këtë do të nënshkruheshin në të ardhmen të gjitha marrëveshjet që ishin rrjedhojë e këtij bashkimi doganor. Gjithashtu nuk ishte më e nevojshme përdorimi i pashaportave për të lëvizur nga Jugosllavia në Bullgari dhe anasjelltas (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 737).

Në artikullin e pestë të marrëveshjes thuhet se përveç bashkëpunimit dhe marrëveshjeve politike, ekonomike dhe ushtarake, Jugosllavia dhe qeveria e Frontit Kombëtar të Bullgarisë marrin përsipër të përmbushin gjithë kushtet që duhen për të krijuar një shtet të përbashkët federal, i cili do të ketë përfaqësues kombëtar të përbashkët dhe qeveri të përbashkët (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 737).

Ideja e krijimit të një shteti të përbashkët federal bullgaro-jugosllav kishte ardhur nga Moska ashtu siç kishte ardhur çdo ide tjetër për krijime Federatash në Evropën Lindore pas Luftës së Dytë Botërore. Një ide e tillë, për një federatë bullgaro-jugosllave i ishte paraqitur Titos nga Stalini në takimin e tyre në Moskë, në shtator të vitit 1944 (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 737).

Nga çështja e Federatës jugosllavo-bullgare, e marrëveshjeve të ngushta mes tyre, e bashkimit doganor dhe lëvizjes së lirë, gjithashtu e marrëveshjeve që Jugosllavia bëri me Poloninë, Hungarinë, Çekosllovakinë, të cilat ishin pak a shumë në të njëjtën frymë, sigurisht jo duke bashkuar doganat, por duke krijuar një sistem sigurie dhe bashkëpunimi të ndërsjelltë në Evropën Lindore dhe Juglindore, shohim se edhe Shqipëria ishte pjesë e këtij sistemi dhe se i gjithë konceptimi i tij vinte nga Moska. Shqipëria, Jugosllavia, Bullgaria dhe shtetet e tjera të Evropës Lindore ishin pjesë e strategjisë sovjetike për Evropën Lindore dhe asnjë prej tyre nuk ndërmerre të nënshkruante marrëveshje të tilla me vullnetin e tyre të lirë.

Historiografia shqiptare pas rënies së Komunizmit, shpeshherë e ka akuzuar Enver Hoxhën dhe udhëheqjen shqiptare për marrëveshjet me Jugosllavinë apo dëshirën e tyre për t'u bashkuar me Jugosllavinë, por siç e pamë dhe më lart, kjo nuk është e pranueshme, pasi qoftë Tito, qoftë Enver Hoxha u këshilluan më parë me sovjetikët për të nënshkruar marrëveshjen.

U pa që Tito e kishte shtyrë tre herë vizitën e Enver Hoxhës në Beograd, vizitë që sigurisht do të sillte marrëveshje të rëndësishme si ato që erdhën pas vizitës në qershor 1946 dhe Tito e kishte shtyrë vizitën pasi kërkonte të këshillohej me Stalinin. Nëse Tito dhe jugosllavët do të kishin ideuar marrëveshjet me Shqipërinë apo Bullgarinë, atëherë nuk do të kishte pritur mendimet apo urdhrat e Stalinit, por do të kishte vazhduar me planet e tij dhe do i kishte nënshkruar marrëveshjet.

E njëjta gjë vlen edhe për Enver Hoxhën. U pa më sipër që ai kishte biseduar me të dërguarin sovjetik në Tiranë para se të nisej për në Beograd, që do të thotë se Hoxha kishte gjithë mbështetjen sovjetike për marrëdhëniet që duhet të ndërtonte me jugosllavët dhe marrëveshjet që duhet të nënshkruante. Nuk mund të akuzosh udhëheqjen shqiptare për afrimin me Jugosllavinë. Ky ishte një afrim i imponuar, qoftë nga presioni sovjetik, qoftë nga çështja e kufirit greko-shqiptar që rrezikonte seriozisht pavarësinë dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë dhe faktit që këto pretendime greke mbështeteshin prej Britanisë së Madhe dhe Shteteve të Bashkuara.

Por, duket se jugosllavët e kishin kuptuar se pse Stalini këmbëngulte aq shumë për çështjen e Federatës. Aleksandar Rankoviç, ministër i brendshëm i Jugosllavisë i shkruante Josip Xherxhës në mars të vitit 1948 se mendimi në Moskë është që Jugosllavia duhet të bëjë federatë me Bullgarinë dhe pastaj me Shqipërinë, por sipas tij nuk kuptohet se pse duhet bërë me Bullgarinë dhe pse pikërisht tani. Sipas Rankoviçit, nuk ekzistojnë kushtet që diçka e tillë të ndodhë. Rankoviçi këshillon Xherxhën që të flasë me Enver Hoxhën se cili është mendimi i tij për këtë çështje. (AKSKJ, IX, 1VI – 168). Mendimi për Federatën i ardhur nga Moska, sipas Rankoviçit, duket më shumë si një provokim se sa është çështje serioze.

Në bazë të dokumenteve të deritanishme, nuk duket të ketë pasur asnjë plan konkret për dhënien e Kosovës Shqipërisë apo bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Megjithatë, fakti që jugosllavia e fitoi vetë luftën pa ndihmën e Bashkimit Sovjetik mund ta ketë bërë udhëheqjen jugosllave të mendojë se do të ketë një rol të rëndësishëm dhe udhëheqës në Ballkanin e pas Luftës së Dytë Botërore (Zivotic, 2011: 128).

Kjo sjellje është dhe një ndër arsyet themelore të marrëdhënieve jo të mira mes jugosllavëve dhe sovjetikëve pas Luftës së Dytë Botërore. Në pothuajse gjithë shtetet e tjera të Evropës Lindore që u bënë komuniste pas luftës, me përjashtim të Jugosllavisë dhe Shqipërisë, udhëheqësit e pasluftës u importuan nga Bashkimi Sovjetik. Ishin njerëz që periudhën e luftës e kishin kaluar në Moskë në pritje të momentit të duhur për t'u kthyer në vendin e tyre dhe për t'i shërbyer interesave të Bashkimit Sovjetik. Ata ishin personalitete pothuajse anonime në vendin e tyre dhe qëndrimi në pushtet dhe jo vetëm, varej plotësisht prej dëshirave të Moskës. Ky nuk

ishte rasti më Jugosllavinë. Kjo është një çështje themelore për të kuptuar veprimet e Jugosllavisë në vitet 1945-1948, jo vetëm kundrejt Shqipërisë, por edhe kundrejt Bashkimit Sovjetik.

## **Kreu IV. Zhvillim i vërtet ekonomik apo shtojcë ekonomike e Jugosllavisë?**

### **4.1 Shkëmbimet e para tregtare dhe marrëveshjet ekonomike (1945-1946)**

Buka ishte kryefjala e Plenumit të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare në dhjetor të vitit 1946. “Të gjithë thonë se si do të prodhohet më tepër bukë” (AQSH, 14\AP, dosja 4, viti 1946). Gjendja e vështirë ekonomike ishte sidomos në fshatra, të cilat kishin pësuar shumë dëmtime gjatë kohë së luftës, madje në “në fshatrat e Kukësit është mizerje, thuhet se jeta e fshatit sot është më e keqe se sa në fshatin e mëparshëm” (AQSH, 14\AP, dosja 4, viti 1946).

Por, duket se për udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqiptare, rimëkëmbja e ekonomisë së fshatit, domethënë rimëkëmbja e bujqësisë, nuk ishte qëllimi i vetëm, por siç thotë Nako Spiru “për independencën ekonomike të një vendi, vendin e parë e zë industria e rëndë. Edhe për ne, vendin e parë e zë kjo...Ngritja e një industrie të rëndë ka efekte edhe te ne, por ajo te ne nuk zë vendin e parë; vendin e parë e zë bujqësia...Problemi i ekonomisë është problemi kryesor” (AQSH, 14\AP, dosja 4, viti 1946).

Por rimëkëmbjen ekonomike Shqipëria nuk mund ta bëjë e vetme. “Ne me forcat tona nuk shkojmë dot në socializëm”, thotë Nako Spiru në Plenumin e dhjetorit të vitit 1946, “Ne jemi një vend i vogël afër një shteti të madh” vazhdon Nako Spiru duke iu referuar Jugosllavisë me “shtetin e madh”. Dhjetori i vitit 1946 është koha kur Shqipëria tashmë i ka nënshkruar marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë dhe kur mbështetja për rimëkëmbjen ekonomike të vendit, tashmë ishte përcaktuar dhe ajo do të ishte Jugosllavia (AQSH, 14\AP, dosja 4, viti 1946).

Mbështetja ekonomike jugosllave duhet të ishte e menjëhershme pasi gjendja ekonomike ishte shumë e vështirë, jo vetëm në fshat, por siç thotë dhe deputeti Adil Çarçani “gjendja ekonomike në qytet, sidomos tani që ka hyrë dimri, është keqësuar. S’ka prodhime industriale në dyqanet e shtetit” (AQSH, 14\AP, dosja 4, viti 1946).

Por, bashkëpunimi ekonomik nuk do të ishte vetëm i njëanshëm, nga Jugosllavia në Shqipëri por edhe anasjelltas. Siç thotë Spiro Pano, në Plenumin e dhjetorit: “kjo mund të shkaktojë që, duke menduar se çdo gjë do të vijë nga Jugosllavia, ne vetë të mos punojmë” (AQSH, 14\AP, dosja 4, viti 1946).



Sipas një promemorie të vitit 1945 drejtuar Këshillit Ekonomik, “mbi përfundimin e bisedimeve me shokët e shtetit Federativ Demokratik të Jugosllavisë” thuhet se deri në atë moment Shqipëria ka eksportuar drejt Jugosllavisë: 3000 kuintal lesh, 15 mijë kuintal vaj ulliri, 50 mijë kuintal kripë, gjer në 600 kuintal benzinë për muajin mars, 2000 kuintal për prillin, 500 kuintal naftë gjer në prill, 200 kuintal vaj-guri në muajin prill, 150 kuintal vaj lubrifikant pas muajit maj” (AMPJ, drejtorja IV, Jugosllavia, dosja 40)

Në promemorie thuhet gjithashtu se është premtuar se mund të jepen edhe këto sende: mallifaturë fioco, pije, likerna, djathë etj. Gjithashtu i është ofruar dhe lëkurët që disponohen në Shqipëri. “Ata kanë vetë tepricë dhe nuk u nevojiten, por kanë siguruar se do të kujdesen në Zvicër dhe Francë për t’eksportuar të tyret dhe të Shqipërisë, nëse nuk gjejnë një treg tjetër” (AMPJ, drejtorja IV, Jugosllavia, dosja 40)

Në shkurt të vitit 1945, Shqipëria nënshkroi me Jugosllavinë dy marrëveshje, ku njëra prej të cilave kishte të bënte me ekonominë. Në të parashikohej bashkëpunimi i ardhshëm ekonomik mes dy vendeve, mundësia e heqjes së doganave për lehtësimin e qarkullimit të mallrave si dhe këshillimi me njëra-tjetrën për marrëveshjet që mund të nënshkruanin me një palë të tretë (AMPJ, drejtorja IV, Jugosllavia, dosja 40). Pika e tretë e marrëveshjes, ajo e konsultimit për marrëveshjet me një palë të tretë, duket se më shumë kishte të bënte me marrëveshjet që mund të nënshkruante Shqipëria dhe që duhet të bëheshin pas këshillimit jugosllav, se sa e kundërta.

Por, marrëveshja me Jugosllavinë nuk ishte e vetmja marrëveshje ekonomike e Shqipërisë në atë kohë. Në shtator të vitit 1945 Shqipëria nënshkroi një marrëveshje ekonomike edhe me Bashkimin Sovjetik. Sipas kësaj marrëveshjeje, Bashkimi Sovjetik do të dërgonte në Shqipëri ekspertë për industrinë e naftës dhe atë minerare, ndërsa Shqipëria do të eksportonte drejt Bashkimit Sovjetik duhan, perime dhe naftë e minerale të papërpunuara (Slavković, B. 2012: 62).

Në këmbimit të mallrave shqiptare, Jugosllavia do të japë: bereqet, gjer në 130 mijë kuintal me 1/3 grurë dhe 2/3 misër, sasi që mund të dorëzohet prej 15 marsit gjer më

30 korrik të vitit 1945. Sasia mund të arrinte dhe gjer në 200 mijë kuintal, por për shkak të mungesës së transportit të mjaftueshëm u kufizua në 130 mijë, acid sulfurik, gjer në 1000 kuintal, karbit 300 kuintal për çdo 3 muaj (AMPJ, drejtorja IV, Jugosllavia, dosja 40). Çështja e transportit, siç do e shohim edhe më vonë, paraqitet problematike në kalimin e mallrave nga Shqipëria në Jugosllavi dhe anasjelltas, gjë që në një masë të madhe dhe pengon shkëmbimet tregtare pasi për shkak të pamundësisë së transportit, kalimi i mallrave nga njëri shtet në tjetrin është më i vogël se ç'parashikohej të ishte.

Në promemorien dërguar Këshillit Ekonomik thuhet se ‘’jugosllavët materialet që do të japin i kanë në dorën e shtetit, ndersa Shqipëria i ka akoma në dorë të privatit, me përjashtim kripën dhe karburantin’’ dhe ky mund të jetë një problem tjetër, veç atij të transportit, në qarkullimin e mallrave(AMPJ, drejtorja IV, Jugosllavia, dosja 40).

Dorëzimi i mallrave do të bëhet në Manastir (Bitola), Ohër, Strugë, Prizren dhe Podgoricë. Shqipëria do të çojë aty mallrat për eksport dhe do të marrë mallrat që do të importojë. Gjithashtu Jugosllavia do të japë brenda 2-3 muajve gjer më 500 kuintal sheqer dhe edhe më shumë kur të fillojë nga puna fabrikat jugosllave. Shqipëria ka kërkuar nga Jugosllavia edhe: kartë cigari, shpresa, gur çakmaku, amoniak likuide, sulfate alumini, vegla automjetesh për ndërrime, naftalinë, gur kali, letër për shtyp, etj (AMPJ, drejtorja IV, Jugosllavia, dosja 40).

Për udhëheqjen shqiptare duket se ishte mendimi se ndihma ekonomike nuk ishte vërtet jugosllave, por sovjetike, e ardhur nëpërmjet Jugosllavisë (Komatina 1995: 47). Në maj të vitit 1946, para se Josip Broz Tito të vizitonte Moskën, Edvard Kardelj i kishte thënë Lavrentjevit, ambasadorit sovjetik në Beograd, se operacionet tregtare mes Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë duhet të bëheshin nëpërmjet shoqërive sovjeto-jugosllave, posa këto të krijoheshin (Gibianski, L. 1998: 126).

Ndoshta dhe ideja se ndihma jugosllave ishte ndihmë sovjetike nëpërmjet Jugosllavisë, e pretenduar nga historiani Milorad Komatina, vinte prej faktit që qysh në verën e vitit 1945, gjatë një vizite të një delegacioni shqiptar në Moskë, kur ishte diskutuar për furnizimin e ushtrisë shqiptare, Bashkimi Sovjetik kishte miratuar një

rezolutë për të dërguar armatime në Shqipëri nëpërmjet Jugosllavisë, domethënë bashkë me dërgesat që do të bëheshin në Jugosllavi (Gibianski, L. 1998: 126).

Nako Spiru, Ministër i Ekonomisë, kishte shkuar në Beograd për të diskutuar për marrëveshjet ekonomike qysh në prill të vitit 1946, ndërkohë që marrëveshjet ekonomike u nënshkruan disa muaj më vonë. Në një mbledhje të Byrosë Politike në 3 maj 1946, Enver Hoxha thotë për bisedimet me jugosllavët se ‘‘puna e marrëveshjeve ekonomike me Jugosllavinë ka mbetur në vend’’ (AQSH, F.14\AP, dosja 7, 1946). Të paktën, kështu lajmëronte Nako Spiru në telegramet nga Beogradi.

Më tej, Enver Hoxha thotë se sipas Nakos ‘‘duhet t’u japim atyre më tepër se ç’u kemi premtuar, që të mund të marrim të tjera sende që neve na duhen...Ata tani për tani nuk mund të bëjnë një traktat tregtar me ne, se, thonë nuk janë konditat, por vetëm një marrëveshje tregtare me karakter të kufizuar, që të ketë vleftë për një vit dhe për çështje të caktuara’’ (AQSH, F.14\AP, dosja 7, 1946).

Në këtë mbledhje Enver Hoxha shpreh dhe një pakënaqësi të tij kur thotë se ‘‘jugosllavët nuk janë në dispozicion të blenë sendet tona me çmimet e tregut ndërkombëtar, por me çmimet e tregut të tyre dhe si u intereson atyre’’ (AQSH, F.14\AP, dosja 7, 1946). Por duket se gjithë përgjegjësinë ia lë Nako Spirit kur thotë se ‘‘ai i di më mirë dhe le të mendohet vetë se ç’mund t’u japim ne. Ne nuk dimë më mirë se Nakoja’’ (AQSH, F.14\AP, dosja 7, 1946).

Në maj të vitit 1946, mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë u nënshkrua marrëveshja për shkëmbimet tregtare. Lista e mallrave që mund dhe duhet të tregtoheshin mes dy vendeve mund të ndryshohej edhe gjatë kohës që zgjaste marrëveshja (Slavković, B 2012:134). Çmimin e mallrave që do të tregtoheshin duhet ta vendoste një komision i përbashkët. Kjo pikë pak a shumë konfirmon atë që kishte thënë Enver Hoxha në mbledhjen e Byrosë në 3 maj, që çmimet e mallrave nuk do të vendoseshin sipas tregut ndërkombëtar, por ashtu siç dëshironte komisioni, me fjalë të tjera, ashtu siç dëshironin jugosllavët.

Të dy palët ranë dakord që shuma monetare e mallrave që do të tregtoheshin nga të dy anët e kufirit të mos ishte më shumë se 20 milionë dinarë (Slavković, B 2012:134).

Kjo marrëveshje zëvendësoi akordin e arritur në shkurt të vitit 1945, në bazë të të cilit siç e pamë më sipër ishin shkëmbyer disa lloje mallrash mes dy vendeve. Për pagesën e mallrave nga ana shqiptare, në Bankën Popullore në Jugosllavi u hap një llogari në emër të shtetit shqiptar (Slavković, B 2012:134).

Pas vizitës së Enver Hoxhës në Beograd, në qershor të vitit 1946, u nënshkrua marrëveshja për krijimin e shoqërive të përbashkëta shqiptaro-jugosllave. Siç u pa edhe në kapitullin e kaluar, një marrëveshje të tillë, jugosllavët kishin kërkuar edhe nga sovjetikët, por këta të fundit nuk kishin pranuar.

Marrëveshja me Shqipërinë u nënshkrua në 1 korrik 1946 nga Nako Spiru për Shqipërinë në cilësinë e Ministrit të Ekonomisë. Në artikullin I të kësaj marrëveshjeje thuhet se “me qëllim që të përtërihen dhe të shtohen mundësitë e prodhimit të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë kanë vendosur të organizojnë shoqëri mikste shqiptaro-jugosllave me aksione si më poshtë:

- Shoqëria për ndërtimin dhe eksploatimin e hekurudhave
- Shoqëria për nxjerrjen dhe fabrikimin e naftës
- Shoqëria për zbulimin e minierave, për eksploatimin dhe përdorimin e metaleve
- Shoqëria për elektrifikimin
- Shoqëria për lundrimin detar
- Shoqëria tregtare për importim dhe eksport
- Banka shqiptaro-jugosllave”(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 40)

Në artikullin II të marrëveshjes thuhet se “qeveria e Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë do t’i japë Republikës Popullore të Shqipërisë ndihmën teknike për industrinë ushqimore e tekstile dhe për industrinë e metaleve dhe të materialit të ndërtimit, gjithashtu në bujqësi do t’i japë ndihmë duke dërguar ekspertë jugosllavë në Shqipëri, duke dhënë informata teknike, duke elaboruar projekte dhe dokumentacione e instruksione të tjera si edhe duke mësuar në Jugosllavi specialistë shqiptarë dhe duke bërë të njohur punën dhe funksionimin e ndërmarrjeve dhe

institucioneve teknike dhe shkencore të Jugosllavisë” (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 40).

Pika e dytë e marrëveshjes është pothuajse identike me marrëveshjen që Shqipëria kishte bërë me Bashkimin Sovjetik. Në artikullin III të marrëveshjes parashikohet një kredi jugosllave për furnizim makinash e veglash, ‘‘me qëllim që të ngrejnë industrinë e saj për prodhimin e artikujve të konsumit të zakonshëm’’(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 40).

Artikulli IV i marrëveshjes parashikon krijimin e shoqërive të përbashkëta dhe funksionimin e tyre. Në të thuhet se ‘‘shoqëritë mikste shqiptaro-jugosllave...do të organizohen sipas principit të paritetit. Pjesët e palëve të interesuara në kapitalet e aksionerëve të shoqërive të përmendura do të jenë të barabarta. Çdo palë do të marrë pjesë të barabartë në këshillat administrative të këtyre shoqërive, gjithashtu në administrimin e çdo shoqërie. Të dy palët do të përfaqësohen prej një numri votash të barabarta’’. (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 41).

Në këto shoqëri, fuqia ekzekutive do të ishte tek shqiptarët dhe jugosllavët si ndihmësa. Këto shoqëri duhet të kishin një jetëgjatësi prej 30 vjetësh, por siç do e shohim edhe më vonë, këto shoqëri nuk funksionuan as 2 vjet, kjo si pasojë e prishjeve të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ku edhe funksionimi i këtyre shoqërive kishte pjesën e tij në prishjen e marrëdhënieve. Gjithashtu parashikohej që në mbarim të afatit 30 vjeçar, Shqipëria kishte të drejtë të blinte aksionet që zotëronte pala jugosllave dhe kështu shoqëritë të bëheshin plotësisht shqiptare. Nëse pala shqiptare nuk dëshironte të blinte aksionet, atëherë shoqëritë do të funksiononin deri në likuidim (Plasari, N. & Malltezi. L1996: 41).

Megjithëse marrëveshja për krijimin e shoqërive të përbashkëta duket mjaft idilike në barazinë dhe mirëkuptimin e plotë të dy palëve, siç do e shohim më vonë, punët në praktikë ishin larg atyre në letër.

Para nënshkrimit të marrëveshjeve me Shqipërinë, në tetor të vitit 1946, përfaqësia tregtare jugosllave në Tiranë, përpiloi një raport mbi problemet ekonomike të Shqipërisë dhe fushat në të cilat mund të bëheshin përmirësime dhe që marrëveshjet e

ardhshme ekonomike me Shqipërinë duhet t'i mbulonin. Raporti u shkrua nga Havliçek, përfaqësuesi tregtar i Jugosllavisë në Tiranë dhe iu dërgua Aleksandër Hardingut, Presidentit të Komisionit të Planit të Jugosllavisë (Gaćeša, N. L. 1990: [http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda\\_1.php](http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda_1.php)).

Sipas Havliçekut, që të kishte një zhvillim të ekonomisë shqiptare dhe një përafrim sa më të madh të saj me ekonominë jugosllave ishte e nevojshme që të kiheshin parasysh disa çështje:

- zhvillim i planifikuar i bujqësisë shqiptare
- realizim i marrëveshjeve për themelimin e shoqërive të përbashkëta, rregullimin dhe financimin e punëve publike, minierave
- ndihmë në këshillim-organizim për sektorë të veçantë të ekonomisë së Shqipërisë
- dhënie kredie për ndërtimin e industrisë së lehtë (Gaćeša, N. L. 1990: [http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda\\_1.php](http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda_1.php)).

Më tej raporti vazhdon duke bërë një analizë më të detajuar të çështjeve të mësipërme. Sipas Havliçekut, zhvillimi i bujqësisë duhet të kishte vëmendjen më të madhe pasi me bujqësi merret 80% e popullsisë së Shqipërisë. Sipas tij Shqipëria kishte tre faktorë natyrorë të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë, të cilin ishin: klima subtropikale, mesdhetare në shumicën e territorit, burime të mëdha ujore që lehtësojnë ujitjen e tokave dhe tokë të cilësisë shumë të mirë, e cila sipas raportit të Havliçekut qëndron e pa shfrytëzuar ose shfrytëzohet në mënyrë primitive, ndërsa tokë të papunueshme ka relativisht pak.

Sipas Havliçekut, në Shqipëri duhet të zhvilloheshin ato kultura bujqësore për të cilat Jugosllavia kishte nevojë dhe që nuk mund t'i prodhonte vetë ose që në Shqipëri mund të prodheshin më mirë dhe me kosto më të ulët, për shembull pambuk dhe vaj ulliri. "Në këtë mënyrë do të rritej shkëmbimi ynë tregtar me Shqipërinë dhe ajo akoma edhe më shumë do të lidhej me Jugosllavinë, në një bashkësi ekonomike të vetme, të qëndrueshme dhe afatgjatë" (Gaćeša, N. L. 1990: [http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda\\_1.php](http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda_1.php)).

Në raportin e tij Havlishçeku thekson se ky zhvillim bujqësor mund të rrisë të ardhur e popullsisë shqiptare shumë më shpejt dhe më mirë se sa nëse do të investohej në miniera ose industri, që sipas tij, janë sektorë që kanë nevojë për shumë vite investime(Gaćeša, N. L. 1990: [http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda\\_1.php](http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda_1.php)). Më tej, ai thekson krijimin e shoqërive të përbashkëta, por për të cilat mendon se është e vështirë që të funksionojnë nëse nuk zgjidhen çështja financiare si kursi i shkëmbimit të dinarit jugosllav me frangën shqiptare dhe gjetja e mënyrës për të financuar kapitalin dhe investimet e këtyre shoqërive nga ana e shqiptarëve(Gaćeša, N. L. 1990: [http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda\\_1.php](http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda_1.php)).

Siç do të shohim edhe më vonë, këto dy çështje, nuk u zgjidhën asnjëherë dhe kështu ndikuan në keqfunksionimin e shoqërive të përbashkëta. Për çështjen e kursit të dy monedhave dhe pamundësinë prej kësaj çështjeje të funksionimit të shoqërive të përbashkëta, Havlishçeku thotë se e ka biseduar me Nako Spirun, ndërsa për çështjen e financimit të kapitalit shqiptar në shoqëritë e përbashkëta, Havlishçeku thotë se nëse Shqipëria hedh në këto shoqëri rreth 20 milionë franga, siç parashikohej, atëherë kjo do të ishte një shumë goxha e madhe për Shqipërinë në ato kohë dhe që absolutisht nuk mund ta realizonte pasi do të përbënte 2\5 e gjithë qarkullimit monetar në vend në atë kohë, prandaj sipas Havlishçekut pagesa mund të bëhej me mallra(Gaćeša, N. L. 1990: [http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda\\_1.php](http://rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda_1.php)).

Gjithashtu në raport, ai thekson si urgjente ndërtimin e hekurudhës Durrës-Elbasan dhe ndërtimin e hidrocentraleve në Valbonë, Berat-Selenicë.

Raporti i Havlishçekut hedh dritë mbi këndvështrimin jugosllav për marrëdhëniet ekonomike me Shqipërinë. Në të vihet theksi tek zhvillimi i atyre degëve të ekonomisë që kishte nevojë Jugosllavia dhe jo Shqipëria. Jugosllavët nga Shqipëria kërkonin lëndë të parë dhe prodhime bujqësore. Ky këndvështrim jugosllav ishte krejtësisht i kundërt me atë shqiptar.

I dërguari jugosllav në Tiranë, Josip Xherxha, në telegramet e tij dërguar në Beograd në vitin 1946 shkruan se në ekonominë shqiptare mbizotëron kaosi dhe reforma agrare nuk kishte arritur të ndryshonte ndonjë gjë pasi ajo kishte prekur vetëm një

pjesë të popullsisë dhe se kapitali i hedhur për të realizuar këtë reformë nuk ishte shpenzuar siç duhej(Slavković, B 2012:134). Në këtë kohë, siç e shohim edhe nga fjalët e përfaqësuesve në Plenumin e dhjetorit 1946 të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, nevojat ekonomike të Shqipërisë ishin ende për mallrat dhe produktet më bazike, siç ishte gruri për të prodhuar bukë.

Në qershor të vitit 1947 është nënshkruar protokollin për krijimin e komisionit të koordinimit të planeve ekonomike. Çështja e këtij komisioni ka dalë edhe në fund të vitit 1947 dhe fillimin e 1948, duke u parë si përpjekje e Jugosllavisë për të bashkuar Shqipërinë me Jugosllavinë pas rritjes së ndikimit sovjetik në Shqipëri, por komisioni ka qenë nënshkruar qysh në mes të vitit 1947 dhe nuk duket se ka lidhje me rritjen e presionit jugosllav mbi Shqipërinë.

Komisioni do të jetë i përbërë nga dy anëtarë prej secilës qeveri dhe krijohet me qëllimin e bashkëpunimit më të ngushtë ekonomik, të koordinimit të planeve, të bashkimit doganor dhe të barazimit të monedhës. Qëllimi i këtij komisioni është:

- studimi i problemeve ekonomike
- të bëjë propozime qeverive respektive për të marrë masa të caktuara të nevojshme
- survejimi dhe kontrolli i ekzekutimit të drejtë të marrëveshjeve të nënshkruara
- të bëjë me dije dy qeveritë mbi parregullsitë që dalin gjatë ekzekutimit të obligimeve dhe të propozojë masa për të eliminuar parregullsitë.

Vendimet e komisionit merren me konsensus(AMPJ, drejtorja IV, Jugosllavia, dosja 182).

Gjithashtu në qershor 1947 u nënshkrua dhe një protokoll për krijimin e një këshilli arbitrazhi shqiptaro-jugosllav. Ky këshill do të dëgjojë të gjitha konfliktet e pronësisë të çdo lloji natyre që mund të dalin gjatë ekzekutimit të marrëveshjes prej 2 miliardë dinarësh mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ashtu si dhe për problemet e shoqërisë shqiptaro-jugosllave për eksport-importin. Ky këshill përbëhet prej tre anëtarësh, të emëruar në mënyrë të pavarur prej të dyja qeverive. Presidenti i këshillit do të jetë me rradhë një shqiptar dhe një jugosllav. Në 22 qershor është nënshkruar dhe akordi për



likuidimin e një kredie 1.2 milionë dollarë që SHBA ia akordoi nëpërmjet Jugosllavisë, shtetit shqiptar. Nëpërmjet këtij protokollit parashikohet që Jugosllavia do të paguajë për punimet, shërbimet etj., për llogari të qeverisë së Shqipërisë, dhe shuma e gjithë në dinarë shkon në 36.7 milionë (AMPJ, drejtoria IV, Jugosllavia, dosja 182).

## 4.2 Qëndrimi i udhëheqjes shqiptare mbi marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë

Reiz Malile, anëtar i Komitetit Qëndror, në Plenumin e dhjetorit të vitit 1946 thotë se “ardhja e grurit në Durrës ka bërë një efekt të madh” te popullsia, gjë që tregon rëndësinë që kishte një mall aq bazik si gruri për popullin dhe ardhja e grurit kishte lidhje me Jugosllavinë, jo vetëm me marrëveshjet e nëntorit 1946, por edhe me të tjera marrëveshje të mëparshme, por në pjesë të tjera të Shqipërisë ndikimi i marrëveshjeve me Jugosllavinë ende nuk ishin ndjerë. Për Reiz Malilen shqetësimi përse i përket marrëveshjeve me Jugosllavinë ishte që ato në popull duhet të shpjegoheshin që populli të mos i shihte njëllë si ato me Italinë në vitet 20-të dhe 30-të (AQSH, F.14\AP, dosja 4, viti 1946).

Ashtu siç u trajtua edhe në kapitullin e mëparshëm, marrëveshjet me Jugosllavinë, ekonomike ose jo, nga shumë media dhe diplomatë perëndimorë u panë si një hap drejt përfshirjes së Shqipërisë në Federatën Jugosllave, por në fjalimet dhe letërkëmbimin e Enver Hoxhës apo udhëheqjes shqiptare të asaj kohe, një gjë e tillë nuk përmendet. Në kapitullin e kaluar u pa që për jugosllavët dhe sovjetikët, një plan i tillë, për të krijuar një Federatë Ballkanike mes Jugosllavisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë ekzistonte dhe ishte vullneti i sovjetikëve që kjo çështje të shtyhej për më vonë.

Për Nako Spirun, njeriun që në cilësinë e Ministrit të Ekonomisë nënshkroi marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë, pikërisht ato marrëveshje që në sytë e perëndimorëve supozohej ta bënin Shqipërinë republikë të shtatë të Jugosllavisë, marrëveshjet kishin vetëm një këndvështrim ekonomik.

Në një mbledhje të Kuvendit Popullor, 27 dhjetorit 1946, e premte ora 17, Nako Spiru, Ministër i Ekonomisë dhe Kryetar i Planit Ekonomik pasi shpjegon marrëveshjet ekonomike të nënshkruara ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë thotë se “me këto marrëveshje ne hyjmë në lidhje të ngushtë ekonomike me Jugosllavinë, lidhje që do të jenë një faktor i dorës së parë për forcimin e ekonomisë t’onë dhe për zhvillimin e vendit përgjithësisht” (AQSH, fondi 489, dosja 123, viti 1946).

Më tej Nako Spiru pasi thotë se vendi pas shkatërrimeve të mëdha të luftës filloi ta marrë veten për shkak të ndryshimit politik dhe konsolidimit të fuqisë së pushtetit popullore dhe furnizimit të popullit me bukë pavarësisht thatësisë më të madhe që ka parë ndonjëherë vendi në dy vitet e fundit, thotë se ‘‘për zhvillimin e mëtejshëm dhe më të madh të ekonomisë së tij vendi i jonë ka nevojë për ndihmë. Ka nevojë për mjete prodhimi të cilat na nuk i prokurojmë dot menjëherë me t’ardhurat t’ona, ka nevojë të marëri punime më të mëdhaja të nevojshme për të sigurue një ekonomi ma të përparueme; ka nevojë për produkte ma shumë me anën e të cilave t’i përgjigjet punës së popullit dhe që së paku për një kohë të shkurtër nuk asht në gjendje t’a prodhojë vetë në shkallën që i duhen’’(AQSH, fondi 489, dosja 123, viti 1946).

Për Nako Spirun, ndihma që i duhet Shqipërisë mund të jepet vetëm në një frymë mirëkuptimi të thellë dhe se Jugosllavia është aleati natyral për këtë përkrahje. Ai thekson faktin që miqësia me Jugosllavinë është garanci për pavarësinë e Shqipërisë dhe në këtë mënyrë ajo bëhet garanci dhe për zhvillimin e ekonomisë, gjë që sipas tij plotëson pavarësinë e Shqipërisë (AQSH, fondi 489, dosja 123, viti 1946).

Nako Spiru vazhdon duke shpjeguar çfarë do të ndryshojnë kompanitë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave dhe ndikimi që ato do të kenë në ekonominë shqiptare si dhe projektet konkrete që do të zbatojnë, siç është për shembull projekti për ndërtimin e hekurudhës dhe disa centraleve elektrive në vitin 1947. ‘‘Të drejtat e të dy palëve në këto shoqëri janë të barabarta. Kjo asht një karakteristikë e veçantë e marrëdhënjëve t’ona në kundërshtim me marrëdhënjët në baza imperialiste. Suprimimi i doganave dhe barazimi i vleftë së lekut me atë të dinarit jugosllav, së bashku me koordinimin e planeve shërbejnë për zhvillimin uniform të ekonomisë t’onë me atë të Jugosllavisë dhe eliminojnë shumë pengesa që do t’a ndalojshin ekonominë t’onë të forcohesh krahas me atë të Jugosllavisë. D.m.th e bëjnë të mundur qi ngritja e fuqisë ekonomike të Jugosllavisë të ketë reperkursjone të mbëdhaja në ngritjen e fuqis ekonomike të Shqipërisë. Barazimi i vleftë së lekut me atë të dinarit nga ana tjetër, siguron një bazë stabël të monedhës s’onë. Ky operacion nuk do t’i sjellë asnjë dëm popullit t’onë dhe do të realizohet në konditat ma të favorshme për atë’’(AQSH, fondi 489, dosja 123, viti 1946).

Kjo politikë ekonomike sipas Nako Spirut çon në barazimin e çmimeve dhe më pas edhe të rrogave me Jugosllavinë dhe në fund çon në barazimin e standartit të jetesës mes dy vendeve. Fjalët e Nako Spirut në një farë mënyre përmbledhin këndvështrimin e udhëheqjes shqiptare mbi marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë. Ato i shërbejnë ruajtjes së pavarësisë së Shqipërisë nëpërmjet zhvillimit ekonomik dhe kanë qëllim përfundimtar arritjen e nivelit të jetesës së Jugosllavisë.

Të njëjtat fjalë me ato të Nako Spirut mbi ndihmën që Jugosllavia jep për Shqipërinë dhe se si kjo është diçka bëhet vetëm për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe se nuk ka asgjë përtej kësaj, i thonë pothuajse të gjitha folësit e tjerë në mbledhjen e Kuvendit Popullor në 27 dhjetor të vitit 1946. Hasan Pulo, deputet i Vlorës pasi flet për problemet e shtetit të ri shqiptar në vitet e pas pavarësisë, se si fuqitë imperialiste greko-serbo haheshin me njëra-tjetrën për zona influence në Shqipëri dhe si më në fund Italia fashiste pushtoi shqipërinë në 7 prill 1939, thotë se ishte Jugosllavia ajo që pas luftës ndihmoi shqipërinë me bereqet, kur shqipëria mbeti keq dhe kjo sipas tij tregon se ‘‘populli shqiptar e pa se sa e sinqertë është miqësija e popujvet të Jugosllavisë me neve’’(AQSH, fondi 489, dosja 123, viti 1946).

Edhe për Tuk Jakovën, deputetin e Shkodrës, marrëveshjet me Jugosllavinë kanë për qëllim zhvillimin e vendit dhe afrimin e standartit ekonomik të Shqipërisë me atë të Jugosllavisë, që sipas tij është shumë më e zhvilluar se Shqipëria. Gjithashtu Jakova thekson një pikë që ishte e rëndësishme për gjithë udhëheqjen shqiptare, zhvillimin e industrisë: ‘‘Fillimi i punës drejtë industrializimit të vendit me ndihmën që herë pas herë do të marrim nga Jugosllavija si që thohet shprehimisht në artikullin (2) të marrëveshtjes do t’a çojë vendon t’onë drejtë lulzimit ekonomik. Në këtë mënyrë dhe bujqësija e jonë do të zhvillohet sa ma mirë’’(AQSH, fondi 489, dosja 123, viti 1946).

Fjalët e Tuk Jakovës për zhvillimin e ekonomisë shqiptare me ndihmën që do të japë Jugosllavia janë të ngjashme me fjalët e deputetit të Tiranës, Abdyl Këllezi e më vonë nga deputeti i Korçës, Pëllumb Dishnica. Më tej deputeti i Gjirokastrës, Qirjako Harito thotë se ‘‘traktate si këto që janë nënshkruar në Belgrad më 27 të muajit të kaluar në mes Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe të Republikës t’onë Popullore nuk mund të gjenden në historin e kombeve të tjerë’’ (AQSH, fondi 489, dosja 123, viti 1946).

E parashikuar me këto marrëveshje ekonomike me Jugosllavinë ishte edhe që ekspertët që do të merrnin pjesë në ndërtimin e hekurudhave dhe ndërtimin e centraleve elektrive dhe pothuajse çdo veprë tjetër publike në Shqipëri, do të ishin ekspertë jugosllavë, ndërsa ndihma shqiptare në këto raste do të ishte e kufizuar(Slavković, B. 2012: 135).

#### **4.3 Pakënaqësitë e palës shqiptare për marrëdhëniet ekonomike**

Por, marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve në këtë periudhë, mesi i vitit 1947, nuk ishin aq të mira sa dukeshin dhe megjithëse ndihma ekonomike jugosllave për Shqipërinë vazhdonte të vinte, në letrat e marrëveshjeve të nënshkruara mes dy vendeve, ajo ishte më e madhe se sa në realitet. Për këtë arsye, Nako Spiru, në prill të vitit 1947 udhëhoqi një delegacion për në Beograd pikërisht për të diskutuar këto probleme që në dukje ishin ekonomike por në marrëdhënie të tilla siç ishin ato mes Shqipërisë dhe Jugosllavia, politika nuk ishte kurrë larg.

Delegacioni shqiptar në Beograd propozoi krijimin e një industrie të lehtë në Shqipëri dhe për këtë kërkoi ndihmën e jugosllavëve për të importuar nga Jugosllavia ato materiale të nevojshme për të ndërtuar në Shqipëri industrinë e lehtë, por jugosllavët e kundërshtuan propozimin e Ministrit Shqiptar të Ekonomisë pasi sipas tyre Shqipëria ende nuk kishte përmbushur marrëveshjet e vitit të kaluar (Pearson, O. 2007: 179). Në të kundërt jugosllavët propozuan që Shqipëria të fokusohet sa më shumë në zhvillimin e bujqësisë, por përse i përket furnizimit me grurë duhet të ishte e varur nga importet nga Jugosllavia (Pearson, O. 2007: 179).

Çështja e grurit është një çështje shumë e ndjeshme dhe shumë e rëndësishme për një vend si Shqipëria që në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore u gjend në vështirësi të madhe përse i përket furnizimit me grurë, siç u pa në fillim të këtij kapitulli dhe jugosllavët duket se synonin ta përdornin këtë nevojë jetike të Shqipërisë për ta mbajtur atë lidhur ngushtë me Jugosllavinë, ndërkohë që kërkesa e Nako Spirit në Beograd ishte që Shqipëria të merrte ndihma ekonomike nga Jugosllavia gjër sa të ishte në gjendje të prodhonte vetë ato çka i nevojiteshin dhe jo të ngelej si shtojcë ekonomike e Jugosllavisë.

Propozimin jugosllav, Nako Spiru e hodhi poshtë duke vënë në dukje se me këtë propozim Shqipëria do të ngelej përherë një shtet i varfër dhe i varur nga të tjerët, ashtu siç hodhi poshtë edhe kërkesën e jugosllavëve që me Shqipërinë të nënshkruanin një marrëveshje të fshehtë në mënyrë që nëse në Shqipëri rrezohej pushteti aktual, interesat ekonomike jugosllave të ruheshin të paprekura (Pearson, O. 2007: 179).

Kjo kërkesë e jugosllavëve duket e çuditshme pasi në mesin e vitit 1947 nuk kishte asgjë që të rrezikonte pushtetin e atëkohshëm në Shqipëri dhe ndikimi jugosllav ishte shumë i madh në shumë drejtime aq sa të mos kishte frikë një rënie të pushtetit dhe humbjes së ndikimit të tyre, veçse nëse shqetësimi i tyre, siç do të shohim edhe më poshtë, kishte të bënte me rritjen e ndikimit sovjetik në Shqipëri, sidomos në ekonomi, që gjer në atë çast kishte qenë ekskluzivitet i Jugosllavisë dhe që duket se Jugosllavia këtë ndikim në ekonomi e shfrytëzonte edhe për të mbajtur sa më afër vetes Shqipërinë.

Pikërisht në korrik të vitit 1947, Shqipëria dhe Bashkimi Sovjetik nënshkruan në Moskë një marrëveshje sipas së cilës Bashkimi Sovjetik i akordonte Shqipërisë një kredi për zhvillimin e industrisë dhe plotësimin e bujqësisë me të gjitha mjetet motorike që nevojiteshin (Pearson, O. 2007: 179). Në njoftimin për nënshkrimin e marrëveshjes thuhet se “Bashkimi Sovjetik i jep Shqipërisë një kredi të vogël nëpërmjet së cilës Bashkimi Sovjetik do të furnizojë Shqipërinë me pajisje për industrinë e lehtë dhe bujqësinë” (Pearson, O. 2007: 179).

Përmendja e industrisë së lehtë në njoftim është domethënëse për faktin se tregon atë rivalitet, nëse mund të quhet i tillë, mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik për ndikimin në Shqipëri. Bashkimi Sovjetik i dha Shqipërisë më këtë marrëveshje atë që Jugosllavia ia kishte refuzuar duke dashur që të impononte në Shqipëri modelin ekonomik që i përshtatej më mirë Jugosllavisë dhe jo të ndihmonte Shqipërinë për t’u zhvilluar ekonomikisht.

Për këtë arsye, përfaqësuesi jugosllav në Moskë kishte kërkuar nga ambasadori shqiptar atje, Mihal Prifti, që jugosllavët të kishin një kopje të marrëveshjes shqiptaro-sovjetike si dhe duke vënë në dukje se Shqipëria nuk mund të nënshkruante asnjë marrëveshje me një palë të tretë pa miratimin e Jugosllavisë (Pearson, O. 2007: 179).

Një muaj para se të nënshkruhej marrëveshja me Bashkimin Sovjetik, Enver Hoxha, në një bisedë me të dërguarin sovjetik në Tiranë, Çuvahinin, kishte shprehur kontradiktat në marrëdhëniet ekonomike me Jugosllavinë. Enver Hoxha i ka folur Çuvahinit për delegacionin shqiptar të kryesuar nga Nako Spiru në Beograd, në prill

1947, të përmendur më sipër, por që sipas Enver Hoxhës, megjithëse delegacioni shqiptar kishte disa javë që qëndronte në Beograd, nuk ishte arritur të merreshin vesh me jugosllavët për asnjë prej çështjeve që ishin: përfundimi i planit ekonomik të Shqipërisë për vitin 1947, puna e shoqërive shqiptaro-jugosllave, ndihma financiare për Shqipërinë si dhe çmimet e mallrave(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 44).

Sipas Hoxhës ‘‘jugosllavët u treguan krejtësisht të papërgatitur për diskutimin e çështjeve të shtruara, pavarësisht se delegacioni shqiptar shkoi në Beograd pas kërkesës së tyre këmbëngulëse...Ata vazhdojnë të mbeten tek opinioni jashtëzakonisht i lartë për veten’’, thotë Enver Hoxha, ‘‘dhe në të njëjtën kohë i vlerësojnë shumë pak cilësitë e punës të punonjësve shqiptare. Jugosllavët mendojnë se gjithçka që thonë ata, shqiptarët duhet ta pranojnë pa kushte e pa kundërshtime, sepse gjithçka që propozojnë përfaqësuesit jugosllav, niset nga premisa që vendet tona zhvillohen në drejtim socialist dhe pikërisht këtu shqiptarët, sipas mendimit të jugosllavëve, nuk kanë fare eksperiencë’’(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 45).

Në bisedën me Çuvahinin, Enver Hoxha thotë se ‘‘jugosllavët e shohin socializmin edhe në çështjet e vogla, thjesht komerciale, dhe kur shqiptarët i kundërshtojnë, fillojnë të operojnë me citate nga veprat përkatëse të Marksit dhe Engelsit, duke u përpjekur të tregojnë erudicionin e tyre’’(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 45).

Jugosllavët, sipas Hoxhës, megjithëse flasin me citate dhe përmendin faktin që të dy vendet, Shqipëria dhe Jugosllavia ecin sëbashku në rrugën e socializmit, ‘‘nuk i harrojnë interesat e tyre shtetërore dhe i shpërfillin fare interesat e popullit shqiptar’’(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 45). Më tej Enver Hoxha në bisedën me Çuvahinin futet më në detaje të marrëdhënieve ekonomike me Jugosllavinë kur ankohet për çështjen e kredisë prej 2 miliardë dinarësh, e cila siç u pa më lart u zgjidh pak kohë pas bisedës së Hoxhës me të dërguarin sovjetik në Shqipëri. Ankesa kishte edhe për shoqëritë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave, mënyra e financimit të së cilave mbetej konfuze dhe dëmtonte funksionimin e tyre.

Ndërsa ‘‘për aleancën doganore dhe hapjen e kufirit shqiptaro-jugosllav për qytetarët e dy vendeve delegacioni jugosllav deklaroi se sipas mendimit të qeverisë jugosllave, kufiri jugosllav duhet të jetë i hapur dhe pa shtyrje të mëtejshme afati. Bile,



jugosllavët deklaruan kategorikisht se, në qoftë se shqiptarët nuk duan të hapin kufirin e vet, ata mund të mos e bëjnë këtë, por, në çdo rast, për qytetarët shqiptarë në Jugosllavi ai do të jetë i hapur dhe se qeveria jugosllave, nuk do t'ju sjellë kurrfarë pengesash, për ata qytetarë dhe firma shqiptare, që duan të futen në marrëveshje tregtare me qytetarë dhe firma jugosllave”(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 46).

Çështja e hapjes së kufirit dhe e bashkimit doganor, edhe në historiografinë shqiptare të pas rënies së komunizmit, është parë si dëshirë e udhëheqjes shqiptare të kohës për të bashkuar Shqipërinë me Jugosllavinë. Kjo çështje më shumë ka të bëjë me faktin që përtej kufirit, në Jugosllavi, jetonte një popullsi e konsiderueshme shqiptare në Kosovë, Maqedoninë veriperëndimore dhe Mal të Zi dhe një marrëveshje e tillë, për hapjen e kufirit dhe për krijimin e një tregu të përbashkët mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë sigurisht që do të kishte përfitime të mëdha për popullsinë shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni ashtu si për shqiptarët në kufi me Kosovën dhe Maqedoninë, ku siç u pa në kapitullin e mëparshëm kishin shumë interesa ekonomike në anën tjetër të kufirit qoftë me shitjen e produkteve të tyre në Prizren, Gjakovë e Tetovë, qoftë me pasjen e tokave edhe në anën tjetër të kufirit.

Por, përtej këtij fakti, në bisedën me Çuvahinin, Enver Hoxha shprehu frikën e tij se me hapjen e kufirit dhe heqjen e taksave doganore, jugosllavët mund të blejnë në Shqipëri mallra që në Jugosllavi mungojnë(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 47), por që do të dëmtonin ekonominë shqiptare pasi çmimet e mallrave në Shqipëri janë të ndryshme nga ato në Jugosllavi. Në marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë ishte parashikuar edhe barazimi i çmimeve të mallrave në të dy vendet, por Enver Hoxha thotë se “jugosllavët në kundërshtim me synimin e tyre fillestar, vënë në dyshim mundësinë e unifikimit të çmimeve të mallrave në të dyja vendet”(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 47).

Nga biseda e Enver Hoxhës me të dërguarin sovjetik në Tiranë, ashtu si nga vizita e delegacionit shqiptar në Beograd kryesuar nga Nako Spiru, shihet se pavarësisht marrëveshjeve mes dy vendeve dhe përshtypjes që ato kishin lënë tek media dhe diplomacia Perëndimore si fillim i bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë, bindje që e ka dhe një pjesë e historiografisë shqiptare postkomuniste, në praktikë gjërat ishin larg marrëveshjeve dhe përshtypjeve dhe zbatimi i marrëveshjeve ishte larg

parashikimit dhe i tillë do të jetë gjer në fund të marrëdhënieve të ngushta shqiptaro-jugosllave.

“Shqipëria”, i tha Enver Hoxha të dërguarit sovjetik, duke konfirmuar dhe një herë atë që autori i këtij punimi ka përsëritur disa herë, që bashkimi me Jugosllavinë tek Enver Hoxha ishte një ide që nuk ekzistonte në një kohë që ai dhe udhëheqja shqiptare përpiqeshin të theksonin pavarësinë dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë, “ka nevojë për ndihmën e huaj, në veçanti nga ana e Jugosllavisë, por ne do të donim, që me ne të mbajnë qëndrim si me një vend të pavarur, të mbajnë parasysh mendimin tonë dhe t’i respektojnë përfaqësuesit tanë...Jugosllavët përpiqen gjithandej të theksojnë epërsinë e tyre...pa një pa dy, tallen në çdo rast të volitshëm me shqiptarët dhe i shohin ata si desh të egër”(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 47-48).

Çështja e kredisë prej 2 miliardë dinarësh që Jugosllavia supozohej të jepte edhe nga mesi i vitit 1947 ishte ende një çështje konfuzë dhe problematike. Në mbledhjen e Byrosë Politike në 29 maj të vitit 1947, Nako Spiru thotë se “në lidhje me 2 miliardët jugosllavët kanë paraqitur një projektprotokoll. Ne i marrim 2 miliardët si kredi dhe ne i detyrohemi Jugosllavisë. Si do të kthehen, kjo do të caktohet më vonë... Për çështjen e 2 miliardëve ata thonë se 2 miliardët janë baraz me një vleftë plaçkash dhe ata vetëm këtë vleftë plaçkash mund të japin...Kur të shtrohet çështja e kthimit të kësaj kredie, gjë që ne nuk e kemi përcaktuar dhe që duhet ta përcaktojmë më vonë, kjo do të kthehet ashtu si është marrë”(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 100), domethënë në plaçkë.

Për këtë çështje, Enver Hoxha, në mbledhjen e Byrosë thotë se “jepen si kredi dhe se ne i detyrohemi Jugosllavisë”, duke iu referuar jugosllavëve, “sigurisht ne do të mbështetemi te situata. Sigurisht, ne s’do t’i paguajmë nesër. Kështu ne s’kemi si të kërkojmë precizionin”(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 100).

Nga këto fjalë të Enver Hoxhës dhe Nako Spirit në mbledhjen e Byrosë së majit 1947 shikohet një konfuzion mbi ato që ishin nënshkruar me jugosllavët në marrëveshjet e nëntorit 1946. Ky konfuzuan përsa i përket çështjes së kredisë prej 2 miliardë dinarësh, do të shohim se nuk është i kufizuar vetëm në këtë çështje, por pothuajse në

çdo drejtim tjetër të ekonomisë që pati një bashkëpunim shqiptaro-jugosllav gjatë viteve 1946 dhe 1947.

Ky konfuzion shihet edhe në fjalët e Nako Spirut në mbledhjen e Byrosë së majit 1947 ku thotë se “del problemi se jugosllavët shumë plaçka që do t’i marrin nga ne do t’i eksportojnë përjashta. Këtu duhet precizuar që për çdo importim që do të bëjë Jugosllavia për në si dhe për materialin tonë që do të riekportoje duhen bërë kontrata të veçanta”(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 101).

Gjashtë muaj pasi Shqipëria kishte nënshkruar marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë, midis të dy vendeve ende nuk kishte një saktësim të asaj çka do të tregtohej, diçka që del si problematike edhe në punën e shoqërisë së eksport-importit, Impeksit.

Problem ishin edhe marrëdhëniet ekonomike me Bashkimin Sovjetik. Që udhëheqja shqiptare nuk i shihte marrëdhëniet me Jugosllavinë si marrëdhënie ekskluzive vetëm ne atë shtet duke lënë mënjanë të tjerët shihet edhe nga fjalët e Nako Spirut në mbledhjen e Byrosë ku ai shqetësohet për faktin që jo çdo gjë që Shqipëria eksporton duhet të shkojë drejt Jugosllavisë, por ka nevoja ekonomike që duhet të plotësohen nga Bashkimi Sovjetik dhe kjo iu duhet bërë e qartë jugosllavëve(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 101).

“Problemi është: do t’ia japim të gjitha eksportimet tona Jugosllavisë apo edhe Bashkimit Sovjetik? Ne mund t’u shtrojmë jugosllavëve se çfarë do të mbajnë për vete nga eksportimet tona dhe çfarë do të riekportoje Jugosllavia, pastaj t’u themi se neve na nevojiten traktorë e makina të tjera, të cilat ne mund t’i marrim në Bashkimin Sovjetik dhe për këto duhet t’i japim Bashkimit Sovjetik plaçkën tonë ose valutën që do të vijë nga plaçka jonë që do të riekportohej. Ne duhet të kërkojmë edhe që valuta që do të na japin ndihmë shqiptarët e Amerikës dhe diçka nga valuta që do të na vijë nga riekportimi i plaçkave tona të na lihet ta përdorim lirisht. Në lidhje me dhënien e plaçkave Bashkimit Sovjetik ose blerja e disa plaçkave në Bashkimin Sovjetik me dollarë, duhet të kemi parasysh edhe çështjen e një kredie që mund të kërkohej nga Bashkimi Sovjetik”(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 101).

Për çështjen e monedhave dhe çmimeve të artikujve në të dy vendeve, edhe kjo e parashikuar me marrëveshjet e nëntorit 1946, por edhe me marrëveshjet e mëparshme, duket se nuk kishte një qëndrim të prerë për këtë çështje disa muaj pasi marrëveshjet ishin nënshkruar, për këtë Nako Spiru thotë se “duhet vendosur a do të kemi çmime unike krejtësisht apo do të bëjmë si vendosëm herën e parë. Pastaj, duhet vendosur a duhet që ata të na i shesin plaçkat me një çmim pak më të ulët ose ne t’i shesim plaçkat tona pak më shtrenjtë...Shkëmbimin e monedhës duhet ta bëjmë nga fundi i muajit”(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 101).

Çështja e kredisë prej 2 miliardë dinarësh që Jugosllavia supozohej të jepte edhe nga mesi i vitit 1947 ishte ende një çështje konfuzive dhe problematike. Në mbledhjen e Byrosë Politike në 29 maj të vitit 1947, Nako Spiru thotë se “në lidhje me 2 miliardët jugosllavët kanë paraqitur një projektprotokoll. Ne i marrim 2 miliardët si kredi dhe ne i detyrohemi Jugosllavisë. Si do të kthehen, kjo do të caktohet më vonë... Për çështjen e 2 miliardëve ata thonë se 2 miliardët janë baraz me një vleftë plaçkash dhe ata vetëm këtë vleftë plaçkash mund të japin...Kur të shtrohet çështja e kthimit të kësaj kredie, gjë që ne nuk e kemi përcaktuar dhe që duhet ta përcaktojmë më vonë, kjo do të kthehet ashtu si është marrë”(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 100), domethënë në plaçkë.

Për këtë çështje, Enver Hoxha, në mbledhjen e Byrosë thotë se “jepen si kredi dhe se ne i detyrohemi Jugosllavisë”, duke iu referuar jugosllavëve, “sigurisht ne do të mbështetemi te situata. Sigurisht, ne s’do t’i paguajmë nesër. Kështu ne s’kemi si të kërkojmë precizionin”(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 100).

Nga këto fjalë të Enver Hoxhës dhe Nako Spirit në mbledhjen e Byrosë së majit 1947 shikohet një konfuzion mbi ato që ishin nënshkruar me jugosllavët në marrëveshjet e nëntorit 1946. Ky konfuzion përsa i përket çështjes së kredisë prej 2 miliardë dinarësh, do të shohim se nuk është i kufizuar vetëm në këtë çështje, por pothuajse në çdo drejtim tjetër të ekonomisë që pati një bashkëpunim shqiptaro-jugosllav gjatë viteve 1946 dhe 1947.

Ky konfuzion shihet edhe në fjalët e Nako Spirit në mbledhjen e Byrosë së majit 1947 ku thotë se “del problemi se jugosllavët shumë plaçka që do t’i marrin nga ne

do t'i eksportojnë përjashta. Këtu duhet precizuar që për çdo importim që do të bëjë Jugosllavia për në si dhe për materialin tonë që do të riekportoje duhen bërë kontrata të veçanta''(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 101).

Pyetjes së Liri Belishovës në mbledhjen e Byrosë së majit 1947 se kur do të dalë plani për vitet 1946-1947, Enver Hoxha i përgjigjet se kjo çështja duhet të precizohet sa më shpejt në Jugosllavi dhe se për këtë çështje duhet të dërgohet një delegacion shqiptar në Beograd, ''ndryshe plani nuk realizohet dhe kjo do të jetë një disfatë politike. Ne jemi shumë vonë me planin, realizimi dhe deklarimi zyrtar i tij duhet të bëhet medoemos brenda gushtit''(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 102).

Duket se shqetësimeve të majit 1947 për kredinë jugosllave prej 2 miliardë dinarësh, iu erdhi fundi, të paktën në letër, në qershor të po atij viti. Në 12 qershor të vitit 1947, Shqipëria dhe Jugosllavia nëpërmjet përfaqësuesve të saj respektivë Ministrin e Ekonomisë së Shqipërisë Nako Spiru dhe Ministrin e Industrisë së Jugosllavisë, Boris Kidriç, nënshkruan marrëveshjen për kredinë prej 2 miliardë dinarësh që Jugosllavia i jepte Shqipërisë ''duke pasur dëshirën për të ndihmuar në krijimin e konditave të nevojshme për koordinimin e planeve ekonomike të vendeve aleate të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe për të dhënë një mbështetje materiale që do të lejojë rimëkëmbjen e ekonomisë dhe të industrisë shqiptare në një nivel korrespondues''(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 103).

Ashtu siç ishte parashikuar nga Nako Spiru dhe Enver Hoxha në mbledhjen e majit të Byrosë Politike, kredia jugosllave ''do të paguhet në sende tregtare, material dhe shkëmbime të nevojshme për investimet dhe punimet që kanë të bëjnë me përtëritjen dhe rimëkëmbjen ekonomike të Republikës Popullore të Shqipërisë si dhe në sende tregtie të konsumit të madh''(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 103). Për listën e sendeve që do të përdreshin si shkëmbim në vlerën e 2 miliardëve dinarë, ''për mënyrën e dorëzimit dhe çdo gjë të nevojshme që mbetet në lidhje me furnizimet e parashikuara''(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 104), si dhe për afatet dhe kushtet në të cilat Shqipëria do të kthejë kredinë, do të vendosej në marrëveshje të mëvonshme.

#### 4.4 Funkcionimi i shoqërive të përbashkëta shqiptaro-jugosllave

Në dokumente të ndryshme nga pala shqiptare shfaqen ankesa të vazhdueshme ndaj Impeksit (shoqërisë së import-eksportit). Aty thuhet se vazhdimisht Impeksi nuk e realizon planin e përcaktuar dhe disa raste, si për shembull në vitin 1947, plani i këtij viti fillon në mes të vitit pasi deri atëherë nuk ka përfunduar akoma plani i vitit të kaluar. Impeksi asnjëherë nuk ka dituar detyrat e tij të vërteta përsa i përket planit dhe ka bërë veprime që nuk janë kompetencë e tij (AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97).

Një shembull se si punonte një degë e Impeksit në Durrës: ‘‘agjencia e Impeksit në Durrës formohet nga 10 nëpunës. Ajo kryen punën e speditorit dhe punën e magazinierit. Si speditor Agjencia kryen punën mirë. Merr raportet mbi dërgimin e mallit, njofton ndërmarrjet për ngarkim shkarkimin e vaporit, merr mallin nga vaporit, nga magazina, njofton konsumatorët (me konsumatorë kuptohen blerësit, tregtarët, jo konsumatorët në kuptimin e sotëm të fjalës. *Shënim i autorit*) mbi mallin e arritur dhe e dorëzon mallin po këtyre konsumatorëve’’.

Më pas agjencia e Impeksit njofton seksionin e transportimeve në Qendër dhe pastaj lidhet me ‘‘Agjencinë Jugosllave Durrës’’. Anijen e shkarkuar në port e merr me qera dhe në të ngarkon mallin që do të eksportohet. Agjencia ka një magazinë të sajën në skelë dhe një hapësirë të pakufizuar pranë skelës. Ka një magazinier dhe një ndihmës magazinier, ndërkohë që punëtorë për magazinë nuk i ka të përhershëm por i merr përkohësisht me pagesë nga Ndërmarrja e Ngarkim Shkarkimit (AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97).

Si punonte Impeksi? Impeksi merrte në fillim të vitit nga Komisioni i Planit të Shqipërisë listën e mallrave të cilët duhet t’i eksportonte. Në këtë kohë Impeksi nga ana e grupeve prodhuese në Jugosllavi merrte kontigjente të ndryshme për të cilat lidhte kontrata. ‘‘Organizimi i Impeksit është analoge me organizimin e një Ndërmarrjeje për tregëti me jashtë por përmbajtja e punës në disa seksione nuk ashtu e njajhtë përmbajtjes së punës të seksioneve të një Ndërmarrjeje tregtare me jashtë. Kjo asht shkaktuar për arsye se Impeksi ka kryer punime të ndryshme dhe mund të thuhet

se në përgjithësi nuk ka kryer punën e një Ndërmarrjeje tregtare''(AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97).

Për shembull më tej thuhet se Impeksi ka kryer dhe punën e Komisionerit, punë të cilat e suallën në rolin e një agjenti. Gjithashtu Impeksi ka kryer dhe punën e magazinierit dhe të speditorit. Por të gjitha këto janë në kundërshtim me organizimin që në teori ka Impeksi. Në fillim ishte ideja që Impeksi do të kishte aksione, përkatësisht ''100 aksione nominale që nuk cedohen''. ''Por aksionet nuk u shtypën dhe kjo shkaktoj që në themelimin e Shoqëris në vend të mbledhjes së aksionistave u arrit që Qeveriat e R.F.P.J dhe R.P.SH kanë patur nga 5 përfaqësues të tyre nga të cilët vetëm 3 erdhën në kushtetimin e Këshillit drejtonjës. Por pasi shoqnia nuk i janë dhënë as një mjet tjetër financiar përveç mjeteve kryesore nga 1.000 000 fr shqiptare d.m.th 12 500 000 lek, Shoqnia nuk ka mundur të kryejë punat tregtare dhe të Komisionarit, por ka kryer rolin e marrësit dhe dhanësit të mallit qoftë nga pikëpamja e marrëveshtjes tregtare qoftë edhe pas kreditit të dy miliardëve. Katë rol, që kishte një karakter ndërmjet komisionerit dhe axhentit Impeksi e zgjeroi dyke marrë mbi vehte punë e dërgimit dhe të magazinave që mungonin në R.P.SH''(AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97).

Qëllimi i shoqëritë së import-eksportit, Impeksit, është të kryejë krejt tregtinë e importit dhe eksportit ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë si dhe të kryejë tregtinë e importit dhe eksportit ndërmjet R.P.Sh dhe vendeve të tjera dhe duhet të funksionojë si shoqëri aksionere(AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97), gjë që nuk ka ndodhur.

Për importimet nga Jugosllavia Ndërmarrjet dhe Drejtorinat Shqiptare i dërgonin qëndrës së Impeksit në Tiranë, elementet e nevojshme për kontraktimin, specifikimin, afatet dhe dispozitat e tjera. Qendra e Impeksit i dërgonte këto degës në Beograd e cila nga ana e vet lidhte kontratën me prodhuesit Jugosllavë dhe i kthente qëndrës në Tiranë. Qendra në bazë të këtyre kontratave lidhte kontrata me konsumatorët në Shqipëri. Për eksportin qëndra lidhte kontrata me prodhuesit dhe me Ndërmarrjet në Shqipëri dhe pas kësaj vet Qendra pa pjesëmarrjen e degës lidhte kontrata me konsumatorët jugosllavë. Për këtë arsye Impeksi do të ishte ndërmarrja që

do të blente mallin dhe do të shiste në Shqipëri dhe anasjelltas(AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97).



#### 4.5 Problemet në marrëdhëniet ekonomike

Në një raport të Inspektoriatit Financiar dërguar Ministrisë së Financave thuhet se “Impeksi nuk ka qenë i aftë të kryejë një operacion të këtillë. Ka patur një aparat të vogël dhe jo teknik kurse u donte të bënte tregëti me afro 5000 artikuj nga Degët e ndryshme të prodhimit. Nji nga vështirësit e mëdha objektive për punën e Impeksit, asht mos njohunia e prodhimeve të RFPJ nga ana e konsumatorëve Shqiptarë. Shqipëria asht mësue me prodhimet italiane edhe kërkesat e konsumatorëve ma tepër basohen në këtë bazë, njohunia e prodhimit jugosllav nga ana e Shqipëris paraqet një proces të gjatë kurse Impeksi ashtë një pengesë për shpektimin e këtij procesi”(AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97).

Më tej thuhet se fakti që Impeksi ka monopolin e import-eksportit dhe kjo ka krijuar pasivitet tek konsumatorët shqiptarë. Në këtë rast shitësi i mallit bën kërkesat dhe pret që Impeksi të sjellë mallrave dhe kjo sipas raporteve të organeve shtetërore ka krijuar pasivitet tek ‘konsumatori’(AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97).

Problem i madh, veçanërisht gjatë vitit 1947 ka qenë dhe transportimi i mallit. Afërsisht 80% e gjithë mallit të eksportuar nga Jugosllavia ka ardhur nëpërmjet detit dhe pothuajse i gjithë është shkarkuar në portin e Durrësit cili ka pasur probleme dhe nuk mund të përballonte gjithë tregtinë me Jugosllavinë(AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97).

Probleme gjithashtu kanë qenë: 1) mungesa e hapësirës për anijet 2) kapaciteti i vogël i skelës së Durrësit 3) diskordinimi i planeve të tremujorit. 4) puna e pa organizuar në skelë. Ekziston një ndërmarrje për ngarkim shkarkimin që ka rreth 130 punëtorë në vitin 1948, 3 kamionë dhe 2 traktorë me rimorkio. 5) nuk është i organizuar deklarimi i mallit në planin e transportit në Jugosllavi(AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97).

Për shembull gjatë vitit 1947 krejt xhiroja ka qenë rreth 275 000 ton mall, nga e cila 185 000 ton i takon skelës së durrësit. Për shkak të problemeve të përshkruara më sipër ka pasur humbje në shkarkimin e mallit. Anijet që kanë humbur kohën në limanin e Durrësit dhe Vlorës mund të transportonin edhe 100 000 ton të tjerë. Nga

eksportimet e Shqipërisë në vitin 1948 prej 310 mijë ton, vetëm nafta i takon 178 000 në Vlorë dhe 120 mijë ton në Durrës(AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97).

Në një relacion të fundit të vitit 1947 për planin e realizimit të kredisë 2 miliardë dinarë që Jugosllavia i dha Shqipërisë, thuhet se plani nuk është realizuar. Si arsye për mosrealizimin e planit përmenden mungesa e shpejtësisë nga dikasteret e ndryshme për të dërguar listat e shpërndarjes(AQSH, fondi 1003, dosja 89, viti 1947, fq. 60-97).

Edhe për shoqëritë e tjera të përbashkëta shqiptaro-jugosllave, gjërat nuk kanë shkuar më mirë se sa me Impeksin. Inspektoriatin financiar thotë se “puna e deritanishme e këtyre shoqërive ka pasë rezultate të rëndësishme në përparimin e ekonomisë Shqiptare dhe në krijimin e bazës ekonomike të përbashkët shqiptaro-jugosllave. Ndërtimi i hekurudhës Durrës-Peqin që u krye nën drejtimin e shoqrisë së përbashkët për ndërtimin e hekur-udhave, ka qenë në vitin e kaluar suksesi më i madh politik dhe ekonomik i Republikës Popullore të Shqipërisë”(AQSH, fondi 891, dosja 3, viti 1948).

Më tej Inspektoriatin Financiar thekson se “në rastin e kontrollimit të punës së shoqnive të përbashkëta janë konstatue një seri dobësish të mëdha, gjë që ka përfaqësue gjatë vitit të kaluem një pengesë serioze në punën e tyre dhe në rast se nuk çduken, mund të influencojnë në mënyrë decisive në mos kryerjen e detyrave për vitin 1948 dhe të kenë pasoja të dëmshme për zhvillimin e tyre të drejtë dhe posaçërisht për përparimin e ekonomisë shqiptaro-jugosllave”(AQSH, fondi 891, dosja 3, viti 1948).

Më tej thuhet se “udhëheqja e dyfishtë e shoqnive ka krijuë njikohësisht dhe marrëdhanie jo të shëndosha ndërmjet shqiptarve dhe jugosllaveve n’udhëheqjen e shoqnive si dhe ndërmjet personelit tjetër ndër shoqnitë e ndërmarrjet. Nëpunsat shqiptarë janë drejtuar udhëheqësit shqiptar të Drejtorisë ase të ndërmarrjen dhe nëpunsat jugosllave udhëheqësit jugosllav. Kështu Drejtoritë dhe ndërmarrjet në realitet janë drejtue prej dy drejtorësh. Këto marrëdhanie janë ashpërsue dhe shfrytëzue posaçërisht prej disa elementave shovinistë dhe karieristë të cilët kanë ba këtë për interesat e ndryshme personale dhe kanë shpërnda parulla të ndryshme anti jugosllave”(AQSH, fondi 891, dosja 3, viti 1948).

Për vitin 1947, shoqëria e hekurudhave e ka kryer planin vjetor 103%. Shoqëria e përbashkët për kërkimin e metaleve e ka kryer planin e prodhimit të bakrit në masën 36% dhe të punimeve të kërkimit të kromit në 3%. Shoqëria e përbashkët për import-eksport (Impeks) e ka kryer planin 85%. Shkaqet kryesore të mos kryerjes së planit sipas Inspektoriatit Financiar kanë qenë këto: 1) mungesa e një drejtimi të përbashkët ekonomik ose udhëheqjeje 2) mungesa në kuadro dhe material, me përjashtim të shoqërisë së përbashkët të elektrifikimit ku shkaku kryesor qëndron në udhëheqjen e shoqërisë(AQSH, fondi 891, dosja 3, viti 1948).

Më tej flitet përsëri për çështjen e kuadrove që ka qenë një ndër shkaqet kryesore për mosrealizimin e planit të vitit 1947: “dobësija kryesore e udhëheqsve të shërbimit të kuadrit (shqiptarë) është qëndrimi sektar kundrejt specialistëve – shqiptarë dhe jugosllavë. Kundrejt specialistë zakonisht shikohet me një farë mosbesimi”(AQSH, fondi 891, dosja 3, viti 1948).

Pasojat e një politike të tillë veçanërisht janë treguar edhe në ngritjen e paktë të kuadrove shqiptarë. Edhe një numër i kurseve speciale me tematikë të hapura nuk ka qenë i organizuar dhe mungesa e mësimave elementare të shkrimit dhe leximit formon një pengesë serioze në ngritjen e tyre. Pastaj, përveç këtyre dhe në mënyra e parregulltë e marrjes në shërbim të kuadrove që eksistojnë e ka ngatërruar akoma më tepër gjendjen e vështirë të kuadrove(AQSH, fondi 891, dosja 3, viti 1948).

Në raport thuhet se “struktura organizative e drejtorive dhe ndërmarrjeve nuk i përgjigjet nevojave specifike dhe detyrave”. Shqetësim ishte ndarja e qartë e punës mes atyre që duhet të bënin punë operative dhe të tjerëve. Për shembull në Drejtorinë e Përgjithshme të Naftës sektori operativ merret me planifikim dhe sektori i planit me evidencën operative dhe statistike. Në ndërmarrjen Patos detyrat e seksioneve të ndryshme nuk janë të qarta. Në shumicën e drejtorive dhe ndërmarrjeve nuk ekzistojnë sektorët më kryesorë: sektori i planit, komercial dhe i kuadrit. Shërbimi i kontabilitetit është gjithashtu i organizuar shumë keq kështu që prej tij nuk mund të shihen rezultatet e punës financiare dhe materiale”(AQSH, fondi 891, dosja 3, viti 1948).

Gjithashtu më tej thuhet se ndarja e organizimit të udhëheqës jugosllav dhe zëvendës shqiptar apo e kundërta është ‘‘pengesë e madhe organizative’’ pasi nuk ka mundësi të realizohet parimi i udhëheqjes teknike me prodhimin(AQSH, fondi 891, dosja 3, viti 1948).

Problemin e kuadrove e nxjerr dhe shoqëria e elektrifikimit në një raport mbi realizimin e planit të vitit 1947 gjatë ndërtimit të hidrocentralit të Selitës në vitin 1947. Vazhdimisht theksohet mungesa e kuadrove dhe teknikë që në shumë raste ka çuar në shtyrjen e fillimit të punimeve dhe sigurisht në mosrealizimin e planit(AQSH, fondi 891, dosja 3, viti 1948).

Çështja e mungesës së kuadrove të kualifikuar dhe problemet në ekonomi që kanë rezultuar nga kjo çështje, ashtu si dhe problemet që kjo ka krijuar në zbatimin e marrëveshjeve ekonomike me Jugosllavinë, është prekur edhe nga Nako Spiru në një bisedë me Sekretarin e Parë të Misionit të Bashkimit Sovjetik në Shqipëri, Gagarinovin.

Sipas Gagarinovit, Nako Spiru tha se ‘‘organizatat lokale të fshatit e qytetit janë mbushur plot me njerëz të paaftë e elementë të huaj. Pavarësisht se kjo gjë është tejet e qartë, me këtë punë nuk po merret askush dhe nuk është marrë asnjë masë konkrete për rregullimin e gjendjes...Organizatrat e partisë në terren, si pasojë e dobësisë së punonjësve drejtues të tyre, të cilët jo vetëm që nuk e njohin gjendjen e vërtetë të situatës në terren, për mungesë komunikimi me popullin, por nuk njihen as me punën e shokëve drejtues vendorë’’(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 62).

Nako Spiru thotë se ‘‘emërimi i kuadrove sipas meritave dhe aftësive për zëvendësimin e njerëzve të paaftë, apo me prirje armiqësore ndaj nesh, tash për tash, është një çështje me rëndësi kryesore, nga i cili varet realizimi i planit dhe realizimi i të gjithë detyrave që qëndrojnë para nesh, me qëllim ecjen përpara në rrugën e demokracisë’’(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 62).

Ai ankohet se ky problem, i kuadrove, nuk merret seriozisht dhe nuk kuptohet, ‘‘si rezultat del se me fjalë dhe sipas informacioneve gjendja aktuale ekonomike është e mirë, kurse në të vërtetë ajo është keq. Kështu është puna me drithin – me mbledhjen

e dorëzimit të tij shtetit; kështu është puna me kantieret tona të ndërtimit, duke përfshirë ndërtimin e rrugës Durrës-Elbasan”(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 62).

Ndërsa jugosllavët, sipas Nako Spirut, për çdo probleme ekonomik ia hedhin fajin vetë atij dhe siç u pa në disa raste të tjera në këtë kapitull, në përgjithësi ia hidhnin fajin shqiptarëve, qoftë drejtuesve, qoftë teknikëve në terren duke u justifikuar se ishin shqiptarët që zvarrisnin realizimin e planit ndërkohë që jugosllavët realizonin gjithmonë shumicën e planit.

Të njëjtën gjë Nako Spiru e thotë në bisedën me Gagarinovin. Thotë se jugosllavët “përpiqen të justifikojnë të gjithë kuadrot e tjerë drejtues, të cilët punojnë në fushën e industrisë. Në rast se ndonjë prej tyre qëllon të paraqesin ndonjë problem gjatë ushtrimit të detyrës, jugosllavët menjëherë luajnë rolin e të habiturit – gjoja se ky problem nuk është ngritur më parë dhe aq sa kanë mundësi, përpiqen që ta zgjidhin atë, pra është e qartë tendenca për të hedhur sa më shumë dyshime për aftësitë drejtuese të Nako Spirut, si funksionar i industrisë dhe në të njëjtën kohë, për të tërhequr në anën e tyre të gjithë të tjerët”(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 64).

Sipas Gagarinovit, duket se Nako Spiru kishte patur një bisedë së fundmi me Enver Hoxhën dhe gjërat aty nuk kishin shkuar mirë. Enver Hoxha supozojë të kishte hedhur poshtë shumë argumente dhe probleme që Nako Spiru kishte parashtruar në lidhje me ekonominë, gjë që “kishte ngjallur dyshim e alarm tek Nako Spiru”(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 64).

Nako Spiru shqetësohej se të gjitha problemet ekonomike ia hidhnin atij përsipër, “e ndjen se jugosllavët po bëjnë një farë pune në mënyrë që ta ‘djegin’ atë, e në veçanti ai konsiderohet si një nga iniciatorët e krijimit të ‘frontit antijugosllav’...Nuk përjashtohet mundësia që Nako Spiru, si drejtues i lartë i industrisë, do të akuzohet nga opinioni i gjerë shoqëror si përgjegjës kryesor”(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 64).

Në fund, Gagarinovi përmend faktin që dikur Nako Spiru ka qenë drejtues i organizatës së Rinisë Fashiste në Durrës dhe se ky ishte shkaku i vërtetë i debatit të tij me Enver Hoxhën dhe jo problemet ekonomike(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 64).

Për çështjen e unifikimit të çmimeve, Enver Hoxha në një bisedë me Savo Zllatiçin, thotë se “vetëm nga fundi i janarit dhe në shkurt filluam të bisedojmë mbi çmimet...Paraqitën në fillim të marsit disa lista mbi barazimin e çmimeve, ku parashikohej subvencionimi i disa mallrave. Por për ndërtimin e strukturës së çmimeve tona puna nuk po fillonte akoma...Ata thanë se duhej organizuar më mirë dhe duhej të vinin disa teknikë që erdhën”(AQSH, fondi 14\AP, dosja 3, 1947). Më tej Enver Hoxha vë në dukje vonesat e vazhdueshme nga ana e jugosllavëve për të marrë një vendim të qartë për çështjen e unifikimit të çmimeve dhe të miratimit të buxhetit vjetor, që sipas jugosllavëve ishte i pamundur të bëhej dhe kështu Shqipëria duhej të mjaftohej vetëm me një buxhet tre-mujor(AQSH, fondi 14\AP, dosja 3, 1947).

Nga fjalët e Enver Hoxhës dallohet fakti që shqiptarët në këtë kohë pothuajse nuk bënë asnjë hap para në ekonomi pa marrë mendimin e jugosllavëve dhe fakti që pothuajse për çdo çështje për të cilat ishte rënë dakord në marrëveshjet e nëntorit 1946 apo edhe në marrëveshje të mëparshme, pritej vendimi i jugosllavëve, tregon që marrëveshjet kishin qenë qysh në fillim ide e jugosllavëve, me mbështetjen e sovjetikëve, siç u pa në kapitullin e kaluar dhe shqiptarët vetëm sa i firmosnin dhe prisnin vendimin e jugosllavëve për realizmin e mëtejshëm të tyre në praktikë, gjë që tregon një varësi të tepruar, ndoshta krijuar prej mirëbesimit të jugosllavët.

Për të arritur tek një arsye e këtyre vonesave, Enver Hoxha thotë se “çështjet në lidhje me çmimet ishin të zorshme jo vetëm për njerëzit tanë...por edhe për jugosllavët dhe se zgjidhja e çështjeve është dhënë më tepër në forma të prera dhe pa shpjegime të thella, ku të mësonin njerëzit tanë, t’i kuptonin më mirë dhe t’i zgjidhnin ato më shpejt. Ka pasur shumë hezitacione dhe kontradiksione në opinionet e shokëve jugosllavë, gjë që ka dezorientuar shokët tanë të rinj. Kjo çështje, po të shtrohej drejt që në fillim të marsit, me të meta, por mund të mbaronte”(AQSH, fondi 14\AP, dosja 3, 1947).

Vonesa të ngjashme me unifikimin e çmimeve, kishte edhe më çështjen e planit, që udhëheqja shqiptare shpresonte ta nxirrte në 1 janar 1947, ashtu si në Jugosllavi me qëllim që dy planet të kombinoheshin me njëri-tjetrin meqë edhe në marrëveshjet e nëntorit ishte parashikuar koordinim i planeve, por kjo çështje vazhdoi dhe muaj të

tjerë pas janarit. Jugosllavëve, sipas Enver Hoxhës, ‘‘u dhamë listat e materialit, të përkthyer dhe plani natyrisht, kërkesat e teknikëve dhe gjithë të tjerat, ç’ ishte e nevojshme. Këtu u fillua të ripunohej prapë dhe, në rast nevoje të bëheshin korigjimet e duhura’’(AQSH, fondi 14\AP, dosja 3, 1947).

Por, jugosllavët e rikthyen disa herë planin shqiptar pasi sipas tyre kishte probleme me listat e materialeve dhe se sipas tyre nuk duhet të parashikoheshin shumë investime, pasi ato ishte e vështirë që të realizoheshin të gjitha. Edhe pas kritikave të jugosllavëve, në prill të vitit 1947 u dërgua një delegacion shqiptar në Beograd, që u përmend edhe në paragrafët e mësipërm, ndër të tjera, për të diskutuar dhe përfunduar çështjen e planit. Por, sipas Enver Hoxhës, ‘‘aty nuk ishte punuar mjaft për këto gjëra, por me insistimin e madh të shokëve tanë puna mundi të mbarohej nga mesi i majit...Disa shtesa që kërkuam ne nuk u panuan, disa me rezerva dhe disa po. Mirëpo në hartimin definitiv të materialit mund të themi se një përqindje fare e vogël u pranua’’(AQSH, fondi 14\AP, dosja 3, 1947).

Megjithëse plani ishte për ekonominë shqiptare, duket se ishin jugosllavët që vendosnin gjithçka, çfarë investimesh do të bëheshin në Shqipëri, cilat mallra do të importoheshin nga Jugosllavia dhe cilat do të eksportoheshin, ndërsa mendimi i shqiptarëve, që duhet të kishin rolin kryesor dhe jo atë të spektatorit në këtë rast, merrej vetëm në pak raste, siç e pohon edhe vetë Enver Hoxha. Por, edhe pse jugosllavët vendosnin pothuajse për gjithçka në ekonominë shqiptare, edhe nga ana e tyre duket një lloj neglizhimi ndaj këtyre çështjeve, ndryshe nuk mund të shpjegohet një vonesë dhe zvarritje e tillë, aq sa një plan që duhet të dilte qysh në 1 janar, përfundon në mes të majit, pesë muaj më vonë, një plan që edhe në mes të majit ende kishte nevojë për rregullime.

‘‘Disa ndërmarrje jugosllave kërkojnë përsëri specifikime’’, thotë Enver Hoxha, ‘‘megjithatë njerëzit tanë kanë punuar pa u lodhur dhe u janë përgjigjur kërkesave. Por, nga kjo urgjencë, çështjet kanë dalë të pastuduara mirë. Po të ishte shtruar mirë një plan punimi dhe një afat i logjikshëm për këto gjëra, çështjet do të dilnin më të studiuara, pse realizimi i planit, duhet ta njohim, ka një rëndësi të dorës së parë. Tash ne shohim se punimet tona nuk kanë filluar me ritmin e paraparë nga plani, pse teknikët kanë ardhur me vonesë dhe në disa vende, sidomos në bujqësi, nuk kanë

ardhur fare...Materiali i tremujshes të parë ka ardhur në një shkallë nën 50%''(AQSH, fondi 14\AP, dosja 3, 1947).

Për mbështetjen dhe popullaritetin e madh të Jugosllavisë në Shqipëri, në shtator të vitit 1947, Helen Simon, korrespondente nga Tirana e revistës komuniste *The Worker* në Nju Jork shkruante se ''Shqipëria është kaq e pazhvilluar industrialisht sa qytetarët e saj e vlerësojnë Jugosllavinë si vëllain e madh të pasur që do të vijë përherë në ndihmë. Jugosllavët – pavarësisht varfërisë së tyre – dërguan ushqime për të shpëtuar shqiptarët vitin e kaluar kur përmbytjet shkatërruan shumicën e të mbjellave të tyre. Jugosllavia jep shinat dhe lokomotivat për hekurudhën e parë të Shqipërisë. Jugosllavia pagoi 2\3 e buxhetit të Shqipërisë. Pankartat 'Rroft Tito' janë po aq të shumta sa dhe 'Rroft Enver''(Pearson, O. 2007: 230).

Më tej ajo shkruan se në zemrat e shqiptarëve, Rusia ka vendin e dytë, megjithëse është pak e njohur. Por, fjalët e saj duhen parë me shumë dyshim pasi, ajo jo më kot është një ndër amerikanët e paktë që është lejuar të hyjë në Shqipëri dhe nëse nuk do të ishte pjesë e një reviste komuniste në SHBA, vështirë se do të vinte në pah vetëm pjesët e mira të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

Përsa i përket buxhetit vjetor të Shqipërisë për vitin 1947, që e përmend dhe Helen Simon në shkrimin e saj nga Shqipëria, zëvendës ministri i Financave, Abdyl Këllezi, në një mbledhje të Kuvendit Popullor të korrikut 1947 thotë se ndihma ekonomike e Jugosllavisë prej 2 miliardë lekësh, përbën 56.73% të buxhetit vjetor të Shqipërisë. Një vit më vonë, Ministri i Financave, Ramadan Çitaku deklaroi se ndihma Jugosllave për atë vit që ishte rreth 3 miliardë lekë, përbënte 48.3% të buxhetit të shtetit(O'Donnel, J.S. 1999: 20).

Por, pavarësisht thëniesve të tilla, qoftë nga Ministria e Financave të Shqipërisë, qoftë nga Helen Simon, edhe me buxhetin, ashtu si pothuajse me çdo pjesë tjetër të marrëdhënieve ekonomike me Jugosllavinë, kishte probleme. Enver Hoxha, thotë se buxheti për vitin 1947 ishte planifikuar të ishte gati në prill të atij viti, por ''çmimet, plani, ligjet e reja financiare e penguan''. Megjithëse jugosllavët kishin premtuar dërgimin e një specialisti në maj të atij viti për këtë çështje, Enver Hoxha thotë në



korrik se ai ende nuk ka ardhur, por jugosllavët, si argument të fundit, kishin ngritur çështjen e riorganizimit të pushtetit lokal(AQSH, fondi 14\AP, dosja 3, 1947).

#### 4.6 Qëndrimi i jugosllavëndaj problemeve ekonomike mes dy vendeve

Por, ndërsa Enver Hoxha dhe udhëheqja shqiptare akuzonte jugosllavët për problemet në marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve, jugosllavët akuzonin shqiptarët. Savo Zllatiç, si përgjigje ndaj problemeve që kishte vënë në dukje Enver Hoxha, nxjerr si arsye kryesore ngadalësinë në realizimin e detyrave nga shqiptarët dhe se sipas tij meqë në Jugosllavi është adoptuar sistemi sovjetik dhe ky është kaluar edhe në Shqipëri, nuk ishte nevojë për shpjegime të thella (AQSH, fondi 14\AP, dosja 3, 1947).

Për jugosllavët, problemet në marrëdhëniet ekonomike me Shqipërinë ishin si pasojë e vetë sjelljes së shqiptarëve dhe i krijimit të një rryme të dytë kundër jugosllavëve brenda Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe jo faj i jugosllavëve. Enver Hoxha, në korrik të vitit 1947, thotë se sipas jugosllavëve “vija e dytë që po konkretizohet në praktikë dhe në lëmin ekonomik në lidhje me të dy problemet...karakterizohet nga javashllëku në kryerjen e tyre, mungesa e guximit në këtë punë, nga një moskuptim i drejtë i marrëdhënieve me njerëzit jugosllavë dhe shqiptarë në këtë çështje ose nga moskuptimi si duhet i detyrave që shtrohen përpara njerëzve tanë, të cilët e kondicionojnë zgjidhjen e këtyre problemeve me vështirësitë në zbatimin e planit, me ardhjen e materialit dhe e teknikëve nga Jugosllavia etj., që për ju janë gjëra të rëndësishme, por të dorës së dytë” (AQSH, fondi 14\AP, dosja 3, 1947).

Por Enver Hoxha, në një bisedë me Savo Zllatiç, thotë se të gjithë, shqiptarët dhe jugosllavët, duhet të thellohen në zgjidhjen e problemeve: “çështja e buxhetit, e planit, e organizimit e shumë të tjera” dhe jo që këto probleme të nënvleftësohen dhe moskryerja e tyre të merret si shenjë mosbesimi ndaj jugosllavëve. “Mund të bëjmë kritika sa të duash në këtë fushë, do të bëjmë vazhdimisht edhe më vonë, pse të pretendojmë se kuadrot tanë, por edhe tuajt që punojnë në Shqipëri nuk bëjnë gabime, do të jetë një budallallëk dhe një gabim i madh...Sikundër që në punën tonë ka ngadalësime, ka gabime, ka lëshime e të tjera të meta, në punën e njerëzve jugosllavë që janë të lidhur me çështjen e Shqipërisë ka dhe ndër ta të meta, gabime, lëshime etj...Por nga disa gabime ose lëshime ose ngadalësime, që mund të kenë bërë njerëzit jugosllavë që janë të lidhur me çështjen shqiptare, ne nuk mund kurrë të bëjmë

deduksione dhe të themi se në Jugosllavi po shtrembërohet vija''(AQSH, fondi 14\AP, dosja 3, 1947).

Sipas fjalëve të Enver Hoxhës duket se pakënaqësia e jugosllavëve dhe ''vija e dytë'' sipas tyre kishte ardhur nga fakti që kishte pasur një vonesë prej një muaji në daljen e vendimit për çmimet dhe rrogat.

Më tej Hoxha thotë duke iu drejtuar jugosllavëve se ''nga kjo vonesë ju bëni deduksionin se po kristalizohej një vijë e dytë në çështjet ekonomike dhe në kundërshtim me vijën e drejtë të Komitetit Central që karakterizohet me ngadalësimin, me mospasje guximi, me taktitëk defensive në zgjidhjen e çështjeve, me një tendencë mosbesimi me njerëzit jugosllavë ose me detyrat që na vihen përpara duke e lidhur zgjidhjen e këtyre detyrave me sende të tjera që janë të rëndësishme, por të dorës së tyre. Këtu nuk jemi dakord domethënë, pikpamja jonë është se nga kjo vonesë nuk mund të deduizojmë se këtu ka shtrembërim vijë ose një vijë të dytë. Mund të ketë çdo gjë tjetër, dhe ka, por jo vijë të dytë''(AQSH, fondi 14\AP, dosja 3, 1947).

Ministria e Punëve Tregtare e Jugosllavisë, në korrik të vitit 1947 bën me dije se pala shqiptare është ankuar për produktet jugosllave që kanë ardhur në Shqipëri si me cilësi të dobët, ambalazhim të keq etj., dhe sipas të dërguarit jugosllav për çështjet e tregtisë, Stojan Diviç, qëndrimi shqiptar kundrejt Jugosllavisë në çështjet tregtar ka qenë i padrejtë(Slavković, B. 2012: 139). Një shembull për këtë qëndrim të shqiptarëve, jugosllavët japin atë të portit të Durrësit, ku shqiptarët përditë kërkonin të dërgoheshin mallra nga Jugosllavia, por tregonin një ngadalësi shumë të madhe në shkarkimin dhe kontrollin e atyre mallrave që dërgoheshin, gjë që ndikonte në dërgimin e mallrave të tjera. Për shembull, një anije jugosllave qëndroi 7 ditë në kontroll dhe kur fillonte shkarkimi ai vazhdonte me orë të tëra. Gjithashtu gjendja në port ishte kaotike, sa edhe mallrat që vinin nga Jugosllavia nuk mbroheshin nga efektet e motit(Slavković, B. 2012: 139).

Stojan Diviç shkruan se në tregun shqiptar mbizotëron kaosi dhe spekulimi dhe se shqiptarët përpiqen të dalin të vetëm dhe të pavarur në tregun botëror(Slavković, B.

2012: 139), gjë që tregon dhe qëndrimin e udhëheqjes shqiptare për të mënjeluar ndikimin jugosllav.

Sipas jugosllavëve, përqindja e planifikuar e import-eksportit të mallrave mes dy vendeve nga Jugosllavia është plotësuar në 26% ndërsa nga Shqipëria 21% gjer në korrik të vitit 1947. Sipas jugosllavëve, pajisjet për fabrikën e sheqerit të dërguara nga Korçë ishin shkarkuar në Ilucë në mes të fushës, ashtu si dhe marrja e mallrave nga shqiptarët nuk ishte organizuar mirë dhe fakti i mosnjohjes së gjuhës nga përfaqësuesit shqiptarë dhe jugosllavë në terren bënte që të kishte konfuzion se cilat mallra ishin dërguar dhe cilat jo (Slavković, B. 2012: 139).

Sipas jugosllavëve, gjatë vitit 1947, në Shqipëri u krijua tendenca që shqiptarët të largohen ngadalë prej kontrollit ekonomik të Jugosllavisë. Mendimet e ekspertëve jugosllavë vazhdimisht janë injoruar dhe vetë ata janë quajtur sabotatorë dhe spekulantë (Slavković, B. 2012: 139). Një gjendje e tillë vazhdoi edhe gjatë vitit 1948, veçanërisht pas fillimit të prishjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, shumë punë publike që ishte të planifikuara ose në ndërtim, u braktisën.

Për shembull diçka e tillë ndodhi me linjat Shkodër-Titograd dhe Shkodër-Kukës, ashtu si në fund të qershorit të vitit 1948 u anuluan dërgesat e naftës drejt Jugosllavisë. Gjithashtu, sipas jugosllavëve, shqiptarët u përpoqën të merrnin me forcë pjesën tjetër të mallrave që kishin mbërritur në Shqipëri nga Jugosllavia, po ashtu si me forcë morrën edhe planet dhe studimet e shoqërive të përbashkëta si dhe ushqimin për punëtorët jugosllavë që punonin në ndërtimin e veprave publike në Shqipëri (Slavković, B. 2012: 139).

Deri në fund të vitit 1947, prej kredisë prej 2 miliardë dinarësh, Shqipëria kishte përfituar rreth 1.6 miliardë, prej të cilave 1.3 miliardë ishin mallra, që përbënin 84% të parashikimit, ndërsa pjesa tjetër nuk ishte përmbushur, sipas jugosllavëve, si pasojë e konfuzionit të shqiptarëve në përpilimin e listave të kërkesave (AQSH, Fondi 890, viti 1948, dosja 48, fq 143). Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 1947, Shqipëria kishte dërguar në Jugosllavi mallra me vlerë rreth 150 milionë dinarë, ndërsa për vitin 1948 Shqipëria kishte dërguar në Jugosllavi mallra me vlerë 240 milionë dinarë, ndërsa Jugosllavia në Shqipëri prej 3 miliardëve dinarë që ishte parashikuar për vitin 1948,

kishte realizuar, sipas jugosllavëve, 90% të parashikimit, që pothuajse ishin mallra që ose kishin mbërritur në Shqipëri ose ishin në rrugë(AQSH, Fondi 890, viti 1948, dosja 48, fq 143).

Sipas qeverisë jugosllave, vetëm gjatë vitit 1948, Jugosllavia humbi 52 milionë dinarë prej faktit që çmimet e mallrave që Jugosllavia dërgonte në Shqipëri ishin shumë më të ulëta se në tregjet ndërkombëtare(AQSH, Fondi 890, viti 1948, dosja 48, fq 143). Ndërkohë që Enver Hoxha në bisedat e tij me jugosllavët dhe sovjetikët akuzonte jugosllavët se kishin vonuar dhe zvarritur procesion e unifikimit të çmimeve mes dy vendeve, që do të eliminonte të paktën humbjet e Jugosllavisë si pasojë e diferencës mes çmimeve, qeveria jugosllave nga ana tjetër akuzonte shqiptarët se kishin vonuar këtë proces me qëllim mbajtjen e çmimeve të mallrave të tyre të ulëta(AQSH, Fondi 890, viti 1948, dosja 48, fq 143).

Me vënien në dukje të faktit që në tregtinë me Shqipërinë Jugosllavia dilte me humbje, qeveria jugosllavia dëshironte të theksonte se kjo tregti dhe ndihmë që Jugosllavia i jepte Shqipërisë ishte një nder që i bëhej Shqipërisë dhe Jugosllavia nuk kishte asnjë përfitim ekonomik.

Gjithë materialitet e shfrytëzuara në ndërtimin e hekurudhës Durrës-Peqin, ashtu si dhe ekspertët, erdhën nga Jugosllavia, ashtu si me ndihmën e Jugosllavisë u ndërtua hidrocentrali i Selitës së Vogël në vitin 1947, e gjithë tregtia mes dy vende zhvillohej nëpërmjet anijeve jugosllave, gjithashtu në vitin 1948 Shqipërisë iu vunë në dispozicion 5 mjete detare që në atë kohë përbënin 50% të tonazhit të marinës shqiptare(AQSH, Fondi 890, viti 1948, dosja 48, fq 143).

#### 4.7 Arritjet e marrëveshjeve ekonomike

Pavarësisht problemeve, ndihma ekonomike e Jugosllavisë shërbeu për të krijuar disa vepra publike të rëndësishme. Hekurudhën e parë shqiptare Durrës-Elbasan e ndërtoi pikërisht shoqëria shqiptaro-jugosllave për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hekurudhave në vitin 1947. Nga shoqëria për shfrytëzimin e burimeve të naftës Qeveria e R.P të Shqipërisë do të marrë 50% neto nga nxjerrja e naftës dhe 15% nga serra, kurse të ardhurat e tjera ndahen proporcionalisht me kapitalin bazë dhe investimet suplementare. Me anën e një protokollit të veçantë, R.F.P e Jugosllavisë angazhohet të ndërtojë një central idraulik brenda 2 vjetësh, i cili të ketë një kapacitet që të përmbushë nevojat e nxjerrjes dhe rafinerimit të naftës në Kuçovë. Shpenzimet, materiali, veglat e ndryshme do t'i njihen Jugosllavisë si investime suplementare. Me anën e një protokollit tjetër qeveria R.F.P jugosllavisë angazhohet që brenda 5 vjetësh të ngrejë një rafineri për naftën e Kuçovës dhe Patosit dhe shpenzimet do t'i njihen si investime suplementare(AQSH, fondi 489, dosja 140, viti 1947 fq 1-13).

Nga Shoqëria për kërkimin dhe shfrytëzimin e minierave qeveria shqiptare merr 15% të fitimit neto që do të investohen nga nxjerrja e mineraleve, kurse të ardhurat e tjera do të ndahen midis palëve në bazë të kapitalit dhe investimeve suplementare. Gjithashtu me anën e një protokollit të veçantë, qeveria R.F.P jugosllavisë angazhohet të ndërtojë gjatë vitit 1947 një central elektrik të mjaftueshëm për nevojat e qytetit të Tiranës. Shpenzimet e ndërtimit do t'i njihen qeverisë jugosllave si investime suplementare(AQSH, fondi 489, dosja 140, viti 1947 fq 1-13).

Në të njëjtën kohë, me ndihmën jugosllave u ndërtua fabrika e sheqerit në Korçë, fabrika e marmalatës në Elbasan, fabrika e sardeleve në Vlorë, centrali telefonik dhe shtypshkronja e Tiranës. Gjithashtu nga Jugosllavia në Shqipëri u dërguan 3 lokomotiva, 69 vagonë, 20 automobila, 3 anija, 10 pajisje më të vogla detare, 278 makina bujqësore, 130 elektromotorë, 2.6 milionë metra pambuk tekstil, 800 ton sheqer, 160 mijë palë këpucë dhe ilaçe me vlerë 16 milionë dinarë(Zivotic, A. 2009: 144).

Në ndihmën për vitin 1947, Jugosllavia i dha Shqipërisë 360 milionë dinarë prej të cilave në mallra 268 milionë, ndërsa Shqipëria i dha Jugosllavia 141 milionë dinarë

mallra. Ndër artikujt e përditshme dhe bazikë që Jugosllavia i dha Shqipërisë në vitin 1947 ishin rreth 20 mijë ton grurë, 2 500 ton misër, 752 mijë metër tekstile, 500 ton sheqer dhe 349 ton marmalatë, ndërsa Shqipëria drejt Jugosllavisë nga 36 mijë ton naftë e parashikuar, nuk dërgoi asnjë, nga 26 mijë ton bitum u dërgua vetëm 12 mijë e 949, nga 2 mijë e 100 ton pambuk e parashikuar për t'u dërguar, vetëm 142 ton u dërgua dhe nga 5 mijë e 700 ton fara luledielli, u dërguan vetëm 2 mijë e 11 ton(Zivotić, A. 2009: 144).

Në 7 korrik 1947, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë vendos të aprovojë dekretligjin mbi heqjen e nga qarkullimi të bankënotave në franga të emisionit të Bankës së Shtetit Shqiptar dhe t'atyre të mbetura nga emisione të ndryshme në banknota dhe monedha metalike të ish Bankës Kombëtare të Shqipërisë(AQSH, fondi 489, dosja 140, viti 1947 fq 1-13).

Kjo u bë për shkak se “sistemi monetar i trashëguar nga e kaluara ka qenë i pa përshtatshëm për vendon t'onë...se sistemi i ri monetar që vendoset me anë të kësaj Dekret ligje, i bazuar në unitetin e vetëm Lek, është i njëllojtë me sistemin monetar që është sot në fuqi në Republikën F.P të Jugosllavisë dhe se konventa ekonomike e lidhur në mes të Republikës s'onë dhe të R.F.P të Jugosllavisë parashikonte, në mes të tjerave dhe parifikimin e monedhës.” Më tej “se ky sistem i ri monetar është m'i përshtatshëm për vëndin t'onë, pasi populli, në marrëdhëniet e tij të çkëmbimit, gjen lehtësi më të madhe llogaritjeje, duke qenë se nuk paraqet fraksione të shumta sikundër ka sistemi i sotshëm monetar...se adoptimi i këtij sistemi të ri monetar bën të mundëshme unifikimin e çmimeve”(AQSH, fondi 489, dosja 140, viti 1947 fq 1-13).

Gjatë katër viteve të marrëdhënieve të ngushta ekonomike me Jugosllavinë në Shqipëri pati një rritje të dukshme të prodhimit të disa produkteve bazike. Në vitin 1938 Shqipëria prodhonte 38 mijë e 570 ton grurë dhe 143 mijë e 750 ton misër, dy përbërësit kryesorë të bukës në Shqipëri, ndërsa në vitin 1948, vitin e fundit të marrëdhënieve të tilla ekonomike me Jugosllavinë, Shqipëria prodhonte 70 mijë ton grurë, dyfishin e sasisë së vitit 1938 dhe 160 mijë ton misër(Griffith, W. E, 1963: 179)

Gjithashtu në industrinë minerale pati një ndryshim të konsiderueshëm. Me përjashtim të prodhimit të bitumit që u zvogëlua nga 17.1 ton në vitin 1938 në 11.8 ton në vitin 1948, në mineralet e tjera pati rritje të madhe. Prodhimi i qymyrgurit u rrit nga 3 mijë e 686 ton në vitin 1938 në 12 mijë ton në vitin 1948, kromi u rrit nga 7 mijë ton në vitin 1938 në 16 mijë e 500 ton në vitin 1948(Griffith, W. E, 1963: 179).

Në vitin 1949, një raport në frëngjisht i qeverisë shqiptare për marrëdhëniet ekonomike me Jugosllavinë shpjegon në detaje më së shumti problemet e marrëdhënie dhe jo arritjet. Në raport thuhet se deri në 28 shkurt të vitit 1947, eksportet shqiptare në drejtim të Jugosllavisë shkonin në 1.55 miliardë dollarë, ndërsa eksportet jugosllave në Shqipëri në 1.3 miliardë, kështu eksportet shqiptare drejt Jugosllavisë ishin 247 milionë dollarë më shumë se ato jugosllave në Shqipëri(AMPJ, drejtorja IV, Jugosllavia, dosja 182, fq. 21).



## **Kreu V. Kosova, çështja që nuk ishte**

### **5.1 Propozimi i Titos për Kosovën (1944)**

Enver Hoxha, tek *Titistët*, shkruan se në takimet me Titon, udhëheqësi i Jugosllavisë i tha se Kosova dhe pjesët e tjera të banuara nga shqiptarë brenda Jugosllavisë, do të bëheshin pjesë e Shqipërisë (Hoxha, E. 1983: 259-260).

Një dokument në gjuhën franceze në origjinal dhe i gjendur në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Jugosllavisë, me datë 21 prill 1944 (Zutić, N. 2004: 176), tregon se fjalët e Titos thënë Enver Hoxhës, nuk ishin shpikje dhe ka mundësi të kenë qenë një shprehje e qëndrimit të vërtetë të Titos për çështjen e Kosovës.

Në dokument bëhet një paraqitje e gjendjes së luftës kundër pushtuesit brenda Shqipërisë dhe të grupeve kryesore, ku sipas dokumentit dallohet Komiteti Kombëtar i Çlirimit sipas termit që përdoret në dokument, i cili drejtohej nga komunistët dhe që ishte më i organizuari, por sipas dokumentit, problem mbetej pjesa veriore e Shqipërisë e cila paraqitet si shumë nacionaliste, antikomuniste dhe antiserbe. Në këtë situatë, janë anglezët që paraqiten si të gatshëm të luajnë rolin e ndërmjetësit mes Komitetit Kombëtar të Çlirimit të drejtuar prej komunistëve dhe veriut të Shqipërisë (Zutić, N. 2004: 177).

Në këtë situatë, Kajro të Egjiptit, realizohen bisedime mes anglezëve dhe përfaqësuesve të Titos. Mendohet se mes komunistëve, të cilët sipas dokumentit e kanë bazën në jug dhe në Shqipërinë e mesme dhe veriut antikomunist mund të zhvillohet një luftë e ashpër nëse veriut i premtohet mbështetje prej serbëve (Zutić, N. 2004: 177).

Çështja më e rëndësishme përse i përket Kosovës është se gjatë këtyre mes anglezëve dhe përfaqësuesve të Titos, në emër të Titos, përfaqësuesi jugosllav i thotë anglezëve se pas luftës krahina serbe e Kosovës duhet t'i jepej Shqipërisë dhe kjo gjë mund të

bënte që mes komunistëve dhe veriut të Shqipërisë të arrihej paqja duke qenë se Kosova do të bashkohej me Shqipërinë(Zutić, N. 2004: 177).

Sipas përfaqësuesit të Titos, lideri i partizanëve jugosllave, ishte plotësisht dakord me një veprim të tillë.

Ky propozim i Titos për anglezët nuk kishte të bënte fare me një bashkim të mundshëm mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Megjithatë, pas përfundimit të luftës dhe krijimit të marrëdhënieve shumë të ngushta mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në udhëheqjen jugosllave kishte dy mendime të ndryshme për çështjen e Kosovës dhe marrëdhënieve me Shqipërinë. Njëri mendim ishte që Kosova duhet t'i jepej Shqipërisë dhe pastaj të gjithë shqiptarët të integroheshin brenda Federatës Jugosllave dhe mendimi i dytë ishte që si pasojë e afrimit sa më të madh mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, dhe pse jo edhe bashkimit mes tyre, kufiri mes Shqipërisë dhe Kosovës do të zhdukej(Zivotić, A. 2009, *Otvoranje*: 91).

## 5.2 Koncepti i jugosllavëpërçështjen e Kosovës

Josip Xherxha, i dërguari jugosllav në Tiranë, i cili ishte i pranishëm në takimim e Enver Hoxhës me Titon në Beograd në qershor të vitit 1946 dhe që shërbente njëkohësisht si përkthyes mes të dyve, nuk e pohon që Tito i tha Enver Hoxhës se Kosova dhe pjesët e tjera të banuara nga shqiptarë në Jugosllavi do të bëheshin pjesë e Shqipërisë (Nasi, L. 1994: 92).

Por, Xherxha, sipas shënimeve të të dërguarit sovjetik në Tiranë, Çuvahinit, i kishte thënë këtij të fundit se Enver Hoxha, në takimim me Titon, e kishte shtruar gabimisht çështjen e Kosovës. “Enver Hoxha shtroi në mënyrë të papërshtatshme çështjen e Kosovës dhe të Metohisë. Në vend që të fliste hapur, siç i takon komunistit me komunistin, Enver Hoxha nga larg, bëri vërejtje të mëdha dhe në përgjithësi gjatë diskutimit të kësaj çështjeje, ndjehej në siklet dhe jo krejtësisht i bindur” (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 31).

Më tej Çuvahini thotë se “Enver Hoxha vendosi të fliste me Titon për çështjen e Kosovës e të Metohisë, pasi mori telegram nga i dërguari shqiptar në Moskë, Koço Tashko. Ky i fundit, sikur e kishte informuar Enver Hoxhën, se gjatë kohës së qëndrimit para pak kohësh të mareshalit Tito në Moskë, J.V Stalini, e kishte ngarkuar për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe Metohisë, gjatë takimit të pritshëm me Enver Hoxhën në Beograd” (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 31).

Sipas Josip Xherxhës, i cili kishte çuar fjalët e Titos në takimim me Enverin tek Çuvahini, Tito kishte thënë se në atë kohë nuk ishte momenti i duhur për t’u marrë me një çështje të tillë. “As situata e brendshme në Jugosllavi dhe as situata ndërkombëtare në përgjithësi nuk e favorizojnë ngritjen e çështjes së bashkimit të këtyre krahinave me Shqipërinë” (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 31).

Sipas Titos, nga ky bashkim i mundshëm i Kosovës, por edhe i pjesëve shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi me Shqipërinë, “Shqipëria nuk do të forcohej, ndërsa Jugosllavia do të humbiste shumë, veçanërisht në Serbi, për të cilën ky problem ka rëndësi të veçantë” (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 31).

Vetë Josip Xherxha, i cili ishte me origjinë nga arbëreshët e Zadarit në Kroaci, thotë se bashkimi i mundshëm i Kosovës me Shqipërinë do të ishte një fatkeqësi për Shqipërinë. ‘‘Çështja është se në këtë rajon punët deri tani shkojnë jo kaq vaj, siç do të dëshironim ne. Kjo krahinë i sjell shumë telashe seksionet të mbrojtjes së popullit të Jugosllavisë (OZNA), pavarësisht nga fakti, se tashmë OZNA ka fituar përvojë të madhe...dhe kush e di, ndoshta, bashkimi në situatën e tanishme të Kosovës dhe Metohisë me Shqipërinë, do të kishte pasoja fatale për çështjen e paqes në Ballkan’’(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 31).

Më pas Çuvahini thotë se mendimi i qarqeve të caktuara në Jugosllavi është se ato toka, veçanërisht Kosova, ‘‘janë prej kohësh toka jugosllave dhe se shqiptarët nuk kanë shkaqe të veçanta bindëse lidhur me pretendimet e tyre për këto rajone’’(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 31).

Por, megjithë diskutimet për çështjen e Kosovës, jugosllavët vazhduan me projektin e tyre për krijimin e Federatës Jugosllave, e cila u realizua me Kushtetutën e vitit 1946, sipas së cilës Kosova u vendos brenda Republikës së Serbisë dhe ky veprim pothuajse shuajti çdo diskutim tjetër për çështjen nëse Kosova mund të bashkohej me Shqipërinë. Nëse diçka mund të ishte bërë në këtë drejtim, duhet të ishte bërë para se të miratohej Kushtetuta e vitit 1946, që vulosi njësitë territoriale brenda Federatës Jugosllave dhe pas saj ishte pothuajse e pamundur që të ndryshohej ndonjë gjë, veçanërisht për një çështje aq të ndjeshme për serbët siç ishte Kosova.

Dekada më vonë, në fund të viteve 80-të dhe fillimin e 90-tës, u pa që përpjekjet për të ndryshuar kufijtë e shteteve të Federatës Jugosllave që u krijuan në vitin 1946, përfunduan me luftra të përgjakshme.

Ideja që Kosova duhet të jetë pjesë e Serbisë, në udhëheqjen jugosllave ka qenë qysh në mbledhjet e Komitetit Popullor të Serbisë në 8, 9 dhe 10 korrik 1945. Në rezolutën e dalë prej kësaj mbledhjeje, përdoret fjala serbe ‘‘prikluçenje’’ (përfshirje) për lidhjen e serbisë me Kosovën dhe jo ‘‘pripajanje’’ (bashkim). Kjo bëhet me qëllim se kufinj të Serbisë të periudhës mes luftrave ishin të njohura ndërkombëtarisht dhe Kosova ishte brenda tyre dhe çfarë ndodhi gjatë luftës nuk njihej ndërkombëtarisht. (Миливојевић, С. 2006: 172) Gjithashtu më tutje, në 1 shtator 1945, Kuvendi

Popullor i Serbisë vendosi që Serbia, brenda Jugosllavisë, të ndahet në 16 rrethe, në krahinën autonome të Vojvodinës dhe krahinën autonome të Kosovës dhe Metohisë dhe e tillë Kosova do të përfshihet në Kushtetutën e vitit 1946.

Kufinj të brendshëm të Jugosllavisë u vendosën jo nga etnitë e ndryshme që popullonin Jugosllavinë, por nga Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë me në krye Josip Broz Titon. (Миливојевић, С. 2006: 174). Në këtë këndvështrim gjithçka që lidhej me mundësinë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë është nul.

Sipas Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në njoftim e saj, qeveria shqiptare kishte përmendur edhe faktin që Josip Xherxha dhe Savo Zllatiç disa herë kishin folur për të zgjidhur një herë e mirë çështjen e Kosovës, duke nënkuptuar nga qeveria shqiptare që ata kishin folur për një mundësi të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, por historiani serb Aleksandar Zhivotić, ekspert i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, thotë se është e vështirë të vërtetosh nëse Xherxha dhe Zllatiçi kishin pasur ndonjë qëndrim të tillë në bazë të dokumenteve të tanishme (Zivotić, A. 2009, *Otvoranje*: 92).

Sipas historianit serb, ekziston mundësia që Xherxha dhe Zllatiçi, të kenë bërë ndonjë propozim të tillë në biseda private me udhëheqës shqiptarë, por jo zyrtarisht. Në fakt, një këndvështrim i tillë, qoftë nga Xherxha dhe Zllatiçi, qoftë nga Tito më parë, siç u pa më lart, duket të kenë qenë thjesht qëndrime të çastit, pa asgjë konkrete pas tyre. Qoftë ideja që Kosova mund t'i jepej Shqipërisë ose Shqipëria të bëhej pjesë e Jugosllavisë dhe kështu të bashkohej me Kosovën, nuk shkuan asnjëherë përtej fjalëve. Nuk pati asnjë lëvizje në terren për të dyja çështjet.

Në fund të luftës, Tito kishte thënë duke iu referuar Kosovës, se mes Shqipërisë së re demokratike dhe antiimperialiste dhe Jugosllavisë, kjo çështje nuk do të përbënte më një problem (Џећпáнек, V, 2011: 108), një qëndrim pak a shumë të ngjashëm me atë të Enver Hoxhës në vitin 1946 që e shihte çështjen e Kosovës në këndvështrimin e ri të marksizëm-leninizmit.

Të vetmet veprime konkrete ishin ato që e vendosën Kosovën brenda Republikës së Serbisë dhe më pas me Kushtetutën e vitit 1946, e mbyllën përfundimisht këtë çështje brenda Jugosllavisë. Brenda Partisë Komuniste Jugosllave nuk kishte asnjë qëndrim që Kosova pas luftës mund të ishte një njësi federale e Jugosllavisë(Banac, I. 1988: 103). Vetëm dekada më vonë, kur Jugosllavia fillonte të shkatërrohej, vetëm atëherë mundësia e shkëputjes së Kosovës, doli si çështje.

Nga udhëheqësit e lartë të Partisë Komuniste Jugosllave, vetëm Sreten Zhujović-Crni mendonte se Kosova duhet të ndahej mes Serbisë dhe Shqipërisë, por vetëm nëse Shqipëria bëhej pjesë e Jugosllavisë(Banac, I. 1988: 103). Mes historianëve serbë, veçanërisht atyre disidentë në kohën e Jugosllavisë, fakti që Kosova nuk u përfaqësua në rangjet e larta të Partisë Komuniste Jugosllave dhe në konferencat e zhvilluara gjatë luftës tregon se një qëndrim përfundimtar për statusin e saj të pasluftës nuk kishte ende, por historiani kroat Ivo Banac thotë se një qëndrim i tillë është të shkosh shumë larg dhe se me shumë mundësi tek Tito dhe tek udhëheqësit e tjerë të Partisë Komuniste Jugosllave, për Kosovën ishte i njëjti mendim që kishte dhe Sretan Zhujović-Crni(Banac, I. 1988: 103).

Për jugosllavët, çështja e Kosovës, pas përfundimit të luftës asnjëherë nuk u diskutua nëse mund të bashkohej me Shqipërinë apo jo. Thëniet e ndryshme të udhëheqësve jugosllavë, duke përfshirë dhe Titon, duket se kanë qenë më shumë rastësore dhe nuk kishin ndonjë qëllim apo plan të përcaktuar. I vetmi diskutim përse i përket Kosovës në Jugosllavinë e pasluftës ishte nëse do të bëhej pjesë e Serbisë apo Malit të Zi.

Arsyetimi që u paraqit në këtë diskutim ishte se popullsia sllave në Kosovë ishte serbe dhe kështu duhej të bëhej pjesë e Republikës së Serbisë, ndërkohë që popullsia malazeze, në vitin 1948 përbënte vetëm 3,9 përqind të popullsisë së Kosovës(Nasi, L. 1994: 100). Nëse do të ishte shkuar me të njëjtën logjikë, duke marrë parasysh që popullsia shqiptare ishte shumicë dërrmuese në Kosovë, atëherë do të shtrohej mundësia që Kosova të bashkohej me Shqipërinë, por brenda Jugosllavisë duket se një çështje e tillë ishte e paimagjinueshme që të ndodhte.

Për serbët çështja e Kosovës ishte e padiskutueshme. Gjatë mbledhjes në Beograd të Frontit Nacionalçlirimtar të Serbisë, në dhjetor të vitit 1944, u deklarua se Kosova është e Serbisë dhe për këtë nuk kishte asnjë diskutim(Nasi, L. 1994: 100).

### 5.3 Qëndrimi i udhëheqjes shqiptare për çështjen së Kosovës

Për vetë Enver Hoxhën dhe udhëheqësit shqiptarë duket se çështja e Kosovës duhej parë ndryshe për shkak edhe të faktit që tashmë në pushtet në të dy vendet ishin Parti Komuniste, të cilat supozohej që çështje të tillë t'i trajtonin jo si dikur. Në Plenumin e jashtëzakonshëm të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare në 18-20 dhjetor të vitit 1946, Enver Hoxha thotë se nuk është progresiste që të kërkohet Kosova.

“Kur ne të arritëm në socializëm, që do të thotë kur atje dhe këtu mbeturinat e kapitalizmit të kenë ngrënë dru, ahëre, në një situatë të tillë, Kosova do të bashkohet me Republikën Socialiste të Shqipërisë, ahëre Kosova do të bashkohet. Kjo është vija, këtë na mëson marksizmi”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 73).

Enver Hoxha nuk e sheh çështjen e Kosovës dhe të shqiptarëve në Jugosllavi nga pikëpamja etnike apo politike, por e sheh në pikëpamjen e marksizmit. “Në rast se një anëtar partie e ka të qartë vijën, ai e ka të qartë edhe çështjen e Kosovës”, thotë Hoxha në Plenumin e 18-20 dhjetorit, “Jugosllavia është më e avancuar se ne, interesi jonë është që ajo të jetë e fortë. A është në interesin tonë të kërkojmë Kosovën, kjo nuk është progresive. Pra në këtë situatë përkundrazi duhet të bëjmë ç’është e mundur që Kosovarët të vëllazërohen me jugosllavët. Asgjë tjetër nuk është aktuale, nuk është progresiste...Kur ne bëjmë akord, hapim doganat, ky është një hap drejt socializmit e drejt marrëdhënieve të Kosovës me popullin shqiptar”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 73).

Por ky këndvështrim i çështjeve të tilla etnike dhe nacionaliste brenda ideologjisë marksiste nuk ishte vetëm tek Enver Hoxha. Edhe në këndvështrimin e Titos nacionalizmi ishte një fenomen borgjez dhe burokratik, i kundërt me atë të punëtorëve. “Në kushtet e sotme shoqërore, nacionalizmi është përgjithësisht një shprehje e tendencave burokratike dhe hegjemoniste”(Wilson, D. 1979: 153).

Sipas Enver Hoxhës, Tito supozohet t'i ketë thënë të parit në vitin 1946 se “Kosova dhe rajonet e tjera shqiptare iu përkasin juve” (Judah, T. 2008: 49), por kjo gjë nuk mund të realizohej në vitin 1946 për shkak të kundërshtimit të serbëve..



Kur vetë Enver Hoxha në Plenumin e dhjetorit 1946 thotë se udhëheqja shqiptare nuk ka interes dhe nuk do të ishte progresiste të kërkonte Kosovën në atë moment, çfarë mund të jetë dukur problematike në sytë e jugosllavëve për çështjen e Kosovës në takimin e mesit të vitit 1946?

Me përjashtim të vizitës së Enver Hoxhës në Beograd në mesin e vitit 1946, kur siç u tha më sipër, pretendohet që Enver Hoxha e ngriti çështjen e Kosovës në mënyrë të papërshtatshme, udhëheqësit shqiptarët pas kësaj date pak, për të mos thënë, aspak, nuk e kanë prekur çështjen e Kosovës në lidhje me Jugosllavinë, por edhe vetë jugosllavët, me përjashtim të një përmendjeje nga Edvard Kardelji në takimin me Stalinin, nuk e kanë përmendur më tej këtë çështje.

Në rastin e udhëheqjes shqiptare ndoshta kjo mospërmendje e Kosovës ka të bëjë edhe me ndikimin shumë të madh që Jugosllavia kishte në Shqipëri, por edhe nëse Enver Hoxha e ka ngritur këtë çështje në takimin me Titon, nuk duket se ka patur të paktën nga Bashkimi Sovjetik ndonjë mbështetje për këtë çështje. Siç shihet në takimet e jugosllavëve me Stalinin, udhëheqësi sovjetik ishte shumë pak i informuar për Shqipërinë dhe popullin shqiptar në Ballkan. Gjatë vizitës së Josip Broz Titos në Moskë, Stalini, i cili deri në atë moment nuk dinte asgjë për çështjen e Kosovës, kishte këshilluar udhëheqësin jugosllav ta zgjidhte këtë problem me shqiptarët. (ACKSKJ, IX, 1-I, 78, fq. 15)

Por, studiuesë serbë thonë se një prej pakënaqësive të Enver Hoxhës në lidhje me Jugosllavinë, kishte lidhje edhe me Kosovën (Zivotic, 2011: 130).

#### **5.4 Pse Kosova nuk ishte një çështje në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave?**

Çështja e Kosovës ishte përtej mundësive të udhëheqjes shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe nëse nuk do të kishin qenë komunistët që morrën pushtetin në Shqipëri dhe Jugosllavi, vështirë se për këtë çështje do të ishte ndryshuar ndonjë gjë. Forcat anglo-amerikane nuk pranuan të njohin asnjë ndryshim territorial të ndodhur në Evropë gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, ndryshime që kishin prekur edhe territoret e banuara nga shqiptarë, kështu që kjo mosnjohje nga ana e tyre bënte që në fund të luftës Kosova të ishte një çështje që i përkiste Jugosllavisë dhe jo Shqipërisë dhe Jugosllavia vendoste se çfarë mund të bëhej me Kosovën.

Megjithatë kjo nuk mund të justifikojë plotësisht qëndrimin e butë dhe pasiv të Enver Hoxhës dhe udhëheqjes shqiptare në kohën që në Kosovë mijra persona u vranë e u internuan prej qeverisë jugosllave. Qëndrimi i Enver Hoxhës sigurisht që vinte prej marrëdhënieve që Shqipëria kishte ndërtuar me Jugosllavinë. Vetëm pas mesit të vitit 1948 dhe në vitet në vazhdim, kur marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk ishin më si më parë, vetëm atëherë Enver Hoxha u kujtua të flasë gjerë e gjatë për çështjen e Kosovës dhe për ata mijëra persona që u vranë nga qeveria jugosllave pas Luftës së Dytë Botërore.

Por edhe nëse Enver Hoxha dhe udhëheqja shqiptare do të kishte mbajtur një qëndrim tjetër ndaj çështjes së Kosovës, kjo nuk do të kishte ndryshuar faktin që Kushtetuta e Federatës Jugosllave e vitit 1946 sanksionoi kufinj të brendshme të Jugosllavisë dhe mbylli çështjen e ardhmërisë së Kosovës.

Gjithashtu, në kapitujt e mëparshëm u argumentua se politika e jashtme e Shqipërisë ishte nën varësinë e Jugosllavisë, forcat e armatosura të Shqipërisë instruktoheshin dhe furnizoheshin nga Jugosllavia dhe në të njëjtën kohë ekonomia shqiptare ishte e varur në një masë të madhe prej Jugosllavisë. Në këtë këndvështrim, çfarë mund të kishte bërë Enver Hoxha dhe udhëheqja shqiptare e kohës për çështjen e Kosovës? Edhe nëse do të kishte qenë dëshira ose synimi për të bërë diçka, mundësitë ishin pothuajse zero.

Megjithatë, në politikën e Shqipërisë së Enver Hoxha kundrejt Kosovës duket se diçka ndryshoi pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, duke filluar me bërjen publike të letrave të Stalinit dërguar jugosllavëve dhe më pas me rezolutën e Informbyrosë dhe aksioneve të mëtejshme që shkaktuan një sërë incidentesh mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Një gjendje e tillë u pasqyrua edhe në lidhje me Kosovën dhe pjesët e tjera të Jugosllavisë të banuara nga shqiptarët.

Në fillim ishte Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste të Maqedonisë që akuzoi Shqipërinë për shovinizëm kundrejt Jugosllavisë duke përmendur popullsinë shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni dhe se qëndrimi i udhëheqjes shqiptare pas rezolutës së Informbyrosë, ka qenë ai i mbështetjes së grupeve nacionaliste dhe shoviniste, sipas maqedonasve, në Kosovë dhe Maqedoni (Zivotić, A. 2009, *Otvaranje*: 92).

Në shtator të vitit 1948, qeveria shqiptare i hedh poshtë akuzat për shovinizëm dhe përmend faktin që jugosllavët kishin dashur ta bënin Shqipërinë pjesë të Jugosllavisë, ashtu siç përmend edhe represionin ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë. Sigurisht që represioni ndaj popullsisë shqiptare në Jugosllavi, nuk ishte diçka e re dhe kishte nisur qysh në fund të Luftës së Dytë Botërore, por i ri ishte qëndrimi i qeverisë shqiptare të Enver Hoxhës që tashmë nuk e lidhte më asgjë me Jugosllavinë dhe kishte mundësi të përmendte gjithçka që gjer pak kohë më parë ishte e ndaluar, pikërisht për shkak të marrëdhënieve të ngushta me Jugosllavinë.

Megjithatë, edhe nga dokumenti i paraqitur në fillim të këtij kapitulli mbi bisedimet e Titos me anglezët gjatë luftës dhe përmendja e Kosovës aty, tregon se ndoshta një mendim ndryshe tek Tito mund të kishte qenë, por nga ana tjetër përmendja e Kosovës në bisedimet me anglezët dhe lidhja me krijimin e simpatisë në Veriun e Shqipërisë për Partinë Komuniste Shqiptare duke premtuar Kosovën pasluftës, mund të kishte qenë vetëm një taktikë e Titos për të tërhequr gjithë shqiptarët nën ndikimin e Partisë Komuniste Shqiptare. Nga ana e tyre, pas prishjes me jugosllavët, në kufirin Shqipëri-Jugosllavi pati gjithmonë incidente dhe Enver Hoxha foli shpesh për çështjen e shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëve të tjera të Jugosllavisë.

## **Kreu VI. Fundi vëllazërisë së panatyrshme shqiptaro-jugosllave**

### **6.1 Vizita e Enver Hoxhës në Moskë**

Vizita e Enver Hoxhës, në Moskë, në korrik të vitit 1947, nuk ishte fillimi i distancimit të shqiptarëve nga jugosllavët, ashtu siç pretendon historiografia serbe (Zivotić, A. 2009: 95). Qëndrimi i Stalinit ndaj Shqipërisë ishte po ai që kishte qenë edhe më parë. “Ne nuk mund t’ju ndihmojmë dot drejtpërdrejt. Ndihamat tona ne do t’jua japim nëpërmjet Jugosllavisë, pse po t’jua japim drejtpërdrejt dhe po të marrin vesh për këtë anglo-amerikanët, atëherë ata do të përpiqen të bëjnë pengesa. Po ndihamat do të vijinë nëpërmjet Jugosllavisë...Në Jugosllavi ka njerëz të mirë dhe s’besoj që t’jua mbajnë ato që do të dërgojmë për ju, bile do t’i ndihmojmë edhe ata. Është shumë mirë që ju keni Jugosllavinë aleat në kufi. Shqipëria është një vend i vogël dhe ka nevojë për një mbështetje të fortë. Nuk mundeni vetëm”, i tha Stalini Enver Hoxhës në takimin e 17 korrikut të vitit 1947(Plasari, N. & Malltezi. L1996: 117).

Vizitën e Enver Hoxhës në Moskë e kishte paraprirë një delegacion shqiptar i kryesuar nga Nako Spiru në prill të vitit 1947 dhe marrëveshjet që Nako Spiru nënshkroi me sovjetikët siç ishin ato për dërgimin e ekspertëve sovjetikë në Shqipëri, shkollimi i studentëve shqiptarë në Bashkimin Sovjetik, organizimi i ekspozitave dhe leksioneve, e rritën shumë ndikimin sovjetik në Shqipëri, (Zivotić, A. 2009: 95) por nuk mund të thuhet se zbehën atë jugosllav, pasi vetë fjalët e Stalinit vazhduan ta detyronin Shqipërinë të qëndronte e lidhur pas Jugosllavisë.

Duket se orientimi i politikës së jashtme nuk ishte në dorë të udhëheqjes shqiptare, pavarësisht dëshirës së tyre për të patur qysh në fillim marrëdhënie të ngushta me Bashkimin Sovjetik. Shqipëria duhet të vazhdonte të ishte nën patronazhin e Jugosllavisë, sepse kështu kishte vendosur Bashkimi Sovjetik. Vetëm kur Jugosllavia do të kalojë kufijtë që ka vendosur Bashkimi Sovjetik në marrëdhëniet me Shqipërinë dhe Bullgarinë, vetëm atëherë Enver Hoxha mund t’i kthehet dëshirës së tij të parë: të lidhet me Bashkimin Sovjetik.

Që Enver Hoxha priste një ndryshim në politikën e jashtme pas vizitës në Moskë, duket edhe nga fakti që ambasadorit sovjetik në Tiranë, Çuvahinit, Hoxha i kishte

deklaruar para se të nisej për në Moskë se interesat kombëtare të Jugosllavisë nuk përputheshin me ato të Shqipërisë dhe se Hoxha, në Moskë, do të kërkonte ndihmën ekonomike të sovjetikëve (Zivotic, 2012: 250).

Në këtë bisedë me Çuvahinin dalin në pah dy çështje themelore të marrëdhënieve me Jugosllavinë pas Luftës së Dytë Botërore: interesi kombëtar dhe ekonomia. Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në këtë periudhë tregojnë se për shqiptarët dhe jugosllavët afërsia ideologjike e dy Partive Komuniste që drejtonin vendet respektive nuk kishte vlerë. Interesi kombëtar ishte përpara gjithçkaje tjetër dhe për Enver Hoxhën duket se interesi kombëtar i Shqipërisë nuk ishte në të njëjtën linjë me atë të Jugosllavisë.

Vizita e Enver Hoxhës në Moskë gjithashtu u parapri nga një shtim i konsiderueshëm i artikujve në shtypin shqiptar për Bashkimin Sovjetik dhe një zvogëlim i ndjeshëm i artikujve për Jugosllavinë, një veprim që kishte qëllim të popullarizonte sa më shumë Bashkimin Sovjetik tek popullsia shqiptare. Në të njëjtën linjë ishin edhe fjalimet e Nako Spirut nëpër Shqipëri menjëherë pas kthimit të tij nga Bashkimi Sovjetik (Zivotic, A. 2009: 95). Megjithatë, siç u pa dhe në kapitullin ku flitej për marrëdhëniet ekonomike me Jugosllavinë, Helen Simon, e revistës *The Worker* shkruante nga Shqipëria në shtator të vitit 1947 se Bashkimi Sovjetik nuk ishte shumë i njohur në Shqipëri dhe vendin e parë në renditjen e popullaritetit e mbante Jugosllavia.

Para vizitës së Hoxhës në Moskë, i dërguari sovjetik në Tiranë, Çuvahini në një raport të tijin dërguar Moskës i informonte sovjetikët me detaje për gjendjen në Shqipëri dhe veçanërisht brenda Partisë Komuniste Shqiptare, të cilën ai e konsideronte si të keqe në organizim dhe me mundësi për elementë reaksionare, borgjezë që të futeshin brenda Partisë, ashtu siç theksonte edhe një mbështetje dhe këshillim të tepruar të udhëheqjes shqiptare me jugosllavët (Zivotic, A. 2009: 96).

Edhe përgatitjet e sovjetikëve për vizitën e Enver Hoxhës në Moskë ishin të konsiderueshme. I dërguari sovjetik në Tiranë, Çuvahini, dërgoi në Moskë një raport të detajuar të gjendjes në Partinë Komuniste Shqiptare dhe organizimit të saj, që siç u pa edhe më parë, e paraqiste atë si të keqorganizuar dhe vinte në dukje një mbështetje

të tepruar tek jugosllavët. Me kritikën ndaj kaosit brenda Partisë Komuniste Shqiptare, Çuvahini kritikonte tërthorazi edhe jugosllavët të cilët e kishin këshilluar Partinë Komuniste Shqiptare(Zivotić, A. 2009: 98).

Vetë jugosllavët kishin pak dijeni për vizitën e Enver Hoxhës në Moskë, pasi edhe komunikimi mes sovjetikëve dhe shqiptarëve për këtë vizitë nuk u bë nëpërmjet Jugosllavisë, por pati një komunikim të drejtpërdrejtë, aq sa jugosllavët, megjithë ndikimin e madh që kishin në Shqipëri dhe në udhëheqjen shqiptare, vetëm në momentet e fundit arritën të mësonin përbërjen e delegacionit shqiptar në Moskë, se kush do e shoqëronte Enver Hoxhën(Zivotić, A. 2009: 98). Nëse kjo ishte e qëllimshme nga sovjetikët apo ishte diçka e rastësishme është e vështirë për ta përcaktuar, por ngelet fakti që në këtë rast jugosllavët u mënjanuan.

Ky mënjanim ndaj jugosllavëve vazhdoi edhe gjatë kohës që delegacioni shqiptar i përbërë nga Enver Hoxha, Koçi Xoxe, Manol Konomi, Fadil Paçrami dhe Hysni Kapo, gjendej në Moskë, ku u konsultua me sovjetikët për disa probleme të brendshme të Shqipërisë dhe të Partisë Komuniste Shqiptare, që gjer atëherë ishin këshilluar vetëm me jugosllavët.

Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe kërkuan mendimin e sovjetikëve përsa i përket riemërtimit të Partisë Komuniste Shqiptare në Parti të Punës, gjithashtu për programin e statutit të Partisë ku sovjetikët i këshilluan shqiptarëve që të shikonin statutet ekzistuese të Partisë Komuniste Rumune, Bullgare, Polake dhe Mongole, por mungon përmendja e Jugosllavisë. Gjithashtu sovjetikët ishin të gatshëm të dërgonin në Shqipëri njerëzit e tyre në ndihmë të Komitetit Qëndror për të organizuar punët e Partisë(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 49).

Kërkesa për ndihmë e Enver Hoxhës ishte bërë nëpërmjet një letre dërguar Zhdanovit, Sekretarit të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Pansovjetike, gjatë kohës që delegacioni shqiptar ishte në Moskë. Kur flet për statutin e partisë, Enver Hoxha shkruan se për realizimin e tij, janë bazuar ‘’kryesisht mbi statutin e Partisë Komuniste Pansovjetike (Bolshevike), duke e përshtatur me situatën aktuale në vendin e partisë tonë. Përveç kësaj, ne kemi shfrytëzuar statutin e Partisë Punëtore

Bullgare dhe teza të veçanta nga statuti i Partisë Komuniste Rumune''(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 49).

Edhe në këtë rast shikohet që Jugosllavia nuk përmendet dhe kjo është diçka e çuditshme duke marrë parasysh konsultimet e gjera që shqiptarët kishin bërë me jugosllavët, pothuajse për çdo gjë. Si është e mundur që shqiptarët nuk këshillohen me jugosllavët për diçka kaq të rëndësishme siç është statuti i partisë? Duket e vështirë që kjo të jetë e rastësishme, duke patur parasysh nivelin shumë të lartë të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

Që kjo nuk duket dhe aq e rastësishme, konfirmohet kur në letër Enver Hoxha shkruan se ‘në projekt-statut janë shtjelluar parimet kryesore, në të cilat duhet të bazohemi pas konsultimit me ju dhe pasi të jenë bërë korrigjimet e duhura, që ju do të na këshilloni''(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 49). Këshillat sovjetike kanë mënjanuar këshillat jugosllave për Enver Hoxhën dhe sovjetikët siç u pa dhe më lart, nuk hezitojnë të dërgojnë njerëzit e tyre në Shqipëri për të këshilluar shqiptarët në një çështje kaq të rëndësishme. Ndoshta i gjendur në Moskë, aty ku priste të shkonte prej 2 vitesh, Enver Hoxha u përpoq të hiqte qafe presionin jugosllav dhe të fillonte të ndërtonte atë që kishte dëshiruar qysh në vitin 1945: një marrëdhënie të ngushtë me Bashkimin Sovjetik, pa ndërmjetësimin e Jugosllavisë.

Më tutje në letrën drejtuar Zhdanovit, Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe, për lëkundjet në vijën e Partisë, të cilat u analizuan në kapitullin e dytë të këtij punimi, ata bëjnë me faj përfaqësuesin jugosllav pranë Partisë Komuniste Shqiptare (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 49). Duket pak e vështirë që ky të ketë qenë një mendim edhe i Koçi Xoxes, duke patur parasysh afrinë e tij me jugosllavët dhe mendimin shumë të mirë që kishin jugosllavët për të si një përfaqësues të vërtetë të klasës punëtore në Shqipëri.

Ndërkohë që gjatë vitit 1946, Enver Hoxha kërkoi ndihmën dhe këshillën jugosllave për ushtrinë shqiptare, madje i shkroi dhe Titos për këtë çështje, në letrën dërguar Zhdanovit ku vazhdimisht kërkohet gjykimi i tij, përmenden edhe problemet dhe gjendja në ushtrinë shqiptare, madje duke shkruar se ‘shoku jugosllav, gjeneral-leinant Svjetozar Vukmanoviç-Tempo, i cili kryeson udhëheqjen politike në ushtrinë jugosllave, na ka informuar pak mbi marrëdhëniet reciproke midis Shtabit të

Përgjithshëm të Ushtrisë dhe udhëheqjes politike në Jugosllavi''(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 49).

Në bisedën që Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe bënë me Zhdanovin pak ditë pas dërgimit të letrës, që të dy ranë dakord me të gjitha këshillat dhe propozimet e Zhdanovit.

Në asnjë rast Zhdanovi nuk përmendi këshillimin me jugosllavët, por propozoi dërgimin e dy punonjësve sovjetikë në Shqipëri, njëri për punën në sektorin e kulturës dhe agjitpropit të Komitetit Qëndror dhe tjetri specialist për problemet e organizimit të punës ideologjike, të dy punonjësit të kërkuar nga Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe(Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 59).

Çuvahini, i cili shoqëroi delegacionin shqiptar në Moskë, shkruan se në bisedën e Enver Hoxhës me Stalinin, ky i fundit u shfaq i pakënaqur me politikën e Jugosllavisë ndaj Shqipërisë duke theksuar se Shqipëria është një vend i pavarur dhe pavarësisht nga Jugosllavia, duhet të zhvillojë marrëdhënie edhe me vende të tjera(Zivotiç, A. 2009: 95). Vetë Enver Hoxha në librin e tij me kujtime për Stalinin, pasi e përshkruan në mënyrë pak si të ekzagjeruar pritjen në Bashkimin Sovjetik dhe nga vetë Stalini, shkruan se i bëri shumë përshtypje ndihma e pakufizuar ushtarake që Bashkimi Sovjetik i ofroi Shqipërisë(Hoxha, E. 1979: 33-52), gjë që tregon dhe një herë atë që autori i këtij punimi theksoi në kapitullin e dytë, që ndihma dhe mbrojtja ushtarake e Shqipërisë ishte shumë e rëndësishme për Enver Hoxhën dhe përcaktuese në marrëdhëniet e tij me Jugosllavinë dhe Bashkimin Sovjetik.

Në një moment të tillë, Jugosllavia ka filluar të përbëjë rrezik për sovranitetin e Shqipërisë me planet e saj për krijimin e Federatës Ballkanike, të cilat duhet të ishin të njohura për udhëheqjen shqiptare dhe kjo mbështetje ushtarake sovjetike duhet të ishte shumë e rëndësishme për Enver Hoxhën, për të balancuar ndikimin jugosllav.

Edhe në takimin e 15 korrikut me Ministrin e Punëve të Jashtme të Bashkimit Sovjetik, Molotov, Enver Hoxha shprehu pakënaqësitë e tij për Jugosllavinë, veçanërisht në marrëdhëniet ekonomike, megjithatë theksoi lidhjen e ngushtë që ekzistonte mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë(Zivotiç, A. 2009: 95).



Në krahasim me Stalinin, që kritikoi qëndrimin e Jugosllavisë, Molotovi vetëm bëri pyetje pa thënë vetë asgjë konkrete(Zivotić, A. 2009: 95). Qëndrimi i Stalinit mbi pavarësinë e Shqipërisë, megjithëse shënimet e Çuvahinit për takimin mes Enver Hoxhës dhe Stalinit janë fragmentare, duket të jetë i vërtetë, edhe për faktin se gjatë vitit 1948, sovjetikët i mëshojnë shumë faktit që Jugosllavia në marrëdhëniet me Shqipërinë dhe Bullgarinë ka tejkalar këshillat e Bashkimit Sovjetik(Павловец Ю. С. 2010: 112).

## 6.2 Reagimi i jugosllavëve ndaj vizitës së Enver Hoxhës në Moskë

Pas përfundimit të vizitës së Enver Hoxhës në Moskë, në 26 korrik dhe kthimit në Tiranë, Savo Zllatiçi nga Tirana i shkruan qeverisë jugosllave se në të ardhmen Shqipëria do të orientohet në një bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Bashkimin Sovjetik dhe për Zllatiçin nuk ishte e qartë se çfarë vendi dhe roli do të kishin marrëveshjet ekonomike me Shqipërinë në këtë kurs të ri të politikës së jashtme të Shqipërisë(Zivotić, A. 2009: 101).

Savo Zllatiçi i shkruan Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Jugosllave se fjalimi i Enver Hoxhës pas kthimit nga Moska hoqi paqartësitë që ekzistonin tek udhëheqja shqiptare por edhe tek vetë jugosllavët në Shqipëri në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Sipas tij, Enver Hoxha la të nënkuptohej se tashmë lidhja mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik do të jetë e drejtpërdrejt. Zllatiçi shkruan se është ende e paqartë se çfarë do të ndodhë në marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe me marrëveshjet ekonomike të nënshkuara mes dy vendeve, pasi Enver Hoxha pas kthimit nga Moska tha se Shqipëria do të merrte ndihmë dhe mbështetje ekonomike të drejtpërdrejt nga Bashkimi Sovjetik (ACKSKJ, IX, 1-I, 122).

Në këtë pikë, Enver Hoxha kishte arritur atë që dëshironte qysh prej dy vitesh: lidhjen e drejtpërdrejt me Bashkimin Sovjetik. Një lidhje e tillë hiqte dhe dyshimet apo frikërat që ekzistonin tek udhëheqja shqiptare por edhe tek populli në përgjithësi në lidhje me Jugosllavinë. Savo Zllatiçi thotë se udhëheqja shqiptare, duke përfshirë sigurisht dhe Enver Hoxhën, bën një politikë jo të sinqertë në lidhje me Jugosllavinë pasi sipas tij, interesi kryesor i shqiptarëve ishte lidhje direkte me Bashkimin Sovjetik, sidomos në fushën ekonomike. Pas këtij qëndrimi, sipas Zllatiçit, qëndron dëshira e udhëheqjes shqiptare për të qenë e pavarur.

Në të njëjtën linjë, i dërguari jugosllav në Shqipëri, shkruan se drejtuesit shqiptarë kishin thënë hapur se nuk mund t'i respektonin marrëveshjet që kishin me Jugosllavinë, veçanërisht atë për dërgimin e naftës në Jugosllavi, pasi ajo sasi që ishte përcaktuar për Jugosllavinë duhej të dërgohej në Bashkimin Sovjetik për të marrë pajisje për fabrikat shqiptare(Zivotić, A. 2009: 101). diçka që siç u pa në kapitullin e

ekonomisë Jugosllavia kishte refuzua ta bënte gjatë vizitës në Beograd të delegacionit shqiptar të kryesuar nga Nako Spiru.

Kjo lëvizje, sipas jugosllavëve, kishte të bënte me përpjekjen e shqiptarëve për favorizuar këtë e tutje marrëdhëniet ekonomike me Bashkimin Sovjetik kundrejt atyre me Jugosllavinë(Zivotić, A. 2009: 101).

Për Jugosllavët një shenjë tjetër e faktit që Enver Hoxha kishte filluar t'i mënjanonte ata ishte dhe fakti që megjithëse kishte premtuar të vizitonte ambasadorin jugosllav në Moskë, Vladimir Popoviç, në fund të vizitës së tij në Moskë, Enver Hoxha nuk shkoi dhe dërgoi vetëm Hysni Kapon, i cili i tha Popoviçit se Hoxha ishte shumë i zënë dhe nuk mund të vinte. Përveç mungesës së vizitës, Popoviçi ishte acaruar së tepërmi për shkak se shqiptarët nuk ishin konsultuar me të për vizitat në Moskë(Zivotić, A. 2009: 101).

Por, pavarësisht një situatë të tillë të tensionuar, Hysni Kapo në bisedë me Popoviçin i kishte thënë se me sovjetikët kishin biseduar për ato problemet të cilat nuk mund t'i zgjidhin me jugosllavët, për pajisje fabrikash që jugosllavët nuk i kishin dhënë. Gjithashtu kishin biseduar për dërgimin e traktorëve, tekstileve dhe specialistëve sovjetikë në Shqipëri(Zivotić, A. 2009: 101).

Por, duket se për Enver Hoxhën nuk kishte ndryshuar ndonjë gjë e madhe në marrëdhëniet me Jugosllavinë. Në një fjalim në Gjirokastrë, në 5 tetor të vitit 1947, Enver Hoxha tha se "Shqipëria e vogël është shumë me fat që ka në kufijtë e saj një shtet të madh dhe demokratik si Jugosllavia, një shok të sinqertë dhe të dashur të popullit tonë. Imagjiloni, shokë, si do të ishte fati i popullit tonë të vogël pa Jugosllavinë miqësore dhe demokratike. Populli i vogël shqiptar nuk do të kishte lirinë, që tani e kanë, por do të gjendej në ditë të errëta dhe në një fat të zi. Kjo është mënyrë në të cilën ne e gjykojmë miqësinë, vëllazërinë dhe aleancën që na lidh me Jugosllavinë e Titos"(Zivotić, A. 2009: 101).

Më tej Enver Hoxha përmend Greqinë dhe problemet me të si një çështje e rëndësishme në marrëdhëniet me Jugosllavinë, një pikë që autori i këtij punimi e ka theksuar vazhdimisht. "Mundëj dot vendi ynë i vogël të mbronte frutet e gjakut të tij,

të derdhur gjatë luftës për vendosjen e rendit të sotëm demokratik, një ndër më progresistët, nëse do të ishte i rrethuar nga vende si Greqia?

Do të qëndronte vallë vendi ynë me këmbët e tij dhe të ndërtonte një jetë të re ndershmerisht dhe në liri? Do të ishte shumë e vështirë, do të ishte e pamundur. Shikoni pra pse miqësia me popujt e Jugosllavisë është kaq e shtrenjtë për popullin tonë''(Pearson, O. 2007: 231).

Megjithëse fjalimi i Enver Hoxhës i përket fundit të vitit 1947, disa muaj pas vizitës së tij në Bashkimin Sovjetik dhe pakënaqësisë që kjo vizitë e pakoordinuar me jugosllavët, kishte krijuar tek ta, qysh disa javë pas përfundimit të vizitës në Moskë, Tito kishte thirrur në takim ambasadorin sovjetik në Beograd, Lavrentjevin, pikërisht për këtë çështje. Në shënimet e tij Lavrentjevi thotë se biseda me Titon ishte e hapur dhe direkte.

Tito i tha Lavrentjevit se ''pas kthimit të delegacionit shqiptar nga Moska, ka pasur disa deklarata nga përfaqësues shqiptarë në të cilat është vënë në dukje se Jugosllavia dëshiron të vëjë dorë mbi Shqipërinë, se vetëm premtion ndihmë ekonomike dhe nuk e jep, që Shqipëria i intereson vetëm për shkak të afërsisë gjeografike dhe pozicionit strategjik dhe që Jugosllavia mohon pavarësinë e Shqipërisë''(Zivotić, A. 2009: 102).

Tito i tha Lavrentjevit se marrëveshjet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik nuk ndryshojnë gjë në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, madje i bëjnë ato edhe më të forta, por ashtu siç në kapitullin e ekonomisë u vu në dukje shqetësimi i Nako Spirut se jugosllavët për çdo problem ia hidhnin përgjegjësinë atij, edhe në takimin me ambasadorin sovjetik, Tito fajësoi Nako Spirun për politikën e tij antijugosllave dhe se do të kërkonte nga udhëheqja shqiptare që të përjashtonte Nako Spirun si pasojë e politikës së tij antijugosllave dhe antimarksiste dhe për këtë ishte i gatshëm të ftonte për një vizitë në Beograd Enver Hoxhën dhe Koçi Xoxen(Zivotić, A. 2009: 102).

Në shënimet e tij, ambasadori sovjetik thotë se kërkesës së Titos për një mendim mbi çështjen e përjashtimit të Nako Spirut, Lavrentjevi nuk i dha një përgjigje por vetëm e dëgjoi(Zivotić, A. 2009: 101).

Edhe i dërguari sovjetik në Tiranë, Çuvahini, në një takim me përfaqësuesin jugosllav në Shqipëri e siguroi atë se mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk do të ndryshojë asgjë dhe se Bashkimi Sovjetik do të ndihmojë Shqipërinë nëpërmjet Jugosllavisë, pak a shumë të njëjtat fjalë që Stalini i tha Enver Hoxhës në Moskë. Të njëjtën gjë përsërit edhe Enver Hoxha në librin e tij *Titistët*. Kjo tregon se në atë kohë, mesi i vitit 1947, mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik nuk kishte ndryshuar ndonjë gjë dhe në këtë mënyrë edhe midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk duhet të ndryshonte asgjë (Zivotić, A. 2009: 103).

Por, megjithëse kishte thirrje nga të gjitha palët që në marrëdhëniet Shqipëri-Jugosllavi nuk kishte ndryshuar gjë, në këndvështrimin e jugosllavëve kjo nuk ishte e vërtetë. Në arkivin e Jugosllavisë, në dosjen *Informacione mbi marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare*, e datës 1 gusht 1947 thuhet se Abdyl Këllezi, zëvendës ministër i Financave, në Kuvendin Popullor hapur kritikoi Jugosllavinë dhe falënderoi Bashkimin Sovjetik “duke vënë në dukje se ekspertët sovjetikë janë me vlera, të besueshëm, që i mbarojnë në kohë përgjegjësitë dhe që nuk shohin orën kur do përfundojë puna, ndërsa jugosllavët nuk i shtrohen punës, nuk punojnë, presin fundin e orarit të punës dhe se midis tyre ka edhe sabotatorë” (Zivotić, A. 2009: 103).

Në të njëjtën linjë ftohjeje marrëdhëniesh shqiptaro-jugosllave, sipas jugosllavëve ishte edhe fakti që Kristo Themelkos, i cili po kurohej në Bled të Sllovenisë, iu kërkua të kthehej menjëherë në Tiranë dhe pak kohë më vonë u dërgua për kurim në Bashkimin Sovjetik, “pasi aty ka mjekë të vërtetë, të cilët, në dallim nga jugosllavët, janë më ekspertë dhe të besueshëm” (Zivotić, A. 2009: 103).

Megjithëse shenjat e ftohjes dhe ndryshimit të kursit, sipas jugosllavëve, ishin të vogla por të dukshme, kur Enver Hoxha kërkoi nga Stalini jo vetëm ekspertë teknikë për Ushtrinë Shqiptare, të cilët në fakt u dërguan në Shqipëri në fillim të vitit 1948, por dërgimin edhe të ekspertëve politikë për të organizuar më mirë Ushtrinë Shqiptare, Stalini e hodhi poshtë kërkesën e Enver Hoxhës dhe këshilloi që këto çështje të diskutoheshin më mirë drejtpërdrejt me jugosllavët. Sipas sovjetikëve, instruktorët jugosllavë në Ushtrinë Shqiptare e bëjnë shumë mirë punën e tyre dhe kështu nuk është nevoja për një prezencë të sovjetikëve (Zivotić, A. 2009: 103).

### 6.3 Kritikak e jugosllavëve ndaj udhëheqjes shqiptare

Në nëntor të vitit 1947, jugosllavët, shenjat e vogla të ftohjes i kthyen në kritika të forta ndaj Partisë Komuniste Shqiptare. Sipas jugosllavëve marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në atë kohë nuk ishin të kënaqshme dhe vihet në dukje një rënie e intensitetit të tyre veçanërisht në ekonomi, (AQSH, 14\AP, dosja 3, viti 1947) një çështje që në kapitullin që kishte të bënte me marrëdhëniet ekonomike u theksua disa herë.

Duket se problemet politike ndërmjet dy vendeve, nisnin nga problemet ekonomike dhe kjo më tepër për shkak të qëndrimit të jugosllavëve, të cilët niseshin nga ekonomia për të kritikuar qëndrime politike dhe ideologjike. Nëse kishte probleme në marrëdhëniet ekonomike, nuk duket se bëhej ndonjë përpjekje e vërtetë për të ndryshuar ndonjë gjë në ekonomi por hidhej faji nga njëri krah në tjetrin, veçanërisht theksohej zvarritja e punëve dhe mungesa e dëshirës dhe menjëherë jugosllavët në këto probleme gjenin një vijë antijugosllave në udhëheqjen shqiptare. Ky qëndrim jo vetëm që nuk ndryshonte gjë në ekonomi dhe siç u pa edhe në kapitullin e ekonomisë, vërtet nuk ndryshoi asgjë gjer në vitin 1948 pavarësisht kritikave dhe vënies në dukje të problemeve, por nga ana tjetër, por këto acarimin edhe më shumë marrëdhëniet mes Partive Komuniste që drejtonin të dy vendet.

Edhe në kritikën e nëntorit, jugosllavët i rikthehen të njëjtave probleme: se shqiptarët nuk përfitojnë nga ndihma ekonomike jugosllave dhe se për këtë e kanë fajin disa njerëz që kanë frikë nga ky bashkëpunim dhe se në shoqëritë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave gjendja është aq e keqe sa vazhdimisht kërkohet ndërhyrja e Komisionit të Koordinimit. Gjithashtu përballë teknikëve jugosllavë qëndrimi i shqiptarëve është aq i keq sa mund të shkaktojë edhe probleme të mëdha (AQSH, 14\AP, dosja 3, viti 1947).

Përsëritja e kritikave dhe kalimi nga problemet ekonomike tek ato politike shihet edhe kur nga jugosllavët thuhet se ‘kemi përshtypjen se në vend të përpjekjeve të përbashkëta për të kapërcyer këto pengesa, në disa shokë shqiptarë ka një qëndrim jokonstruktiv. Ata flasin kurdoherë për gjërat që duhet të plotësojë Jugosllavia, ata

kanë një qëndrim të prerë, kurse qëndrimi i tyre është liberal kundrejt detyrave që duhet të plotësojnë shqiptarët...është me të vërtetë e çuditshme që këto marrëdhënie të behen të tilla, në një kohë kur vendet e tjera të Ballkanit dhe të Evropës Qëndrore po lidhen sa më tepër me Jugosllavinë. Na vjen keq që qeveria jugosllave të konstatojë (dhe realiteti është ky) që lidhjet me Hungarinë dhe Rumaninë, të mos flasim për Bullgarinë, janë shumë më të mira se sa me Shqipërinë, me të cilën na lidhin luftëra e shumë gjëra të tjera”(AQSH, 14\AP, dosja 3, viti 1947).

“Një politikë e tillë, ka ardhur në sektorin ekonomik, ku orientimi komplet është në kundërshtim plotësisht diametral me bazën e vijës që është përcaktuar në mes dy vendeve...Marrim ligjin ekonomik. Ky ligj s’ka gjënë kryesore, domethënë atje nuk flitet fare për kreditin e 2 miliardëve...Ligji ka përmbajtje autarkike dhe nuk merr fare parasysh marrëdhëniet ekonomike”(AQSH, 14\AP, dosja 3, viti 1947).

Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë akuzon se “nuk është ngritur ekonomia shqiptare e lidhur me ekonominë e Jugosllavisë...ky orientim nuk ka kapsur ndërmend marrëveshjet me Jugosllavinë dhe direktivat e Komitetit Central. Shpirti që del këndeje tregon qartë se nuk është në prizmën e marrëdhënieve dhe në prizmën e nevojave. S’kemi gjë kundër që qeveria të bëjë bukën ose të zhvillojë industrinë e lehtë, por flitet se sot kemi detyra të përbashkëta”(AQSH, 14\AP, dosja 3, viti 1947).

Jugosllavët i rikthehen edhe një herë besimit të tyre se në Shqipëri ekziston një vijë, që sipas tyre, është politike dhe jo ekonomike, e cila e sheh me dyshim marrëdhëniet me Jugosllavinë. “Nuk është çudi që ky qëndrim u reflektohet aktivistëve shqiptarë nga njerëz me pozita mjaft të rëndësishme dhe këta, në bazë të kësaj, shpesh herë në punën e përditshme mbajnë një qëndrim antijugosllav”(AQSH, 14\AP, dosja 3, viti 1947).

Duke u futur më në detaje dhe marrë shembuj praktikë të këtij qëndrimi jugosllavët thonë se “Zejnel Hamiti vete në Kuçovë dhe thotë se të gjitha seksionet do të lidhen me Ministrinë e Industrisë në Tiranë. Po ky njeri ka thënë se s’pranon letra në gjuhën serbe etj. Ahmet Jegeni ka thënë se duhet të përkthehet e tërë korrespondenca në gjuhën serbe etj. Specialistët jugosllavë thonë se po zvogëlohet vlefata e specialistëve

jugosllavë dhe nënçmohen mendimet e propozimet e tyre...Inxhinieri i portit të Durrësit që u zëvendësua me një italian. Në Patos u punua me qëllim që të komprometohej inxhinieri jugosllav. Nënçmimi i Kraigerit dhe Peroviçit...Për mencën qeveria shqiptare s'u ka dhënë asnjë ndihmë. Në industri shumë jugosllavëve u janë vonuar pagesat. Çështja e kontrollit të reptë në lidhje me vizat. Shokët shqiptarë kanë dashur të zhveshin një shoqë jugosllave për të kontrolluar. Njerëzit tanë shikohen shumë keq këtu''(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 123).

Ankesat e jugosllavëve vazhdojnë me faktin që jugosllavët quhen sabotatorë dhe 20-25 prej atyre janë nxjerrë jashtë nga shtëpitë në Durrës dhe se problemet që kanë ndodhur në hekurudha janë politike dhe jo teknike. 'Asnjë nga republikat tona nuk ka pasur kaq ndihma, kaq kujdes nga Komiteti Central i Jugosllavisë, në bazë të mundësive, për me zgjidhë pengesat, se sa ka qenë ndihma për Shqipërinë...Jugosllavia i ka hapur të gjitha portat Shqipërisë, i ka dhënë çdo skicë sekrete të organizimit të partisë, të ushtrisë, të mbrojtjes, të pushtetit etj''(AQSH, 14\AP, dosja 3, viti 1947) dhe fajtori kryesor për jugosllavët, ose të paktën një prej fajtorëve kryesore ishte Nako Spiru për të cilin jugosllavët thonë se 'kur të analizohen marrëdhëniet mes nesh, ne nuk mund të mos vërejmë një rol të çuditshëm që lot Nako Spiru. Ne na duket se Nako Spiru dëshiron në këtë gjë orientimin antijugosllav dhe është mbrojtësi i këtij orientimi. Ai, Fadil Paçrami e të tjerë, sigurisht pas mendimit tonë, kanë lojtur një rol të dukshëm në dobësimin e marrëdhënieve mes nesh''(AQSH, 14\AP, dosja 3, viti 1947).

Për arsyet e përmendura më sipër 'Komiteti Central i Jugosllavisë dhe qeveria jugosllave shikojnë se, në bazë të situatës të sotme, duhen nxjerrë disa konsekuenca. Konstatohet pamundësia e vazhdimit të punës në bazat e tanishme, veçanërisht në disa qëndrime të disa organeve shqiptare. Qeveria jugosllave do t'i zgjidhë të gjitha punët me qeverinë shqiptare, duke i nënvizuar dhe i harmonizuar në bazë të akordeve''(AQSH, 14\AP, dosja 3, viti 1947).

Duke qenë se jugosllavët nxirrnin Nako Spirun problemin më të madh në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, rasti i mbledhjes së Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare në 18 nëntor të vitit 1947, ishte i duhuri për të kërkuar llogari nga Nako Spiru për qëndrimin e jugosllavëve, por që në



fakt nuk zgjidhi asgjë pasi marrëdhëniet me Jugosllavinë u përkeqësuan edhe më shumë, ndërkohë që në fund të nëntorit, Nako Spiru vrau veten, ngjarje që nga Radio Tirana në atë kohë u lajmërua se ndodhi pasi aksidentalisht Nako Spiru qëlloi veten kur po pastronte armën e tij(Pearson, O. 2007: 238).

Ndërsa vetë qëndrimi i Enver Hoxhës është i dyzuar. Ai vazhdimisht flet për një afrim sa më të madh me Jugosllavinë, por edhe me Bashkimin Sovjetik dhe kur jugosllavët ngrënë problemet ekonomike si politike, Hoxha, siç u pa dhe më parë, preferon t'i trajtojë ato ashtu siç janë: si ekonomike. Enver Hoxha nuk merr një qëndrim të caktuar për këtë çështje, por thotë se ‘’Nakoja mund të flasë për marrëdhëniet ekonomike, që i njeh mirë’’(Миронин, С. *Реабилитация Сталина*, [http://www.zlev.ru/77\\_44.htm](http://www.zlev.ru/77_44.htm)), kështu duke mos i hedhur përgjigjesinë Nako Spirit, por duke e nxjerrë atë përpara si njeriun që i ndërtoi marrëdhëniet ekonomike me Jugosllavinë dhe meqë ishte ai ndërtuesi, duhet të japte shpjegime pse themelet e këtyre marrëdhënieve nuk qëndrojnë.

#### **6.4 Problemet sovjeto-jugosllave dhe ndikimi i tyre në Shqipëri**

Por, ndërkohë që marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave përkeqësoheshin, e njëjta gjë ndodhte dhe me ato sovjeto-jugosllave, gjë që kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në Shqipëri, megjithëse ende përkeqësimi ndodhte në mënyrë të fshehur, të tërthortë dhe jo të drejtpërdrejtë. Veçanërisht nënshkrimi i marrëveshjeve të gushtit dhe nëntorit të vitit 1947 mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë, acaruan së tepërmi Stalinin dhe kritika e tij ndaj Titos në këtë rast ishte e drekte.

Disa muaj më parë, në gusht, pikërisht atëherë kur tek jugosllavët ishte shfaqur shqetësimi për afrimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, në Bled të Sllovenisë, ishte nënshkruar një marrëveshje shumë e rëndësishme me Bullgarinë, që pak a shumë ishte një vazhdim i asaj të nënshkruar në dhjetor të vitit 1944. Gazeta *Borba* e 3 gushtit 1947 boton përmbajtjen e plotë të marrëveshjes bullgaro-jugosllave. Në të thuhet se Jugosllavia dhe Bullgaria do të përpiqen të zhvillojnë gjersa të jetë e mundur shkëmbimin e mallrave dhe bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve, do të unifikojmë monedhat, do të përgatiten për krijimin e një sistemi të përbashkët doganor dhe sa më shumë të koordinojnë planet e tyre ekonomike (Borba, 3 gusht 1947).

Pikat e mësipërme të marrëveshjes nuk ndryshojnë aspak prej marrëveshjeve ekonomike me Shqipërinë. Si fillim, para se të krijohet një sistem i përbashkët doganor, me këtë marrëveshje dakordësohet që fillimisht hiqeshin vizat hyrje-dalëse mes dy vendeve, gjithashtu për një bashkëpunim sa më të ngushta në fushën e hekurudhave, ngarkohej me detyrë shoqëria e përbashkët e hekurudhave (e ngjashme me atë me Shqipërinë) që të përcaktonte pikat në të cilat do të vazhdohej bashkëpunimi, si dhe të zhvilloheshin sa më shumë që të ishte e mundur marrëdhëniet kulturore mes dy vendeve (Borba, 3 gusht 1947).

Marrëveshja tjetër e Jugosllavisë me Bullgarinë do të nënshkruhet në 27 nëntor të vitit 1947, në Eksinograd, në breg të Detit të Zi, në Bullgari. Në pikën e pestë të marrëveshjet ritheksoheshin përgatitjet për krijimin e një sistemi të përbashkët doganor, koordinimin e planeve ekonomike dhe zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik sa më të ngushtë, por gjithashtu theksohej edhe pavarësia dhe tërësia

territoriale e secilit vend pa përmendur mundësinë e ndonjë bashkimi mes tyre për krijimin e një Federate të përbashkët(Petranović, B. 1977: 44).

Marrëveshja me Bullgarinë bëhet në të njëjtën kohë që jugosllavët përpiqeshin të gjenin se cilat ishin shkaqet që marrëdhëniet me Shqipërinë, siç u tha dhe më lart, kishin probleme, veçanërisht në ekonomi dhe shkaqet gjendeshin, sipas jugosllavëve, në politikën që qeveria shqiptare bën kundrejt Jugosllavisë(AQSH, 14\AP, dosja 3, viti 1947).

Ishin veçanërisht veprimet e Titos për të zgjeruar Jugosllavinë duke përfshirë në të edhe Shqipërinë me Bullgarinë, gjë që do të krijonte një shtet shumë të madh në Evropë dhe në të njëjtën kohë do i rriste shumë prestigjin dhe fuqinë Titos, shkaktuan që prej Stalinit Jugosllavia të shihej gjithmonë e më shumë me dyshim. Stalinit nuk i interesonte Shqipëria drejtpërdrejt, por interesonte dhe e shqetësonte fuqizimi i Titos dhe fuqizimi i Titos përfshinte edhe Shqipërinë.

Pas marrëveshjes së gushtit të vitit 1947, Tito dhe Dimitrovi deklaruan se Jugosllavia dhe Bullgaria ishin të gatshme të bashkoheshin në një shtet të vetëm: Bashkimi i Republikave Popullore të Sllavëve të Jugut; por kjo ishte bërë pa këshillimin e Stalinit.

Dy javë pas nënshkrimit të marrëveshjes në Bled të Sllovenisë, Stalini nëpërmjet të dërguarit sovjetik në Jugosllavi, Lavrentjevit, i dërgoi Titos një telegram në të cilin i shkruante se të dyja qeveritë kanë gabuar duke përmbyllur paktin mes tyre pa një këshillim të mëparshëm me Bashkimin Sovjetik dhe nxitimin e të dyja qeverive mund të shfrytëzonin elementët anglo-amerikanë duke ndërhyrë në Greqi dhe Turqi për të dëmtuar Jugosllavinë dhe Bullgarinë(Миронин, С. *Реабилитация Сталина*, [http://www.zlev.ru/77\\_44.htm](http://www.zlev.ru/77_44.htm)).

Por, Tito, në një bisedë të tetorit të vitit 1947 me Lavrentjevin, i tha këtij të fundit se së shpejti Jugosllavia dhe Bullgaria do të publikojnë pikat marrëveshjes për miqësinë dhe ndihmës së ndërsjelltë me njëra-tjerën, por ende në atë kohë nuk ishin përcaktuar ekzaktësisht pikat e marrëveshjes dhe se për këtë çështje do të kërkohej edhe mendimi i qeverisë sovjetike(Советский фактор, 1999: 503). Edhe në një bisedë tjetër me

Lavrentjevin në 13 dhjetor 1947, Tito theksoi se marrëveshja bullgaro-jugosllave ishte e ngjashme në karakter me atë që është nënshkruar me Shqipërinë (Kaba, H. & Çeku, E. 2011: 72).

Në Sofie, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes mes Bullgarisë dhe Jugosllavisë, Tito deklaroi se bashkëpunimi mes dy vendeve duhet të jetë kaq i përgjithshëm dhe kaq i ngushtë sa krijimi i Federatës do të shihet si diçka formale dhe se bashkërisht Jugosllavia dhe Bullgaria krijojnë një bashkim të fortë të popujve sllavë të jugut që mund t'i bëjë ballë çdo përxitim (Миронин, С. *Реабилитация Сталина*, [http://www.zlev.ru/77\\_44.htm](http://www.zlev.ru/77_44.htm)).

Këto ishin lëvizjet që e bënë Stalinin të rimendonte marrëdhënien me Jugosllavinë. Nëse Tito mendonte se mund të vepronte pa marrë më parë mendimin e Stalinit, veçanërisht në ato gjëra që mund të rrezikonin marrëdhëniet me SHBA-të dhe Britaninë e Madhe, atëherë Stalini duhet të gjente mënyrën për të kufizuar ndikimin dhe fuqinë e Titos dhe Jugosllavisë në vendet rreth e rrotull saj dhe një prej tyre ishte edhe Shqipëria.

Në këtë këndvështrim duhet parë fakti i shtimit të konsiderueshëm të ndikimit ekonomik të Bashkimit Sovjetik në Shqipëri pas vizitës së Enver Hoxhës në Moskë dhe pas marrëveshjeve që Tito dhe Dimitrovi nënshkruan pa marrë miratimin e Stalinit. Në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin qëllim, Bashkimi Sovjetik këshilloi shqiptarët që duhet të krijojnë marrëdhënie edhe me vendet e tjera të bllokut komunist dhe jo vetëm me Jugosllavinë. Në këtë mënyrë, në mesin e vitit 1947 shtohet numri i ekspertëve bullgarë në Shqipëri ashtu si edhe zhvillimi i marrëdhënieve kulturore mes dy vendeve (Zivotić, A. 2009: 111).

Në të njëjtën linjë është edhe vizita e një delegacioni hungarez në Shqipëri, të cilët theksuan nevojën e zhvillimit të marrëdhënieve të mira mes dy vendeve, ashtu si edhe Çekosllovakia në fund të vitit 1947 tregoi interes për zhvillimin e marrëdhënieve me Shqipërinë, madje ambasadori i saj në Beograd, Josef Korbel, do të ishte në të njëjtën kohë edhe ambasador për Shqipërinë. Gjithashtu Çekosllovakia në maj të të njëjtit vit kishte dërguar një përfaqësues tregtar në Shqipëri, por jugosllavëve i ishte thënë se Çekosllovakia do i dërgojë mallra Shqipërisë vetëm me miratimin e Jugosllavisë,

(Zivotić, A. 2009: 111) gjë që tregon se edhe pse Bashkimi Sovjetik kishte filluar strategjinë për të kufizuar ndikimin jugosllav në Shqipëri por edhe më gjerë në Ballkan, për vendet e bllokut komunist siç ishte dhe Çekosllovakia, Jugosllavia kishte në dorë Shqipërinë dhe për të zhvilluar marrëdhënie me të duhej marrë miratimi i jugosllavëve.

Në fund të vitit 1947, Koçi Xoxe lajmëroi Savo Zllatiçin se në gjimnazet në Shqipëri gjuha ruse do të mësohej përkrah asaj jugosllave, (Zivotić, A. 2009: 112) gjë që deri atëherë nuk ndodhte, çka tregon edhe më tej shtimin e ndikimit sovjetik në Shqipëri, që nëse të paktën nuk përpiqej në atë kohë ta zëvendësonte atë jugosllav, përpiqej ta kufizonte atë dhe fakti që njoftimin e bën Koçi Xoxe, i njohur për marrëdhëniet e ngushta me jugosllavët, tregon se vendimin për afrimin e ngadaltë me sovjetikët brenda Shqipërisë, mund ta kishte marrë Enver Hoxha.

Bashkë me gjuhën ruse, në shkollat shqiptare u futën dhe gjuhët perëndimore. Ndoshta Enver Hoxha ende nuk e kishte bërë lëvizjen e tij kryesore për t'u vendosur në krah të sovjetikëve, ashtu siç kishte dashur qysh në fillim, por duke parë që në dallim nga vitet 1945-1946 kur Bashkimi Sovjetik, pavarësisht kërkesës së Enver Hoxhës për t'u takuar me Stalinin, kishte mbajtur një qëndrim të ftohtë dhe të distancuar nga Shqipëria duke i ndërtuar marrëdhëniet mes dy vendeve nëpërmjet Jugosllavisë, ky qëndrim tashmë kishte ndryshuar dhe Enver Hoxha duke e kuptuar këtë ndryshim të ngadaltë qëndrimi nga Bashkimi Sovjetik po përpiqej jo të distancohej plotësisht nga njëri për t'u afruar me tjetrin, por duke mbajtur një distancë të barabartë mes të dyve në mënyrë që kur situata mund të bëhej më problematike, sidomos nga jugosllavët që shihnin zvogëlimin dhe kufizimin e ndikimit të tyre në Shqipëri, të paktën Hoxha mund të gjente mbështetjen tek sovjetikët.

Por për Titon, kritikën sovjetike dhe përjekja e tyre për të kufizuar pushtetin e tij në Shqipëri, nuk ishin arsye të mjaftueshme që të tërhiqej nga pozicioni i tij. Pas vetëvrasjes së Nako Spirut, Tito, sipas Xhilasit, u bë shumë i nervozuar dhe filloi të nxitonte me bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Në rrethet e ngushta, ai shprehte frikën e tij kur thoshte se rusët mund t'i rëmbenin Shqipërinë. Në dhjetor, të dërguarit jugosllavë në Shqipëri vendosën krijimin e një komisioni të përbashkët shqiptaro-jugosllav që do të përgatiste integrimin e plotë të dy ekonomive. Një strukturë e

ngjashme, u planifikua për të drejtuar bashkimin e ushtive të Jugosllavisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë(Banac, I. 1988: 39).

Në 17 dhjetor të vitit 1947, ambasadori sovjetik në Beograd, Lavrentjevi takoi Titon për të diskutuar për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, në të cilin Tito përsëri kritikoi shqiptarët se nuk i kanë dhënë asgjë Jugosllavisë ndërsa Jugosllavia ka dërguar ndihma të shumta në Shqipëri ashtu siç Jugosllavia është e gatshme ta bëjë Shqipërinë pjesë të planit të saj 5-vjeçar dhe të vendosë Ushtrinë Shqiptare brenda buxhetit për Ushtrinë Jugosllave(Советский фактор, 1999: 512-513).

Në të njëjtën bisedë të 13 dhejtorit, ambasadori sovjetik në Beograd, Lavrentjevi, thotë se kur i përmendi Titos që qeveria sovjetike do i dërgojë ndihmë ekonomike Shqipërisë dhe kërkoi qëndrimin e tij për këtë çështje, Tito i tha se për këtë duhet të pyeste Kidriçinin, Ministrin e Industrisë, pasi sipas tij, marrëdhëniet tregtare me Shqipërinë nuk kanë qenë aspak normale.

Tito i tha Lavrentjevit se vetëm gjatë vitit 1947, Jugosllavia kishte dërguar në forma të ndryshme në Shqipëri rreth 2 miliardë dinarë ndërsa Shqipëria nuk kishte dërguar asgjë në Jugosllavi dhe kjo gjë sipas tij kishte krijuar një atmosferë të pakuptueshme(Советский фактор, 1999: 512-513).

Për këto çështje, Tito i tha Lavrentjevit se kishte biseduar edhe me Enver Hoxhën duke i vënë atij në dukje se Shqipëria nuk fitonte gjë nga një politikë e tillë e krijuar nga Nako Spiru dhe se Enver Hoxha, nga ana e tij, kishte vënë në dukje se e kuptonte domosdoshmërinë e vazhimit të afrimit ekonomik dhe politik të Shqipërisë me Jugosllavinë(Советский фактор, 1999: 512-513).

Gjithashtu Tito i foli Lavrentjevit edhe për përshtypjet shumë të mira që kishte marrë nga vizita në Bullgari, ku ndër të tjera me Dimitrovin u fol edhe për afrimin gjithmonë e më të madh të dy vendeve, veçanërisht pas marrëveshjeve të nënshkruara në gusht dhe nëntor të të njëjtit vit, marrëveshjet që aq shumë kishin acaruar Stalinin(Советский фактор, 1999: 512-513).

## 6.5 Shtimi i presionit jugosllav ndaj afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik

Por, pavarësisht fjalët e Stalinit thënë Enver Hoxhës gjatë vizitës së tij në Moskë, apo mbështetjen që sovjetikët vazhdonin t'i jepnin drejtpërdrejt Jugosllavisë në lidhje me Shqipërinë, siç u pa edhe në rastin e krijimit të Informbyrosë, për Titon duket se diçka kishte ndryshuar dhe nëse nuk levizte shpejt për të arritur tek kontrolli i plotë mbi Shqipërinë rrezikonte ta humbiste atë dhe siç do të shohim edhe më poshtë presioni jugosllav mbi Shqipërinë vazhdoi të shtohet me qëllim që shqiptarët të zbatonin marrëveshjet që kishin nënshkruar me Jugosllavinë dhe ndoshta për herë të parë në bisedat me shqiptarët, jugosllavët i hapin gjithë letrat e tyre mbi tavolinë duke folur hapur për Federatën.

Në 5 dhjetor, Enver Hoxha takoi përfaqësuesin e Partisë Komuniste Jugosllave në Shqipëri, Savo Zllatiçin, i cili, sipas Hoxhës i tha se Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë mendon se ‘‘marrëdhëniet e Jugosllavisë me Shqipërinë duhet të karakterizohen [nga qëllimi] që çdo ditë bashkimi i tyre të bëhet më i shëndoshë dhe miqësia jonë të shkojë në vëllazërimin dhe bashkëpunimin e popujve tanë, jo vetëm të popujve tanë por edhe të Bullgarisë etj’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 134).

Në këtë takim, Savo Zllatiç flet hapur edhe për çështjen e Federatës, të paktën midis Jugosllavisë dhe Bullgarisë. ‘‘Në fakt në praktikë bëjmë federatën...Kjo do të sigurojë bashkimin e vërtetë dhe do të sigurojë përfitimin maksimal të fuqive tona në ndërtimin e vendeve tona; ne do të kemi suksese më tepër në rast se në këtë drejtim ne bashkëpunojmë ngushtësisht’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 135).

Ai i bën të qartë Enver Hoxhës se me këtë mënyrë siç janë ndërtuar marrëdhëniet e Jugosllavisë me Shqipërinë ‘‘me dhënë ndihma pa këtë bashkëpunim dhe luftë të përbashkët, në të vërtetë kjo do ushqejë tendencat autokritike, indipendente, etj. Mësohet populli vetëm me marrë’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 135). Sipas tij gjithë ndihmat që Jugosllavia ka dhënë për Shqipërinë gjer në atë çast, nuk duhet të vazhdojnë më ashtu pasi nuk kanë dhënë rezultatet e pritshme, të paktën ato që priste Jugosllavia dhe se për të patur një bashkëpunim të vërtetë ekonomik duhet një bashkim ekonomik mes dy vendeve. ‘‘Komiteti Central i ynë nuk mendon për këto

gjëra të bëjë presion. Por e çmojmë se kjo është rruga më e mirë për zhvillimin e shpejtë të ekonomive tona të përbashkëta. Kjo mënyrë do të na sigurojë të shkojmë më shpejt përpara”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 135).

Ndoshta sipas fjalëve të Savo Zllatiçit Jugosllavia nuk bën presion për këtë çështje por edhe vetë Jugosllavia në atë moment ishte në presion për të mbyllur sa më shpejt çështjen e bashkëpunimit dhe ndoshta krijimit të një shteti të përbashkët me Shqipërinë, para se ndikimi sovjetik në Shqipëri të bëhej aq i madh sa lëvizjet e jugosllavëve të ishin të kota.

“Bullgaria, po, mund të rrojë edhe vetë, por Shqipëria jo”, i tha Savo Zllatiç Enver Hoxhës sipas shënimeve që ky i fundit mbajti nga takimi me Zllatiçin, “në këto baza praktikisht federata do të ngrihet në rradhë të parë në sektorët ekonomikë. Duhet të konkretizojmë marrëdhëniet ekonomike të sotme, të cilat në përmbajtjen e tyre, pra, ndihmojnë të shkojmë në këtë rrugë”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 135).

Propozimet konkrete të mëtejshme të Savo Zllatiçit për të afruar edhe më shumë ekonomikisht Shqipërinë me Jugosllavinë, në fakt çojnë praktikisht në një shtet të përbashkët. Sipas tij “metodologjia e planifikimit të jetë e njëjtë me atë jugosllav...Jugosllavët në bazë të planit do të japin kontigjente të caktuara mallrash dhe do të marrin tepricat”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 136). Gjithashtu Komisioni i Koordinimit duhet të shndërrohet në një qeveri ekonomike të përbashkët, që do të thotë se edhe zyrtarisht në këtë mënyrë jugosllavët do të administrojnë ekonominë e Shqipërisë, sigurisht sipas interesave të tyre. “T’i pranojmë gjërat si një gjë e përbashkët ekonomike, si një unitet”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 136).

Zllatiç gjithashtu e ka një zgjidhje edhe për ata që mund të mendojnë ndryshe për këto çështje, ata që sipas tij i shikojnë gjërat “me një sy republikan, të ngushtë” dhe zgjidhja është “që ne të zhvillojmë luftë, kundër këtyre pikëpamjeve lokale...Ky partikularitet ekonomik i ka bazat në shikimin mikroborgjez”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 136).

Dy ditë më vonë, në 7 dhjetor, Byroja Politike e Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare, u mblodh për të diskutuar pikërisht çështjet e ngritura nga Savo



Zllatiç në takimin me Enver Hoxhën dhe Enver Hoxha në mbledhjen e Byrosë pothuajse citon fjalë për fjalë ato që i ka thënë Savo Zllatiçi.

Në këtë mbledhje, për herë të parë Enver Hoxha flet për mundësinë e Federatës Ballkanike. Pasi shpjegon se ‘‘po të zhvillohet ekonomia duke pritur ndihma, populli mësohet vetëm të marrë, orientohet ndryshe drejt punës për autarki kundër bazës së përbashkët të bashkëpunimit’’ dhe se marrëdhëniet e ngushta duhet të ndërtohen edhe me Bullgarinë dhe se ato përmbliken në atë që tha Tito në Varnë të Bullgarisë, ku ai foli për krijimin e një Federate mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë, Enver Hoxha thotë se ‘‘në praktikë, duke punuar kështu, ne punojmë për Federatën Ballkanike, ndërtojmë themelet e kësaj federate, sigurojmë bashkimin e vërtetë. Duke punuar në baza federative, praktikisht ne shkojmë drejt bashkimit të vërtetë, pavarësisht se nga ana formale do të ruhet shteti me ministri të jashtme etj’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 140).

‘‘Zhvillimi ekonomik i tre vendeve në formë të izoluar nuk e ka atë fuqi, prandaj puna dhe zhvillimi i përbashkët për sektorët e ndryshëm, në veçanti dhe për gjithë ekonominë bëhen një forcë e madhe dhe do të kemi rendiment më shumë’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 140). Pasi përmend Federatën, çuditërisht thotë se ‘‘duhen mbajtur vetëm format e jashtme, si independenca, ministritë e jashtme, por politika e jashtme do të jetë në baza të përbashkëta, e orientuar nga Bashkimi Sovjetik’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 140).

Në kapitujt e mëparshëm u vu në dukje se megjithëse kishte një plan jugosllav dhe sovjetik për çështjen e Federatës, vetë sovjetikët mendonin se nuk ishte koha e duhur, të paktën në vitin 1946 për shkak të Britanisë së Madhe dhe SHBA-ve, por e vështirë të thuhet nëse në vitin 1946, kur u nënshkruan edhe marrëveshjet më të rëndësishme me Jugosllavinë, nëse Enver Hoxha kishte dijeni të qëllimeve të paktën të jugosllavëve. Në kapitullin ku shtjellohen marrëveshjet, shkruajta se Enver Hoxha nuk kishte asnjë interes të krijohej një Federatë e tillë pasi gjithë pushteti që ai kishte krijuar në Shqipëri do të humbiste, por me të drejtë mund të bëhet pyetja se pse një vit më vonë, pikërisht në këtë mbledhje të Byrosë në të cilën merr pjesë edhe Savo Zllatiç, pse Enver Hoxha mbështet një projekt të tillë që është kundër interesave të pushtetit të tij por është në kundërshtim edhe të interesave të Shqipërisë?

Dhe si mund të shpjegohen fjalët e tij edhe për Federatën edhe për independencën edhe për ministrinë e jashtme? Nëse Shqipëria do të bëhej pjesë e një Federate Ballkanike me apo pa Bullgarinë, atëherë brenda saj nuk do të kishte independencë siç thotë Enver Hoxha, ashtu siç nuk kishte independencë as Kroacia, Maqedonia apo Bosnje Hercegovina brenda Federatës Jugosllave, ashtu siç secila prej tyre nuk kishin ministri të jashtme, por vetëm një qendrore të Jugosllavisë. Mos ndoshta Enver Hoxha nënkuptonte me togfjalëshin “Federatë Ballkanike” një bashkim ekonomik ka kufij dhe pa dogana apo mos ndoshta Enver Hoxha bënte lojën e sovjetikëve kur fliste në një anë për Federatën dhe në anën tjetër lidhej gjithmonë e më shumë me Bashkimin Sovjetik? Vështirë t’iu përgjigjesh këtyre pyetjeve.

Stalini, po, në Moskë luante lojën e Federatave, për të cilat nuk kishte më asnjë interes, veçanërisht asaj Ballkanike. Qëllimi i tij ishte të shtynte sa më shumë Titon dhe Dimitrovin, por më shumë Titon që kishte ambicie të mëdha dhe kishte treguar disa herë se mund të vepronte pa marrë mendimin e Stalinit, t’i shtynte para me idenë e një Federate Ballkanike dhe më pas t’i sulmonte dhe kjo është ajo që vërtet ndodhi gjatë vitit 1948.

Në këtë situatë duket se Shqipëria dhe Enver Hoxha gjenden në mesin e një vorbulle forcash shumë më të mëdha se Shqipëria dhe pushteti i Enver Hoxhës, forca që as nuk i kuptojnë por edhe nëse do të mundeshin t’i kuptonin, nuk do t’i kundërshtonin dot. Fjala që më mirë e përshkruan qëndrimin e Enver Hoxhës dhe udhëheqjes shqiptare ndaj Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik gjatë viteve 1947-1948 është: naivitet, por edhe injorancë.

Stalini thotë se me Jugosllavinë duhen marrëdhënie sa më të afërta, veçanërisht kur ai vetë nuk ka asnjë interes për Shqipërinë, dhe shqiptarët duke dëgjuar Stalinit thonë se duhen marrëdhënie sa më të ngushta me Jugosllavinë, pastaj Jugosllavia thotë se këto marrëdhënie të çojnë në një Federatë dhe shqiptarët thonë se duhet bërë patjetër Federata, përndryshe mësohet keq populli me ndihmën ekonomike të Jugosllavisë, pastaj Stalini, kur kupton se Tito mund të veprojë edhe pa mendimin e tij, thotë se me jugosllavët duhen këputur fare marrëdhëniet dhe shqiptarët sigurisht thonë se me

Jugosllavinë nuk ka më marrëdhënie. Anekdotikisht ky paragraf përcakton pak a shumë marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë.

“Komiteti Central”, thotë Enver Hoxha, “ndihmën që jep nuk e bën për presion, por e bën për t’u zhvilluar mbi baza të përbashkëta federative, për të shkuar kështu bashkërisht në socializëm”, ndërsa Savo Zllatiç thotë se nëse në fund do të shkohet në një shtet të përbashkët ose jo, kjo mbetet për t’u vendosur nga populli shqiptar dhe sigurisht Partia Komuniste Shqiptare, por “rruga është kjo që do t’i çojë popujt tanë në një bashkim të tillë federativ”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 140).

Që të mos ketë ndonjë dyshim mbi propozimet jugosllave, Koçi Xoxe, në mbledhjen e Byrosë, thotë se “një gjë që ka rëndësi historike për vendin tonë është që të kuptohet mirë se bashkëpunimi dhe bashkimi midis nesh është i shëndoshë me baza internacionale socialiste. Rreziku i madh vjen nga ata që nuk do ta pranojnë bashkëpunimin mbi baza socialiste, internacionaliste me anë të një bashkimi midis nesh. Është detyrë e Partisë që të sqarojë mirë njerëzit e të bëjë që të kuptojnë situatën në baza të reja të shëndosha...Ne duhet të mësojmë popullin shqiptar se atij nuk i preket nacionalizmi, në të vërtetë i forcohet; ky është nacionalizëm i vërtetë”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 145).

“Popullarizimi i Jugosllavisë, si një shtet i fortë dhe i Titos, vendosja e flamurit jugosllav bashkë me tonin, si edhe i udhëheqësve, popullarizimi i rëndësisë së Jugosllavisë që populli shqiptar ta kuptojë këtë rëndësi, që ai të ketë një afrim dhe vëllazërim me gjithë elementin jugosllav, të ketë një afrim familjar me të...Me personelin jugosllav në Shqipëri”, thotë Koçi Xoxe, “të bëjmë një jetë intime, vëllazërore”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 145).

Edhe gjatë vizitës së në Beograd dhe më pas në Sofje të Bullgarisë, në takimin me Titon, ai theksoi se ekonomia e Shqipërisë nuk mund të zhvillohet jashtë asaj jugosllave, domethënë në mënyrë të pavarur, se duhet të jetë e koordinuar me atë të Jugosllavisë dhe kjo ishte ajo që kundërshtonte Nako Spiru, tek i cili jugosllavët shikonin pavarësinë(AQSH, 14\AP, dosja 3, viti 1947).

Sipas Milovan Xhilasit, Enver Hoxha ishte në linjë me sovjetikët. Vetë Xhila në vitin 1962 thotë: ‘pse jugosllavët po krijojnë kompani të përbashkëta me shqiptarët kur vetë ata refuzuan të krijojnë të tilla në vendin e tyre me Bashkimin Sovjetik? Pse dërgojnë instruktorë në ushtrinë shqiptare kur ata vetë kishin instruktorë sovjetikë? Si mundet jugosllavia të jepte ekspertë për zhvillimin e Shqipërisë kur ata vetë kërkonin ekspertë nga jashtë? Si mundet që pa prituri e pa kujtuar (all of a sudden) Jugosllavia vetë e varfër dhe e pazhvilluar, kishte për qëllim të zhvillonte Shqipërinë?’ (Griffith, W. E, 1963: 19).

Në gjendjen e tanishme të njohurive mbi arkivat ish-sovjetike është e pamundur të thuhet nëse fjalët e mësipërme dhe sjellja e Enver Hoxhës kundrejt presionit të Federatës nga ana e jugosllavëve, ishin në një linjë me sovjetikët. Nuk mund të thuhet nëse kjo nuk ishte një lojë e Enver Hoxhës, që nga njëra anë kritikonte dhe akuzonte jugosllavët në takimet me sovjetikët dhe theksonte rëndësinë e ruajtjes së pavarësisë së Shqipërisë dhe nga ana tjetër fliste për bashkimin me Jugosllavinë.

Por, nëse shqiptarët ishin dakord me fjalët dhe propozimet e Titos, kjo nuk mund të thuhet aspak për sovjetikët, të cilët shqetësimin e tyre për veprimet e Titos i shprehën fillimisht nëpërmjet Zhdanovit dhe më pas, në fund të dhjetorit nëpërmjet një letre që Stalini i dërgoi Titos.

Sipas të dërguarit sovjetik në Tiranë, Çuvahinit, Zhdanovi ishte shumë i pakënaqur me marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë (Zivotić, A. 2009: 113). Në 23 dhjetor 1947 Stalini i dërgon letër Titos në të cilën i shkruan se duhet të dërgojë në Moskë një përfaqësues të lartë nga Partia Komuniste Jugosllave me qëllim diskutimin e çështjeve që lidheshin me marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, madje Tito edhe kërkoi që personi të ishte Milovan Xhilasi (Zivotić, A. 2009: 113).

Sipas vetë Xhilasit, në atë kohë marrëdhëniet mes të dërguarit sovjetik në Shqipëri dhe qeverisë shqiptare u bënë shumë të ngushta dhe sovjetikët informoheshin rregullisht për gjithçka që ndodhte në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe gjithmonë e më shumë sovjetikët interesoheshin për shoqëritë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave apo habiteshin se si Jugosllavia mund të ndihmonte ushtarakisht Shqipërinë në kohën që vetë Jugosllavia kishte në territorin e saj Ushtrinë e Kuqe dhe

në të njëjtën kohë kërkonte ndihmë ushtarake nga Bashkimi Sovjetik(Zivotić, A. 2009: 113).

Në librin e tij ‘‘Fytyra e Totalitarizmit’’ (Lico Totalitarizma), Xhilasi thotë se ‘‘marrëdhëniet me Shqipërinë po zhvilloheshin në të gjitha fushat. Jugosllavia po dërgonte në Shqipëri një numër gjithnjë e më të madh specialistësh të fushave të ndryshme. Ajo po e furnizonte Shqipërinë me produkte ushqimore, ndonëse kishte nevojë për vete. Të dyja qeveritë në parim ishin të mendimit se Shqipëria duhej të bashkohej me Jugosllavinë’’(Gjilas, M. 2006: 85).

Xhilas shkruan se ‘‘kushtet, në të cilat, qeveria jugosllave po i jepte ndihma qeverisë shqiptare ishin shumë më të favorshme e më të drejta, se ato, me të cilat qeveria sovjetike i jepte qeverisë jugosllave. Po, me sa dukej nuk ishte puna te drejtësia, po te vetë thelbi i këtyre marrëdhënieve – një pjesë e udhëheqjes shqiptare, në fshehtësi ishte plotësisht kundër tyre’’(Gjilas, M. 2006: 85).

Më pas, ashtu si edhe Tito në bisedën me Lavrentjevin, edhe Xhilasi identifikon Nako Spirun si problemin në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, të cilin e përshkruan si ‘‘shtatshkurtër, fizikisht i dobët, jashtëzakonisht i ndjeshëm e tepër inteligjent’’, dhe për të cilin thotë se kërkoj një zhvillim të pavarur të Shqipërisë, jashtë ndikimit jugosllav. Më pas Xhilasi, ashtu si Vukamanoviç-Tempo dhe Tito, lavdëron Koçi Xoxen, ‘‘punëtor nga jugu i Shqipërisë...komunisti më i palëkundur’’(Gjilas, M. 2006: 85).

Kur flet për Enver Hoxhën, ‘‘një njeri’’, sipas tij, ‘‘pa dyshim, shumë më i arsimuar’’, në krahasim me Koçi Xoxen, ‘‘e shumë më i shkathët’’, Xhilasi pohon të njëjtën pikëpamje që autori i këtij punimi theksoi më lart mbi pavendosmërinë e Enver Hoxhës për të marrë një qëndrim mes atyre që ishin pro marrëdhënieve të ngushta me Jugosllavinë dhe atyre, si Nako Spiru, që i kundërshtonin ato dhe kërkonin një zhvillim më të pavarur, kur Xhilasi thotë se ‘‘pikëpamja e tij e vërtetë (*e Enver Hoxhës. Shën. i autorit*) mbeti e paqartë plotësisht’’(Gjilas, M. 2006: 86).

Në të njëjtën kohë që Enver Hoxha pas bisedës më Savo Zllatiçin, shtronte domosdoshmërinë e bashkimit ekonomik me Jugosllavinë, pse jo edhe më shumë se

një bashkim ekonomik, por me fjalë jo shumë të qartë, siç u pa më sipër, në të njëjtën kohë Enver Hoxha afrohej gjithmonë e më shumë me sovjetikët, ndoshta duke njohur simpatinë e madhe që kishin jugosllavët për Koçi Xoxen dhe nëse Hoxha dilte plotësisht kundër jugosllavëve, atëherë pushteti i tij dhe vetë ai fizikisht do të ishte i rrezikuar. Në një situatë të tillë, shpëtimi i vetëm i Enver Hoxhës ishte të afrohej sa më shumë me sovjetikët.

Këtë e pohon edhe Xhilasi kur thotë se ‘‘po vërehej gjithashtu që me misionin sovjetik po afrohej gjithnjë e më tepër grupi i Enver Hoxhës...Në këtë kohë po binte në sy gjithnjë e më tepër, që udhëheqja e lartë shqiptare po afrohej me BS, gjë që po shprehej gjithnjë e më qartë edhe në propagandën e saj’’(Gjilas, M. 2006: 85).

Sipas Vladimir Dedijerit, në *Novi Prilozi*, është e pranuar që ngrindja e parë mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë ishte për Shqipërinë. Xhilasi ishte në Moskë qysh në janar të vitit 1948 dhe kur priti aty një delegacion tjetër jugosllav të kryesuar nga Edvard Kardelj, kur Xhilasi e pyeti Kardeljin pse ishte zgjedhur një situatë e tillë e tensionuar me Bashkimin Sovjetik për të dërguar dy divizionet në Shqipëri, Kardelji iu përgjigj se ishte Tito që e shtynte diçka të tillë(Banac, I. 1988: 39).

Vetë Milovan Xhilas shkruan se në bisedat me Stalinin në atë kohë, u habit kur pa reagimin e Stalinit që duke afruar dorën afër gojës tha se Shqipëria duhet të gëlltitej nga Jugosllavia, që ishte në një farë mënyrë një konfirmim i çdo lëvizjeje të jugosllavëve ndaj Shqipërisë gjer në atë çast(Banac, I. 1988: 41). Ndoshta strategjia e Stalinit, siç u argumentua edhe më sipër, ishte t’i linte jugosllavët të bënin ç’dëshiron me qëllim që më vonë të kishte material për t’i demaskuar.

Që Stalini luante me qëllimet dhe ambiciet e jugosllavëve në Ballkan pikërisht që më vonë t’i sulmonte për ambiciozë të tepruar, duket edhe nga fakti që i dërguari sovjetik në Tiranë, Çuvahini, në telegramet e tij dërguar në Moskë merr një qëndrim plotësisht kundër jugosllavëve dhe konfirmon fjalët e Enver Hoxhës në bisedën me të, duke kritikuar jugosllavët se nuk kishin respektuar nderin kombëtar shqiptar dhe se në mënyrë jo taktike ishin përfshirë në çështjet e brendshme të Shqipërisë, që masat e tyre ekonomike kishin si qëllim ta bënin Shqipërinë republikë të shtatë të Jugosllavisë(Zivotić, A. 2009: 114).

Sipas historianit serb Aleksandar Zivotiç, një bashkim i Shqipërisë me Jugosllavinë, duke përfshirë pse jo edhe Bullgarinë në një Federatë të madhe Ballkanike, nga pikëpamja sovjetike do të fuqizonte shumë Titon (Zivotiç, A. 2009: 114), i cili mund të fillonte të zhvillonte një politikë të jashtme të ndarë nga ajo e Bashkimit Sovjetik. Tito në këtë mënyrë mund të shndërrohej në një pol të dytë brenda bllokut komunist në Evropën Lindore dhe në krahasim nga të gjithë udhëheqësit e tjerë komunistë të Evropës Lindore, Tito, por edhe Enver Hoxha, kishin një avantazh të rëndësishëm.

Jugosllavia dhe Shqipëria ishin të vetmet vende të Evropës Lindore që ishin çliruar nga pushtimi nazi-fashist me forcat e tyre, pa ndërhyrjen e Ushtrisë së Kuqe, ndërsa gjithë udhëheqësit e tjerë komunistë, në Poloni, Hungari, Çekoslovakia, Bullgari, Rumani, ishin vënë në krye të vendeve të tyre nëpërmjet mbështetjes së Ushtrisë së Kuqe dhe siç thotë Anne Applebaum tek “Iron Curtain”, këta udhëheqës nuk kishin mbështetje të madhe në popull, madje ishin pothuajse të panjohur për shumicën e polakëve, çekoslovakëve apo hungarezëve kështu që e kishin të pamundur të kundërshtonin Stalinin, ndërsa Tito ndjehej i sigurt nga mbështetja popullore që kishte edhe të kundërshtonte Stalinin dhe të përpiqej të bënte një politikë të jashtme të pavarur prej tij.

Stalinit nuk i interesonte vetë Shqipëria, por shtimi i fuqisë jugosllave në Ballkan nëpërmjet bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë. Vetëm dy orë pasi delegacioni jugosllav kishte mbërritur në Moskë, Stalini i thirri në takim dhe drejtpërdrejt akuzoi jugosllavët se për shkak të tyre, anëtarë të Komitetit Qëndror në Shqipëri po vrisnin veten, duke iu referuar Nako Spirut ndërkohë që Xhilasi tha se Nako Spiru kishte qenë kundër marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave dhe se ai kishte izoluar veten brenda Komitetit Qëndror (Pearson, O. 2007: 257).

Xhilasi thotë se kuptoi që diçka nuk shkonte kur Stalini tha se Jugosllavia duhet të gëlltiste Shqipërinë dhe kjo sa më shpejt të ndodhte aq më mirë, ashtu si kur Stalini e pyeti për Enver Hoxhën, Xhilasi u kujdes që të mos jepte një përgjigje të prerë por të përsëriste të njëjtin qëndrim si udhëheqja jugosllave. “Ai është një borgjez i vogël, i prirur drejt nacionalizmit, apo jo”, pyeti Stalini dhe pas pohimit të Xhilas, Stalini pyeti nëse Koçi Xoxe ishte njeriu më i fuqishëm në Shqipëri, pyetja e cila u pohuar përsëri prej Milovan Xhilasit (Pearson, O. 2007: 257).

“Ne nuk duam ta gëlltisim Shqipërinë, po të bashkohemi me të, ta aneksojmë”, i tha Xhilasi Stalinit dhe Molotovi ndërhyri duke thënë se “kjo do të thotë pikërisht ta gëlltisësh”(Gjilas, M. 2006: 90).

Një bisedë e tillë mund të dukej shumë e çuditshme nëse nuk do kishim parasysh gjithë ç’kishte ndodhur në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik në muajt e fundit, veçanërisht pas nënshkrimit të marrëveshjeve mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë, pa dijeninë e Stalinit. Por, duket se me këtë bisedë me Xhilasin dhe anëtarët e tjerë të delegacionit sovjetik, Stalini konfirmoi atë që ambasada sovjetike në Tiranë e informonte kohët e fundit, se Jugosllavët synonin të bashkonin Shqipërinë me Jugosllavinë dhe se simpatitë e tyre brenda udhëheqjes shqiptare shkonin tek Koçi Xoxe.

Por, Stalini po konfirmonte një ide që vetë ai e kishte promovuar. Jugosllavët në marrëdhëniet me Shqipërinë nuk bënë asnjë hap pa u konsultuar me sovjetikët.



## 6.6 Lëvizja e fundit e Titos për të mbajtur Shqipërinë

Por, me gjithë çudinë e Milovan Xhilasit ndaj fjalëve të Stalinit, vetë jugosllavët, në fund të vitit 1947, kishin vazhduar me planet e tyre për një lëvizje përfundimtare ndaj Shqipërisë. Pas propozimit për krijimin e një Komisioni që do të mbikqyrte bashkimin ekonomik të Shqipërisë me Jugosllavinë, në fund të vitit 1947, jugosllavët shkojnë edhe një hap para në një drejtim tjetër duke kërkuar nëpërmjet një promemorie bashkimin e Ushtrisë Shqiptare me Ushtrinë Jugosllave “në interes të përforcimit të mbrojtjes të vendeve tona dhe të përforcimit të Ushtrisë Shqiptare”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 149).

Por, vite më vonë, kur edhe vetë Xhilasi ishte prishur me Titon, ai shkruan se në fund të vitit 1947 Tito vendosi të shkonte përpara me planin e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë dhe me pretekstin se Shqipëria ishte e kërcënuar nga Greqia, Tito urdhëroi dërgimin e dy divizioneve plotësisht të përgatitura në Shqipëri, ndërkohë që edhe një regjiment ajror ishte gati për t'u vendosur në Shqipëri. Tito i kërkoi Enver Hoxhës një bazë pranë Korçës, me qëllim që të ishte përballë Grammos në anën tjetër të kufirit, ku në atë kohë komunistët grekë kishin krijuar një qeveri të përkohshme(Banac, I. 1988: 39).

Lëvizja e Titos me planin e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë duket më shumë një formë presioni ndaj udhëheqjes shqiptare se sa një lëvizje serioze. Tito po shikonte afrimin e shqiptarëve me sovjetikët dhe lëvizja e tij duket më shumë si një lëvizje e dëshpëruar, për të shpëtuar marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në momentin e fundit.

Duke e lidhur Shqipërinë ekonomikisht dhe ushtarakisht pas Jugosllavisë, Tito do ta kishte shumë më të lehtë ta kontrollonte atë edhe politikisht, që raste të tjera si ai i Nako Spirut të mos shfaqeshin më. Për këtë arsye, në promemorien e fundvitit 1947 thuhej se duhet “të kalojmë sa më parë në unifikimin e Ushtrisë Shqiptare me Ushtrinë Jugosllave”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 149), gjë që parashikonte bashkimin e sistemit dhe formave të organizimit, bashkimin e armatimit dhe furnizimit, bashkimin në metodën e stërvitjes së reparteve dhe përgatitjes së shtabeve, bashkimin e normave të jetesës së ushtrisë, bashkimin e sistemit të evidencave dhe të

administratës si edhe bashkimi i metodë së drejtimit të ushtrisë, ashtu edhe ‘të vendoset kontakti direkt dhe i vazhdueshëm midis shtatmadhorive dhe reparteve të tyre në mënyrë reciproke, në mënyrë të tillë që të bëhet i mundshëm unifikimi i të gjithë sistemit të punës së Ushtrisë sonë me Ushtrinë Jugosllave(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 149).

Në linjën e unifikimit të dy Ushtrive ishte edhe pika e promemories që parashikonte hyrjen e buxhetit të Ushtrisë Shqiptare brenda buxhetit të Ushtrisë Jugosllave ku ‘një pjesë të buxhetit të Ushtrisë Shqiptare do ta sigurojë shteti shqiptar (për shembëll, në vitin 1948, 900 milionë), ndërsa pjesën tjetër do ta sigurojë Ushtria Jugosllave nga buxheti i saj. Kështu buxheti i Ushtrisë Shqiptare do të bëjë pjesë në buxhetin e Ushtrisë Jugosllave’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 149).

Disa pika të tjera të promemories parashikonin që ‘në kohë paqeje të ketë ushtarakët jugosllavë pranë Shtatmadhorisë Shqiptare, kështu që kontakti të jetë i përhershëm dhe i gjallë pa ndërmjetësinë e atasheve ushtarakë’, ndërsa ‘në kohë lufte Ushtria Shqiptare duhet të veprojë në të njëjtat kondita sikurse çdo armatë tjetër të Ushtrisë Jugosllave, duke u inkuadruar në njërin nga frontet e Ushtrisë Jugosllave dhe duke vepruar me të njëjtin plan operativ’, ashtu si ‘të unifikohet sistemi i mobilizimit dhe i përgatitjes së vendit për mbrojtje si edhe ligji i detyrimit ushtarak, përgatitja e rezervistëve...të unifikohet sistemi i administratës së Ushtrisë Shqiptare me atë të Ushtrisë Jugosllave...në Shqipëri nuk do të krijohen shkolla ushtarake, mbasi na intereson që oficerët të përgatiten në Jugosllavi’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 149).

Këto dhe pika të tjera të promemories së fundvitit 1947, që duhet thënë se nuk u realizuan, ashtu siç nuk u realizuan as shumica e masave të parashikuara në ekonomi dhe fusha të tjera në marrëdhëniet me Jugosllavinë. Shtimi i ndikimit të Bashkimit Sovjetik në Ushtrinë Shqiptare nëpërmjet shtimit të ekspertëve sovjetikë ashtu si dhe synimi i shqiptarëve për t’u këshilluar me sovjetikët më shumë se me jugosllavët për çështjet e Ushtrisë, bënë që kjo promemorie dhe përpjekjet e jugosllavëve për të bashkuar dy Ushtritë, të duken si një përpjekje e dëshpëruar. Tito dhe jugosllavët e shihnin me shqetësim të madh shtimin e ndikimit sovjetik në Shqipëri, prandaj merrnin masa të tilla që me shumë mundësi do të acaronin më tej marrëdhëniet e

jugosllavëve me sovjetikët, të cilët me çdo veprim të mëtejshëm, konfirmonin gjithmonë e më shumë fjalët që Enver Hoxha i kishte thënë sovjetikëve për jugosllavët.

Vetë Enver Hoxha në këtë kohë, megjithëse në biseda private me sovjetikët, kishte shprehur gjithë pakënaqësitë e tij kundër jugosllavëve dhe kishte kërkuar ndihmën e sovjetikëve për të balancuar ndikimin e Jugosllavisë, ende nuk kishte dalë hapur kundër jugosllavëve. Ndoshta priste reagimin e sovjetikëve ndaj kritikave që ai kishte paraqitur kundër jugosllavëve dhe pastaj të lëvizte vetë.

## 6.7 Në kërkim të fajtorit brenda Partisë Komuniste Shqiptare

Në një mbledhje të Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare, në 24 dhjetor 1947, Enver Hoxha i rikthehet edhe një herë kritikave që kanë paraqitur jugosllavët, për ekzistencën e një vije antijugosllave brenda Partisë dhe se plani ekonomik nuk është bërë në frymën e duhur të bashkëpunimit mes dy vendeve dhe se politika e qeverisë ndryshon ndaj Jugosllavisë (AQSH, 14\AP, dosja 52, viti 1947). Në këtë mbledhje Enver Hoxha përpiqet të gjejë se ku është problemi me Jugosllavinë dhe si të ndryshohet në të ardhmen kjo marrëdhënie. Ashtu si edhe në rastet e tjera, udhëheqësit shqiptarë, ashtu si ata jugosllavë, për çdo problem teknik dhe praktik në marrëdhëniet mes dy vendeve, nuk shkojnë direkt tek problemi, por përpiqen ta gjejnë zgjidhjen tek çështje ideologjike dhe politike.

Problemet ekonomike mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në një masë të madhe ishin probleme teknike, por në të njëjtën kohë dhe dy mënyra të ndryshme të konceptit se si këto marrëdhënie duhet të zhvilloheshin. Ajo që vihet re është se as nga pala shqiptare, as nga ajo jugosllave nuk pati një përpjekje reale të sheshimit të diferencave mes palëve, por u munduan që fajtorin ta gjenin tek individët.

Për të filluar të gjejë problemet e marrëdhënieve me Jugosllavinë, pasi vë në dukje se “plani ynë është përgatitur i ndarë nga Jugosllavia...plani nuk ka aspak frymën e koordinimit dhe të bashkëpunimit simbas lidhjeve ekonomike që kemi”, Enver Hoxha vazhdon të gjejë burimin e problemeve me jugosllavët edhe tek anëtarët e Byrosë Politike, veçanërisht ata që janë të rinj në të, duke thënë se ishte kundër faktit që Nako Spiru dhe Liri Belishova, e shoqja e tij, ishin anëtarë të Byrosë Politike dhe se një gjë e tillë, burrë e grua në Byro, “nuk ndodh as në Partinë Bolshevike” dhe se ai vetë nuk ishte dakord që gruaja e Nako Spirut të futej në Byro ashtu siç nuk ishte dakord as me Fadil Paçramin (AQSH, 14\AP, dosja 52, viti 1947), i cili ishte një emër tjetër bashkë me atë të Nako Spirut si kundërshtarë të afrimit të madh me Jugosllavinë.

Gjithë përpjekjet për t’u përballur me kritikën e Jugosllavisë, të cilat edhe pse merrnin bazën nga problemet ekonomike në fund ktheheshin në çështje politike, edhe në mbledhjet e Byrosë, gjithë diskutimet nuk përqëndrohen në problemet reale por në

biseda se kush i foli kujt dhe çfarë i tha, pa arritur tek thelbi i problemit. Enver Hoxha thotë se Nako Spiru i thoshte se kuadrot e rinisë janë të mirë, por përçmohen nga Koçi Xoxe dhe se ky i fundit i kishte thënë Spirit se po të mos kishte qenë ai, ‘‘Liria do të kishte përfunduar në burg’’(AQSH, 14\AP, dosja 52, viti 1947).

‘‘Ai mori shembull, se gjoja një person i Mbrojtjes paska pyetur në familjen e Nakos në Durrës se si kish ikur Nakoja nga burgu. Megjithëse unë i thashë se nuk është ashtu, ai m’u përgjigj se është e vërtetë. Kur unë kam pyetur Koçin mbi këtë gjë dhe ai është interesuar si qëndron e vërteta, nuk rezulton asgjë’’(AQSH, 14\AP, dosja 52, viti 1947). Enver Hoxha dhe udhëheqësit e tjerë shqiptarë duken më shumë të interesuar për të zgjidhur problemet e tyre personale me njëri-tjetrin dhe se si këto probleme personale mund të kenë ndikuar në marrëdhëniet me Jugosllavinë, veçanërisht marrëdhëniet e tyre me Nako Spirun dhe se si ai kishte ndikuar në problemet me Jugosllavinë dhe çfarë ndikimi mund të kishin në këtë çështje marrëdhëniet e Nakos me Liri Belishovën, një çështje kjo që duket periferike, ashtu si pothuajse çdo diskutim tjetër në Byronë Politike, ndaj marrëdhënieve me Jugosllavinë.

Pasi ka arritur të tregojë se si Nako Spiru i kishte folur jugosllavëve për Enver Hoxhën dhe ata i kishin thënë Enverit për fjalë e Nakos dhe shqetësimet që kishte Nako Spiru me gruan e tij, Enver Hoxha thotë se ‘‘Nakoja ka mbërritur me punën e tij të krijojë në Byro dhe në Komitetin Central tonin një situatë shumë të vështirë, duke arritur të krijojë mosbesimin midis nesh dhe një situatë që nuk i shihej zgjidhja’’(AQSH, 14\AP, dosja 52 viti 1947).

Edhe në mbledhjen e Byrosë Politike në 1 janar 1948, vazhdon diskutimi në të njëjtat linja, pa prekur çështjet thelbësore. Koçi Xoxe akuzon Mehmet Shehun në lidhje me bashkëpunimin ushtarak me Jugosllavinë, ku sipas tij, Mehmet Shehu ka ndjekur ‘‘një vijë shumë të gabuar e ngjashme me atë të Nakos...Pra, Mehmeti ka qenë në vijën e Nakos në sektorin e ushtrisë, si në lidhje me çështjen e unifikimit me Ushtrinë Jugosllave, ashtu edhe me çështjen e Partisë e të kuadrove oportunistë dhe të orientuar nga elementë jo të Partisë’’(AQSH, 14\AP, dosja 52\1, viti 1947).

Fjalë të ashpra thotë Koçi Xoxe edhe për Fadil Paçramin në lidhje me jugosllavët. “Te Fadili ka predominuar fryma antijugosllave...Ai dilte që të mos marrim nga jugosllavët...Në lidhje me Fadilin, edhe ky ka bërë punën e Nakos në sektorin e kulturës, siç e thoshte në biografi, që ai na ka frymëzuar etj”(AQSH, 14\AP, dosja 52\1, viti 1947).

Më tej për Nako Spirun thotë se “fraksioni i Nakos del i sigurt në kokën e Partisë, s’ka më është apo nuk është. Puna e tij ishte fraksion...Ky fraksion kishte për qëllim dorëzimin e Partisë në duart e borgjezisë...Karakteristike janë nënçmimi dhe likuidimi i elementit të shëndoshë të Partisë nga radhët e punëtorisë, një politikë jo e orientuar te klasa, por në mosbesimin dhe injorimin e klasës punëtore në vendin tonë. Kemi dy vjet punë sistematike të Nakos me shokë për këtë qëllim, të dorëzohej Partia në duart e armikut...Nakoja ka përdorur Rininë, ka përdorur intriga në shkallë të gjerë, edhe përbrenda, edhe te miqtë tanë, aq sa nuk kish ku t’i shpinte”(AQSH, 14\AP, dosja 52\1, viti 1947).

Në 5 janar, Enver Hoxha thotë se edhe ai ka bërë gabime, sigurisht i ndikuar nga Nako Spiru, por “procesi i zhvillimit e forcimit të udhëheqjes akoma nuk ka mbaruar. Partia Jugosllave ka me vjetë në këtë proces dhe sot ka ardhur në një stabilitet. Ne po e fillojmë gati sot, nuk jemi njerëz me eksperiencë shumë të madhe dhe mund të gabojmë fare lehtë. Duhet bashkëpunim, sinqeritet”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 169). Pastaj Enver Hoxha thotë gjënë më të çuditshme në lidhje me marrëdhëniet me Jugosllavinë kur thotë se edhe çështjet e partisë duhen parë në baza federative në lidhje me Jugosllavinë. “Sekretar i Përgjithshëm nuk jam unë, por Mareshali”, domethënë Tito, “ne jemi parti, si partitë e republikave të tjera me sekretarët e saj me vijën e njëjtë me të tjerat”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 169).

Megjithë mbledhjet e njëpasnjëshme të Byrosë Politike, udhëheqësit shqiptarë më shumë iu afruan zgjidhjes së problemeve me njëri-tjetrin dhe mërive që kishin ndaj Nako Spirit apo Fadil Paçramit, por nuk iu afruan aspak zgjidhjes së problemeve të vërteta me Jugosllavinë. Nëse përpiqesh t’i gjes problemet jo aty ku ato janë në të vërtetë, por në marrëdhëniet me njëri-tjetrin, atëherë ndodh ashtu siç ndodhi edhe brenda Partisë Komuniste Shqiptare, ku njerëz që kishin bashkëpunuar ngushtë me njëri-tjetrin për vite me rradhë vendosën të hedhin ndaj njëri-tjetrit çdo pakënaqësi,

sado të vogël dhe personale të ishte dhe diçka e tillë vazhdoi të ndodhte edhe pas vitit 1948, gjer në fund të viteve 80-të.

Kjo ishte diçka jo e re në historinë e pushtetit komunist në Evropën Lindore dhe Bashkimin Sovjetik. Edhe Tito në Jugosllavi apo Stalini në Bashkimin Sovjetik e kishin të vështirë të merreshin me problemet reale dhe ashtu si në rastin e Jugosllavisë në marrëdhëniet me Shqipërinë apo problemet ekonomike në Ukrainën e fillimviteve 30-të, çdo problem praktik e shndërronin në politik dhe pasi akuzonin të tjerët për probleme imagjinare, zgjidhja në fund gjendej tek eliminimi fizik i kundërshtarëve. Vetëvrasja e Nako Spirut eliminoi një problem për Partinë Komuniste Shqiptare, por nuk eliminoi problemet në praktikë me Jugosllavinë, të cilat gjatë vitit 1948 u bënë edhe më të shumta.

Në 8 janar, Mehmet Shehu, në një mbledhje të Byrosë Politike, shfaqet i çuditur për marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe thotë se ‘‘tashti i kuptoj ndryshe marrëdhëniet me Jugosllavët, që është një bashkim dhe jo një lidhje si e kemi pasur deri tashti’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 188). Te udhëheqja shqiptare, një pikëpamje e tillë për marrëdhëniet me Jugosllavinë ka munguar, ndërkohë që e tillë qysh në fillim ka qenë vetëm teksovjetikët. Në korrik të vitit 1947 Nako Spiru në një letër dërguar Enver Hoxhës me çudi i vë në dukje se Vukmanoviç Tempo i kishte thënë se Jugosllavia me Bullgarinë do të bëjnë një shtet të vetëm dhe se mund të ndodhë edhe me Shqipërinë(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 112).

Pothuajse një vit para letrës së Nako Spirut, nga Moska, ishte Koço Tashko që i shkruante Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë se ‘‘në qarket demokratike këtu besohet që pas triumfit të Republikës (Popullore) në Bullgari çështja e Federacionit fillestar Ballkanik munt të shtrohet pa pritur vendimet definitive të Konferencës së Paqes në qoftë se këto vendime zgjaten përtej kufirit (që nuk duhet të jetë më tutje se fillimi i mbledhjes së Asamblesë së UNOS). Kapërximi i këtij kufiri do të thotë agravim të qëndrimit të Anglosaksonëve e pra përpara këtij agravimi s’ka veç se qëndrim të fortë, forcim të rradhëve tona’’(AMPJ, Probleme me rëndësi, dosja 141, viti 1947).

Që ky qëndrim për Federatën Ballkanike dhe bashkimin në një shtet me Jugosllavinë dhe Bullgarinë ka qenë në përgjithësi i panjohur tek udhëheqja shqiptare, e konfirmon dhe Mehmet Shehu kur thotë se “pse nuk i kam shikuar unë marrëdhëniet me jugosllavët jo si duhej, pse Partia nuk i ka shtruar kështu. Nuk është aspak influenza e Nakos ose shovinizmi im...Ashtu ishte shtruar nga Partia. Ish çështja të fitohej eksperiencë nga ata dhe jo për një bashkim të tillë. Unë do të mundohem në të ardhmen të kuptoj konkluzionet e Partisë. Ky është refleksioni”(Plasari, N. & Malltezi. L. 1996: 189).

Në një situatë të tillë është e vështirë të arrish tek qëndrimi i Enver Hoxhës. Sigurisht që ai i kishte pranuar kritikën e jugosllavëve dhe i kishte shtruar për diskutim, por në mbledhjet e Byrosë Politike duket se Koçi Xoxe është më i vendosuri në kritikën ndaj atyre që sipas tij ishin antijugosllavë, ndërkohë që qëndrimi i Enver Hoxhës është më i mjegullt. Autori i këtij punimi ka përsëritur disa herë që nuk ishte në interesin e pushtetit të tij, por as në interesin e Enver Hoxhës si drejtues i një shteti të pavarur dhe që aq shumë shqetësohej për pavarësinë dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë, që të pranonte një bashkim me Jugosllavinë apo qoftë edhe me Bullgarinë.

Tre përpjekje mund të bëhen për të shpjeguar këtë ndryshim qëndrimi të Enver Hoxhës në raport me jugosllavët në fund të vitit 1947 dhe fillim të vitit 1948. E para, ka të bëjë me faktin që Enver Hoxha ndoshta i frikësohej një humbje të pushtetit nëse nuk mbështeste çdo propozim të jugosllavëve. Ai e dinte shumë mirë simpatinë e madhe që jugosllavët kishin për Koçi Xoxen dhe një dalje kundër jugosllavëve do të kishte rezultuar në një humbje të sigurt të pushtetit të tij. Në këtë periudhë Enver Hoxha ende nuk kishte një mbështetje të plotë nga sovjetikët që të mund të dilte nga presioni dhe ndikimi i jugosllavëve. Disa muaj më vonë, kur Enver Hoxha siguroi mbështetjen e plotë të Stalinit dhe nuk frikësohej nga humbja e pushtetit përballë presionit të jugosllavëve, atëherë Enver Hoxha do të dalë plotësisht kundër tyre dhe propozimeve për bashkim mes dy vendeve.

E dyta është se Enver Hoxha ndoshta qysh në këtë kohë, fund 1947 dhe fillim 1948, kishte marrë mbështetjen e Stalinit dhe ashtu si Stalini me jugosllavët, edhe Enver Hoxha brenda Partisë së tij luante lojën e jugosllavëve për të parë se deri ku ata mund të shkonin ashtu si për të parë se deri ku mund të shkonin anëtarët e tjerë të Byrosë



Politike në kritikën ndaj atyre që cilësoheshin si antijugosllavëve dhe në këtë rast, në mbledhjet e Byrosë Politike, Koçi Xoxe dallohet si më i pasionuar ndaj antijugosllavëve duke marrë një qëndrim të prerë, gjë që sigurisht do e çojë në eliminimin e tij fizik, një vit e gjysmë më vonë. Por, ky supozim i dytë është spekulues. Ndoshta diku, në ato arkiva ruse dhe ish-jugosllave që ende nuk janë hapur gjendet përgjigja për pranimin e kritikës jugosllave nga Enver Hoxha dhe propozimin e tyre për bashkim.

Dhe e treta është shpjegimi më i thjeshtë, ai që siç u përmend edhe më sipër, sovjetikët e kishin vënë në dukje disa herë, që brenda Partisë Komuniste Shqiptare kishte njerëz me nivel të ulët formimi dhe që ky ishte shkaku pse ishin aq shumë të mbështetur tek Jugosllavia, brenda Partisë Komuniste Shqiptare sipas sovjetikëve kishte njerëz që nuk kishin asnjë iniciativë, asnjë ide dhe kështu dëgjonin plot vëmendje çfarë thoshin dhe propozonin jugosllavët.

Të njëjtën linjë për bashkimin sa më të madh me Jugosllavinë, Enver Hoxha e vazhdoi edhe në 22 janar, në një mbledhje tjetër të Byrosë Politike kur tha se ‘të gjithë sektorët të shkojnë në atë rrugë, me baza federale, duke qenë kështu Sekretar i Përgjithshëm Titoja. Kështu vendi do të shkojë në një Federatë’ (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 206).

Qëndrimi ndaj jugosllavisë, pavarësisht kritikave të tyre, të paktën te Tuk Jakova kishte mbetur i njëjtë. Në fund të janarit, në Kuvendin Popullor, ai deklaroi se ishte ndihma jugosllave që kishte ndihmuar në ndërtimin e një jete më të mirë në Shqipëri dhe se ‘vendi ynë i vogël, me një ekonomi të prapambetur, nuk mund të zhvillohet dhe të jetohej i ndarë nga ajo rrugë e drejtë. Kjo është arsyeja pse popujt e Jugosllavisë na dhanë, dhe vazhdojnë të na japin, gjithë ndihmën e mundur për progresin e vendit tonë’ (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 206).

## 6.8 Përkeqësimi i marrëdhënieve sovjeto-jugosllave dhe Shqipëria

Por, ndërkohë që për shqiptarët marrëdhëniet me Jugosllavinë, vazhdonin njëloj, pavarësisht kritikave, për Stalinin ato nuk ishin njëloj. Me nënshkrimin e marrëveshjeve me Bullgarinë mesin dhe pastaj fundin e vitit 1947 si dhe shqetësimi i madh i sovjetikëve për ndikimin shumë të madh të jugosllavëve në Shqipëri, kishte bërë që për Stalinin Tito të ishte shndërruar nga nxënësi i tij më i mirë në Evropën Lindore, në një person problematik, që nuk e kishte aspak problem të vepronte pa u këshilluar me Stalinin, madje edhe kundër këshillave të Stalinit. Në shkurt të vitit 1948, në Moskë, jugosllavëve iu ishte thënë prerë se duhet të ndërprisnin çdo manovër ushtarake në Shqipëri dhe çdo synim për të vazhduar më tej me bashkëpunimin ushtarak.

Në shkurt, Stalini thirri një delegacion jugosllav në Moskë për bisedime, ndër të cilat edhe për Shqipërinë. Arsyeja kryesore për thirrjen e delegacionit jugosllav kishin të bënin me pakënaqësinë e Stalinit për politikën e jashtme të Jugosllavisë dhe Bullgarisë (Gibianski, L. 1998: 115), që ishte zhvilluar kohët e fundit pa këshillimin e sovjetikëve. Pas marrëveshjeve të vitit 1947 mes dy vendeve, për të cilat udhëheqësit e Jugosllavisë dhe Bullgarisë kishin pranuar gabimet e tyre, në janar të vitit 1948 vjen edhe një lëvizje e pamenduar dhe e pakëshilluar me sovjetikët e Dimitrovit i cili foli për Federatën e “demokracive popullore” të Evropës Lindore, për heqjen e kufijve, bashkimin e doganave etj.

Në 29 janar, *Pravda* e Moskës në të cilën ishte botuar fjala e Dimitrovit në Bukuresht për bashkimin e “demokracive popullore”, distancohet nga thëniet e Dimitrovit, madje duke theksuar se “atyre vendeve nuk iu duhet një federatë problematike...as bashkimi doganor, por mbrojtje e pavarësisë dhe sovranitetit nëpërmjet mobilizimit dhe organizimit të fuqive të brendshme demokratiko-popullore” (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 906).

Në kohën që shqiptarët debatonin me njëri-tjetrin se kush e kishte fajin, sovjetikët nga ana e tyre kishin filluar veprime praktike për largimin e dalëngadaltë nga qëndrimi i Titos, aq sa të para në këtë këndvështrim mbledhjet e Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Shqipërisë me grindjet e tyre të vogla dhe problemet

personale mes anëtarëve, duken si të një bote tjetër, që nuk merrte informacion të duhur nga jashtë.

Në 12 shkurt të vitit 1948, Partia Komuniste e Rumanisë vendosi që të heqë nga çdo vend, portretet e Titos në të cilat ai shfaqet në shoqërinë e Stalinit, (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 906), veprim ky sigurisht me urdhër të Stalinit, që i shndërron në nul të gjitha diskutimet e udhëheqjes shqiptare për bashkimin e ushtrisë apo të partisë me homologet e tyre jugosllave.

Stalini kishte marrë një qëndrim të qartë kundër jugosllavëve qysh në janar të vitit 1948, veçanërisht pas deklaratës së Dimitrovit në Rumani. Tito me siguri e kishte kuptuar qëndrimin e Stalinit, kështu që në fillim të shkurtit në Moskë nuk shkon vetë por dërgon delegacionin e kryesuar nga Kardelji. Takimi i Moskës i shkurtit 1948, është vendi ku Stalini i lë mënjanë gjithë kortezitë dhe mirësjelljet e takimeve mes delegacioneve të vendeve të ndryshme. Stalini ia bën të qartë, në mënyrë të drejtpërdrejtë Kardeljit dhe Xhilasit se koha kur Jugosllavia mund të kishte autonomi nga Bashkimi Sovjetik në zhvillimin e politikë së saj të jashtme kishte marrë fund (Pirjevec, J.1988: 80).

Përveç fjalëve të Dimitrovit në Rumani, arsyeja tjetër pse Stalini kërkoi një delegacion jugosllav në Moskë, kishte të bënte me kërkesën për dërgimin e dy divizioneve jugosllave në Shqipëri, një lëvizje e realizuar pa dijeninë e sovjetikëve, por me miratimin e shqiptarëve (Gibianski, L. 1998: 115). Në takimin e 10 shkurtit, Molotovi thotë se sovjetikët e mësuan aksidentalisht kërkesën jugosllave për dërgimin e dy divizioneve në Shqipëri dhe se shqiptarët i kishin thënë sovjetikëve se ata mendonin që kërkesa jugosllave ishte bërë me dijeni të sovjetikëve, prandaj e kishin pranuar kërkesën e jugosllavëve (Gibianski, L. 1998: 129).

Për çështjen e divizioneve, Molotovi lexon një telegram të ambasadorit sovjetik në Beograd, Lavrentjeviti i cili pas një bisede me Titon shkruan se kërkesa jugosllave është e vërtetë dhe ka ardhur pas raportimeve për një sulm të mundshëm grek ndaj Shqipërisë dhe se sipas Titos, futja e divizioneve në Shqipëri nuk do të shkakonte asnjë reagim nga anglo-amerikanët përtej një fushate në shtyp dhe se sipas Titos, çfarëdo që të ndodhte më tej, Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik do ta zgjidhnin së

bashku(Gibianski, L. 1998: 129). Por, pas qëndrimit kundër të sovjetikëve, Jugosllavia hoqi dorë nga kjo kërkesë.

Më tej Molotovi thotë se jugosllavët nuk i kishin informuar shqiptarët për problemet që kishin pasur me sovjetikët për çështjen e divizioneve(Gibianski, L. 1998: 129), gjë që përforcon më tej gjendjen e udhëheqësve shqiptarë në një terr informativ edhe për çështje që kishin të bënin me vendin e tyre dhe ndërkohë që ata diskutonin për propozimet e jugosllavëve për bashkim të gjithanshëm, situata kishte avancuar tepër aq sa i bën diskutimet e Byrosë Politike të kota.

Shqipëria është pika jonë e dobët, kishte thënë Stalini, sepse vendet e tjera janë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, janë të njohura, ndërsa Shqipëria nuk është, por Bashkimi Sovjetik, SHBA dhe Britania e Madhe sipas tij, garantojnë pavarësinë e Shqipërisë dhe nëse Shqipëria sulmohet nga një vend tjetër atëherë duhet të jetë vetë Parlamenti në Shqipëri që të kërkojë ndihmën e Jugosllavisë, por jo e kundërta. Nëse trupat jugosllave do të hynin në Shqipëri, atëherë SHBA dhe Britania e Madhe do të ngriheshin si mbështetëse të pavarësisë së Shqipërisë(Gibianski, L. 1998: 129).

Sipas tij duhet ndihmuar ushtria shqiptare, duhen mësuar shqiptarët dhe merr si shembull Kinën në të cilën Bashkimi Sovjetik është i pranishëm por kinezët luftojnë vetë, ndërsa sipas Stalinit jugosllavët dhe bullgarët nuk i informojnë sovjetikët për asgjë dhe në fund sovjetikët përballen me një *fait accompli*(Gibianski, L. 1998: 129).

Më pas Kardelji flet për lidhjet me Shqipërinë duke pranuar se mosnjohimi i sovjetikëve për kërkesën e dy divizioneve ishte një gabim serioz, ndërsa Stalini e ndërpret duke i thënë se jugosllavët kanë prirjen ta thjeshtësojnë çdo gjë, ndërkohë që kjo është një çështje serioze. Më tej Kardelji thekson lidhjet e forta ekonomike me Shqipërinë si dhe mbështetjen që Jugosllavia i jep Ushtrisë Shqiptare ndërkohë që Stalin thotë se mundësia e një sulmi ndaj Shqipëria është e pranishme, por pyet nëse nuk mund të kihet besim tek Ushtria Shqiptare, duke shtuar se shqiptarët duhen mësuar dhe ushtria duhet të ndërtohet(Gibianski, L. 1998: 129).

Më pas Stalini duke qeshur thotë se jugosllavët kanë aq frikë nga rusët në Shqipëri sa janë të gatshëm të dërgojnë me nxitim trupat e tyre, ndërkohë që Kardelji e pyet se

çfarë duhet bërë në fund të fundit në Shqipëri dhe Stalini përsërit të njëjtat fjalë të tij të mëparshme mbi ndërtimin e Ushtrisë Shqiptare(Gibianski, L. 1998: 129).

Por, në krahasim me atë që kishte menduar Stalini se jugosllavët do të bënin pas fjalëve të tij, jugosllavët ishin edhe më të bindur pas bisedës me Stalinin se Jugosllavia nuk mund të ishte një satelit i Bashkimit Sovjetik(Pirjevec, J.1988: 80), kështu që marrëdhëniet mes dy vendeve u përkeqësuan edhe më tepër. Me fjalët e rënda që Stalini i adresoi Kardeljit dhe Xhilasit në takimin e Moskës, për sovjetikët roli i Jugosllavisë si ndërmjetëse në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik, rol që Bashkimi Sovjetik ia kishte dhënë Jugosllavisë qysh në fund të Luftës së Dytë Botërore dhe që udhëheqja shqiptare kishte qenë e detyruar ta pranonte, kishte marrë fund(Павловец Ю. С. 2010).

Në vazhdim të takimit të Moskës, Bashkimi Sovjetik lajmëroi se Beogradi ‘injonon Bashkimin Sovjetik si fuqia vendimtare në kampin e demokracisë dhe socializmit’, dhe kështu në hapin e mëtejshme Bashkimi Sovjetik, në mars të vitit 1948 vendos të tërheqë nga Jugosllavia gjithë ekspertët sovjetikëve dhe këshilltarët në Ushtrinë Jugosllave, pasi sipas sovjetikëve ata ishin të rrethuar nga jomiqësia(Павловец Ю. С. 2010).

Megjithëse Tito dhe jugosllavët kishin qenë përgjithësisht ndjekësit më besnikë të modelit sovjetik në Evropën Lindore, herë pas here, ndoshta për shkak të faktit që për çlirimin e tyre nuk i detyroheshin Ushtrisë së Kuqe, ndodhte që edhe të kundërshtonin qëndrimin e Stalinit, kështu që ngjarjet e vitit 1947 dhe fillimit të 1948 nuk ishin diçka krejt e re.

Përveç marrëveshjeve me Bullgarinë, të realizuara pa dijeninë e Stalinit, kërkesës për dërgimin e dy divizioneve në Shqipëri ashtu si përpjekjeve për të shtuar sa më shumë varësinë e Shqipërisë ndaj Jugosllavisë edhe pse për ta bërë Shqipërinë pjesë të Federatës Jugosllave, gjë që për sovjetikët nuk ishte çasti i duhur, jugosllavët kundrejt sovjetikëve kishin shprehur mendimin se edhe kolektivizimi në Jugosllavi nuk duhet të ndodhte ashtu si në Bashkimin Sovjetik ashtu si udhëheqës jugosllavë hodhën dyshime mbi faktin nëse sistemi arsimor sovjetik ishte i përshtatshëm me atë të Jugosllavisë(Perovi, J. 2007: 32-63).

Edhe për çështjen e agrikulturës dhe kolektivizimit, asnjë vend tjetër në Evropën Lindore nuk qëndronte në vitin 1948 më afër kolektivizimit të plotë se sa Jugosllavia (Banac, I. 1988: 22), megjithëse ajo ishte kritikuar disa herë për radikalizmin e paktë në këtë drejtim. Ashtu si edhe në drejtime të tjera, Jugosllavia kishte ndjekur pothuajse përpikmërisht rrugën e Bashkimit Sovjetik dhe megjithëse kishte mendime për rrugë të ndryshme zhvillimi, askush nuk vinte në diskutim se cili ishte qëllimi fundor (Perovi, J. 2007: 32-63): Bashkimi Sovjetik. Çështje të tilla nuk mund të përbënin thelbin e fjalëve të rënda dhe të drejtpërdrejta që Stalini përdori kundër Kardeljit dhe Xhilasit në takimin e Moskës. Ajo që shqetësonte më shumë sovjetikët përsa i përket Jugosllavisë, ishte politika e jashtme jugosllave e cila në sytë e sovjetikëve, dëshironte të krijonte një pol të dytë brenda bllokut komunist pas Moskës.

Thelbi i qëndrimit të Stalinit ndaj jugosllavëve duhet të kërkohej pikërisht tek Shqipëria. Në mes të prillit të vitit 1948, Tito deklaroi në Komitetin Qëndror të Partisë Komuniste Jugosllave se konflikti i parë mes sovjetikëve dhe jugosllavëve kishte nisur për Shqipërinë (Dedijer, V. 1980: 370).

Çështja e Shqipërisë ishte kaq e ndjeshme dhe problematike për jugosllavët, sa në vitin 1953, Kardelji ndaloi që kjo çështje të përmendej më në biografite e Titos (Dedijer, V. 1980: 370). Por, ndërsa sovjetikët dhe jugosllavët diskutonin dhe ishin pothuajse në momentet e fundit të marrëdhënies së tyre të përzemërt, vetë shqiptarët çfarë bënin? Mes 26 shkurtit dhe 8 marsit të vitit 1948 u mbajt Plenumi i 8-të i Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare, në të cilën çështjet që kishin të bënin me Jugosllavinë u diskutuan gjerë e gjatë, por që të para në këndvështrimin e asaj ç'kishte ndodhur mes sovjetikëve dhe jugosllavëve në shkurt dhe mars, këto diskutime duken pak si pa lidhje.

Megjithëse vetë sovjetikët kishin dalë kundër jugosllavëve, siç duket ende jo hapur, pasi nëse kjo do të kishte ndodhur mund të ishte reflektuar edhe në qëndrimet e Partisë Komuniste Shqiptare gjatë këtij Plenumi, por ndoshta në padijenit të asaj që kishte ndodhur, udhëheqja shqiptare vazhdonte, ashtu si edhe në mbledhjet e Byrosë Politike në fund të vitit 1947 dhe fillimin e 1948, të diskutonte për rolin e Nako Spirut në keqësimin apo mosrealizmin siç duhej të marrëdhëniet me jugosllavët.

Pasi vihet në dukje se marrëdhëniet vëllazërore me Jugosllavinë u ndërtuan qysh gjatë luftë dhe se Partia ka për qëllim ta udhëheqë popullin shqiptar drejt ndërtimit të socializmit, sigurisht me ndihmën e Jugosllavisë, thuhet se ishte Nako Spiru që doli kundër kësaj vije, “duke zbatuar një vijë në praktikë, një vijë që shpinte në përçarje dhe shkëputje midis dy vendeve tona. Nako Spiru si armik i Partisë, që ka qenë, ka përdorur çdo mjet dhe çdo mënyrë për të arritur qëllimet e tij”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 224).

E parë në këndvështrimin e kritikave që Bashkimi Sovjetik i kishte bërë Jugosllavisë përse i përket lidhjeve me Jugosllavinë, të shprehura këto në letrat e Zhdanovit apo raportet e të dërguarit sovjetik në Tiranë, Çuvahinit, dërguar në Moskë, qëndrimi i Nako Spirut ndaj Jugosllavisë në mesin e vitit 1947, duket më afër qëndrimit të Bashkimit Sovjetik.

Kritikat sovjetike kishin të bënin me krijimin e një varësie totale të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë e duket se përpjekja e Nako Spirut, qysh në mesin e vitit 1947, për të lehtësuar sadopak këtë varësi jugosllave, sidomos ekonomike, duke kërkuar ndihmën jugosllave për të ndërtuar në Shqipëri industrinë e lehtë që do hiqte një pjesë të konsiderueshme të varësisë ekonomike të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë, ndihmë që Jugosllavia nuk e dha, por e ofroi Bashkimi Sovjetik, e vendos Nako Spirun, të parë tashmë nga largësia e viteve, si të afërt me qëndrimin e Bashkimit Sovjetik për këtë çështje. Sovjetikët kishin kritikuar varësinë e Shqipërisë nga Jugosllavia dhe Nako Spiru kërkoi ta zvogëlonte këtë varësi, por ajo që e dënoi Nako Spirun nuk ishte qëndrimi i tij, i cili në fund të fundit ishte i drejtë, por fakti që marrëdhëniet mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë në mesin e vitit 1947 ishin ende shumë të mira dhe ato nuk mund të prisheshin për hir të varësisë së Shqipërisë ndaj Jugosllavisë.

Ajo që vihet re prej mbledhjeve të Byrosë Politike apo edhe Plenumi të 8-të në shkurtmars të vitit 1948, është se udhëheqja shqiptare, duke përfshirë sigurisht edhe Enver Hoxhën, e kishte të vështirë të shihte çështjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë, në koncepte më të përgjithshme dhe më themelore, por kufizoheshin në diskutime që kishin të bënin me marrëdhëniet e tyre personale me njëri-tjetrin ose me drejtues jugosllavë.

Në kohën kur vetë Bashkimi Sovjetik kishte mbajtur një qëndrim të prerë kundër Jugosllavisë dhe siç u pa dhe më lart, nuk e shihte më Jugosllavinë si pjesë të marrëdhënies që Bashkimi Sovjetik kishte me Shqipërinë, në Shqipëri, në Plenumin e Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare, vazhdohej të flitej me fjalë të ashpra dhe të cilësoheshin si armiq ata që nuk kishin dashur një lidhje pothuajse bashkuese me Jugosllavinë, një lidhje për të cilën edhe Bashkimi Sovjetik kishte dalë kundër, por diskutimet nuk kufizohen vetëm tek etiketimi si armik i Nako Spirut ‘‘që kishte qëllime më ambicioze, qëllime prej armiku’’(Plasari, N. & Malltezi. L. 1996: 224) por gjendeshin edhe lidhje të vjetra, qysh nga koha e luftës kur qysh atëherë ishte dukur pikëpamja e kundërt e njërit apo tjetrit ndaj Jugosllavisë.

Sovjetikët në raportet e Çuvahinit apo letrat e Zhdanovit i kishin gjetur problemet në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave tek dëshira e Jugosllavisë për të patur një ndikim sa më të madh mbi Shqipërinë, ndërsa vetë udhëheqësit shqiptarët, në Plenumin e 8-të, problemet i gjetën më së shumti tek Nako Spiru i cili, sipas tyre ‘‘ka përdorur të gjitha mënyrat, duke hedhur në planin politik të gjitha mungesat e të metat që dilnin gjatë punës së përbashkët me jugosllavët, duke diskredituar kuadrot jugosllavë, duke i akuzuar teknikët jugosllavë si të pazot e sabotatorë e duke i bërë përgjegjës jugosllavët për mosrealizmin e planit tonë’’(Plasari, N. & Malltezi. L. 1996: 226).

Përsa i përket thënies së Nako Spiru ‘‘i kishte hedhur në planin politik të gjitha mungesat e të metat’’ e punës së përbashkët shqiptaro-jugosllave, kjo nuk ishte e vërtetë, pasi në fillim kishin qenë vetë jugosllavët, të cilët siç u vu në dukje disa herë më sipër, kishin tendencën që problemet teknike, problemet që lindnin nga mangësitë praktike, qoftë tek shqiptarët, qoftë tek jugosllavët, kishin prirjen që këto probleme praktike t’i shndërronin në probleme politike, pra, të shihnin politikën kudo dhe më pas udhëheqësit shqiptarë, të shtyrë në këtë linjë, nuk merreshin me problemet e vërteta, por me problemet imagjinare politike që ngrinin jugosllavët dhe në këtë thënie në Plenumin e 8-të, faji për këtë çështje i hidhet Nako Spirut.

Më tej thuhet se ‘‘në të gjithë sektorët, kur dilnin pengesa, Nako Spiru kish futur frymën që të thuhej se fajet i kanë jugosllavët, se kjo ose ajo punë nuk po realizohet, pse s’po na dërgojnë materialin nga Jugosllavia, pse ata kanë material po nuk duan të na i japin etj. Njëkohësisht ai, bashkëpunëtorët dhe njerëzit e influencuar prej tij i



nxisnin sa më shumë mosmarrëveshjet, si ata që i frynë zjarrit; ku do hidhnin parullën që jugosllavët s'janë të zot, e s'bëjnë gjë, por duan të na imponohen dhe, për t'u mbuluar, ngrinin sovjetikët''(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 226).

Edhe në këto fjalë pak ka të vërteta, sepse nuk ishte Nako Spiru që vinte në dukje mangësitë e jugosllavëve, ose më mirë nuk ishte ai i vetmi që e bënte, por disa herë Inspektoriati Financiar gjente problemet teknike si tek shqiptarët dhe tek jugosllavët.

Për të kuptuar sa të painformuar ishin udhëheqësit shqiptarë për ato që kishin ndodhur javët e fundit në marrëdhëniet sovjeto-jugosllave, duket edhe nga fakti që Nako Spiru në Plenumin e 8-të akuzohet se ishin më afër sovjetikëve dhe merret si tipike në këtë qëndrim të tijin ajo ç'ka ai kishte thënë dikur se ''Molotovi di më shumë se Zllatiçi dhe shokët e tij''(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 226), por pak më vonë del se qëndrimi i Nako Spirit s'ka qenë dhe aq shumë pro-sovjetik, pasi në thelb ka qenë ''antisovjetik në esencë, kundër Bashkimit Sovjetik, sepse kjo rrugë e çonte Partinë tonë dhe vendin tonë drejt armikut. Nako Spiru është armik dhe këtë donte''(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 226).

Nga fjalë të tilla mund të kuptohet, se ende, në fundin e muajit shkurt dhe fillimin e marsit të vitit 1948, udhëheqësit shqiptarë ishin nën ndikimin shumë të madh të jugosllavëve, pasi në këtë Plenum të 8-të nuk bëjnë gjë tjetër veçse përsërisin ato që kishin thënë jugosllavët për Nako Spiritun apo edhe të tjerë që sipas tyre ishin kundër marrëdhënieve me Jugosllavinë, sigurisht duket i shtuar edhe çështjet personale.

Thoshin jugosllavët që fajin e ka Nako Spiru dhe udhëheqësit shqiptarë pas tyre kritikonin Nako Spiritun, pastaj thoshin sovjetikët se fajin e kishin jugosllavët dhe Koçi Xoxe dhe të gjithë viheshin në rradhë kush të kritikonte më shumë jugosllavët dhe Koçi Xoxen që nuk kishin pasur sjellje të drejtë. Këto qëndrimi pak a shumë përshkruajnë gjithë marrëdhëniet me jugosllavët gjatë viteve 1947-1948 kur filluan dhe të shfaqen pakënaqësi, të cilat, për ta theksuar edhe një herë, në një masë të madhe kishin burim probleme teknike që zgjidheshin nga teknikë, jo nga mbledhje të Byrosë Politike.

Këto qëndrime konfirmojnë fjalët e sovjetikëve, në vitin 1947, se brenda Partisë Komuniste Shqiptare mbretëron kaosi dhe kështu mënyra më e mirë për ta, por më e keqja për sovjetikët, është që të mbështeten sa më shumë tek jugosllavët aq sa edhe kritikantët për anëtarët e tjerë të Partisë vijnë nga jugosllavët dhe përsëriten nga udhëheqësit shqiptarë, pa patur as në këtë drejtim asgjë origjinale.

Qëndrimi i udhëheqësve shqiptarë në Plenumin e 8-të me fjalët për sabotimet që bënte Nako Spiru tregojnë se ata jo vetëm që ende ishin thellësisht në ndikimin e jugosllavëve, por as nuk kishin fuqi të ndryshonin diçka në këtë drejtim. Nëse Bashkimi Sovjetik nuk do të ishte shqetësuar prej mundësisë së rritjes së fuqisë së Titos në Ballkan duke krijuar një shtet të madh në formën e një Federate Ballkanike, atëherë udhëheqësit shqiptarë vështirë se mund të kishin arritur të ndryshonin diçka në lidhje me marrëdhëniet me Jugosllavinë.

Qëndrimi i Enver Hoxhës në këtë Plenum është pak më i ndryshëm, ashtu siç ka vënë në dukje edhe Milovan Xhilas, qëndrimi i tij është pak më i paqartë. Ai është njeriu i cili merr kritikantët e Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe këto kritika ia paraqet Byrosë Politike “dhe shokët e Partisë...filluan ta zbulojnë çështjen dhe ta goditin problemin në kokë”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 244). Megjithatë edhe vetë Enver Hoxha e kritikon drejtpërdrejt Nako Spirun, në shumë raste ai e paraqet qëndrimin kritikues më shumë si kolektiv, në emër të Byrosë Politike, por edhe ai vetë e ka të vështirë të dalë përtej këndvështrimit jugosllav mbi këto çështje.

Në shumë raste në bisedat me sovjetikët, siç u pa disa herë më sipër, Enver Hoxha vetë kishte kritikuar jugosllavët për rolin e madh që kishin në Shqipëri dhe për faktin që shqiptarët nuk i përfillnin, por në shkurt-mars të vitit 1948, ishte i njëjti person që kritikonte Nako Spirun se kishte bërë ndaj jugosllavëve të njëjtat kritika që edhe vetë Enver Hoxha kishte bërë në bisedat me Çuvahinin apo me sovjetikët në Moskë. Pikërisht ky qëndrim i dyfishtë i Enver Hoxhës kërkon një shpjegim të cilin dokumentet e gjertanishme vështirë se mund ta japin. Është e vështirëbesueshme që Enver Hoxha ta kishte seriozisht në të dy rastet.

Ose Enver Hoxha dinte diçka më shumë se të tjerët në Byronë Politike dhe përpiqet të nxjerrë sa më shumë në pah ata që janë kundër jugosllavëve, për të patur më pas

mundësinë për t'i eliminuar kur të kthehet plotësisht kah Bashkimit Sovjetik, ashtu siç Shqipëria kishte filluar dalëngadalë të kthehej qysh nga fundi i vitit 1947, ose Enver Hoxha ishte po aq i paditur sa të tjerët në këtë çështje dhe shkonte andej nga e çonin jugosllavët.

Në 14 mars, në një mbledhje të Byrosë Politike, megjithëse Bashkimi Sovjetik kishte dalë kundër çdo ideje të një bashkimi të mundshëm mes Shqipërisë me Jugosllavinë duke theksuar nga Stalini në takimin e shkurtit me delegacionin jugosllav se duhej krijuar një Federatë bullgaro-jugosllave dhe kjo ishte më tepër një lëvizje e Stalinit për të kuptuar se sa larg shkonin ambiciet e jugosllavëve në lidhje me bashkimin me shtetet e tjera, në Komitetin Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare, vazhdohet të flitet për çështjen e bashkimit, aq sa Enver Hoxha ankohet pse nuk ka ardhur Savo Zllatiç që t'i informojë më tepër për këtë çështje pasi sipas tij "ne jemi për bashkimin, që ta bëjmë sa më parë" (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 407).

Megjithatë nga fjalët e mëtejshme të Enver Hoxhës duket sikur ai dhe anëtarët e tjerë të Byrosë nuk dinin gjë për ato që kishin ndodhur mes sovjetikëve dhe jugosllavëve. Hoxha thotë se "ka disa kontradiksione të çuditshme në mendimet e këtyre jugosllavëve. Këta na thanë që t'i bënim telegram BS dhe ne i bëmë. Tashti na thonë që çështjen ta vendosim vetë. Këto janë kontradikta. Ata kanë shkuar në Moskë, sigurisht, kanë biseduar për këtë. Nëse duhet të marrim ne iniciativën, për këtë të na thotë Komiteti Central i Jugosllavisë dhe ne ta shtrojmë e ta shpiem çështjen deri në fund" (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 407-408).

Megjithatë Enver Hoxha thotë se ata, duke folur përherë në shumës, kanë qenë gjithmonë pro bashkimit, megjithëse diçka e tillë në fjalët e tij është shfaqur vetëm në fund të vitit 1947 dhe atëherë pas presionit të jugosllavëve që kishin filluar të shqetësoheshin prej shtimit të ndikimit sovjetik në Shqipërisë, ndikim që sigurisht nuk mund të ishte shtuar pa miratimin dhe dijeninë e Enver Hoxhës. "Kjo nuk shtrohet nëse ne jemi për bashkimin...Çështja është e ngritur. Ne punojmë në fakt në baza federale dhe çështja e federatës është një gjë formale, që në rastin oportun ne do ta shpallim. Kjo nuk varet nga ne...Pyetja do t'u bëhet të dyve, Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik" (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 407-408).

Në një mbledhje të Byrosë Politike, një ditë më pas, në 15 mars, shihet se megjithë kundërshtimin e hapur të Stalinit ndaj kërkesës jugosllave për dërgimin e dy divizioneve në Shqipëri, jugosllavët nuk kishin hequr dorë prej kësaj ideje, aq sa udhëheqja shqiptare mbledhet për të diskutuar jo vetëm dërgimin e divizioneve jugosllave por edhe për përforcimin e Ushtrisë Shqiptare, sipas porosive të jugosllavëve, rreth rrezikut të një sulmi grek.

Në 15 mars Enver Hoxha thotë se jugosllavët i kanë këshilluar që të përgatiten si për gjendje lufte dhe pasi vë në dukje gjithë masat që duhen marrë në praktikë, thotë se në fund kjo çështje i duhet dërguar jugosllavëve që ta shikojnë ata, madje se edhe të dy ushtritë, shqiptare dhe jugosllave do të jenë të përziera, mundësisht me një komandë të vetme (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 410). Por, pothuajse 1 muaj pas vizitës së Kardeljit dhe Xhilasit në Moskë ku Stalini kundërshtoi pikërisht çështjen e divizioneve, Gogo Nushi, në mbledhjen e 15 marsit thotë se Xhilasi dhe Kardelji kanë shkuar në Moskë, ndoshta pikërisht për çështjen e divizioneve, gjë që tregon padijëninë e plotë të udhëheqësve shqiptarë mbi atë që ndodhte në marrëdhëniet mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë.

Për këto çështje ishte thirrur dhe Savo Zllatiç, cili megjithatë nuk kishte thënë asgjë të saktë, por kishte përmendur çështjen e Kosovës, shumëmundësisht me dijeninë e Titos, ndoshta për t'i tërhequr shqiptarët më afër Jugosllavisë nga ideja e një bashkimi të mundshëm me shqiptarët e Kosovës. ‘‘Ka ardhur koha që populli shqiptar të grumbullohet’’, kishte thënë Savo Zllatiç (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 411).

Shikohet se jugosllavët ishin të interesuar që këto çështje, e dërgimit të divizioneve, e komandës së përbashkët mes dy ushtrive, etj., të vinin në formë kërkesë nga Shqipëria, ndoshta edhe për shkak të kundërshtimit të Stalinit, i cili, siç u pa dhe më sipër, kishte thënë në takimin e 10 shkurtit se Shqipëria mund të mbrohet nga Jugosllavia vetëm kur ata, shqiptarët, e kërkojnë vetë këtë gjë dhe jo të dërgojë Jugosllavia divizione në Shqipëri.

Pak ditë pas mbledhjes së Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, sovjetikët e kanë marrë tashmë vendimin për të tërhequr nga Jugosllavia gjithë specialistët e tyre, veprim ky që tregon se për Bashkimin Sovjetik

çështja e Jugosllavisë po shkon drejt një konfrontimi final. Për këtë çështje, në 20 mars, Tito i shkruan një letër Molotovit ku i shkruan për vendimin e tërheqjes së specialistëve sovjetikëve nga ushtria por edhe të ekspertëve civilë dhe sipas Titos ky veprim është i pashpjegueshëm dhe kërkon prej sovjetikëve që të shpjegojnë se për çfarë bëhet fjalë ekzaktësisht në këtë çështje pasi sipas tij do të ishte e keqe një gjendje e tillë për marrëdhëniet mes dy shteteve (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 907).

Në përgjigjen dërguar Titos nga Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste Sovjetike, nuk përmenden arsyet e vërteta të problemeve me Jugosllavinë, që më së shumti kishin të bënin me ambiciet e tepruara të jugosllavëve për të dominuar në Ballkan, por përmendet se në udhëheqjen e Jugosllavisë ekzistojnë qëndrime antisovjetike, sidomos të tilla që thonë se në Bashkimin Sovjetik ekziston shovinizmi, që Bashkimi Sovjetik dëshiron të pushtojë ekonomikisht Jugosllavinë, që në Bashkimin Sovjetik socializmi ka pushuar së qeni revolucionar dhe se vetëm Jugosllavia është mbajtësja e socializmit revolucionar (Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 908).

Kritikat që sovjetikët hedhin kundër jugosllavëve ngjajnë në një masë të madhe me ato që vetë jugosllavët kishin hedhur ndaj shqiptarëve dhe që udhëheqja shqiptare i kishte debatuar gjerë e gjatë dhe pothuajse të gjitha i kishte hedhur tek Nako Spiru. Kritika të tilla si ato që kishin të bënin me rritjen e elementëve borgjezë dhe kapitalistë në fshat e qytet dhe ndikimin e tyre brenda Partisë, janë të ngjashme me ato që udhëheqësit jugosllavë i kishin thënë shqiptarëve dhe shqiptarët kishin akuzuar Nako Spirun dhe të tjerë të afërt me të.

Sipas historianëve serbë, një çështje e tillë e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë, të paktën në vitet 1946-1947, nuk ka ekzistuar, përkundër planeve, të shkruara dhe të diskutuara gjerë e gjatë me Bullgarinë për të krijuar një shtet të përbashkët mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë (Zutić, N, 2004: 176). Sipas Branko Petranoviçit, një çështje e tillë e bashkimit mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk është diskutuar as gjatë vizitës që Enver Hoxha realizoi në Beograd në vitin 1946 (Zutić, N, 2004: 176). Një fakt i tillë bën që lëvizja e Titos në fund të vitit 1947 për të krijuar një komision që do të koordinonte bashkimin e dy ekonomive në një, të jetë një lëvizje e sforcuar duke parë shtimin e ndikimit sovjetik në Shqipëri.

Vështirë të mendohet se Tito mund të realizonte bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë pa dëshirën dhe miratimin e Stalinit, ashtu siç nuk mund ta realizonte një gjë të tillë as me Bullgarinë. Me çështjen e bashkimeve mes shteteve të ndryshme ballkanike për të krijuar një Federatë, ekziston një konfuzion i madh dhe roli i udhëheqjes shqiptare në të është edhe më konfuz, gjë që konfirmohet edhe nga qëndrimi i Enver Hoxhës në fund të vitit 1947 kur për herë të parë flet hapur mbi mundësinë e një bashkimi, por edhe atëherë me fjalë konfuz. Për një çështje të tilla, mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk pati asnjëherë diçka konkrete, diçka të ngjashme me marrëveshjet që Bullgaria dhe Jugosllavia nënshkruan me njëra-tjetrën, në të cilat thuhej qartë se të dy vendet synonin të bashkoheshin. Një gjë e tillë me Shqipërinë nuk u bë kurrë, as atëherë kur në fund të vitit 1947 u fol për një bashkim të tillë. Çdo diskutim tjetër, nga historiografia shqiptare për një çështje të tillë është spekulim.

Në 17 mars të vitit 1948, Enver Hoxha i dërgon një letër Titos në të cilën i shkruan se sipas tij është e nevojshme që të ketë një komandë të vetme nëse forcat jugosllave do të vendosen në Shqipëri, ‘‘pse nuk mundet që në një front ku ndodhen dy ushtri, si tonat, të veprojnë kundër të njëjtit armik nën dy komanda të veçanta’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 415). Në letër, përkundër asaj që thonë autorët Plasari dhe Malltezi, nuk përmendet fare bashkimi i Shqipërisë me Jugosllavinë.

Gjithashtu në këtë letër shihet se nuk bëhet fjalë për një bashkim të mundshëm të Ushtrisë Shqiptare me atë Jugosllave, por në rastin e një rreziku grek ndaj Shqipërisë dhe vendosjes së forcave ushtarake jugosllave në jug të Shqipërisë, komanda e ushtrisë duhet të ishte e përbashkët.

Në rezolutën e Plenumit të 8-të, në 27 mars të vitit 1948, konfirmohet përsëri bashkëpunimi i ngushtë me Jugosllavinë, gjë që është ‘‘rruga më e shpejtë, me sigurt dhe e natyrshme, që krijon mundësitë për ndërtimin e socializmit në vendin tonë’’, ashtu siç theksohet bashkimi ekonomik me Jugosllavinë, por nuk përmendet më ndonjë bashkim i ndonjë lloji tjetër(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 426).

Që letrat e dërguara Titos nga Bashkimi Sovjetik kishin vënë në dilemë udhëheqjen jugosllave duket edhe nga fakti që pak ditë pas dërgimit të tyre, në 30 mars të vitit

1948, Enver Hoxha, sigurisht pa dijeninë e letrave, në një mbledhje të Byrosë Politike të Komitetit Qëndror thotë se jugosllavët i kanë thënë se për çështjen e Federatës, duke përfshirë edhe Bullgarinë, nuk është koha e duhur, ashtu siç nuk ishte koha e duhur as për një komandë të përbashkët të forcave ushtarake, gjë që tregon se jugosllavët kishin bërë një hap prapa pas kritikave të sovjetikëve, por Enver Hoxha në mbledhjen e fundmarsit thekson se çështja e Federatës nuk është ngritur nga shqiptarët, por nga jugosllavët dhe bullgarët(AQSH, 14\AP, dosja 70, viti 1948).

Por fakti që jugosllavët kishin bërë një hap prapa, nuk ishte i mjaftueshëm për sovjetikët, të cilët pas dërgimit të letrave Titos, vënë në lëvizje partitë e tjera komuniste në Evropën Lindore që të dalin kundër Titos. Më 8 prill të vitit 1948, është Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste të Hungarisë që kritikon qëndrimin e jugosllavëve ndaj Bashkimit Sovjetik dhe i këshillon jugosllavët të bëjnë një autokritikë të thellë. Në të njëjtën kohë hungarezët bien dakord me ç'ka ishte shkruar në letrat dërguar Titos dhe madje vërejnë se në theniet antisovjetike të udhëheqësve jugosllavë ka elemente trockiste(Dedijer, V. 1980: 388).

Në përgjigjen e Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Jugosllave ndaj letrave dërguar Titos, pasi vihet në dukje toni i rëndë i letrave, bëhen me faj elementë të caktuar brenda Partisë Komuniste Jugosllave të cilët duke i dhënë informacione të gabuara përfaqësuesve sovjetikë në Jugosllavi kanë pasur për qëllim të prishin unitetin e udhëheqjes dhe të Partisë në përgjithësi, por jugosllavët shprehen të çuditur dhe nuk mund të kuptojnë se si sovjetikët nuk kanë folur me njerëz të përgjegjshëm për çështje të tilla. Më tej jugosllavët hedhin poshtë ç'ka është thënë për disa prej udhëheqësve të Jugosllavisë, të cilët sipas letrave ishin shprehur kundër Bashkimit Sovjetik(Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 912-913).

Në të njëjtën kohë, fundi i prillit 1948, Tito i dërgon dy letra Enver Hoxhës, në të cilat ankohet për keqësimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, arsyen e të cilave Tito i sheh tek "mungesa e besimit të duhur nga ana juaj në sinqeritetin e mendimeve tona kundrejt Shqipërisë...Me fjalë nga ana juaj pranohet sakrificat materiale që bën vendi ynë me qëllimet më të mira për të ndihmuar aleatën e vet Shqipërinë, kurse në praktikë veprohet në të kundërtën. Nga të gjitha këto del qartë se ne nuk mund të pranojmë të bëjmë në dobi të Shqipërisë një sakrificë materiale jo të

paktë, në dëm të popullit tonë dhe të mos kemi përmirësime dhe përforcime të marrëdhënieve tona, përkundrazi, marrëdhëniet të keqësohen përsëri jo për fajin tonë”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 467).

Në letër Tito i bën me dije Enver Hoxhës se subvencionimi i ushtrisë shqiptare nëpërmjet buxhetit të Jugosllavisë, tashmë është rrëzuar si ide dhe mund të mendohet në të ardhmen dhënia e një kredie për këtë çështje dhe nëse dëshirohet nga shqiptarët një afrim i vërtetë, ‘‘të rishqyrtojmë bashkëpunimin tonë të mbarë dhe ta vemë atë në një bazë të atillë që do t’i përgjigjet etapës aktuale dhe rrethanave ndërkombëtare’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 468).

Momenti vendimtar në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishte mesi i muajit prill, kur Enver Hoxha mori letrën që Stalini i kishte dërguar Titos dhe ku kritikonte udhëheqjen jugosllave për qëndrimet antisovjetike. Pas këtij momenti, Enver Hoxha do të pozicionohej qartësisht në krah të Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit. Enver Hoxha kishte dashur qysh në fillim të lidhej sa më shumë me Bashkimin Sovjetik dhe Jugosllavia kishte qenë një ndërmjetës në marrëdhëniet mes tij dhe Bashkimit Sovjetik që Enver Hoxha nuk e kishte zgjedhur vetë, por që ishte imponuar prej Bashkimit Sovjetik dhe tashmë ishte përsëri Bashkimi Sovjetik që hiqte nga rruga Jugosllavinë si ndërmjetëse.

Nëse Enver Hoxha do të kishte dashur të bashkonte Shqipërinë me Jugosllavinë, atëherë qëndrimi i tij do të kishte qenë pro jugosllavëve. Nuk mund të thuhet se Enver Hoxha zgjodhi të përkrahë Stalinin me qëllim ruajtjen e pushtetit të tij duke patur parasysh që për jugosllavët Koçi Xoxe ishte një figurë më e pranueshme, sepse Enver Hoxha edhe nëse do të ishte pozicionuar pro jugosllavëve, me siguri do të kishte mbrojtur pushtetin e tij po aq sa e mbrojtë edhe duke u pozicionuar në krah me Stalinin. Por nuk ishte vetëm Enver Hoxha që u pozicionua në krah me Stalinin. Para tij, të njëjtin qëndrim kishin patur edhe bullgarët, hungarezët, polakët, rumunët dhe çekoslllovakët(Боффа, Д. *История Советского Союза, Том 2*, [http://scepsis.net/library/id\\_3197.html](http://scepsis.net/library/id_3197.html)).

Por, edhe jugosllavët megjithë sulmin e Stalinit ndaj tyre, nuk u tërhoqën asnjë hap prapa. Pasi Tito kishte hedhur poshtë si të pavërtetë çdo akuzë të Komitetit Qëndror të



Partisë Komuniste Sovjetike, jugosllavët duket se në vend që të tërhiqeshin, kishin vazhduar me një sjellje edhe më të ftohtë dhe problematike ndaj Bashkimit Sovjetik. Në fund të marsit, gjatë përkujtimit të revoluconit të vitit 1848 në Hungari, Milovan Xhilasi, që ishte përfaqësuesi jugosllav në atë përkujtim, kishte mbajtur, sipas të dërguarit sovjetik, një qëndrim të ftohtë ndaj sovjetikëve(Советский фактор, 1999: 571).

Milovan Xhilasi kishte bërë sikur nuk e kishte vënë re prezencën e sovjetikëve në Hungari, ndërkohë që sipas të dërguarit sovjetik, delegacioni i tyre ishte i rrethuar nga vëmendja e të gjithëve. Jo vetëm kaq, por pak ditë më vonë, gjatë fjalimeve në Parlamentin Hungarez, Xhilasi nuk e kishte përmendur asnjë herë të vetme luftën që Bashkimi Sovjetik kishte bërë kundër Gjermanisë naziste, ashtu siç e përmendën përfaqësuesit e delegacioneve të tjera, por Xhilasi kishte folur vetëm luftën që kishin bërë jugosllavët dhe se si ata me këtë luftë kishin treguar një rrugë të re të luftës dhe të pavarësisë së kombeve(Советский фактор, 1999: 571).

Duket se në fund të marsit, marrëdhëniet e Jugosllavisë me Bashkimin Sovjetik kishin përfunduar. Megjithëse udhëheqja shqiptare pas njohjes së letrës që Stalini i kishte dërguar Titos, kishte mbajtur anën e Bashkimit Sovjetik, në letrat e Titos dërguar Enver Hoxhës nuk duket se ka një përpjekje të jugosllavëve për të tërhequr pas tyre shqiptarët. Në ato letra më së shumti ka një keqardhje për nivelin e marrëdhënieve Shqipëri-Jugosllavi dhe përpjekje përmirësimi, por jo përpjekje për ndryshimin e qëndrimit të Shqipërisë në krahun e Jugosllavisë.

## 6.9 Prishja e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë

Nëpërmjet një letre të 23 majit 1948, Enver Hoxha, edhe në emër të Politbyrosë së Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare, i paraqet Titos qëndrimin e udhëheqjes shqiptare ndaj gjithë kritikave që ai kishte shfaqur në letrat e mëparshme dërguar në Shqipëri. “Byroja Politika e KC të PKSH nuk pajtohet me pikëpamjet dhe konkluzionet e arritura nga KC i PKJ se marrëdhëniet në mes dy vendeve tona kanë filluar në kohët e fundit të keqësohen për fajin tonë...Një akuzë e tillë e paargumentuar edhe pa baza nuk pranohet nga ana jonë. Mendimi ynë është se çdo gjë vërteton të kundërtën e asaj që akuzohemi”.

Pasi vë në dukje besimin e madh dhe dashurinë vëllazërore që populli shqiptar ka ndaj popujve të Jugosllavisë, Enver Hoxha thekson se “të akuzohet Partia jonë dhe udhëheqja e saj pas këtij realiteti të madh që ata me sakrifica, me gjak, me vetëmohim, me një ndërgjegjetë pastër komuniste e ndërjuan, është kryekëput e papranueshme nga ana jonë”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 490-491).

“Me bindjen dhe me besimin më të madh, Partia jonë i pranoi pikëpamjet tuaja për vendosjen e marrëdhënieve të rregullta në mes dy vendeve tona. As më i vogli objeksion nuk u bë nga ana jonë. Partia jonë, pranoi me bindjen dhe me besimin më të madh të gjitha format, pikëpamjet, këshillimet etj., tuaja se si këto marrëveshje të zbatoheshin në jetë. Partia jonë, me bindje dhe besimin më të madh te Partia Komuniste Jugosllave pranoi në mënyrë të padiskutueshme, gjë që s’është shumë objektive dhe jashtë principeve marksiste-leniniste, për më tepër se një herë, kritika të ashpra dhe të bëra në mënyrë verbale nga ana e Komitetit Central të PKJ kundër Partisë sonë, udhëheqjes së saj dhe njerëzve të Partisë sone. Një gjë e tillë nuk vërteton ekzistencën e mosbesimit nga ana jonë, por të kundërtën”(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 490-491).

Më tej Enver Hoxha vë në dukje seriozitetin me të cilën udhëheqja shqiptare i ka shqyrtuar të gjitha propozimet dhe kërkesat e jugosllavëve, por e pranon se në këto marrëdhënie me Jugosllavinë, ka pasur brenda shumë idealizëm, për shkak edhe të faktit që në të dy anët e kufirit në pushtet ishin Parti Komuniste dhe ato nuk mund t’ia kishin me të hedhur njëra-tjetrës. Enver Hoxha hedh poshtë gjithë kritikën e

jugosllavëve, por nuk i akuzon ata për ndonjë gjë konkrete, madje shkruan se ‘‘në asnjë moment ne nuk e kemi harruar dhe nuk do ta harrojmë përgjegjësinë historike që kemi për forcimin e marrëdhënieve sa më të ngushta, sa më vëllazërore, të sinqerta dhe komuniste në mes popujve dhe partive tona’’(Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 490-491).

‘‘Marrëdhëniet me popujt e Jugosllavisë dhe me Partinë motër jugosllave janë të shenjta për udhëheqjen tonë. Për këto marrëdhënie kemi luftuar dhe do të luftojmë, që të jeni më të forta, më vëllazërore. Ne jemi gati të rishqyrtojmë të gjitha punët tona të përbashkëta dhe atje ku s’janë drejt t’i vemë drejt, atje ku ka gabime t’i ndreqim dhe marrëdhëniet tona të ecin kurdoherë përpara, për lumturinë e popujve tanë’’, (Plasari, N. & Malltezi. L 1996: 496) e mbyll letrën e tij Enver Hoxha duke mos e mbyllur derën për një rigjallërim të marrëdhënieve me Jugosllavinë. Në letrën e Enver Hoxhës nuk ka një prishje të plotë të marrëdhënieve me Jugosllavinë, por vetëm një hedhje poshtë të kritikave të tyre, duke rikonfirmuar dëshirën për marrëdhënie të përzemërta. Jo vetëm në këtë letër, por edhe gjer nga mesi i muajit qershor, qeveria shqiptare nuk ka marrë ende një qëndrim përfundimtar për këtë çështje, domethënë nuk ka ndodhur një prishje e plotë e marrëdhënieve. Ishte lënë e hapur mundësia që marrëdhëniet mund të rregullohesin, që problemet të zgjidheshin. Një qëndrim i tillë ka qenë edhe nga jugosllavët, të cilët gjer nga mesi i qershorit mendonin akoma për afrimin më të madh me Shqipërinë, (Pavlovec, S. J. 2009: 297-306), të njëjtën gjë që kishte theksuar dhe Tito në letrat dërguar Enver Hoxhës.

Ishte konferenca e Informbyrosë, mbajtur në datat 19-23 qershor, në Bukuresht, që ndryshoi plotësisht marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Pas kësaj konference nuk kishte më mundësi, veçanërisht nga ana e shqiptarëve, për të rregulluar marrëdhëniet me Jugosllavinë. Pas Bukureshtit kishte prishje totale të marrëdhënieve. Në këtë konferencë, megjithëse jugosllavët ishin lajmëruar në 19 qershor për të marrë pjesë, (Dedijer, V. 1979: 295), ata nuk kishin shkuar.

Konferenca e Bukureshtit doli me një rezolutë për situatën me Jugosllavinë, në të cilën viheshin në dukje se me politikën e saj antisovjetike dhe kundër parimeve të marksizëm-leninizmit, udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave është vendosur kundër partive të tjera dhe është ndarë nga fronti i përbashkët socialist kundër

imperializmit dhe ka kaluar në qëndrime nacionaliste(Pavlovec, S. J. 2009: 297-306). Vetë jugosllavët, në 29 qershor e hodhën poshtë rezolutën e mbledhjes së Bukureshtit si të bazuar në thënie të pabazuara dhe ka për qëllim të prishë imazhin e Partisë Komuniste Jugosllave brenda dhe jashtë vendit. Vetë sovjetikët, sipas jugosllavëve, nuk pranuan dhe nuk arritën të vërtetonin thëniet e tyre në letrat e majit(Pisma CK KPJ i pisma CK SKP, 1948: 297-306).

Vladimir Dedijeri thotë se Titua qëndroi 3 orë vetëm në dhomën e tij duke lëvizur nga njëri cep i saj në tjetrin dhe se kjo rezolutë e mbledhjes së Bukureshtit e shqetësoi shumë(Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 933-934). Tito i kishte thënë Dedijerit se nuk i kishte ardhur keq pse kishin këputur lidhjet me Kremlinin, por se për shkak të kësaj çështjeje kishte ndodhur një goditje ndaj revolucionit në Jugosllavi. ‘‘Revolucioni ynë u mbyt’’, kishte thënë Tito, ‘‘në emër të BRSS’’(Petranović. B, & Zečević. M, 1988: 933-934).

Rezoluta u botua menjëherë në gazetën *Borba* në 500 mijë kopje. Në njoftimin e Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Jugosllave mbi rezolutën e Bukureshtit thuhet se në rezolutë u akuzua Jugosllavia për politikë armiqësore ndaj Bashkimit Sovjetik, por pa treguar asnjë fakt. Njoftimi gjithashtu hedh poshtë thëniet se në Jugosllavia nuk janë trajtuar mirë specialistët jugosllavë dhe përsëriten të njëjtat gjëra që u shkruan edhe në letrat dërguar në Bashkimin Sovjetik duke hedhur poshtë çdo kritikë të Bashkimit Sovjetik(Pisma CK KPJ i pisma CK SKP, 1948: 29-30).

Shqipëria ishte e para që e mbështeti rezolutën e Informbyrosë, në fund të qershorit 1948(Pavlovec, S. J. 2009: 297-306). Disa ditë më vonë, udhëheqja shqiptare e akuzoi qeverinë jugosllave për marrëdhënie armiqësore dhe koloniale, një akuzë që do të përsëritet shpesh në vitet dhe dekadat e mëpashme nga udhëheqja shqiptare. ‘‘Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste Shqiptare, njëzëri miratoi rezolutën e Informbyrosë, me protestë të madhe e gjykoi politikën antisovjetike dhe antimarksiste të udhëheqjes së Partisë Komuniste Jugosllave’’, dhe se udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave është kthyer drejt një rruge trockisto-menshevike dhe nacional-borgjeze(Pavlovec, S. J. 2009: 297-306).

Rezoluta ‘‘Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave’’ është marrë në shqyrtim nga Komiteti Qëndror i Partisë Komuniste Shqiptare, në një mbledhje të jashtëzakonshme të tij. Komiteti Qëndror thotë se solidarizohet plotësisht me Rezolucionin e Byrosë Informativë të partive komuniste Mbi gjendjen në Partinë h ç? ??æ??g?-gosllave dhe dënon rreptësisht tradhëtinë e hapët të udhëheqësve të Partisë Komuniste Jugosllave, të cilët kanë tradhëtuar marksizmin-leninizmin, kanë tradhëtuar kampin e socializmit dhe janë në luftë të hapët dhe të pandershme me atdheun e lavdishëm të socializmit, me Partinë e lavdishme të Lenin-Stalinit, me kampin demokratik dhe antiimperialist. Udhëheqësit e Partisë Komuniste g çë????I tradhëtarë, trockistë, kanë tradhëtuar kauzën e shenjtë të popullit heroik dhe vëllat jugosllav, të cilin kërkojnë ta çojnë në rrugën e greminës (Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste Pranë KQ të PPSH, 1970: 475).

Në një takim me Molotovin, në Varshavë, në qershor 1948, Enver Hoxha i thotë Ministrin të Jashtëm të Bashkimit Sovjetik se letra e Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Sovjetike ‘‘e shpëtoi Shqipërinë nga një rrezik i madh. Shqipëria dhe shqiptarët u kërcënuan seriozisht si rezultat i veprimeve të kuadrove udhëheqëse jugosllave’’ (Minxhozi, Y. 2002: 41). Pasi miratimit të fjalëve të tij nga Molotovi, Enver Hoxha vazhdon duke i thënë se ‘‘Udhëheqësit e PK të Shqipërisë i besuan plotësisht KQ të PK Jugosllave dhe veçanërisht Titos. Ata ishin të bindur se kjo është në përputhje me porositë e KQ të PK (b) të Bashkimit Sovjetik’’

Ky qëndrim i Hoxhës nuk është sa për sy e faqe, për t’i treguar sovjetikëve se shqiptarët kanë qenë gjithmonë me Bashkimin Sovjetik dhe se mendonin se edhe jugosllavët në veprimet e tyre kundrejt Shqipërisë kishin miratimin e Bashkimit Sovjetik. Ky është një qëndrim i vërtetë. Në rastin e kërkesës jugosllave për baza vendosjen e dy divizioneve në Shqipëri, shqiptarët i kishin thënë sovjetikëve se ata mendonin që kjo lëvizje kishte miratimin e Bashkimit Sovjetik.

Pas konferencës së Bukureshtit dhe denoncimit përfundimtar të Jugosllavisë, edhe qeveria shqiptare brenda Shqipërisë fillon të ndërmarrë veprime që synojnë të shkëputin çdo lidhje me Jugosllavinë. Në fund të qershorit, qeveria shqiptare vendos të marrë në dorëzim të gjitha shoqëritë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave.

Në 1 korrik të vitit 1948, Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë i dërgoi dy letra përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë në të cilat shkruhej se të gjithë ekspertët dhe punëtorët jugosllavë që gjendeshin në Shqipëri duhet të largoheshin brenda 48 orëve dhe në të njëjtën kohë Shqipëria hiqte dorë nga çdo marrëveshje ekonomike që kishte nënshkruar me Jugosllavinë(Slavković, B. 2012: 139).

Në një relacion në lidhje me dorëzimin e shoqërive shqiptaro-jugosllave thuhet se “kur komisioni shkoi për të marrë në dorëzim shoqërinë e vajgut, elementi jugosllav rezistoi duke thënë se neve nuk kemi udhër nga qeveria e jonë, gjith-ashtu nuk nënshkruan as proces-verbalin e dorëzimit dhe për këtë u thirr gjyqtari dhe ata u larguan. Pjerin Shllaku që ishte anëtar i komisionit në zyrën e kryellogaritarit jugosllav të quajtur Nikolla Igumenoviç pa të varur fotografinë e Titos, të cilën e hoqi dhe e grisi. Jugosllavi s’foli as gjë, vetëm uli kokën.

Për shoqërinë e metaleve, kur komisioni ish duke marrë dorëzimin në këtë shoqëri, vjen Presidenti i Shoqërisë që është dhe antar i Komisionit të Koordinimit Jugosllav, Pavlej Jeliç, i cili i kishte dhënë urdhër nëndrejtorit që të mos dorëzonte asgjë. Është shoqëri jugosllave, nuk mund të merrni asgjë, duhet urdhër nga të dy qeveritë. Nëndrejtori rezistoi për të hequr fotografitë e Titos duke thënë se vetëm me zor mund të hiqen”. Më pas të dërguarit shqiptarë ngrisen nga një fotografi të Titos në prezencën e jugosllavëve(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948).

“Tek shoqëria e import-eksportit janë gjetur çrregullime të mëdha dhe s’dihet se ku është njëra, se ku është tjetra. Elementi jugosllav ka qenë i lajmëruar nga Legata më parë se të bëhej komunikimi i byrosë informative, kështu që janë tërhequr dokumenta nga zyrat ku punonin siç vërtetohet edhe në hekurudhën durrës-tiranë, por se çfarë nuk dihet, mbasi dorëzimi është marrë në përgjithësi”(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948).

Sipas relacionit, jugosllavët nuk ishin krejtësisht të papërgatitur për veprime të tilla nga ana e qeverisë shqiptare. Kjo shpjegon edhe faktit që në shumicën e rasteve nuk ka pasur ndonjë kundërshtim prej tyre, por vetëm mosbashkëpunim, si pasojë e faktit që veprimet janë vetëm nga ana e qeverisë shqiptare, pa miratimin e jugosllavëve.

Në 29 qershor edhe shoqëria e ndërtimit të hekurudhave ka marrë njoftim që të ndalojë punimet për ndërtimin e hekurudhës Shkodër-kufi dhe gjithashtu të ndalojë kërkimet për ndërtimin e hekurudhës Shkodër-Tropojë dhe Kufi-Kukës-Kufi. Më 30 qershor i është komunikuar drejtorit të shoqërisë për naftën, Mevoldit, se sipas urdhrit të Ministrisë së Industrisë së Shqipërisë, të ndalohet dërgimi i naftës dhe bitumit për në Jugosllavi. Më datë 30 qershor urdhërohet shoqëria shqiptaro-jugosllave për naftën dhe shoqëria mikse për minierat që deri në një urdhër të dytë të ndalojë çdo dërgim për Jugosllavi, duke përfshirë kështu edhe stoqet e rezervat në limanin e Durrësit dhe Vlorës(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948).

Puna në portet shqiptare me ngarkim shkarkimin e anijeve jugosllave prej dita ditës ka ardhur duke u ashpërsuar. Në muajin maj ka qenë norma mesatare ditore 863 ton me 270 punëtorë dhe 117 automjete, ndërsa në qershor në 621 ton. “Keqësimi i ngarkim shkarkimit është bërë me qëllim”, thuhet në shkresën e Ministrisë së Jashtme, “që të bëhet i pamundshëm bashkëpunimi ekonomik jugosllavo-shqiptar”(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948).

Në 2 korrik të vitit 1948, Ministria e Jashtme Jugosllave i ka dërguar një notë qeverisë shqiptare ku shprehet e çuditur prej veprimeve të fundit të qershorit ku nga qeveria shqiptare janë marrë në dorëzim shoqëritë e përbashkëta dhe janë ndalur dërgesat për në Jugosllavi. Jugosllavët thonë se për Shqipërinë në 2 vitet e fundit kanë dhënë thjesht një ndihmë ekonomike, ndërkohë që Shqipëria asnjëherë nuk ka dërguar në Jugosllavi një vlerë të njëjtë mallrash dhe shërbimesh, duke lënë të kuptohet sipas jugosllavëve se ata në këtë marrëdhënie ekonomike më shumë kanë dalë të humbur dhe s’kanë fituar asgjë, as ato që kanë investuar(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948).

Në përgjigjen e qeverisë shqiptare ndaj letrës së jugosllavëve, dërguar pak ditë më vonë, hidhen poshtë të gjitha supozimet e jugosllavëve. Ministria e jashtme e Shqipërisë njofton Legatën e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë se jugosllavët dëshirojnë të ngarkojnë me përgjegjësi qeverinë shqiptare për çështje që në të vërtetë bien direkt në përgjegjësinë e qeverisë jugosllave.

Qeveria jugosllave, sipas letrës dërguar Legatës Jugosllave në Tiranë, ‘‘ka ndjekur qëllime të caktuara ndaj shtetit shqiptar dhe nuk i plotësoi asnjëherë angazhimet e mara ndaj shqipërisë ashtu siç përcaktoheshin me akordet dhe protokollet e lidhura mes dy vendeve’’(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948, fq 52-53). Gjithashtu i bëhet me dije legatës jugosllave për masat që qeveria shqiptare ka marrë për ndalimin e punimeve në hekurudhë dhe ndalimin e dërgimit të naftës dhe bitumit në jugosllavi.

Thuhet se ‘‘argumentacionet e paraqitura nga të cilat ministria e jashtme e republikës federative të jugosllavisë nxjerr si konkluzion se pengesat e ndodhura janë bërë me qëllim nga qeveria shqiptare janë aq të rreme sa dhe qesharake sa që na bën të themi se nuk përbajnë gjë tjetër në vet vehte përveç qëllimit të keq për të goditur qeverinë shqiptare me argumente të cilat janë të mohuara nga vetë faktet, pse qeveria jugosllave duhet të jetë e mirë informuar nga njerëzit e saj të ish ndërrmarjes import-eksport si shefi i seksionit transportit jugosllav gotin...të cilët kanë njohur vështirësit që kanë hasur organet shqiptare të transportit nga çrregullimet e shkaktuara nga ana e transportit maritim jugosllav dhe këto vërtetohet në letrën e impeksit të 5 korrikut.

Mjetet lundruese jugosllave nuk kanë sjellë mallin normalisht në kohët e caktuara. Organet e transportit maritim jugosllav nuk kanë paralajmëruar nisjen e anijeve sipas marrëveshjes. Pse organet e mësipërme nuk kanë kontraktuar me ish shoqërin import eksport në Shqipëri për kohën që do të nevojiteshin për qëndrimin e anijes për t’u bërë shkarkimi materialit, por kanë përcaktuar ato vetë kohën pa marrë parasysh kapacitetit e shkarkimit të moleve shqiptare.

Pse ngarkesat e materialit të destinuar për shqipëri që janë bere në mjetet lundruese të ardhura nga jugosllavia kanë qenë të tilla të çrregulluara sikurse eshte vertetuar ne vaporin tusla sa që nuk kanë lejuar përmirësimin e normës së shkarkimit por përkundrazi kanë sjellë vonesa në shkarkim’’(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948, fq 52-53).

Duke u bazuar në sa mësipër qeveria shqiptare hedh poshtë konkluzionin e gabuar në të cilin ka mbërritur qeveria jugosllave, ‘‘të nxjerrë nga pretendimet e saja se gjoja qeveria shqiptare paska shkel në mënyrë të vrazhët e të pa kuptuarshme angazhimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Ministria e jashtme e Republikës Popullore të



Shqipërisë përsërit edhe një herë se është qeveria jugoslave ajo që vetëm i ka shkel në mënyrë të vrazhtet e plotësisht të pakupëtueshme raste normale të angazhimeve dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe marrëveshjet në fuqi, por me gënjeshtër mundohet të mohojë këtë akt brutal duke dash të ngarkojë me përgjegjësi qeverinë shqiptare, akt që ka dëmtuar rëndë ekonominë e vendit tonë”(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948, fq 52-53).

Qeveria shqiptare shpreh çudinë e saj me thëniet e jugosllavëve se kanë ndihmuar Shqipërinë pa marrë asgjë në kthim. “Thënie këto që janë të bazuara vetëm në teori por me praktikë nuk janë zbatuar kurrë prej qeveris jugoslave ndërsa qeveria shqiptare ka plotësuar pjesën më të madhe të angazhimeve të saja ndaj Jugosllavisë... akte të tilla të qeveris republik federat të jugosll ndaj vendit t’onë pse sot duken kjartazi qëllimet për të cilat ka vepruar në atë mënyrë qeveria e republikës federat të jugosll ndaj shtetit shqiptar”(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948, fq 52-53).

Ministria e Jashtme bën me faj qeverinë jugoslave për veprimet që u ndërmorrën ne 29-30 qershor “sa kohë që qeveria jugoslave është shkaktare që të krijohen marrëdhëniet të tilla midis dy vendeve mike dhe ajo vetë ka shkelur parimet e bashkëpunimit të zakonshëm ndërkombëtar”(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948, fq 52-53).

Në korrik të vitit 1948, Legatës në Beograd, në emër të Hysni Kapos i shkruajnë se jugosllavët tashmë kanë filluar duke kryer akte dhune ndaj shtetasve shqiptarë në Jugosllavi, “ndaj studentave, shegerta, oficerat, etj.”. Përmendet rasti i arrestimit të një studenti, Sadik Kumbaro, si dhe dëbimi nga spitali i të sëmurëve shqiptarë. Për këtë arsye kërkohet që Legata të marrë një informacion sa më të plotë(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948, fq 52-53).

Kërkohet që “t’u vihet si detyrë që të mos na kalojë as një rast pa e marrë vesh”. Gjithashtu kërkohet që të ngarkohet “posaçërisht një shok të Legatës që të shikojë me kujdes korrespondencën (radiograme sidomos, por edhe shkresa) të dërguara veçanërisht nga Komisioni i Planit...të cilat bëjnë fjalë mi kërkesat urgjente që jugosllavët ishin angazhuar t’i bënin dhe nuk i kryen”. Për shkak edhe të letrës që qeveria jugoslave kishte dërguar në Shqipëri, ku argumentohej se pala shqiptare nuk

kishte dërguar asgjë në Jugosllavi, Legatës shqiptare në Beograd i kërkohet shikimi i radiogrameve të Komisionit të Planit, ‘‘që t’u nxjerrim në shesh’’(AMPJ, Jugosllavia, dosja 180, viti 1948, fq 52-53).

Në 23 korrik, në një raport dërguar Legatës shqiptare në Romë, bëhet një shpjegim i veprimeve të fundit në marrëdhëniet me Jugosllavinë. ‘‘nga ngjarjet e fundit në Jugosllavi kemi çkëputur lidhjet dhe deri më sot as gjë nuk dërguar nga të dy anët. Qysh më datën 29 qershor 1948 kryeministria me qarkore të posaçme urdhëroi që të hiqet nga zyrat dhe vitrinat fotografia e Titos për arsye të qëndrimit të tij dhe Qeverisë së tij anti-shqiptar, anti-sovjetik dhe anti-marxist. Në udhëzimet që iu dërguam Legatave iu theshim që kontaktet me përfaqësitë jugosllave të jenë të kufizuara dhe të kenë karakterin e korektesës e të kurtuazisë dhe jo për punë. Sa herë të jetë nevoja për punë dhe për këshillime duhet të jetë bashkëpunimi me përfaqësitë e Bashkimit Sovjetik dhe në mendimin e tyre të mbështeten’’.

‘‘Politika e udhëheqjes të Partisë Komuniste Jugosllave dhe e Qeverisë Jugosllave ka qenë një politikë shfrytëzimi; anti-shqiptare dhe koloniale karshi vendit t’onë. Natyrisht që edhe marrëdhëniet t’ona u ftohën dhe u keqësuan me një herë mbas Rezolucionit dhe Komunikatës të Partisë t’onë....Qeveria t’onë, me aprovimin e Presidiumit, denoncoi të gjitha marrëveshjet ekonomike të nënshkruara me Jugosllavinë. Këto marrëveshje nuk kanë qenë me baza komuniste por me baza kapitaliste dhe koloniale. Qeveria t’onë urdhëroi njëkohësisht largimin më një herë të të gjithë teknikëve, specialistëve, profesorëve dhe mësuesve si dhe nënpunësve të sektorëve të ndryshme të ekonomisë dhe arësimit të vendit t’onë të ardhur nga Jugosllavia’’(AMPJ, Jugosllavia, dosja 10, viti 1948).

Duke iu referuar letrës që Enver Hoxha i kishte dërguar Titos në fund të majit por edhe pozicionimi i Shqipërisë në krah të Bashkimit Sovjetik në mosmarrëveshjen mes Titos dhe Stalinit thuhet se ‘‘Mbas komunikatës t’onë qëndrimi jugosllav ndaj Shqipërisë u bë dita ditës shumë armiqësor dhe provokatif duke bërë çpifje dhe ofeza me anë të radios dhe të shtypit dhe me nota zyrtare për të cilat Qeveria Shqiptare iu përgjegj duke ia hedhur syve të gjitha gënjeshttrat dhe çpifjet’’(AMPJ, Jugosllavia, dosja 10, viti 1948).

‘‘Antarët e Partisë flasin me simpathi për udhëheqjen e Partisë t’onë që u rezistoi me trimëri presioneve dhe shantazheve të Komitetit Central të P.K Jugosllave dhe janë solidarë me qëndrimin e drejtë të Partisë t’onë karshi tradhëtisë të udhëheqësve jugosllavë. Për shembull përfaqësues të Italisë kanë bërë sondazhe pranë përfaqësuesve t’onë duke lënë haptazi të kuptohet që Italia tani është në gjendje të fillojë me Shqipërinë marrëdhënie politike dhe ekonomike. Sigurisht që ky është një gjest që i shërben vetëm imperializmit. Marrëdhëniet t’ona me Italinë janë prej kohësh të precizuara dhe s’ka nevojë për koment gjesti i mësipërm’’(AMPJ, Jugosllavia, dosja 10, viti 1948).

Presidiumi i Kuvendit Popullor në mbledhjen e datës 30 qershor 1948 i ka denoncuar të gjitha akordet ekonomike me Jugosllavinë, me përjashtim të traktatit të miqësisë dhe ndihmës reciproke e datës 9 korrik të vitit 1946. Në një raport të vitit 1949 në gjuhën frënge të qeverisë shqiptare thuhet se sipas të drejtës ndërkombëtare, nëse një akord është dhunuar (violé) nga një prej palëve kontraktuese dhe që nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara nga ky akord, pala tjetër ka të drejtë ta konsiderojë si të rrëzuar këtë akord dhe ta konsiderojë veten si të çliruar prej të gjitha detyrimeve që vijnë prej atij akordi. Denoncimi i jugosllavëve, në 3 korrik ndaj marrëveshjeve, si të prishura në mënyrë unilaterale, brutale dhe kundër interesave të Jugosllavisë, sipas raportit, është diçka e panjohur dhe që nuk gjendet askund dhe që është në kundërshtim me zhvillimin historik të marrëdhënieve ndërkombëtare(AMPJ, Jugosllavia, dosja 182, drejtorja IV, viti 1948).

Në një mbledhje të Këshillit të Ministrave të 30 qershorit 1948 Enver Hoxha tha se ‘‘politika e tyre (e jugosllavëve. *Shënim i autorit*) ka qënë armiqësore dhe anti-shqiptare. Ata me pretekstin e një kredije kanë dashur të zhdukin independencën e vëndit tonë, të bëjnë një politikë koloniale, shfrytëzimi, të zhdukin independencën tonë politike dhe ekonomike. Akordi i nënshkruar në 1946 ne mendojmë se është në rrugën e drejtë. Protokollet e tjera që erdhën pas tij dhe marrëveshjet kanë pasur qëllime antishqiptare.

Ne kemi pasur besim te Qeveria Jugosllave dhe populli Jugosllav, kemi kujtuar se janë në rrugë të drejtë, se ndërtohet socializmi, mbasi në krye janë Partitë Komuniste.

Kjo ka qenë bindja e miqësisë sonë. Mirëpo nuk kanë menduar kështu udhëheqësit Jugosllavë. Vendi ynë s'mund të ngrihej pa ndihmën e një aleati dhe ky aleat i natyrshëm qe Jugosllavia, e cila do të na jepte një kredi''(AQSH, Fondi 890, viti 1948, dosja 48, fq 1-5).

Më tej Enver Hoxha thotë se krijimi i shoqërive të përbashkëta shqiptaro-jugosllave ka qenë me qëllim të mirë për zhvillimin e ekonomisë mes dy vendeve, të paktën nga ana e shqiptarëve. ''Mirëpo këto shoqëri s'vepruan kështu, ato akaparuan mallrat tona dhe nuk lejon të shkonin hiçgjëkund tjetër, veç Jugosllavisë dhe bënin çmos që ne të mos lidheshim me shtetet e tjera, si me Bashkimin Sovjetik....Ata kanë dashur në shoqëri të thoshin fjalën vetëm ata... në këto shoqëri ka pasur grindje midis nesh. Ata në mënyrë kërcënimi e shantazhi donin të impononin vullnetin e tyre....Ata na nxirrnin vështirësi e pengesa të vazhdueshme për këto gjëra''(AQSH, Fondi 890, viti 1948, dosja 48, fq 1-5).

Enver Hoxha thotë se jugosllavët dëshironin të impononin vullnetin e tyre mbi Shqipërinë, një akuzë që Hoxha e kishte parashtruar edhe para sovjetikëve në takimet me ta, qysh në vitin 1947. ''Kudrot tona ishin të bindura dhe punonin me ndërgjegje..'', thotë Enver Hoxha në mbledhjen e 30 qershorit, por sipas tij gjendja ishte acaruar shumë 4-5 muajt e fundit. ''Metoda e tyre është flagrante, imperialiste, fyese dhe kërcënuese që s'mund të durohej'', vazhdon Hoxha, ''këta karshi meje kanë përdorur shantazhe, kur politika jonë u orientua nga Moska. Por donin që vendi ynë të bashkohej me Jugosllavinë. Ata donin të unifikohesh ushtria etj., etj. Ne këto s'i kemi pranuar, por i kemi hedhur poshtë''(AQSH, Fondi 890, viti 1948, dosja 48, fq 1-5).

Enver Hoxha vlerëson rolin e Bashkimit Sovjetik si shpëtimtar të popullit shqiptar nga një katastrofë dhe në këtë mbledhje për herë të parë thotë se marrëdhëniet me Jugosllavinë kanë përfunduar. ''Pra, unë propozoj që të denoncohen të gjitha marrëdhënjet e protokollat që kemi me Jugosllavinë dhe njëkohësisht të gjithë jugosllavët që janë në zyrat tona shtetërore të largohen brënda 48 orëve nga vendi ynë. Po si do të bëjmë për ndërtimin e vëndit? Do të na ndihmojnë në radhë të parë Bashkimi Sovjetik dhe Demokracitë Popullore....Në fakt marrëdhëniet me

jugosllavinë më shumë na kanë penguar në ekonominë tonë se sa na kanë ndihmuar’’(AQSH, Fondi 890, viti 1948, dosja 48, fq 1-5).

Qeveria jugosllave i hodhi poshtë fjalët e Enver Hoxhës dhe motivin pse u prishën marrëveshjet ekonomike mes dy vendeve. Sipas jugosllavëve, marrëdhëniet ekonomike kishin shkuar në favor të Shqipërisë në masën 81.5% ndërsa vetëm 18.5% në favor të Jugosllavisë, ndërsa qeveria shqiptare u përgjigj duke thënë se gjatë vitit 1948, Shqipëria kishte përmbushur 74.02% të detyrimeve të saj sipas marrëveshjeve ekonomike, ndërkohë që Jugosllavia kishte përmbushur vetëm 13%(AQSH, Fondi 890, viti 1948, dosja 48, fq 1-5).

Në 2 korrik 1948 ministria e jashtme jugosllave proteston për ndërprerjen e punimeve në hekurudhat Shkodër-kufi dhe Shkodër-Tropojë. Gjithashtu proteston për urdhrin e dhënë nga ministria e industrisë për ndërprerjen e transportimit të naftës bitumit, këto i quan akte për të demtuar floten detare jugosllave. Në 3 korrik gjithashtu qeveria jugosllave akuzon qeverinë shqiptare për sa i përket marrëveshjes për bashkimin doganor dhe barazimin e monedhave. Në 2 korrik proteston për mbylljen e librarisë jugosllave në Tiranë, për heqjen e fotografisë së Titos nga të gjitha zyrat e shoqërive jugosllave-shqiptare, dhe për ofendimet që u janë bërë jugosllavëve duke u thënë se Titua është tradhtar. Këtu thekson se qeveria jugosllave do të marrë të gjitha masat eventuale për ndalimin e këtyre veprimeve të cilat kanë për qëllim të dëmtojnë seriozisht raportet reciproke miqësore, në rast të kundërt qeveria jugosllave nuk e quan përgjegjëse veten për pasojat që mund të rrjedhin(AMPJ, Jugosllavia, dosja 167, drejtoria IV, viti 1948).

Një muaj e gjysmë më vonë, në 26 gusht, Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Jugosllavisë njofton se ka larguar nxënësit ushtarake shqiptarë në Zagreb ‘‘për arsye të qëndrimit të tyre hapur armiqësor’’. Në 7 shtator qeveria jugosllave vendos të mos marrë fare parasysh gjithë notat e qeverisë shqiptare dhe të legatës shqiptare në Beograd, për shkak të ofendimeve të rënda, dhe shpifjeve drejtuar organeve jugosllave, të cilët theksojnë se qeveria shqiptare vazhdon prapë që të drejtojë nota të tilla të cilat kanë për qëllim për mospasjen e marrëdhënieve normale(AMPJ, Jugosllavia, dosja 167, drejtoria IV, viti 1948).

Në një radiogram të 12 gushtit 1948, Hysni Kapo nga Beogradi lajmëron se ‘marrëdhëniet me Jugosllavinë janë ashpërsuar shumë. Këto ditë kanë arrestuar një student shqiptar dhe zbuar jashtë Jugosllavisë. Kanë nxjerrë jashtë sanatoriumit dy shokë të sëmurë rëndë me turbekuloz’ (AMPJ, Jugosllavia, dosja 167, drejtoria IV, viti 1948). Për shkak të një sjelljeje të tillë nga ana e autoriteteve jugosllave, gjer në shtator të vitit 1948 shumica e shtetasve shqiptarë që gjendeshin në Jugosllavi janë kthyer në Shqipëri. Shumica e tyre ishin studentë, kursistë dhe ushtarakë (AMPJ, Jugosllavia, dosja 167, drejtoria IV, viti 1948).

Jo vetëm kaq, por sipas raporteve të qeverisë shqiptare, shtetasit shqiptarë në Jugosllavi janë ndjekur dhe përgjuar vazhdimisht nga agjentët e UDB-së, të cilët pasi janë zbuar nga Jugosllavia, autoritetet jugosllave kanë refuzuar t’iu japin vizë për të kaluar në Shqipëri, kështu që janë detyruar të kalojnë disa ditë nëpër rrugët e Beogradit, ‘shpeshherë janë lënë pa bukë dhe janë detyruar të flenë në rrugë’, (AMPJ, Jugosllavia, dosja 167, drejtoria IV, viti 1948), thuhet në raport.

Ka pasur edhe raste keqtrajtimesh. Një shembull është kur një prej personave që po riatdhesoheshin nga Australia, është keqtrajtuar nga autoritetet jugosllave dhe për shkak edhe të shëndetit të tij të dobët, ka humbur jetën (AMPJ, Jugosllavia, dosja 167, drejtoria IV, viti 1948). Në tetor të vitit 1948, Legata shqiptare në Beograd i bën me dije Ministrisë së Jashtme se i ka kërkuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë të kthejë motorat e aeroplanëve të Ministrisë së Shëndetësisë, por jugosllavët kanë refuzuar duke thënë se nuk kanë garanci nga qeveria shqiptare për pasuritë jugosllave në Shqipëri (AMPJ, Jugosllavia, dosja 181, drejtoria IV, viti 1948).

Kishte gjithashtu dhe disa pajisje të tjera të dërguara në Jugosllavi nga Shqipëria që nuk ishin kthyer, disa sonda shpimi të naftës të cilat ishin dërguar në Rijeka të Kroacisë si dhe një pompë për shfrytëzimin e puseve të naftës që ishte marrë nga jugosllavët qysh në vitin 1947 (AMPJ, Jugosllavia, dosja 181, drejtoria IV, viti 1948).

Agjencia jugosllave e lajmeve, Tanjug, në 1 korrik 1948 lajmëron se ‘në Shqipëri janë zhvilluar...një varg incidentesh të organizuara, që ofendojnë popujt e Jugosllavisë, shtetin e Jugosllavisë dhe udhëheqësit e saj. Është mbyllur ‘Libri Jugosllav’ dhe është ndaluar shitja e gazetës *Borba*’. Tanjug gjithashtu lajmëron se

Ministria e Punëve të Brendshme në Shqipëri ka udhëruar shkollat që nga librat të hiqen tekstet që kanë të bëjnë me Titon, të ndalohen këngët për Titon dhe në provime të mos bëhen pyetje për Titon(AMPJ, Jugosllavia, dosja 181, drejtorja IV, viti 1948).

Gjithashtu pas prishjes së marrëdhënieve ekonomike, jugosllavët nuk kanë kthyer anijen ‘‘Borova’’, ashtu si nuk kanë lejuar reparacionet gjermane të kalojnë nga Jugosllavia për në Shqipëri(AMPJ, Jugosllavia, dosja 181, drejtorja IV, viti 1948). Pati raste kur akuzat e ndërsjellta mes qeverive shqiptare dhe jugosllave, u bënë dhe absurde. Një rast i tillë është kur qeveria jugosllave akuzon atë shqiptare se në qytetin e Shkodrës, një familjeje jugosllave, në një farmaci i ishte refuzuar dhënia e një aspirine, apo një rast tjetër kur thuhet se një ndihmës i një ministri të qeverisë shqiptare i ka ndaluar një inxhnieri jugosllav të shkojë në tualet nga ora 7 deri në orën 14(Pavlovec, S. J. 2009: 297-306).

Nga shtypi jugosllav, Enver Hoxha u cilësua si agjenti sovjetik në qeverinë shqiptare dhe se në veri të Shqipërisë pati thirrje për luftë kundër qeverisë shqiptare me ndihmën e jugosllavëve(Pavlovec, S. J. 2009: 297-306).

Qëndrimi përfundimtar i qeverisë shqiptare ndaj marrëdhënieve me Jugosllavinë ishte në Plenumin e XI-të të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare, në shtator të vitit 1948. Në këtë Plenum jo vetëm që u analizuan marrëdhëniet e fundit me Jugosllavinë por u kritikua dhe qëndrimi në Plenumin e VIII-të, këtë pikë më të zezë të historisë së Partisë sonë, siç e ka quajtur shoku Enver Hoxha, plenum ky që adoptoi një vijë politike dhe ekonomike krejtësisht të gabuar, antishqiptare dhe anti- sovjetike, ku u shkelën rëndë parimet marksiste-leniniste të ndërtimit dhe të jetës së Partisë, ku u goditën pa të drejtë shumë shokë besnikë e të vendosur për çështjen e Partisë dhe ku Partia u fut në një rrugë të shtrembër antimarksiste (Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste Pranë KQ të PPSH, 1970: 478)

Duke analizuar marrëdhënjet e Partisë dhe të shtetit tonë me ato të partisë dhe të RFPJ. Plenumi XI i KQ të Partisë nga analiza e thellë e këtyre marrëdhënjeve nxori fare qartë qëllimet e vërteta antimarksiste, antishqiptare dhe naciona?-shoviniste të revizionistëve jugosllavë që do- nin ta kthenin vendin tonë në një republikë të shtatë të Jugosllavisë. Një vëmendje të veçantë Plenumi XI i KQ të Partisë i kushtoi ana-

lizës së vijës organizative të Partisë nga ku doli se nën ndikimin dhe me ndërhyrjen direkte të revizionistëve jugosllavë ishin bërë shtrembërime dhe gabime shuinë të rënda, për të cilat përgjegjësia binte mbi Koçi Xoxen, ish-sekretar organizativ, që ishte dhe përçues i vijës jugo- sllave në vendin tonë.

Plenumi XI i KQ të Partisë u dha fund gjithë këtyre shtrembëri- meve dhe gabimeve në vijën politike dhe organizative të Partisë. Ai shënoi fillimin e një kthese me rëndësi të madhe në jetën e Partisë sonë. Plenumi ripohoi qëndrimin e patundur për të ndjekur edhe në të ardhshmen politikën e miqësisë dhe të bashkëpunimit të ngushtë e vëllazëror me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë Bolshevike dhe gjithë lëvizjen revolucionare punëtore demokratike dhe antiimperialiste në bo-të. Ai shtroi para Partisë detyrën që të studjohej përvoja e ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik dhe të zbatohet ajo në mënyrë krijuese në kushtet e Shqipërisë (Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste Pranë KQ të PPSH, 1970: 478).

Një herë, Stalini i kishte thënë shqiptarëve se sa të lëvizte gishtin ai dhe do mbaronte Titua, do fluturonte. “Por me shokun Tito nuk ngjau ashtu. Sado që lëvizi Stalini jo vetëm gjishtin, por edhe çdo gjë që pati mundësi, Titua nuk fluturoi. Pse? Sepse në grindjen me shokët Jugosllavë, me Titon ishte shteti, ishte populli që kishte kaluar shkollën e ashpër të luftës për lirinë dhe pavarësinë e vet, popull që i përkrahu udhëheqësit e vet” (AQSH, fondi 14, MPKBS, viti 1956, dosja 3, fq. 64).



## **Kreu VII. Konkluzione**

Qëllimi i këtij punimi ka qenë që në shumë pika të hedhë një vështrim të ri dhe të riinterpretojë marrëdhëniet e komplikuar mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948. Tre vjet është një kohë e shkurtër për të ndërtuar një marrëdhënie intensive mes dy shteteve dhe siç është treguar në faqet e mësipërme të këtij punimi, në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave pati shumë plane të mëdha por pak realizime në praktikë të tyre, qoftë për shkak të kohës, por mbi të gjitha për shkak të problemeve në këto marrëdhënie, për shkak të këndvështrimit të ndryshëm që kishin dy palët për mënyrën se si marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë duhet të zhvilloheshin.

Në këtë punim është argumentuar se zgjedhja e Jugosllavisë si partner i “parë” dhe më i rëndësishmi i Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore nuk ishte plotësisht vullnet i udhëheqjes shqiptare. Takimet mes Stalinit dhe Titos tregojnë se shqiptarët dëshiron me ngulm të shkonin në Moskë në fillim pastaj në Beograd, ndërkohë që udhëheqësi sovjetik ngulmonte për të kundërtën. Më së shumti ishte një zgjedhje e Bashkimit Sovjetik që përcaktoi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Ashtu si telegramet e të dërguarit jugosllav në Tiranë, Josip Xherxhës, tregojnë se shqiptarët nuk ishin plotësisht të bindur për një marrëdhënie të ngushtë me Jugosllavinë. Xherxha raportton shumë herë se kishte dyshime për këto marrëdhënie.

Për udhëheqjen shqiptare kishte një rëndësi të madhe ruajtja e sovranitetit territorial të Shqipërisë si dhe zhvillimi ekonomik i saj. Vazhdimisht në mbledhje të Kuvendit Popullor flitet për një këndvështrim të ri të zhvillimit ekonomik në krahasim me marrëdhëniet që Shqipëria kishte pasur me Italinë në vitet 30-të. Ky këndvështrimi i ri kishte të bënte me faktin që udhëheqja shqiptare nuk dëshironte që Shqipëria të bëhej një shtojcë ekonomike e Jugosllavisë, duke krijuar varësi prej saj, siç kishte ndodhur me Italinë, por Shqipëria, sipas udhëheqjes shqiptare, duhet të zhvillonte industrinë vendase, duhet të prodhonte vetë shumicën e gjërave që i nevojiteshin dhe në këtë pikë është ngulmuar shumë herë në marrëdhëniet ekonomike me Jugosllavinë.

Marrëveshjet që u nënshkruan mes dy vendeve përse i përket ekonomisë duhen parë në këtë drejtim, të paktën nga pala shqiptare, si një mënyrë për të forcuar pavarësinë e Shqipërisë, këtë rradhë edhe ekonomike. Marrëveshjet mes dy vendeve parashikonin

bashkimin e doganave, koordinimin e planeve ekonomike, që në këndvështrimin jugosllav do të thoshte që Jugosllavia do të diktonte planin ekonomik të Shqipërisë, por siç është vënë në dukje në punim, ky qëndrim nuk ishte i pranueshëm nga udhëheqja shqiptare, gjithashtu dhe përbashkimin e monedhave.

Në punim është treguar se marrëveshje të tilla të Jugosllavisë nuk ishin ekskluzive me Shqipërinë, por u nënshkruan edhe me shtete të tjera, siç është Bullgaria. Por, mund të thuhet se në të dyja raste, por sidomos në atë të Shqipërisë, pak prej atyre që ishin parashikuar në marrëveshjet u realizua në praktikë. Ajo që u realizua në tre vitet e miqësisë ishin disa vepra të mëdha infrastrukturore si hekurudha, centrale elektrike, fabrika, të cilat u ndërtuan me ndihmën e madhe të Jugosllavisë në ekspertizë teknike dhe financime. Gjithashtu nëpërmjet shoqërisë së përbashkët të Import-Eksportit u shtua shumë volumi tregtar mes dy vendeve, por jo aq sa ishte parashikuar në marrëveshjet e bëra.

Ekonomia zë një vend të rëndësishëm në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të kësaj periudhe, pasi udhëheqja shqiptare e shihte zhvillimin ekonomik të vendit nëpërmjet ndihmës së Jugosllavisë si një pjesë shumë të rëndësishme të pavarësisë së Shqipërisë. Në këndvështrimin e tyre nuk duhet të ndodhte më ai nënshkrim ekonomik që ndodhi në marrëdhëniet e Shqipërisë me Italinë në vitet 30-të, pasi një nënshtrim ekonomik është hapi i parë i nënshtrimit politik.

Por jo vetëm pavarësia ekonomike ishte e rëndësishme, por edhe tërësia territoriale e Shqipërisë dhe çështja e kufirit greko-shqiptare në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore ishte shumë e rëndësishme, një problem për të cilin qëndrimi i Jugosllavisë në krahun e Shqipërisë dhe e Bashkimit Sovjetik pas Jugosllavisë, përcaktoi kufijnjtë e Shqipërisë pas Luftës.

Ideja e një Federate Ballkanike mes Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë nuk ishte në krye një ide as e shqiptarëve, as e jugosllavëve dhe as e bullgarëve, por një ide e ardhur nga Bashkimi Sovjetik, madje si ide është hedhur qysh në vitet 30-të, kur në krye të Kominternit ishte një bullgari Dimitrov, i cili u bë udhëheqës i Bullgarisë pas Luftës së Dytë Botërore, por që nga takimet mes udhëheqësit jugosllav Tito dhe atij sovjetik Stalin kuptohet se i pari e shihte me dyshim një gjë të tillë, ndërsa me

dokumentat e deritanishme është e pamundur të kuptohet se pse Stalini e dëshironte diçka të tillë. Ndoshta për Stalinin një ide e tillë ishte një mundësi për të kontrolluar më mirë rajonin, por kjo mbetet vetëm në nivelin e spekulimit.

Jugosllavia dhe Bullgaria bënë hapa konkretë drejt krijimit të një federate, gjë që do të bashkonte vërtet të gjithë sllavët e jugut në një shtet. Marrëveshjet mes tyre e shënojnë të zezë mbi të bardhë që synimi është krijimi i një shteti të përbashkët. Diçka e tillë në marrëdhëniet e Jugosllavisë me Shqipërinë nuk ndodhi. Të paktën me gjendjen e sotme të dokumentave nuk del që në ndonjë marrëveshje të dy vendeve të jetë shkruar ashtu si në rastin e Bullgarisë, që Jugosllavia dhe Shqipëria kishin synim të bashkoheshin në një shtet.

Një synim i tillë do të ishte i çuditshëm dhe jologjik në krahasim me veprimet e udhëheqjes shqiptare, e cila ishte shumë e shqetësuar për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë dhe forcimit të pavarësisë ekonomike të vendit. Në këto kushte, një synim i bashkimit me Jugosllavinë në një shtet të vetëm duke i humbur të dyja këto, duket i paarsyeshëm nga udhëheqja shqiptare. Jugosllavia fillonte të diskutonte diçka të tillë, vetëm në kohën kur marrëdhëniet mes dy vendeve po përkeqësoheshin dhe një bashkim i mundshëm duket si një kamardare shpëtimi nga ana e Jugosllavëve, por që nuk dukej të ishte plotësisht serioze pasi ajo asnjëherë nuk erdhi nga udhëheqja e Jugosllavisë dhe për më tepër një diskutim i tillë duket si formë presioni.

Në momentet e fundit të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, edhe Enver Hoxha filloi të fliste në terma të mjegullt për një bashkim të tillë, por interpretimi i këtij qëndrimi duket i vështirë, pasi një bashkim i tillë për Enver Hoxhën do të thoshte humbje e pushtetit dhe një ecje drejt rrugës së bashkimit duket e paarsyeshme. Dokumentat e tanishme nuk na lejojnë të kuptojmë se sa i afërt ishte Enver Hoxha me sovjetikët në momentet e fundit të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Ndoshta një qëndrimi i tillë i Enver Hoxhës ishte një kurth për të shtyrë më tej Jugosllavinë drejt përplasjes me Bashkimin Sovjetik.

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave nuk duken aq idilike sa historiografia shqiptare postkomuniste i ka përshkruar. Qenia e Partive Komuniste në pushtet në të dyja

vendet dhe afërsia ideologjike mes tyre, nuk e ka ndaluar aspak Enver Hoxhën të kritikojë dhe të ankohet për jugosllavët tek Bashkimi Sovjetik si dhe të kërkojë ndihmën e Bashkimit Sovjetik. Enver Hoxha dhe udhëheqja shqiptare dëshironte zhvillim të industrisë vendase dhe për këtë kërkonte ndihmë nga Jugosllavia, por që jugosllavët nuk pranonin ta jepnin dhe ky ishte një ndër problemet e këtyre marrëdhënieve për të cilin Enver Hoxha u ankua tek përfaqësuesi sovjetik në Tiranë por edhe gjatë vizitës së tij në Moskë, dhe Hoxha kërkoi nga Bashkimi Sovjetik atë që Jugosllavia nuk e jepte: ndihmë për një pavarësi ekonomike të Shqipërisë.

Për këtë arsye marrëdhëniet ekonomike janë thelbësore për të kuptuar zhvillimin dhe prishjen e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948. Enver Hoxha dhe udhëheqja shqiptare e dinte mirë se varësia ekonomie çonte në varësi politike dhe kjo ishte ajo së cilës udhëheqja shqiptare përpiqej t'i shmangej. Ky problem bëhej më shqetësues për faktin se Jugosllavia ishte në kufi me Shqipërinë dhe një varësi ekonomike e më pas politike mund të çonte në 7 prillin e vitit 1939 me Italinë, ndërkohë që Bashkimi Sovjetik ishte larg dhe ndoshta për këtë arsye ishte i gatshëm të jepte atë që Jugosllavia nuk dëshironte.

Në sjelljen e Jugosllavisë ndaj Shqipërisë shikohet një tendencë për të krijuar varësi ekonomike, por jo një tendencë drejt bashkimit të dy vendeve në një. Siç u tha më lart, bashkimi për jugosllavët u paraqit si një mundësi e fundit për të shpëtuar diçka që tashmë po mbaronte dhe s'kishte rrugëdalje tjetër veç një qëndrimi kaq të fortë. Marrëveshjet e nënshkruara mes të dy vendeve, që shpesh janë interpretuar si një rrugë drejt bashkimit, ishin konsultuar më parë me Bashkimin Sovjetik. Enver Hoxha është konsultuar me përfaqësuesin sovjetik në Tiranë para se të nënshkruante marrëveshjet me Jugosllavinë, ndërkohë që në krahun tjetër jugosllavët kanë marrë miratimin e sovjetikëve për brendësinë e marrëveshjeve me Shqipërinë.

Në këtë situatë, nuk mund të akuzosh as udhëheqjen shqiptare se synonte të bashkonte Shqipërinë me Jugosllavinë, as atë jugosllave se po çonte në një aneksim të Shqipërisë, pasi çdo hap është bërë në konsultim dhe miratim të plotë me Bashkimin Sovjetik.

Çështja e Kosovës ishte një çështje pak e pranishme në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948. Gjatë viteve të luftës, jugosllavët në diskutimet me britanikët në Kajro të Egjiptit kishin hedhur mundësinë e dhënies së Kosovës Shqipërisë pas përfundimit të luftës, por diçka e tillë kurrë nuk shkoi përtej formulimeve jo zyrtare. Për këtë çështje nuk pati asgjë konkrete dhe Kushtetuta e Federatës së Jugosllavisë e vitit 1946 e sanksionoi Kosovën si pjesë të Serbisë dhe diskutimet e mëtejshme për ndryshime kufinjsh ishin të kota.

Enver Hoxha për çështjen e Kosovës kishte një këndvështrim bazuar mbi ideologjinë e përbashkët të partive në pushtet në Shqipëri dhe Jugosllavi. Meqë të dy vendet drejtoheshin nga parti komuniste, nuk mund të ekzistonte më një qëndrim armiqësor që kishte qenë më parë përsa i përket Kosovës dhe marrëveshjet mes dy vendeve që synonin krijimin e një tregu të përbashkët, bashkim doganash etj., bënë që kufiri mes shqiptarëve në Shqipëri dhe në Jugosllavi të mos ekzistonte më.

Nga dokumentat e deritanishme dimë se në takimin me Titon Enver Hoxha e kishte paraqitur në mënyrë të pasaktë, sipas jugosllavëve, çështjen e Kosovës, por nuk mund të thuhet se çfarë nënkuptonin jugosllavët me këtë mënyrë të pasaktë. Në këtë punim është mbajtur qëndrimi se Kushtetuta e vitit 1946 mbylli çdo shteg për ndryshim kufinjsh për Kosovën.

Prishja e marrëdhënieve mes dy vendeve nuk ishte e befasishme dhe e menjëhershme. Hija e Bashkimit Sovjetik qëndronte vazhdimisht pas këtyre marrëdhënieve, veçanërisht pas vitit 1946 dhe ishte Shqipëria ajo që herëpashere e nxirrte Bashkimin Sovjetik nga hija për të kritikuar Jugosllavinë dhe për këtë kërkuar nga Bashkimi Sovjetik atë që nuk e jepte Jugosllavia. Acarimi i marrëdhënieve mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik, që lidhej pjesërisht me Shqipërinë, e bëri afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, që ishte dhe synimi fillestar i udhëheqjes shqiptare, më të lehtë për t'u arritur.

Edhe pa problemet sovjeto-jugosllave, shohim se kishte një lëvizje të ngadaltë të udhëheqjes shqiptare drejt Bashkimit Sovjetik, veçanërisht për arsye ekonomike. Një lëvizje e tillë mund të shihet brenda kuadrit të teorisë realiste të marrëdhënieve ndërkombëtare. Ideologjia e përbashkët nuk e ndaloi Enver Hoxhën të lëvizte nga

Jugosllavia drejt Bashkimit Sovjetik dhe një lëvizje e tillë ka nisur më herët se viti 1948. Një lëvizje e tillë shpjegohet me interesin kombëtar: bërjen e Shqipërisë ekonomikisht të pavarur, gjë që Jugosllavia nuk e mundësonte, por edhe ruajtja e pushtetit personal pasi një varësi ekonomike nga një vend fqinj dhe kufitar me Shqipërinë mund të çonte në varësi politike dhe humbje të pushtetit.

Edhe nëse nuk do të kishte ndodhur prishja e marrëdhënieve mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, me shumë mundësi udhëheqja shqiptare do të kishte vazhduar të shkëputej dalëngadalë nga Jugosllavia.

Në thelb, mosmarrëveshjet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë kishin lidhje me çështje ekonomike, por që shndërroheshin në politike. Çdo problem i natyrës ekonomike që krijohet mes dy vendeve, shndërrohet, veçanërisht nga Jugosllavia në një problem politik, interpretohet si mosdëshirë për bashkëpunim me Jugosllavinë, përpjekje për të sabotuar punën e përbashkët etj. Në shumë raste, edhe udhëheqja shqiptare i shkonte pas këtyre pretendimeve jugosllave duke u përpjekur të gjente fajtorë imagjinarë.

Në fund, çfarë fitoi Shqipëria nga bashkëpunimi i ngushtë tre vjeçar me Jugosllavinë? Në planin ekonomik pati një zhvillim të vogël pas shkatërrimeve të mëdha të Luftës së Dytë Botërore si dhe u hodhën disa hapa për të krijuar një industri vendase, por këto hapa u hodhën pas ndërhyrjes së Bashkimit Sovjetik. Shumë prej atyre që parashikoheshin të realizoheshin në marrëveshjet e nënshkruara, nuk u realizuan dhe historia përfundoi duke akuzuar njëri-tjetrin për sasinë e mallrave që njëri kishte dërguar tek tjetri. Në këtë këndvështrim, duket se Jugosllavia kishte marrë përsipër një detyrë që nuk kishte potencialin ta përmbushte në njërën anë dhe që nuk duket se dëshironte ta bënte nga ana tjetër.

Në planin politik, marrëdhënia me Jugosllavinë krijoi një varësi të madhe të udhëheqjes shqiptare ndaj jugosllavëve, një varësi që udhëheqja shqiptare dhe sidomos Enver Hoxha përpiquej të shkëputej.

Kundrejt të dyja këtyre zhvillimeve: ekonomike dhe politike, Enver Hoxha u përpoq t'iu largohej duke gjetur shpëtim tek Bashkimi Sovjetik.

## **Bibliografia**

### **Arkiva**

AQSH – Arkivi Qëndror i Shtetit, Tiranë

AMPJ – Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Tiranë

ACKSKJ – Arhiv Centralnog Komiteta Saveza Komunističa Jugoslavije, Beograd

AJ – Arhiv Jugoslavije, Beograd

### **Libra dhe Artikuj**

Applebaum, A. *Iron Curtain: The Crushing of Eastern Europe*, Allen Lane 2012

Banac, I. *With Stalin against Tito*, Cornell University Press 1988

Боффа, Д. *История Советского Союза, Том 2. От Отечественной войны до положения второй мировой державы. Сталин и Хрущев. 1941 — 1964 гг.*, [http://sceptis.net/library/id\\_3197.html](http://sceptis.net/library/id_3197.html)

Dedijer, V. *Novi prilozi za biografiju Josipa Broz Tito, vol. III*, Beograd 1982

Dedijer, V. *Dokumenti 1948, vol.I*, Beograd 1979

Dokumenti o spoljnoj politici SFRJ, 1946 I, Beograd 1985

Dokumenti o spoljnoj politici SFRJ, 1946 II, Beograd 1985

Gaćeša, N. L. *Privredni odnosi Jugoslavije i Albanije 1945-1948, "Stanovništvo slovenskog porijekla u Albaniji"* - Zbornik radova sa međunarodnog naučnog skupa održanog na Cetinju 21, 22. i 23. juna 1990. Godine, [https://www.rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda\\_1.php](https://www.rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/ngacesa-privreda_1.php)

Gibianskii ,L. *The Soviet Bloc and the Initial Stage of the Cold War: Archival Documents on Stalin's Meetings with Communist Leaders of Yugoslavia and*

*Bulgaria, 1946-1948.* COLD WAR INTERNATIONAL HISTORY PROJECT  
BULLETIN 10

Glenny, M. *The Balkans 1804-2012*, Granta Books 2012

Gjilas, M. *Fytyra e Totalitarizmit*, Tiranë 2006.

Hoxha, E. *Titistët*, Tiranë 1982

Hoxha, E. *Me Stalinin*, Tiranë 1979

Judah, T. *Kosovo: What Everyone needs to know*, Oxford University Press, 2008

Đurić, L. *Sećanja na ljude i događaje*, Beograd 1989

Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste Pranë KQ të PPSH, *Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare*, vol. I, Tiranë 1976

Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste Pranë KQ të PPSH, *Dokumenta Kryesore të Partisë së Punës së Shqipërisë*, vol. II, Tiranë 1976

Kaba, H. & Çeku, E. *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946-1962*, Prishtinë 2011

Kaba, H. *Dështimi i përpjekjeve të qeverisë shqiptare për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA*. Studime historike, 3-4\2005

Kardelj E. *Sećanja*, Ljubljana 1980

Komatina, M. *Enver Hodža i jugoslovensko-albanski odnosi*, Beograd, 1995

Kissinger, H. *Diplomacy*, New York 1994

Lynch, A. *The Soviet Study of International Relations*, London 2012



Maclean, F. *The Heretic*, Harper 1957

Marović, B. *Međudržavni ugovori zaključeni između Jugoslavije i Albanije 1946. Godine*. "Stanovništvo slovenskog porijekla u Albaniji" - Zbornik radova sa međunarodnog naučnog skupa održanog na Cetinju 21, 22. i 23. juna 1990. Godine, [https://www.rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/bmarovic-ugovori\\_1.php](https://www.rastko.rs/rastko-al/zbornik1990/bmarovic-ugovori_1.php)

МИЛИВОЈЕВИЋ, С, *Комунистички концепт аутономије Косова и Метохије, Баштина, бр. 20, стр. 161-176, Београд*

Миронин, С. *Реабилитација Сталина*, Журнал «Золотой Лев» № 77-78, [http://www.zlev.ru/77\\_44.htm](http://www.zlev.ru/77_44.htm)

Minxhozi, Y. *Letër e panjohur e Enver Hoxhës mbi Kosovën, Dokumenta të Arkivave Ruse*, Tiranë 2002

Morgenthau, H. *Politika ndërmjet kombeve*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare 2008

Nasi, L. *Ripushtimi i Kosovës* Tiranë, 1994

O'Donnel, J.S *A Coming of Age. Albania Under Enver Hoxha*, East European Monographs, 1999

Olson, W. C., & Groom, A. J. R. *International relations then and now: origins and trends in interpretation*. London 1991

Pavlovec, S. J. *Albanski siže u razvitku sovjetsko-jugoslovenskog konflikta i kriza jugoslovensko-albanskih odnosa (mart 1948-septembar 1948)*, ПОЛИТИЧКА РЕВИЈА POLITICAL REVIEW, 1\2009, fq. 297-306

Pearson, O. *Albania in the Twentieth Century*, volume III, London 2006

Perovi, J. *The Tito-Stalin Split: A Reassessment in Light of New Evidence*, Journal of Cold War Studies, volume 9, numer 2, Spring 2007, fq. 32-63

Pettifer, J. *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Onufri, 2013

Petranović, B. *Istorija Jugoslavije, knjiga III. Socialistička Jugoslavija*, <http://www.znaci.net/00001/95.htm>

Petranović, B. *Zapisnici sa sednica Politbiroa Centralnog Komiteta KPJ (11 jun 1945 – 7 jul 1948)*, Beograd 1995

Petranović, B. & Zečević, M. *Jugoslavija 1918-1988 Tematska zbirka dokumenata. Socialistička Jugoslavija 1945-1988*, <http://www.znaci.net/00001/138.htm>

Pisma CK KPJ i pisma CK SKP(b), Beograd, 1948.

Plasari, N. & Malltezi, L. *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948 Dokumente, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave*, 1996.

Pllumi, Z. *Rrno vetëm për me tregue*, Tiranë 2001

Ristović, M. *Trumanova doktrina, Grčka i Jugoslovenske Reakcije (1947-1949)*, Tokovi Istorije, 1-2\2008

Skëndi, Stavro, *Albania within the Slav Orbit: Advent to Power of the Communist Party*, Political Science Quarterly, Vol. 63, No. 2 (Jun., 1948), pp. 257-274

Stavrianos, *The Balkans since 1453*, New York University Press, 2000

Советский фактор в Восточной Европе. Т. 1. (1944—1948), документы, Москва 1999

těpánek, V. *Jugoslavie – Srbsko – Kosovo: Kosovská otázka ve 20. století*, Brno 2011

Tismaneanu, Vladimir (edit) *Stalinism Revisited, The Establishment of Communist regimes in East-Central Europe*, Central European University Press, 2009

Tempo, S.V. *Revolucija koja teče, Memoari, knjiga 1*, Beograd 1971

VojnoIstoriskiInstitut, *Zbornikdokumenataipodataka o narodnooslobodilačkomratunarodajugoslavije, tom 8, knjiga 1*, Beograd 1969

Zivotić, A. *PitanjeAlbanije u OdnosimaJugoslavijeiZapada 1945-1947*, Istorija 20.veka 2010, vol. 28, br. 3

Zivotić, A, *Jugoslavijaijačanjesovjetskoguticanja u Albaniji (1947-1948)*, TokoviIstorije 3\2009,

Zivotic, A. *Jugoslavija, AlbanijaiVelikeSile, Arhipelag*, Beograd 2011

Zivotić, A. *Otvaranjealbanskogpitanja u Jugoslaviji u sencisukobaizmeđuJugoslavijeiInformbiro-a 1948-1954*, Istorija 20.Veka 2\2009

Zutić, N. *Josip Broz, engleziipitanjepredajeKosmetaAlbaniji*, Istorija 20.Veka 2\2004

Waltz, K. *Man, the State and War*, Columbia University Press 2001

Wilson, D. *Tito's Yugoslavia*, Cambridge University Press 1979